

Hazyr Dervishi

KODI
Prilli i ditës së dytë

Botues :

SHOQATA I INTELEKTUALËVE JAKOVA- Gjakovë

Korrektor:

Autori

Radhitja kompjuterike:

Agim Jaka

Kopetrina:

Fetah Krypa

Dizajni:

Salih Imeri

Realizimi kompjuterik

“Kibernetika”- Gjakovë

*POPULLI MUND TA HAJË VETVETEN VETËM KUR
ÇELET KODI I TIJ.*

KODI HEBRAIK (HEBRE)

Pasuesit e vërtetë të profetëve hebraikë kanë qenë studiuesit e madhej – Rabinët, por askush nga ata nuk shquhet sa themeluesi i Diasporës hebraike – Rabi Jochanan ben Sakai . Kur luftëtarët hebre vendosën në vitin 70 pas Krishtit të hyjnë në luftë kundër Romës shumë më të fuqishme dhe vendosën të vdesin të gjithë, Rabi Jochanan ben Sakai e bëri një tradhti. Ai, tok me 30 nxënësit e vet të San Hredinit u arratis nga Jerusalemi; u dorëzua tek gjenerali roman dhe i kërkoi atij liqensën e krijimit të Universitetit Hebre dikund në diasporë. Kjo u bë ruajtje e traditës së pasur hebraike dhe në të njejtën kohë humbje e çdo gjëje që hebrenjve u kishte tepruar: shtetin, religjionin, tempullin, burokracinë priftërore dhe ushtarake, kafshët e tyre të shenjta dhe të gjitha ritet... (Erih From)

Hebrenjtë, në vitin 70 pas Jezusit e kishin të sigurtë humbjen e luftës kundër Romes Perandorake. Rabi Jochanan ben Sakai e shqyrtoi thellë gënjeshtren e përrallës biblike të fitores së Davidit xhuxh mbi Goliatin gjigant.

Rabi Jochanan ben Sakai e shpëtoi kodin hebraik përmes Universitetit hebre në Diasporë plot një mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e tetë vjet derisa Amerika e hapi kodin hebraik në vitin një mijë e nëntëqind e dyzet e tetë, kur e bëri shtetin e Izraelit.

Sikur Amerika ta kishte bërë një gabim: ta kishte hapur kodin Izraelit vetëm duke e krijuar shtetin hebre pa e mbrojtur nga vetvetja hebreje, pa e mbrojtur nga arabët, atëherë puna e Rabi Jochanan ben Sakai do të kishte vajtur kot, krejt kot,

kundruall deklaratës së përbotshme të Gamal Abdel Naserit në vitin një mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e shtatë:

“Arabët , brenda dhjetë ditësh me fshesë të hekurt do ta hedhin në det Izraelin”

sipas Gamal Abdel Naserit këtë vitë duhej të vdiste kodi i Izraelit.

Sipas Amerikës, Kodi hebre i Rabi Jochanan ben Sakai duhej të jetonte.

KODI AMERIKAN (SHBA)

Në vitin një mijë e qashtëqind e tetëmbëdhjetë anëtarët e një grupi protestantësh angloirlandezësh, me anijen Mayflower u arratisën nga Anglia drejtë Virgjinisë.

Në anije ishin njëqind veta.

Pesëdhjetë veta vdiqën rrugës.

Era e rrëmbyeshme e nxori anijen në bregun e shkretë të Masaqusetit.

Angloirlandezët protestant u shkëputen nga tradita konzervative e Evropës, nga të gjitha rregullat e shtetit të Nikolla Makiavellit. Një mijë vjet angloirlandezët e kapërcyen Atlantikun drejtë tokës së re.

Kur gjysma e ekuipazhit të anijes Mayflower dha shpirtë, John Harker arriti tek tenda e kryetarit të fisit Iroki.

Ariu i kuq, i mbështjellë në lëkurë të bizonit e dëgjoi me vëmendje kur John Harkeri i tha:

“Unë heq dorë nga Angloirlanda ime, unë heq dorë nga tempujt, nga religjioni, nga pushteti shtetëror, Unë heq dorë nga Angloirlanda ime por vetëm mësomë ta mbijetoj këtë dimër të egër.”

Ende pa i sosur fjalët John Harkeri para Ariut të kuq Angloirlanda e kuptoi tradhëtin e madhe në Masaquset.

Tribali i madh Angloirlandez e dënoi tradhtinë e John Harkerit me këto fjalë:

“John Harkeri le të varroset i gjallë në mishin e kafshës jashtëbiblike të quajtur bizon, le të varroset i gjallë në bimën jashtëbiblike të quajtur misër, le të varroset i gjallë në mishin e vajzës jashtëbiblike të quajtur Pocahontas Powhatan”

KODI I AMERIKËS LATINE

Çka ndodhi me Huan Garsia Gonzalesin e Amerikës Latine?

Në për cilën rrugë udhëtoi Ai?

Huan Garsia Gonzalesi erdhi nga Spanja nëpër rrugën e misionarit qonquistador. Me vete i solli të gjitha standardet e Evrospanjës.

U vendos në Sant Luis.

Gonzalesi i ftoi të katër djemtë e Poëhatanit të fisit Iroki për t'ua mësuar vargjet nëntëmbëdhjetë e njëzet të Zanafillës nga Bibla.

Katër bijtë e Poëhatanit nuk i mësuuan këto vargje biblike.

Huan Garsia Gonzalesin urdhëroi:

“Le të tredhen të katër djemtë e prijësit Poëhatan të fisit Iroki”

Ditën e tretë të tredhjes së djemve Iroki, Huan Garsia Gonzalesin vajti për t'i vizituar. Ai pa se katër bijtë e Pëhatanit ishin bërë eunukë.

U bë mbrëmja e tretë në Sant Luis.

KODI I SHQIPTARËVE

Ditën e njëzet e tetë të nëntorit në plagën e mbretëreshës Teutë u paraqit gjaku. Mbretëresha ishte e nemitur kur i thanë se e kishte lindur vetveten.

Rabi Jochanan ben Sakai i vajti tek shtrati dhe e pyeti:

“A të pushuan dhembjet e lindjes?”

“Po” – deshti të thotë mbretëresha në hutimin e çastit.

Nga jashtë u dëgjua një brohoritje.

“Pse shpërthej gjithë kjo brohoritje?”

Populli yt brohoret se ti e bëre një lindje – shpjegoi Rabbi.

“Po ky popull këtu e dy mijë vjet më ther në të njëjtën thertore. Pse sot t’i gëzohet lindjes sime?” – tha Mbretëresha

“Po deshe mund ta shikojmë gëzimin e këtij populli” – i tha Rabbi.

“Po! Le ta shohim!”

“Kujt ia hapin mitrën ata njerëz me aq entuziazëm?” – pyeti Mbretëresha

“Po e hapin mitrën tënde Mbretëreshë”. – u përgjigj Rabbi

“Më paskan tradhtuar austriakët” – u ankua Mbretëresha

“Po deshe kthehu ne kufomën tënde” – i tha Rabbi

“Kurrsesi!” – protestoi Mbretëresha Teutë me lot në sy

“Pse po qanë? Po qanë për plagën tënde apo për fëmijët tu të parakohshëm” – e pyeti Rabbi

Mbretëresha Teutë deshi ta fsheh vajin në sytë e vet.

KODI I KOSOVARË

“Jo atë! Po e lypë atë Teutën tjetër. Po e lypë Teutën kosovare!” – sqaroi John Harkeri

“Ju zotëri po e lypni Teutën e Justinianës së Dytë ?” – tha gjenerali Italian

“Po! Pikërish atë po e lyp” – tha John Harketi

Në ministrinë e brendshme të Evropës konsiliumi i mjekëve amerikan e shqyrtoi gjendjen shëndetësore të Teutës Kosovare. Pasi kryemjeku i konsiliumit amerikan e konstatoi shtazanin e Teutës Kosovare pyeti:

“Në cilën fazë të shtatzanisë gjendet kjo grua?”

“Është në shtazanin e katërt; posa ka hyrë në shtazanin sllave”

“Në të gjitha shtatzënitë e kësaj gruaje paskan hedhur gjak hardhuce” – tha kryemjeku i konsiliumit amerikan

Në fund të shiut të bretkosave, qielli i zvarur befas e zbuloi diellin e varur mbi gjuhën e nxjerrë të bjeshkës; të gjithë e panë Prillin e Ditës së Dytë kur raketa *Tomahok*, e nisur prej Shtegut të Oregonit, e shembi pendën e Menstruacioneve të Mbretëreshës Teutë.

Përkthyesja italiane doli e shastisur nga zyra e OSCE-së (dhe), me një gjuhë të pështjelluar evropiane, (tha se) Mbretëreshës Teutë i paskëshin pushuar dhembjet e lindjes; e paskësh lindur fëmijën e parë pas dy mijë vjetësh shtatzënie brenda menstruacioneve kronike, të mbyllura qysh nga nata e raportit ushtarak të “goditjeve të sakta” në gjoksin e Ambasadorit roman. Për të gjitha “goditjet e sakta” Ambasadori roman i kalonte netët shianike para dyerve të Romës duke matur Trekëndëshin e Madh ushtarak nga pallati i Brutit-Kas e deri tek pallati i Cezarit.

...Shtegut të Oregonit Qepa e Madhe e zuri këndin e logosit Biodemokratik të Nati Bumpos në mospërfilljen e Bizonit, të Misrit, të Ariut të Madh, përtej zhvatjes së mishit mashkullor të të katër vëllezërve të saj në San Luis. Bora e sqotur Shtegut të Oregonit e vari heshtjen veshtullore në sytë e Qepës së Madhe të vapulluar nga Konjaku i Shkencëtarit austriak me shikim të kulluar mbi vithet e përkthyeses së gjeneralit italian, gati çjerrës: “Rrotullojeni pas dy mijë vitesh Trekëndëshin e Madh roman, mashtrimtar të Shekspirit, prej pallatit të Brutit-Kas e deri tek pallati i Cezarit; vendoseni Trekëndëshin roman në Shtegun e Oregonit. Midisi Trekëndëshit roman dhe Shtegut të Oregonit qëndron një Bibël e tërë.

“Mbretëresha Teutë e lindi fëmijën e parë pas dy mijë vitesh shtazënie Menstruacionesh të mbyllura në Mitër kur raketa *Tomahok* e futi në mitrën e saj farën veshtullore biodemokratike të Shtegut të Oregonit”.

Rrugës së Diellit të asaj mbrëmjeje, tek u sos shiu i bretkosave, nëpër Shtegun e Oregonit, për afër Klyshit të Kones së Danielit, për afër kufomës së Kryedjallit të Mefistos së Doktor Faustit, për afër Insektit të Madh të Francë Kafkës, Rabii Johanan ben Zakai zbriti nga Këndi i pushtetit të gjeneralit roman drejt Këndit të civilizimit të Nati Bumpos.

Jakovi i biri i Halevit, në fund të pritjes përpara derës sy gjyqit evropain, i lodhur nga shikimi ngadhënjyes i syve të Kones së Danielit të birit të Benjaminit, e pa ngushllueshëm dorën shpëtimtare të Nati Bumpos, kur e preku stomakun e fryrë të Kones së Danielit.

“Ku gjendesh tash?” – e pyeti Rabii Johanan ben Zakain.

“Brenda mishit të Djallit Mefisto të Doktor Faustit në Teatrin e Berlinit” – u përgjigj Rabii ben Zakai.

Nga kulisa, afër skenës, në aktin e dytë, Nati Bumpo e zgjati dorën e butë deri tek supet e ngritura të Mefistos së Doktor Faustit.

“Ku gjendesh tash?” – e pyeti për të dytën herë Nati Bumpo, po me të njëjtin zë Rabii ben Zakain.

“Brenda mishit të Insektit të Madh të Francë Kafkës, para dyerve të çelikut të krematoriumit” – u përgjigj Rabii ben Zakai.

Nati Bumpo, për të tretën herë e preku me dorën e butë Karrocën e Insektit të Francë Kafkës kur iu shfaq Rabii Johanan ben Zakai duke menduar se të tri herat ka biseduar me Jakovin, të birin e Halevit.

“Më tradhtove” – deshi t’i thotë Jakovit të birit të Halevit përtej Nati Bumpos.

“L etë shetisim paksa!” – Nati Bumpo ia këputi shkurt Rabii ben Zakait.

Në Sanhedrinin e Jahnes u shkreh kuja rrëqethëse.

“Përse po qajnë studentët e Sanhedrinit të Jahnes?” – pyeti Rabii ben Zakai nxënësin e vet Rabii Gamliel ben Shimon ben Gamlielin.

“Studentët e Sanhedrinit të Jahnes ia thonë kujës rrëqethëse vetëm pse ti u shërove nga mishi i Klyshit të Kones së Danielit. Po deshe kthehu në mishin e Kones së Danileit, po deshe kthehu në mishin e Djallit Mefisto të Doktor Faustit, po deshe kthehu në mishin e Insektit të Madh të Franc Kafkës; ende ke mundësi” – i tha Nati Bumpo nga ana e këtejme e Jakovit në anën e përtejme Rabii Johanan ben Zakait.

“Jo! Kurrsesi” – tha Rabii Johanan ben Zakai në fund të Shtegut të Oregonit.

Në fund të shiut të bretkosave, mbështjellur tisit zvetënues të atij pasdielli të mbrëmjes së Prillit të Ditës së Dytë, Bendisa e njohu Rabii Johanan ben Zakain Shtegut të Oregonit. Për dorën e djersitur Ajo e mban të atin kërthi të kapitur peshës së shekujve; po iknin pas Rabii Johanan ben Zakait, Shtegut të Oregonit. Për një çast ndaloi i ati i Bendisës së mbështjellë me tisin e mbrëmjes së Prillit të Ditës së Dytë; me shikim të përmallshëm drejt Qytetit Eunuk sikur i paskësh treguar vajzës së vet mbi të ftohtit e Prillit të Ditës së Dytë: “Qenka ftohtë të dalësh nga Menstruacionet e ngrohta të Mbretëreshës Teutë as kaq shekujsh, tek pushon shiu i bretkosave”.

“Shiu i bretkosave pushoi ngase Ti u shërove prej Menstruacioneve të Mbretëreshës Teutë “ – i tha Bendisa të atit. “Po deshe kthehu në Menstruacionet e ngrohta të Mbretëreshës Teutë” – vazhdoi e bija.

“Jo! Kurrë më!” – i tha i ati.

Tre tiset, Bendisa me të atin; me fytyrë të buhavitur Rabii Johanan ben Zakai, të mbështjellë me rrezet e zbehta të diellit të mbrëmjes, hipur në makinat e OSCE-së u nisën kah

perëndimi i Prillit të Ditës së Dytë. Mbrëmja mezi po e mbante Diellin mbi dhëmbët e bjeshkës. Rabii ben Zakai nga ana e këtejme e të atit të Bendisë e shikoi përmallshëm Diellin e zvetënuar të mbrëmjes së Prillit të Ditës së Dytë, me atë vështrimin e tij të vjetruar shekujsh.

Prapa tyre mbeti Qyteti Eunuk me barkun e fryrë deri tek dy socializmat e sprasëm. Bendisa fytyrëverdhë, me një rreze fjongo të lidhur të llidhur në flokë, e bëri shenjën e perëndimit të diellit. Drita e diellit të zvetënuar të mbrëmjes së Prillit të Ditës së Dytë u nis drejt Dritës së Shenjtë.

“Ditën e varrimit tim në mishin e Këlyshit të Kones së Danielit binte rrebesh shiu” – tha Rabii ben Zakai në ngrohtësinë e makinës së OSCE-së.

Në Romë ra shi tërë natën e Ambasadorit roman, pasi ishte kthyer nga Mbretëresha Teutë, kur Senatori roman dha urdhër ta lëshojnë brenda lajmëtarin e Gjeneralit roman nga Judeja.

“Natën e varrimit tim në Menstruacionet e Mbretëreshës Teutë bënte shumë lagështi” – sikur paskësh thënë i ati i Bendisë.

Ditën e varrimit u ngutën të hudhin sa më shumë mish të këlyshit të Kones së Danielit mbi Rabii ben Zakain; të hidhnin sa më shumë Menstruacione veshtullore të Mbretëreshës Teutë mbi të atin e Bendisë.

“Pasi më mbuluan me mish të Këlyshit të Kones së Danielit, i dëgjova hapat e Jakovit të birit të Halevit” – tha Rabii ben Zakai, i djersitur në makinën e OSCE-së. – Iu bë Bendisë sikur e paskësh dëgjuar atë tjetrin kur e pyeti të atin e saj: “Sa herë ta kanë hudhur gjumin e Dytë brenda këmishës së ngritur rreth kokës?”

“Shtatë herë!” – e njohu Bendisa zërin e të atit në kërthinin e djersitur në makinën e OSCE-së.

“Shumë, shumë mish mashkulli të kanë hequr nga korpi yt arketip brenda Mitrës së Mbretëreshës Teutë” – i tha Rabii ben Zakai. – “Mua më bënin gazi i botës, çdo mbrëmje nëpër teatrot evropiane duke më përplasur nga mishi i Këlyshit të Kones së Danielit në mishin e Djallit Mefisto të Doktor Faustit” – vazhdoi Rabii.

Në fund të kutërbimit të Insektit të Francë Kafkës, nga brenda Krematoriumit, shiu i bretkosave kishte ndaluar kur sërish Bendisa fytyrëverdhë, me rrezen fjongo të lidhur në flokë, ua fshini djersët të dyve brenda makinës së OSCE-së.

“Ky lumë e paska pirë gjithë atë ujë! Para varrosjes sime në mishin e këlyshit të Kones së Danileit, atë natë shianike të Ambasadorit roman, pasi ra në sytë e ftohtë të Mbretëreshës Teutë, kësaj bjeshke patën filluar t’i dalin dhëmbët e parë.

Sonte, Prillin e Ditës së Dytë, kjo makinë e OSCE-së po m’i nxjerrë eshtrat nga loja e ndotur e Teatrit evropian.

Makinat e OSCE-së po e bartnin mishin e njeriut nga rripi i ngushtë, midis dy kufijve, drejt perëndimit të diellit të mbrëmjes së Prillit të Ditës së Dytë.

Bretkosat, pasi e sosën shiun e vet, e lypën freskimin nëpër barqet metalike të statujave metalike të mashtruara shtatë herë në të njëjtën shkritore.

Nga kutërbimi i mishit të bretkosave të ngordhura në barqet e statujave të Skënderbeut, ushtarët e NATO-s i ngarkonin në kamionët ushtarakë për hekurina të ndryshkura infektuese.

“Njëren dorë, pikërisht dorën e majtë, e paska pasur të sëmurë” – u tha mjeku ushtarak kur e hudhën në kamionin ushtarak statujën e gjeneralisimusit Stalin të infektuar nga mishi i bretkosave të ngordhura bë barkun e saj. Mjeku ushtarak i NATO-s po u fliste ushtarëve pa e veneruar

përkthyesen italiane të mëtuar rreth pastrimit të statujës së Mbretëreshës Teutë. Përkthyeses italiane i piku nga fytyra zilia dymijëvjeçare kur i tha vetes së vet: “Si mund të ketë rënë Ambasadori roman në sytë e ftohtë të kësaj Mbretëreshes kutërbuese nga mishi i bretkosave të ngordhura?!”

Mjeku ushtarak i NATO-s u dha urdhër ushtarëve t’i hudhnin në kamionë ushtarakë të gjitha statujat e bregut të djathtë të rrugës.

“I gjori Plutark” – i tha vetes sëvet përkthyesja italiane kur ushtarët e NATO-s e hudhën në kamionin e hekurinave të vjetra statujën e Mbretëreshës Teutë, kutërbuese nga mishi i bretkosave të ngordhura në barkun e saj.

“Sa qenka prishur mishi i këlyshit të Kones së Danielit” – u çmerit Rabii Johanan ben Zakai, krejt në fund të shtegut të Oregonit, gjatë ngarkimit në kamionin ushtarak të NATO-s: kufomën e këlyshit të Kones së Danielit, të kufomës së Djallit Mefisto të Doktor Faustit, të kufomës së Insektit të Madh të Franc Kafkës nga ana e majtë e rrugës.

“Kush është ky burrë i hajthëm para dyerve të Salemit” – pyeti Rabii bin Zakai.

“Francë Kafka po përpiqet ta kalojë *Besëlidhjen e vjetër* në doganën e shtrigave të Salemit” – e shpjegoi Bendisa.

“Jepja Biblën tënde!” – e urdhëroi Rabii Johanan bin Zakai.

* *
*

Vrapimi tundues i John Harkerit e shkëputi avionin B pesëdhjetë e dy pistës së tretë të Shtegut të Oregonit drejt Zonës së Kuqe të Menstruacioneve kronike mbi shpinën e tëholluar të natës hënore. Instruktori nga baza e urdhëroi John Harkerin të fluturojë dhjetë mijë metra lartësi, tek vdes çdo

stinë. Në të njëjtin çast zëburri nga komanda u dobësua nën zëguruan e celularit të John Harkerit: “Këtu është Harker...”, sikur deshi ta futë hutimin e lejlekut në barkun e avionit mbi këndin dyzet e pesë shkallësh të fluturimit.

“Në zonën e kuqe të Menstruacioneve burrat e zënë rrugën e pushtetit Uliks” – erdhën fjalët pezmatike të Eshli Harkerit nga barku i fryrë i celularit. Zëgruaja rreth orës njëzet e tre e kaloi kufirin e hidhërimit kah pezmatimi: “Johni ynë i vocërr ka temperaturë të lartë, mbase deri tek vdekja”.

“Thirre menjëherë mjekun!” – u shfajësua John Harkeri.

“Tërë ditën e zotit ka mërdhirë jashtë Qerres, përballë fushës sonë duke u zënë me atë Bizonin trashanik” – e ndërroi zërin Eshli Harkeri.

“Mos e lejo Johnin tonë të vocërr ta gjurmojë Bizonin në Bibël. Kot, krejt kot, mërdhinë ai në krye të fushës!” – e gajllëroi paksa zërin John Harkeri.

“Të mos e kërkojë Johni ynë i vogël Bizonin as në vargjet 18, 19, 20 të Kapitullit të Dytë të Zanafillës?” - u bë si e çmeritur zonja Harker.

“As aty” – gati thirri John Harkeri jashtë qerres së mbular pasi e hodhi Trekëndëshin e Madh eurobiblik në tërë shtrirjen e fushës, deri tek kodrinat e valëzuara rrëzë bjeshkës borake, atje ku zinte fill tam-tami i trishtë indigjen. Agsholi i mbrëmjes e shkruani përtyphëm hijen e Bizonit mospërfillës, atje në fushë kur flaka farfuritëse e zjarreve indigjene ia ngacmoi armiqësisht fytyrën John Harkerit. Iu bë sikur barku i tokës lëvizti; krejt beftë e dëgjoi zërin e çjerrë të hijes më të zezë se agsholi i mbrëmjes: “tokën e tokës sate...” – deshi të flasë sikur John Harkeri të mos ishte trembur edhe nga brenda qerres së mbuluar – tek gjumi i tre fëmijëve e të shoqes.

Eshli Harkeri, edhe pse e dëgjoi zëçjerrjen e fantazmës, deshi të kuptojë diç përtej frikës; deshi ta dallojë nemitjen e mbyllur në fytyrën e John Harkerit, për zërin: “Do të na vrasë Ai...” Ajo e e pa të shoqin si po i dridheshin duart mbi Bibël për atë faqen e humbur.

Eshli Harker, me të dyja duart lidhur pas fundit të barkut, zëroi sëmbueshëm në veshin e nemitur të John Harkerit: “Zëgërryesi i fantazmës m’i nxori të përmuajshmet. Hudhe atë Trekëndëshin famëmadh evropian deri tek borëbjeshka! Le të ecin, po mundën, drejt nesh, nëpër Trekëndëshin tënd autoritar, të sjellë nga Evropa: Bizoni trashanik, Indigjeni pusht, Misri halldup – o John Harkeri”.

“Ty, sa herë që të vijnë të përmuajshmet, të ipet të çjerrësh” – u përpoq ta qortojë të shoqen.

Eshli Harker, në fund të orës njëzet e tre, pas dëshirës lektisëse për t’ia çarë barkun celularit të hajthëm, i hyri zëth në vesh të shoqit: “Pse ti, pikërisht ti, kapiteni John Harkeri, je caktuar ta shtyshë avionin deri tek zona e kuqe e Menstruacioneve kronike të atyre kurvave ballkanike?”

Kapiteni John Harker, me gishtin tregues ia xigëloi barkun e hajthëm celularit: “Bizonin trashanik, Indigjenin daulle, Misrin halldup mos t’i kërkojë Johni i vogël në Bibël. Më kanë thënë në Komandë se ata mungojnë për çdo faqe të Biblës...”

“Ti gjatë gjithë rrugës, nga Anglia e deri këtu, prej nga fillon Shtegu i Oregonit, e pate zënë gjithë kuvertën e anijes me atë Trekëndëshin e Madh autoritar të ndërtuar nga druri i Biblës. Hidhe sonte mbase do të bëjë punë si Kryqi i pashkëve!”

Në agsholin e parë të mbrëmjes John Harkeri nga kryefusha e hodhi Trekëndëshin e Mahd autoritar për t’u bërë rrugë: Bizonit trashanik, Indigjenit daulle, Misrit halldup,

përkundër mendjes së tij, nëpër grishjen e vargjeve biblike: 18, 19, 20 të Zanafillës.

John Harkeri pasi e kreu urdhrin e të shoqes, i përhumbur pranë gjumit të fëmijëve, mëdyshoi tërë natën në kishte lëvizur qerrja e mbuluar deri te çjerrja e kryekatastralit Xhim Kuper: “Urdhërqëndrimi! Qerrja e tridhjetëetretë e pronarit John Harker le të shmanget nga karvani!”

Me ngutin e instektit nevrrik, Xhim Kuperi e përsëdyti urdhrin: “John Harkeri le të dalë nga qerrja!”

Midis gjumit të fëmijëve dhe hutesës së John Harkerit – urdhri i Xhim Kuperit egjeti Eshli Harkerin me duart lidhur rreth fundit të barkut: “Prapë m’u tremben t’ përmuajshmet. Po qe se të japin tokë të ligë, mos e merr!” Kthehu në qerre! Do ta marrim më të mirë” – i tha e shoqja.

“Për të satën herë të erdhën të përmuajshmet?” – e pyeti të shoqen komandant piloti John Harker përmes celularit.

“Merre tokën e mirë, tokën bukanike para se avioni yt të hyjë në atë zonën e kuqe të atij Ulksit piziveng” – i tha e shoqja.

John Harkeri po e përcillte në tabelë punën e motorëve të avionit në cep të mendimit se qerrja e mbuluar do të kalbej në lluc’ deri sa e shoqja t’i bie në fund aktrimit të Penelopës. Deshi t’i tregojë të shoqes se epidemia e aktrimit të Menstruacioneve të Penelopës së atij Ulksit piziveng nga kurvat ballkanike mund të kalohet vetëm me raketën “Tomahok” në mitrën e Mbretëreshës së këtyre kurvave.

Eshli deshi të mbetet e hutuar nga mendimi i të shoqit kur qerrja, kaheër e ndalur tek urdhri i Xhim Kuperit, kumboi nga brenda: “John Viliam Harkerit i jepet toka e tokës. Le të nënshkruajë!”

Në fund të urdhrit të Xhim Kuperit, kryeadministratorit të tokave të reja, Eshli deshi t’ia shfaqë të shoqit ndjenjën e hidhërimit për tokën e ligë.

“Mate me Trekëndëshin tënd të sjellë nga Evropa; toka mund të jetë matur me hile” – i tha e shoqja.

John Harkeri, midisi hidhërimit të të shoqes dhe urdhrit të prerë të Xhim Kuperit, pati vetëm aq kohë sa t’i thotë të shoqes: “Trekëndëshin autoritar e hudha mbrëmë në fushë deri rrëzë bjeshkës borake kur u zu ajo fantazma e atyre fjalëve të pakuptueshme “Toka e tokës...” Doli përtueshëm nga barku i ngrohtë i qerres në cep të urdhrit të prerë të Xhim Kuperit sapo u sipkat pyetja e parë: “Ti je John Harkeri...?”

Në cep të hidhërimit teatral të Xhim Kuperit, plumb pushke shpërtheu çjerrja e John Harkerit: “Po! Unë jam...”

Xhim Kuperi me vështrim të mprehur brisk u rropat ta zhveshë John Harkerin: “Nënshkruaj në këtë dokument se për jetë të jetës do t’i shërbesh tokës së tokës sate. Po e ktheve shikimin nga prapa, të përpiu toka” – i tha në fund të nënshkrimit Xhim Kuperi; gjysmën e fjalëve nga Karroca e fundit e karvanit në lëvizje: “Mate tokën tënde të re me Trekëndëshin e Ri! Mësoje rregullën e Këndit të tretë! Ndiqe vetëm Treshin. Mos e prit ndihmën e Shtetit e të Pushtetit në Tokën tënde të Re. Ata janë larg prapa teje gjashtë muaj” – fliste gjithnjë e më përqartë Xhim Kuperi nga karroca e fundit e karvanit në largim.

Filloi të bie borë.

Zëthi i celularit të kapitenit John Harker u krekos grarishte të zihej me uturimën e motorëve të avionit: “Edhe borë filloi të bie!” – u zgjat i përvajshëm Zëri i Eshlit.

“Thuaj djalit le të hyjë brenda në qerre! Shërbimi Meteorologjik i SHBA, siç tregon në tabelën e komandimit, thotë se pas gjysmës së natës do të pushojë stuhia.

Vazhdoi të bie borë.

John Harkeri ende pa i mbështjellë dokumentet e Tokës së Re u fut rrëmbimthi në karrocë.

“Vishu më trashë, vishi fëmijët, po bën ftohtë!” – i tha të shoqes ende duke diskutuar për Tokën.

“Adami i tha të shoqes: Zhvishu” – e ironizoi e shoqja.

“A bie borë në Bibël?”

John Harkerin e zuri amoku i vrapimit përgjatë fushës borake drejt Këndit të Ri të Xhim Kuperit, kur në shpinën e Bizonit mospëfillës e zbuloi rreullën e Treshes. E kapërcu Misrin deri tek rrëza e bjeshkës borake e Indigjenit daulle. I mbështjellë në qyrkun e borës së lagësht, kryetari Çeroki po e thithte çibukun kur pushoi amoku.

“Ndalo këtu!” – i tha Indigjeni daulle. “Përtej këtuhit sosën të gjithë numrat”.

“A bie shumë borë në Biblën tuaj?” – e pyeti John Harkeri Indigjenin daulle.

“Po! Bën edhe shumë ftohtë” – foli Indigjeni daulle përtej tymit të llullës; me shenjën e dorës i solli tre indigjenë daulle me shilore në krah të ngarkuar me mish bizoni. E lëshuan lëkurën e nxehtë plot avull në borë.

“Uria e mund mashtrimin në sytë tuaj” – Indigjeni daulle ia kuptoi amokun e vrapimit nëpër gjithë fushën deri rrëzë bjeshkës borake.

Mishi valuk i bizonit ia nxori urinë John Harkerit deri tek fjalët e Indigjenit daulle: “Pasi ta ngopësh mish bizoni e misër të zier në Nëntorin e Ditës së Njëzetedytë do të falënderosh”.

“Sikur po drishet toka!” – gatii tha Indigjenit daulle.

“Shkundja e pishave borake e rriti vertëllimën në kokën e John Harkerit kur anija u përbirua midis mishit valuk të bizonit dhe misrit të zier.

Marinarët u çmeritën nga Trekëndëshi i drunjtë, shtrirë në tërë gjatësinë e kuvertës së anijes. E hetuan rriten e pandërprerë të Trekëndëshit të drunjtë. Udhët e tyre u çakërdisën: njëri grup i marinarëve udhëtoi drejt këndit 55°.

Rruga u bë tepër e gjatë, gati harrestare: “Ti përse e harrove derën të hapur?” – e pyeti e ëma John Harkerin. Ai provoi t’i qaset nga kjo anë zërit qortues, kur atë zërish e zuri amoku i vrapimit drejt urës së kapitenit të anijes. Në midis të Trekëndëshit evropian, në kuvertë, u shfaq punëtorja e marangozëve. John Harkeri konstruktin gjigant të dërrasave e mori për qiç të anijes. Regjisorin e hipur mbi skelen e lartë, John Harkeri, më kot, u mundua ta dëgjojë. Dikush e lajmëroi Johnin në veshin e regjisorit. Ai zbriti nga skela me shenjën e lazdruar në dorë për t’i shkuar prapa deri buzë tavolinës.

“Do të marrësh pjesë në luftën tonë?” – e pyeti regjisorin John Harkerin, me sy të drejtuar kah dera.

Papritur anija e humbi rrugën pa u mbledhur të gjithë marinarët në sallën e konferencave. Dikush i pëshpëriti në vesh regjisorit-komandant se marinarët, të përhumur, kishin vrapuar tërë gjatësisë së Trekëndëshit të shtrirë në kuvertë.

Filloi të bie borë në det.

Robert Smithi, kryemarinari, e piu rakinë deri tek defrimi i çelur i Ulksit kundrejt Hektorit. Atëherë John Harkeri e mori vesh se dërrasat e lyera me vernik paskëshin qenë për Kalin e Trojës.

“Mbrëmë Hektori ndejti deri vonë në barkun e Kalit” – i tha Ulksi Agamemnonit.

“Homeri e ndalon hyrjen e Hektorit në barkun e Kalit të Trojës” – kundërshtoi Harkeri regjisorin. “Hektori duhet të vritet para se të ndërtohet Kali i Trojës!”

Ulksi dhe Agamemnoni e shikuan njëri-tjetrin sikur thanë: “Mirë. Le të vritet Hektori në kohën e përshtatshme”.

“Hektori do të jetë i vdekur tek dërrasa e parë e Kalit!” – kundërshtoi John Harkeri duke i vështruar marinarët e zdërvajur nga rakia.

“Këta marinarë injorantë ku ta dinë se në cilën kohë duhet të vdesë Hektori?” – foli përçart regjisori duke e kuptuar, më në fund, se vdekja e Hektorit i ngatërron marinarët. Gjithnjë erdhi duke iu qartësuar se vërtitjen e anijes marinarëve ua kishte sjellë në kokë dehja e Homerit...

John Harkeri Trekëndëshin Autoritar evropian, ende në midis të Oqeanit Atlantik, e mbante në pozicion të vjetër edhe pse po kalohej prej kohës së vjetër në kohën e re.

Ende po reshte borë mbi Atlantik.

Në Trekëndëshin e drunj të John Harkerit u dridh tavolina e anijes “Mejflauer” – deri te Kali i Trojës. Dikush në veshin e regjisorit e futi fjalën “furtunë”. Vetëm për një çast Uliksi u hutua deri sa po e zente gotën vërtëlluese nëpër tavolinën e sapolyer me vernik.

“Këta separatistë të fesë së krishterë mendojnë të bëhen bujq. Ne kemi nevojë për aktorë” – foli regjisori i marrë mendsh nga lëvizjet e dehura të Agamemnonit – pa e përmendur Anglinë e Re”.

“Ky Trekëndësh evropian i John Harkerit, i shtrirë në kuvertë, le të mbyllet në barkun e Kalit të Trojës; ndryshe do të humbasim rrugë para shkëmbinjve të Plimuthit” – foli i frikësuar regjisori-komandant.

John Harkeri e çoi dorën për ta zënë sëmbimin në barkun e celularit kur zëgruaja e urdhëroi: “Mos hyrë kurrë më në barkun e Kalit të Trojës!”

Ai mendoi se e shoqja e ngatërroi Kalin me avionin, pa e ditur se i paskësh thënë: “I beson ti veprimi fatalist?”

“Në *Times* të mbrëmjes shkroi se avioni yt po bart farë mashkulli për Mitrën e Mbretëreshës. Kapërcimi i kohës,

metalin vezullues të avionit tënd e shndërron në thikë, e, thika kur ngulet në tulin e butë të tokës e në mishin e njeriut ndodh hutimi i Zogut” – e sëmboi ironikisht Eshli Harkeri të shoqin.

“Tash jemi shumë afër shpirtit të ujit” – i foli komandës John Harkeri.

“Të jesh i vëmendshëm! Aty, avioni, gjumi, ëndrra ujësaven”.

“Sa vajti ora?” – u dëgjua zëri i hajthëm i celularit.

“Ora vajti dy përtej mesit të natës”.

“A do ta ketë zënë gjumi Mbretëreshën Teutë?” – pyeti e shoqja sëmbueshëm.

“Uliksi, mbrëmë, pas orës dy të natës, ishte dehur midis rolesh, me shoqet e Penelopës” – e mgushëlloi i shoqi Eshlin.

...Regjisori dhe Odisea sikur i harruan detarët rreth tavolinës në rrugën e tyre të humbur përgjatë Trekëndëshit evropian të John Harkerit.

Tavolina e anijes “Mejflauer” vërtëllueshëm e tregonte majën e stuhisë kur njëri nga detarët rropatej ta shqyente stuhinë sa i nxirrte për kreje: “Toka, po shihet toka e tokës!”

Të gjithë marinarët e bashkuan shikimin në një sy drejt tokës; sikur bashi i anijes “Mejflauer” e shpoi barkun e stuhisë gjithçka ra në heshtje. Agsholi i hershëm i mëngjesit e nxori tokën nga deti bashkë me thjet e detarëve: “Plimuthi, është Plimuthi!”

Në tokë po reshte borë.

Era cegmore (e cemtë)? ua kujtoi ta numërojnë vetveten; nga njëqind veta të hipur në anijen "Mejflauer", e, dy fëmijë të lindur gjatë rrugës, kishin mbetur vetëm pesëdhjetë.

Indigjeni daulle, i mbështjellë me gëzofin e borës, heshtjen e thithi me tymin e llullës përtej mëtesës për t'i ndihmuar udhëtarët e anijes "Mejflauer".

“Jemi matur me të gjitha legjendat tona sa të jenë ato të banueshme për ju evropianët. Katër djemetë e mi i kam dërguar në San Luis për ta mësuar Biblën” – i pëshpëriti Indigjeni daulle sikur po i fliste dikujt tjetër përtej John Harkerit.

“Provoni t’ua shtoni disa kthina legjendave tuaja as për strehimin e veropianëve!”

“Katër djemetë e mi, – sikur vazhdoi Indigjeni daulle, - deri në fund të Biblës së San Luisit e gjurmuan mishin e Bizonit, e gjurmuan mishin avullak të Misrit, e gjurmuan Indigjenin daulle”.

“Lagështia e legjendave tuaja e dëmton Biblën tonë” – i tha John Harkeri.

Ishte nëna!

Nga lteri përhapet zëri i meshtarit: “Trumcaku e ka gjetur një banesë për vete e turtulli një çerdhe, ku mund të pushojë me zogjtë e vet”.

John Harkeri e dëgjoi të çjerrurën gërryese, midis hidhërimit e habisë, sikur erdhi nga Indigjeni daulle. Me lëvizjen e rrëmbyeshme, gati ta rrëzojë llullën, Indigjeni daulle e bëri shenjën e madhe, kolektive për t’i shpëtuar udhëtarët.

Mbi kokën e vet Johni u rrek ta spikaste frikën nga hidhërimi i të atit me dorë të mbështetur në Librin e psalmeve. I ra ndër mend se nëna Qyteti Eunuk aty; donte ta shuajë frikën e vet në sytë e saj. Ajo po shikonte drejt lterit me ngulm të përkortshëm. Në sytë e nënës John Harkeri e kuptoi se diç ndodhi në Trekëndëshin autoritar evropain.

Zhaurima nëntokësore e shkundi borën nga borigat e gjata e përzier me shenjën e madhe të Indigjenit daulle; po i përcillte të gjitha shenjat me ritmin e daulles.

Meshtari, pasi dhantoi me kemim më shumë se herave të tjera, hodhi ujë të bekuar duke u lutur: “Ti, o Zot, ke dhembje për të gjitha krijesat e tua; mëshiroji ato!”

Gjatë kohës së kemimit dora e meshtarit mbeti e ngritur në ajër, mbi kokën e Johnit. E lypsi dorën e ashpër të të atit mbi Librin e Psalmeve; ishte zëri i nënës: “Eja të dalim!”

Zhaurima e hapave mbi borën e cemtë u përzie me treokllimën e galopit të kuajve. I gjithë fshati i Indigjenit daulle po ngutej.

Kthjelltësia e ajrit të cemtë mbi shkëlqimin e borës ia mundësoi Johnit ta shohë shpinën e të atit duke dalë nga oborri i kishës.

Indigjeni daulle e shpërfilli zëgruan afër veshit të vet. Gruaja tjetër e Indigjenit daulle me gojë, të holluar prej dhelpërie i zëroi në vesh: “Mbrëmë nëpër fushëborë ka ecur shpirti i keq”.

Nënës i rrëshqiti fytyra deri te gëzofi i borës së Indigjenit daulle. Në fushëborë Johni i dalloi shpinat duke dalë nga kisha kur krejt papritmas si në largësi, krisi çjerrja e njërës nga ato shpina: “Është koha, pikërisht tash është koha”.

“Cila kohë?” – pyeti në errësirë John Harkeri pasi vërtëllima marramendëse e dy trekëndëshave ndaloi sikur ndalon thumbi i roletit mbi një numër në kazino: nga Trekëndëshi autoritar evropian kaloi në cepin e tretë të Trekëndëshit biodemokratik të Tokës së Re.

John Harkeri e shikoi orën e shtrënguar në dorën e djersitur kur kishte vajtur saktë njëzet e tre e njëzet e pesë minuta:

“Ishte koha”.

“Cila kohë?”

Avioni B-52, i ngritur nga shtegu i Oregonit po e lante shpinëbarkun në dritën e hënës.

“Tashmë avioni yt e kapërceu kohën nga Trekëndëshi biodemokratik i Shtegut të Oregonit drejt Trekëndëshit autoritar evropian.

“Është koha”.

“Cila kohë?”

“Koordinatat matëse, aparatet sinjalizuese, tregojnë hutesë kohore” – foli zëri nga Shtegu i Oregonit.

“Nga lart shihet vetëm shpirti i ujit” – deshi të përfundojë John Harkeri.

“Shpirti i ujit si në Sagën e vikingëve! Thuaj Menstruacionet e Mbretëreshës” – e bezdisi zëgruaja e të shoqes: “Ngadalsoje shpejtësinë brenda harkut në të djathtë!” – foli qendra nga Shtegu i Oregonit. “Tek paraqitja e parë e zjarreve, sipas urdhrit, lëshohet Raketa”.

“Zjarret në fund të ujit!?” – u çmerit John Harkeri pas sëmbimit nga e shoqja.

Eshli Harkeri u bë aty nga barku i hajthëm i celularit: “Ti, kapiten John Harker, me avionin tënd po shpie farë mashkulli në mitrën e Mbretreshës ballkanike!”

“Mbretëresha e stinës së pestë e ëndërron më tepër zjarrin apo ujin?” – u mundua t’ia hedhë mendjen të shoqes tek En Haçinsoni.

Edhe tridhjetë e pesë minuta avioni i John Harkerit do të hynte në Prillin e Ditës së Dytë Arketipe; së pari në Trekëndëshin e RAF-it anglez e pastaj në Trekëndëshin e Lufthanzes gjermane.

Indigjeni dauille flet përçart në Prillin e Ditës së Dytë pranë gruas së mbështjellë me gëzofin e borës së sqotur. Në fytyrën e Indigjenit dauille përfatuan stinët e harlisura përtej kohës së vjetruar: së pari i ranë nga fytyra gjethe të zverdhura të përcjella me akull të hollë e borë, për t’ia çatisur pranvera e lehtë me një të nxehtë veror në fund.

Vajza e madhe e Indigjenit dauille, përtej dashurisë, ia mësoi John Harkerit gjuhën çeroki, gjuhën e Bizonit mospërfillës, gjuhën e kokrrës së mufatur të Misrit. Ai u

magjeps nga gjuha kënetore e vajzës së madhe të Indigjenit daulle kur e gjeti veten kaq larg.

E zuri frika.

“Nga këtu ku ke arritur, gjashtë muaj prapa vetes e ke pushtetin shtetëror. Për aq sa pushteti shtetëror do të përpiqet të të afrohet, ti do t’i largohesh, me vullnetin tënd të lirë, drejt mishit valuk të Bizonit, drejt Kokrrës së mufatur të Misrit, drejt Indigjenit daulle” – i tha vajza e madhe e Indigjenit daulle duke udhëtuar mbi kalin e kuq të shaluar me lëkurë bizoni Shtegut të Oregonit, tek lisat e malit i gjasuan më lëvorezinj seç ishin nëpër fijatjen e borës. Johni po largohej në frikën e vet bashkë me vajzën e madhe të Indigjenit daulle, kur ajo e zhbraviti frikën e tij: “Katër vëllezërit e mi kanë mësuar Biblën në San Luis. Në Kapitullin e Dytë të Zanafillës, tek vargjet 18, 19, 20, Ai, Adami i Biblës suaj, i thërret të gjitha kafshët për t’i pagëzuar. Ne indigjenët ruajmë në vete diç nga shejtëria e Kafshës, nga shejtëria e Zogut. Babai im quhet Ariu i Madh, vëllai im i madh quhet dreni i Pishës. Në Biblën tuaj ai, Adami, vendos pushtet tiranik mbi kafshët, mbi zogjtë...”

John Harkeri vetëm heshti përbri vajzës së madhe të Ariut të Kuq derisa e shkundi borën e butë nga flokët e saj, të dala paksa nga gëzofi i bizonit. E ndjeu aq afër zjarrin në borën e butë të bjeshkës, larg njollave të gjumit. Iu rrit dëshira ta pyesë vajzën e madhe të Ariut të Kuq për shpirtin e asaj gruas së stinës së pestë.

Vajza e madhe e Ariut të Kuq e ndjeu thellë në mishin e zemrës ndalesën e fjalëve në çastin magjik. Përfytyrimi i dëshirave të John Harkerit asaj i solli rrëqethje midis frikës e të ftohtit.

“Ja zjarri!” – u përplas thma ngulfatëse e vajzës së madhe të Ariut të Kuq.

Zjarri pareshtur ndërronte vend butësisht nëpër syprinën e borës së butë. Atëherë John lektisi për mendimin e vajzës së madhe të Ariut të Kuq duke e afruar kalin pranë saj; ajo në heshtjen magjike po udhëtonte drejt civilizimit në zemrën e egërsisë. Bashkë me ta dimri i borës pishanike po udhëtonte drejt bjeshkës pa asnjë shenjë dalluese, siç është zakon për avionët, zogjtë, stinët...

“Të ndalemi paksa këtu!” – psherëtiti Johni.

“Jo! Po të ndalemi vdes rruga në gjumin e borës së butë” – kundërshtoi vajza e madhe e Ariut të Kuq.

Ecën drejt zjarrit farfuritës nëpër mishin e borës së butë para se të ligej dita në agsholin e mbrëmjes së përzier me fluska bore. U doli përpara fshati i lëkurës së bizonit, i përgjumur në agsholin e mbrëmjes. Në hyrje të fshatit tetë veta po e bartnin mbështjell me lëkurë bizoni një njeri. Mbrëmja e njëtrajtshme nga krrokama metalike e korbave po përsëritej me pritesën uloke mbi fshatin e lëkurtë. Tetë udhëtarët e ndjenin duhmën e gjumit, ende jashtë lëkurës së ngrohtë të bizonit. Tendat gjithnjë po i largoheshin njëra-tjetrës nga zhaurima e topitur nëntokësore. Nga dera e tendës, kundruall masës kërmillore të njerëzve, doli ajo gruaja, siç i thanë, e Stinës. Eci drejt John Harkerit me shikimin e saj të zvarrë nëpër borën e butë.

“Mbrëmë mbi fshat ka fluturuar Korbi Su; e kam dëgjuar zemërimin e tij pa ia këputur rrugën me majën e thikës e me fjalën magjike” – pëshpëriti ajo.

Gruaja e Stinës e përbuzi John Harkerin duke iu qasur vigut ku ishte vënë i plagosuri. E futi dorën nën lëkurën e bizonit, e sigurt për dëshirën e saj. Sikur e preku gjarprin e ftohtë hekur, e tërhoqi dorën me thmë të çjerrë:

“Këtu, tek ky njeri, mungon penisi!”

Masa kërmillore e njerëzve u tkurr si gjarpri i shkelur në bisht nga fjalët e gruas së Stinës.

“Ky njeri ka qenë në San Luis për ta mësuar Biblën”. Atje, evropianët tek mishi i ëmbël i mashkullit ia kanë bërë gropën e zezë” – vazhdoi ajo.

Deshi të vazhdojë edhe më po mos ta përplaste brenda syrit të bizonit Ariu i Kuq. Pasi gruaja e Stinës u përplas në tendë, brenda syrit të bizonit, Ariu i Kuq e përplasi shikimin e helmatisur mbi fytyrën e John Harkerit. Midis të dyve u rrallua ajri.

“Po sjellin mish bizoni” – shpërtheu gëzimi i një fëmije.

Ngazëllimi i fëmijës e stepi Ariun e Kuq me duar të ngritura kah John Harkeri derisa gruaja e Stinës e grisi syrin e bizonit.

John Harkeri mendoi se ajo këtë herë do të shkojë për mish bizoni; vërtet andej edhe u nis duke Uliksiëritur:

“E di. Kapiteni John Harker, me avionin e tij, shtyhet kah Menstruacionet e Mbretëreshës ballkanike. E njoha avionin e tij, e ndava nga Korbi Su, e ndalova këtë fjalës magjike pa e ngulur thikën në mishin e tokës” – tha Eshli Harkeri duke u orvatur ta shpiente deri tek ngjarja vajzën e madhe të Ariut të Kuq përtej katër burrave të fshatit të lëkurtë.

Katër vëllezërit e Çikakos (vajzës së Ariut të Kuq), kur shkuan ta mësojnë Biblën në San Luis, rrëmuan t’i gjejnë: Bizonin heshtak, Mirin torollak, Indigjenin hileqar. Pasi Bizoni heshtak, Misri torollak, Indigjeni hileqar munguan në Bibël, të katër vëllezërit e Qepes së Madhe (vajzës së Ariut të Kuq) ranë në dyshim; sërish vendosën të kthehen në fshatin e Lëkurës së Bizonit.

Ishte bërë tepër vonë.

Ditën e gjashtë të dyshimit të vëllezërve të Qepes së Madhe në San Luis u shfaqen misionarët hugenotë të

pluhurosur si vetë rruga. Francezët hugenotë ndaluan para Shkollës biblike për t'i kuptuar emrat e katër vëllezërve të Qepës së Madhe. Në fillim i quajtën me disa emra të çuditshëm, të sjellë në trastat hugenote. Emrat e djemve të Ariut të Kuq francezët i zgjatnin si llastik të butë. Misionarët hugenotë e tërhoqën zvarrë frikën e rrugës. E kontrolluan gojën shpellë të drejtorit të Shkollës biblike; e lexuan mendimin e tij, kur ende djemtë e Ariut të Kuq po i gjurmonin: Bizonin heshtak, Misrin torollak, Indigjenin holeqar. E sollën kryqin e drunjtë; i rreshtuan njerëzit ta puthin para Hugenotit të veshur me zhgunin e errët.

Hugenotët e futën në seminar kutërbimin e morfinës të mbështjellë me errësirë. Katër djemtë e Ariut të Kuq u rrekën ta kuptojnë errësirën këtej krikëllimës së derës kur Hugenoti me vurratë në fytyrë paskësh thënë: “Hiqeni mishin e tepërt nga këta djem! Gropa e zezë tek mishi i mashkullit e qetëson njeriun”.

Menjëherë dita u buhavit në fytyrë, pasi djali i madh i Ariut të Kuq, pa shpresë, shikoi drejt derës së trashë, nga vinte era e morfinës. E kuptoi sa larg u bë bota përtej kësaj dere.

Djali i madh i Ariut të Kuq ra në errësirë me këmishën e ngritur mbi kokën e mbështjellë. E shpalosën edhe një herë këmishën për t'i hedhur brenda gjumin e dytë plot morfinë.

Koha shterret, soset tek gjumi i dytë.

Djemtë e Ariut të Kuq, në fund të gjumit të dytë, i pritën në vizitë djemtë: apaçi, çeroki, su...çunat bënin njëfarë urimi andej dhimbjes kur djali i madh i Ariut të Kuq u çjerr në kupë të qiellit: “Do të përmjerrem si grua!”

Djemtë su pasi e qetësuan djelin e Ariut të Kuq u nisën kah goja e derës së uritur; djemtë e Ariut të Kuq po i lëpinin gropat e zeza tek ishte dikur mishi i mashkullit.

Larg fshatit të Lëkurës së Bizonit, ujqit po e thërrisnin Nënë e tyre. Dyert e lëkurta të tendave, sy bizoni, mbeten ende, përgjumshëm, gjysmë të hapura.

“Katër vëllezërit e mi ikën nga Shkolla biblike e San Luisit me gropat e zeza tek mishi i mashkullit” – iu kërcënua Qepa e Madhe Eshli Harkerit.

Në fund të kërcënimit të Qepës së Madhe John Harkeri e hetoi gurgullimën e ujit në zërin e saj. Atë e kaploi lagështia tek fytyra e vrenjtur e Ariut të Kuq.

Lagështia tinëzare e Menstruacioneve veshtullore të Mbretëshës ballkanike e vështirësoi hovin e avionit të John Harkerit.

“ma e nxehtë e Menstruacioneve të Mbretëshës ballkanike e nxit epshin e mashkullit” – e njohtoi e shoqja nga celulari.

“Tashmë po e shoh nga dritarja e avionit shpirtin e ujit pas dy mijë vjetësh. Ëndrra avullake e mishit të njeriut po e nxen trupin metalik të avionit” – u lajmërua në Qendër John Harkeri tek Shtegu i Oregonit.

“Në shenjën *Order*, vepro!”

John Harkerit, krejt papritmas iu qas fshati i lëkurtë; flaka në syrin e bizonit; i tërë fshati u ndriçua nga dritë krejt e kaltër. E pa Ariun e Kuq disa metra mbi tokë; krejt të larë në dritën e kaltër. Pastaj arrit krisma me fërshëllimë plumbash midis Ariut të Kuq dhe tokës, derisa John Harkeri po rropatej ta kuptojë nëse e arriti tokën Ariu i Kuq. U zvarrit nëpër lëkurën e cifluar të lëndinës borake deri tek Qepa e Madhe.

“Mund të të vrasin duke u zvarritur rreth saj edhe sonte kur po hyn në Menstruacionet kronike të Mbretëshës ballkanike” – u ankua Eshli Harkeri. “Ajo, Qepa e Madhe, t’i ka bërë trutë dhallë”.

Të katër vëllezërit e Qepës së Madhe, me katër gropat e zeza tek mishi i mashkullit, u rrekën ta hetojnë anën e sulmit të francezëve.

Vëllai i madh i Qepës së Madhe e afroi gojën tek veshi i së motrës: “Ne mbetëm gjallë. Babai ynë ende mbeti afër qiellit”.

Johni, ende i shtrirë, e shihte Ariun e Kuq pezull mbi lëndinë; sikur iu kujtua sorollatja e plumbave. Mbrëmjen e lëpirë nga ulurima u jqve po e shëronte ngadalë nga plaga e krismës; si dhe Ariun e Kuq po e zbriste në lëndinë.

Para se të çohet në këmbë, Johani e urdhëroi Qepën e Madhe: “Ti, me një vrap, sose lëndinën!”

Qepa e Madhe e sosi lëndinën si petull; u përmend vetëm kur shkeli në buzë të pyllit. Nata ishte thurur trashë nën borigat e mbushura me borë të butë.

Qepa e Madhe kur po i ndihmonte Johanit ta kapërcejë rragamin buzë pyllit të borigave borake i pëshpëriti lodhshëm tek veshi: “NEVE PO NA VRASIN FRANCEZËT HUGENOTË. Misionarët e tyre gjashtë muaj përpara po e tërheqin zvarrë pushtetin e tyre shtetëror. Në këtë tokë vetëm kur shtetasi i lirë, i ballafaquar me natyrën, ecën krejt i lirë, gjashtë muaj përpara pushtetit shtetëror, mund të mbijetojë”.

“Po ky evropian pse më bart në shpinë?” – e pyeti Ariu i Kuq me dhimbje trupi të bijën.

“Ky evropian ecën gjashtë muaj përpara pushtetit të tij shtetëror” – e ngushëlloi të atin.

“Mos është ky evropian ai *vallëzimi me ujqit*?” – e pyeti i ati.

“Po. Ai është”.

I shtrirë në borën e butë, nën borigat borake, John Harkeri e hetoi nën peshën e trupit lëkundjen e tokës, të pyllit të borigave borake tek ra shenja *order*.

Avioni u trand para Menstruacioneve të Mbretëreshës ballkanike. Në tavolinën e Gjergjit me katër emra, tek zyra e OSCE-së u derdhën dy gota të verës.

* *

*

Në fillim të muajit Nabi-Uliksi-aker, të xhumanë e parë, Sulejman Besi Ban Efendia ra në ëndërr, afër hanit ku është vendosur ushtria e pluhurit të shkretëtirës. Buajti në tendën e gjeneralit, pashait mehmet Ali, nga po i rrjedhte ëndrra nëpër shtjerrin e kampingjeve të shpeshta. Sulejman Besi Ban Efendinë në gjysmë të ëndrrës, kur po binte në gjumin e tretë, e zuri kroma tek gropa e zezë e mishit të mashkullit; dora i mbeti i zbrazët. Kroma e shtuar e aletit mashkullor Sulejman Besi Banit ia sosi edhe gjumin e tretë. Kur doli nga tenda për të derdhur ujë si mashkull, siç i tha ajo gruanënë në ëndërr, e futi dorën në shallvaret e zhubravitura për ta nxjerrë aletin e mashkullit; për të dytën herë atë natë i mbeti dora e zbrazët.

Pas një gëmushe, ulur si grua, Sulejman Besi Ban Efendia derdhi ujët e hollë me fërshëllimë të një femre të pabërë nga mashkulli.

Mëngjesi i Prillit të Ditës së Dytë e lajmëroi ardhjen pëpjetë rrjedhës së lumit, në fund të gjumit të tretë kur Besi Ben Efendia, pas shtrëngimit grarisht të shallvareve të zhubravitura u afrua tek tenda e sekretarisë; me zë të ngjirur grarisht, iu drejtua kryerojtari:

“Zgjoma kryetagbitarin e ëndrrave!”

“Menjëherë tash, hirësia juaj?” – e pyeti kryerojtari.

“Po. Menjëherë” – foli lodhshëm Besi Ban Efendia.

Kryerojtari, siç e mori urdhrin, pasi foli me rojën e parë, u zhyt në barkun e tendës së sekretarisë. Barku i tendës së fryrë mori frymë thellë sikur po zhdremitej kutërbimit të

ëndrrave epshori të derdhura në hasër, në vend se në mishin e ëmbël të grave.

Besi Ban Efendia për t'iu reshtur kromës së tretë atë natë, i shkoi mendja tek reçatet e namazit. Nata frymonte rëndë, veçanërisht kur epshi i ushtarëve, kuajve, grave mufatej në errësirë si shushunjë.

Në të çarën e tendës hujnike u shfaq kryetagbitari i ëndrrave me një kollitje të ngjirur nga ballgami i nargjiles.

Besi Ban Efendia, porsì e çara e tendës, u bë hujnik; shallvaret i ranë në fund të këmbëve duke i zbuluar një parë këmbë të holla deri tek zguri i varur. Vetë apo dikush e kishte rruar tepër shpejt. Drita e pishtarit sikur u shalakat nga fryma e çastit drejt vendit të pështirë të Besi Ban Efendisë, tek ishte bërë rrënim gjinishë.

Besi Ban Efendia përpak të mbetej tek gramatika biologjike e rrënimit të gjinive kur e hetoi se i kishte pushuar kroma tunduese e mishit të mashkullit. Pa e da mendjen se kujt i foli, iu drejtua kryetagbitarit: “Edhe dy orë do të zbardhë dita. Secilit ushtar, secilës konkubine, secilës deve, secilit kalë t’ua renditësh ëndrrat; po t’i zërë dita ëndrrat njëra mbi tjetrën, në mëngjes do të zgjohet një ushtri gjynahqare, ushtri përbindshe”.

Kryetagbiri, i rrënuar gjinishë, midis dy kollitjeve ngjirëse me zërin fërshëllyes prej gruaje, iu drejtua Besi Ban Efendisë: “Mbrëmë ke dashur ta lindësh veten nga kroma, por këtë herë krejt mashkull. Shpëtoje veten me agjërim! Mos ia beso askujt ëndrrën tënde, krejt as kryetagbirit; mashtroje robin e Zotit para se të të thotë: Mirëmëngjes. Po u vonove në mashtrim do të bëhet tepër vonë për ty”.

“Në ëndrrën time, o kryetagbir, ka shumë pluhur shkretëtire e shumë namaz. Gratë më së pari e mashtrojnë burrin, librat më së pari e mashtrojnë poetin, o kryetagbir mos

iu anko ëndrrës sime. Huri i ngulur në mishin e njeriut shtyhet me shpirtin e robit të Zotit, edhe nga tri ditë, deri sa të vijë vdekja”.

Kryetagbitari, nga gjysmëerrësira, mendoj se i paskësh thën Besi Ban Efendisë: “Në këtë vend të Perandorisë bie shumë shi; më e rrezikshme për ushtrinë e shkretëtirës bëhet vesa e mëngjesit ngase i zë ëndrrat krejt të shpluara”.

O kryetagbir, në rrënjë të këmbëve të tua të holla të shihet rrënimi i gjinisë; ta shoh ligatinën e epshit nga kullon mëkati. Kur burrit i hiqet fara e keqe bashkë me mishin e keq të mashkullit shpëton nga mëkati i gruas dhe nga mëkati i librave. Në librat e krishterë, suret, ajetet, harfat rrugëtojnë drejt mëkatis; rrugëtojnë prej të majtës kah e djathta; rrugëtojnë prej zemrës drejt mushkërive. Në Kur’anin tonë, ajetet, suret, harfat shkojnë nga e djathta në të majtë – drejt zemrës së robit të Zotit. Kështu le të udhëtojnë ëndrrat e ushtarëve, të deveve, të konkubinave, të deveve!”

U bë krejt koha e namazit.

Në fund të namazit, Komisioni austriak e zgjoi Besi Ban Efendinë nga varri për t’ia bërë disa matje të çuditshme, ende pa i sosur fjalët me kryetagbitarin. Ia vunë instrumentet tek kryet e varrit të kthyer kah perëndimi i diellit.

“Mate kohën me aparat! Shiko mirë, a kanë ditë, muaj, vit” – tha njëri.

“Koha e tyre arketipe, që nga nata e ambasadorit roman ka rënë në Menstruacionet e Mbretëreshës së tyre Teutë. Nga kjo natë e stuhishme e Ambasadorit roman pushoi matja e kohës” – u përgjigj tetri. “Mishi arketip i tyre mbeti i pabërë në Mitrën e Mbretëreshës, Libri i tyre pa fillim e pa mbarim – Libër arketip; shkronjat e tyre arketipe udhëtojnë sa nga e majta në të djathtë, sa nga e djathta në të majtë”.

“Nxjerre kohën e tyre arketipe nga varri, nga Mitra e Mbretëreshës Teutë, nga Libri i tyre sakat. Llogaritma ku gjendet dita e sotme” – e urdhëroi ai tjetri.

“Doemos do t’i lexojmë të gjitha pllakëzat e vona në kofhsat e grave të reja nga Komisioni i Vjenës në vitin një mijë e nëntëqind e pesëdhjetë” – foli urdhërdhënësi. “Nxjerre nga turma gruan e re pasi ta ketë dorëzuar para milicist letërnjoftimin tek ura T! Përveç pllakëzës në kofshën e saj lexoje mishin e pabërë në Mitrën e Mbretëreshës Teutë!”

Komisioni i Vjenës ra në zënkë: e matën varrin, mishin e pabërë në Mitrën e Mbretëreshës Teutë, Librin sakat, e matën në të dy drejtimet – djathtas-majtas rrugën e shkronjave.

Njëri grup i Komisionit të Vjenës dha urdhër të prerë: “Le të hapet varri, menjëherë!”

Tjetri grup i Komisionit të Vjenës kundërshtoi: “Arketipi i këtij varri do ta ketë ftohtë Prillin e Ditës së Dytë”.

“Sipas llogarive të shtetit të Vjenës, cila ditë është sot?” – pyeti grupi i parë o Komisionit të Vjenës.

“Dita e dytë”.

“Po muaji, a të është lajmëruar në instrument?”

“Po”.

“Cili muaj?”

“Muaji i kat’r”.

“Prilli i Diutës së Dytë duket i ftohtë për moshën e vet. Në Mitrën e Mbretëreshës Teutë bën vapë. Le të hapet varri menjëher!” – urdhëroi grupi i parë i Komisionit të Vjenës.

Besi Ban Efendia ndjeu dhembje koke; lopata e kishte arritur fundin e varrit.

Ditën e varrimit të tij kishte pasur shumë lagështi. U ngutën t’ia hudhnin dheun përsipër pa e ndarë nga reumatizma. Njerëzit gati se ikën në të gjitha drejtimet. Në varrin e tij e harruan shiun dhe reumatizmen. Njëqind vjet në varrin e tij të

ngrohtë u dobësuan shiu dhe reumatizma. Njëqind vjetët e tjerë i zdërvoji eshtrat shlirshëm. Shekujt e tjerë u bënë të qetë, të heshtur: ai harroi ta matë kohën. Gjumi, shiu, reumatizma u pajtuan midis tyre. Stinët e shtynin njëra-tjetrën deri tek sharrimi i lopatës në fund të varrit.

“Vazhdo rrënimin e varrit!” – urdhëroi grupi i parë i Komisionit të Vjenës.

Qenka ftohtë të dalësh pas kaq shekujsh nga varri i ngrohtë” – tha Besi Ban Efendia.

“E saktë, është pikërisht ai varri i shënuar në vitin Një mijë e nëntëqind e pesëmbëdhjetë” – foli grupi i parë i Komisionit të Vjenës.

“Të kujdesemi me skeletin e tij! A i shihni se ka të ftohtë?” – kundërshtoi grupi i parë i Komisionit të Vjenës. Ngattresa midis dy komisioneve të Vjenës i shpuri ata tek Libri sakat; një kohë qëdnruan në midis të librit pa fillim e pa mbarim. Të dy komisionet e Vjenës e humbën torruan.

Pas shumë matjeve u pajtuan se ky libër paskësh mëtuar të ketë qenë thesar; fletët e mbetura të Librit e mëdyshonin njëra-tjetrën.

“Si paskan çuar meshë me këtë libër pa fillim e pa mbarim?”

Këtu çdo gjë është arketip: Libri sakat, mishi i pabërë në Mitrën e Mbretëreshës Teutë, alfabeti i ndërkryer herë djathtas, herë majtas” – tha shkencëtari austriak mjekërthinjur.

“Nxirrni kohën nga varri i tyre, nxirrni kohën nga Mirta e Mbretëreshës Teutë, nxirrni kohën nga Libri i tyre sakat! Llogaritni instrumentalisht ku gjendet dita e sotme!” – u dëgjua urdhri i gjeneralit vjenez.

“Ky skelet i nxjerrë nga varri po mërdhin; e dëgjoni si i cakëllojnë dhëmbët?” – foli njëri nga grupi i dytë i Komisionit

të Vjenës. “Të kujdesemi që, siç shkruan në raportin ushtarak të Vjenës, ikja e tyre le të mos bie ndesh me kohën e dimrit”.

“Na i jepni të dhënat kohore në instrumentet tuaja: cila ditë është sot?” – pyeti shkencëtari vjenez.

“Është dita e dytë”.

“Cili muaj?”

“Muaji i katër”.

“Cili vit?”

“Një mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë”.

“Cila orë?”

“Ora nëntë”.

“Për këtë kohë këtu bën flohtë” – ndërhyri shkencëtari vjenez.

“Mishi i pabërë po shkulet nga Mitra e Mbretëreshës Teutë”.

Nga baza ushtarake e Vjenës e urdhëruan gjeneralin të mos regjistrojë të dhëna brenda Mitrës së princeshës Tahet pranë skeletit-njeri të Besi Ban Efendisë. Ajo është hazare; sinjalet e mitrës së saj e ngatërrojnë matjen e skeletit-njeri të Besi Banit. Ajo lektis të bëhet nënë me farë eunuku.

“Mishi i pabërë, i shkukur nga Mirta e Mbretëreshës Teutë e dorëzoi letërnjoftimin në fund të Urës T” – i foli qendrës ushtarake në Vjenë gjenerali austriak.

“me çka e ngjet ditën pas orës nëntë të Prillit të Ditës së Dytë njeriu-mish i shkukur Mitrës së Mbretëreshës Teutë?” – e pyeti qendra vjenez gjeneralin austriak.

Copat e Prillit të Ditës së Dytë, të orës nëntë e orës dhjetë mishi-njeri, i shkukur nga Mitra e Mbretëreshës Teutë, po i ngjet me pështymën e NATO-s” – foli gjenerali austriak.

“Kapeni avionin e parë deri tek zyra e OSCE-së! Misioni ynë mbaroi” – e urdhëruan gjeneralin austriak nga Qendra.

Popujt e Mençur ndërtojnë pista ndihmëse në legjendat e tyre. Piloti iu ankua instruktorit për përmasat e vogla të dritares së zyrës së OSCE-së.

Instruktori e qortoi pilotin: “Popujt arketipë, gati doemosdo, e përmendin xixillonjën krahas avionit”.

Piloti u detyrua t’ia shpjegojë instruktorit se xixillonja ngordh në dimër po e lexoi keq kalendarin.

“Ti do të fluturosh lart! Mbi dhjetë mijë metra lartësi vdes çdo stinë” – e qortoi sërish pilotin.

* *

*

Besi Banit i vinte vapullimë dehëse. Zërat e nxënësve në klasë shkriheshin nën lëkurën e ditës së pjekur.

“Sonte” – i pëshpëriti princeshës Tahet tek bulëza e veshit.

Ajo, me ta dëgjuar fjalën “sonte” e tërhoqi trembshëm dorën nga kofsha e Besi Banit; vetëm atëherë i ra ndër mend se ende ishte “sot”. E kishte pjekur mashkullin.

“Sonte tek *Fontana*” – e përsëriti Besi Bani.

“Jo. Unë e kam ndaluar akulloren, në të ka shumë dimër, shumë vjeshtë. Babai më thotë se akullorja e thërret shiun para kohe”.

“Atëherë do të marrim diç të ngrohtë, diç afër korrikut” – u pajtua Besi Bani.

Buzëmbremje u Uliksiën buzë një tavoline tek zdirgjej hezitimi i dy dritave, nga brenda e nga jashtë. Bes Bani e lakmonte fitoren e dritës së dobët, të sharronte sa më thellë drejt errësirës.

Kamerieri i solli dy pije të errëta si nata e pjekur; i vuri mbi tavolinë me një erë të fortë parfumi të paporositur.

Besi Bani e kuptoi shikimin e princeshës Tahet përtej plagës së mishit të mashkullit.

Nata po piqej në hell.

“Do të shkoj në toalet” – i tha ajo.

Ai ra në pjesën më të rrëpirët të ditës; u ngrit pas asaj.

“Sonte do t’u teprojë vend kur të flejme në tehun e shpatës” – tha dikush nga tavolina tjetër.

Dikush ishte bërë xurxull.

Në fytyrën e atij tjetrit mungonin qimet e mjekrës, buzët i trasheshin, vetullat i iknin ballit përpjetë.

Shtati i princeshës Tahet e guduliste natën e pjekur në hell.

Ajo u afrua tek dera e toaletit pa shikuar në e ndiqte Besi Bani. Në sytë e saj ra tisi i mbrëmjes vjeshtore. E hetoi ngutinë e vet të tepruar; gati i rrëshqiti këmba e të bien ditën e diel.

Njeriu i dehur, nga tavolina tjetër, me gjuhë të trashur nga pija lakmonte atë gjumin teprues në tehun e shpatës: “Të gjithëve na tepron nga diçka; na tepron diç nga dita, nga libri, nga nata; na tepron diç nga mishi i ëmbël i gruas së re.

Besi Bani iu afrua Tahetit me shenjën e përkuljes në sytë e tij të mbushur plot ujë të ngrohtë. Tek ajo kishte zbritur hiri i gruasnënë. E pa veten në pasqyrë; ishte zbehur më tepër se ashti i Besi Banit në dorën e shkencëtarit austriak.

Derisa Besi Bani (merrej?) me shumëzim e fytyrave të veta, Tahet e mbylli derën e toaletit e zhgënjyer me të gjitha fytyrat e shumëzuara. Vonesa e princeshës Tahet në toalet ia tundoj dëshirën e menstruacioneve: “Le t’i ketë sonte menstruacionet; le të alivanoset sonte. “Pastaj i shikoi të gjitha fytyrat e zbehta në pasqyrë. Diku në midis të fytyrave të tij të zbehta iu shfaq Mirk Iliçi me urrjetje të kapur shushunjë në buzën e poshtme.

Besi Bani e njohu Mirk Iliçin; ai shpesh vinte në gjimnaz. Sa herë vinte zhdukej ndonjë nxënëse. Për të fliteshin

fjalë të ndryshme derisa në fund mbetej frika si bryma në vjeshtën e vonë. Nga të gjitha fytyrat e veta Besi Bani e zgjodhi më të hutuarën. Po i gëzohej vonesës së princeshës Tahet në toalet. Këtë herë përnjëmend i dëshiroi menstruacionet e saj.

Mirk Iliçi i pasqyrës e lau fytyrën, i shtrini flokët me gishtat e lagur, kutërbues erë hudhre.

Kutërbimi i hudhrës e ngacmoi mendimin e Besi Banit se Mirk Iliçi ishte dehur. E lakmoi menstruacionin njëmijëvjeçar të princeshës Tahet.

Kutërbimi i hudhrës mbeti makth kur Mirk Iliçi doli. Vetëm atëherë Besi Bani u përmend pas njëqind vjetësh; thonë grave të bukura u zgjasin menstruacionet.

Kur doli nga toaleti princesha Tahet fytyrën e kishte më të ngrehur, më të rreshkur, me një fije epshi të harruar në cep të syrit. Ajo u afrua tek pasqyra për ta marrë veten pas menstruacioneve njëqindvjeçare.

“U vonova paksa” – foli princesha me grim të pjekur në fytyrë.

“Jo” – u përgjigj fytyra më e zbehtë e Besi Banit.

Zëri i saj i ndryshuar kishte humbur diç në menstruacionet njëqindvjeçare. Ajo e mori nga pasqyra fytyrën e vet me grim të pjekur. Ata dolën.

Ai tjetri, edhe më i dehur, vazhdoi: “Nga dega e ditës së pjekur gratë i vjelin librat dhe fjalët. Me injeksion ma nxorën farën e jetës nga boshti i kurrizit. Është ogur i keq ta shohësh në ëndërr fanitjen burrëgrua. Edhe ai “Meshari” i tredhur ende e sheh atë ëndërr të trishtë, ëndërr arketip”.

“Arketip” – e përsëriti princesha Tahet.

“Po” – u përgjigj Besi Bani.

“A dehet profesori kështu?” – e pyeti princesha.

“Po. Veçanërisht kur vjen Mirk Iliçi”.

“A vjen shpesh?” – e pyeti sërish princesha.

“Ishte këtu pak më parë”.

“Pse unë mbeta pa e parë?”

“Ishe në toalet”.

“I dashuri yt me farë arketip, si edhe profesori i tij, mendon ta bëjë shtatzënë gruan e re” – mezi foli përçart profesori.

“Qenka dehur sonte profesori sa t’i flasë këto fjalë para nxënësve të vet” – u çudit princesha.

“Tri herë nga e diela deri tek e premtja kanë hequr mish mashkulli nga mishi i tij. E ke zhveshur, krejt lakuriq, për t’ia parë grepat e zeza tek mishi i mashkullit” – vazhdoi profesori, këtë herë duke e shikuar princeshën.

Princeshës Tahet iu tek të skuqet në fytyrën e saj të rreshkur, pa i ndihmuar grimin e pjekur. Sikur profesori t’i kishte folur për seksin arketip para se princesha të kishte hyrë në toalet, ajo do të ishte skuqur si një vajzushë. Besi Banit iu bë se e dalloi stinën e shiut në sytë e saj; ajo i kishte joshur, me qerpikun e vet, retë e mufatura të shiut.

“Tre mijë vjet na kanë detyruar të mbesim arketip në Mitrën e Mbretëreshës Teutë” – foli profesori prapa shishes së konjakut.

princesha Ateh u mbush ngrohtësi molle të pjekur kur iu rrit dëshira për ta grishur shiun.

Besi Bani e thirri kamerierin.

“Marrëveshjen natyra e dëbon, ajo e lakmon vetëm mendjen” – tha Besi Bani tek bulëza e veshit të princeshës Tahet.

“Natyren mund ta bësh incest, mund ta bësh arketip, mund ta bësh eunuk; mishin e ëmbël të mashkullit mund ta përdredhësh çdo ditë të namazit: të premtën, të shtunën apo të dielen, siç e përdredh lastarin kopil për ta tharë. Sonte nën

syryn e parë të urës, me dorën tënde valuke, do ta arrish rrënimin e gjinisë, grmeisjen e mishit mashkullor krej sikur gruaja e re ta grish’ shiun në ndonjëren nga ditët e lutjeve: në të premtën, të shtunën apo të dielën” – fliste profesori tashmë me mjekër të thinjur.

Besi Bani e ndjeu një të therur të përzier me kromë midis këmbëve. Toaleti i maeshkujve kishte qenë i zënë njëqind vjet.

“Po, ti, Besi, ulesh si gratë kur përmjerr?” – e pyeti pëshpëritshëm princesha.

“Më mirë i shkon kur ulet si gratë” – ironizoi këtë herë profesori i dikurshëm.

Princesha Tahet i propozoi Besi Banit të uleshin tek tavolina e mëparshme. Ajo e kishte përbuzur akulloren para toaletit të saj njëqindvjeçar.

Besi Bani deshi ta kundërshtojë me atë pak droçkë mashkulli, kur princesha krejt befas i tha: “Para se të shkoja në toalet ai ishte profesori ynë i letërsisë”.

“Kur ti ishe në toalet, shkencëtari austriak i vitit një mijë e nëntëqind e pesëmbëdhjetë, në kofshën e gruas së re e ka vënë pllakëzën për ta matur menstruacionin e saj. Ky shkencëtari austriak erdhi për t’i lexuar pllakëzat në kofhsat e gruas së re pasi ti dole nga toaleti” – u përgjigj përzëshëm Besi Bani.

“Unë shpëtova nga pllakëza e shkencëtarit vjenez” – foli princesha me gjuhë të mbushur ujë.

“Babai yt të ka mësuar ta grishësh shiun nga bjeshka” – i tha Besi Bani.

“Mrekullia e jet’s i lakmon shiun dhe epshin” – i tha me ironi princesha.

Shkencëtari austriak pasi e lexoi pllakëzën në kofshën e gruas së re udhëtoi tetëdhjetë e gjashtë vjet deri tek tavolina e

princeshës Tahet për t’i thënë: “Arketipi e flet vetëm një gjuhë. Kur e pyeta një kryetar fisi zulu se ku qëndron dallimi midis të mirës dhe të keqes, ai m’u përgjigj: “Kur unë ia rrëmbej gruan armikut, është mirë, kur armiku ma rrëmben gruan mua, është keq”.

“Unë e kam rrëmbyer Besi Ban Efendinë midis ushtrisë shkretinore aziatike të shkrirë në llucë nga shiu i grishur” – iu drejtua princesha Tahet atij shkencëtarit vjenez.

Kur u fola për *Librin* e sakatosur, për *Libri* arketip, ti e tërhoqe dorën trembshëm nga gropa e zezë e mishit të mashkullit” – e provokoi princeshën shkencëtarin.

“Synet quhet rritja e leshit e prerja e mishit të mashkullit” – u përgjigj djallëzisht princesha.

“Sonte mos e zbrit dorën atje ku e kam lexuar pllakëzën në kofshën e mashkullit”.

“Pse ju, profesor, e zgjatni zërin deri tek *Libri* juaj arketip kur mua ma ndaloni ta zbres dorën tek mishi i ëmbël i mashkullit?” – kundërshtoi princesha.

“Fara e zier rri urtë në mishin e ngrohtë të arës dhe në mishin valuk të gruas” – foli dikush pas shishes së konjakut. “*Libri* juaj kur erdhi nga Roma është gjysmë dru e gjysmë letër. Ju i besuat siç mund t’i besohet farës së zier në mishin e ngrohtë të arës e në mishin valuk të gruas së re”.

“U bë vonë” – i tha Besi Bani shikimit të princeshës.

“Po, u bë vonë”.

“Natën e mirë, profesor!” – i tha Besi Bani.

“Natën e mirë, shkencëtar!” – i tha princesha.

Ecnin ngeshëm, të ngjitur për njëri-tjërtrën kur Besi Bani pyeti: “Cilit i thamë *natën e mirë*, profesorit apo shkencëtarit? Ai sot paradreke na foli filologjikisht për *Mesharin* arketip”.

“Të përmuajshmet e mia zgjasin vetëm njëqind vjet. Midis profesorit dhe shkencëtarit, ti para toaletit, më paske pas

pritur vetëm njëqind vjet. Mirk Iliçi paskësh pas hyrë për t'i larë sytë pasi ti qenkësh frikësuar kaq shumë; mbase ne e dimë se ai sot paradreke ishte në zyrën e drejtorit të gjimnazit.

“Sonte të vjen aromë pishe” – i tha Besi Bani tek bulëza e veshit.

“Pas të përmuajshmeve të fundit dua të mbetem shtatzënë!” – sikur i tha dikujt tjetër princesha.

“Sonte ndalohet shtatzënia! Sipas llogaritjeve foshnja do të dalë fryt i dhunimit” – i iku detyrimit Besi Bani.

“Mua më duhen njëqind vjet shtatzënie për ta lindur foshnjën” – u arsyetua princesha.

“Kot, krejt kot, edhe pas njëqind vjetësh, bëhet e njëjta llogari” – iu shmang detyrimit Besi Bani.

“A dhunon eunuku?!” – u dëgjua, vetëm u dëgjua.

?!

Në rrugë, para hënës, ra një errësirë tisore. Vetëm atëherë Besi Banit iu kujtua se duhet të kishte hënë. Para derës së kazermës reflektori ndriçoi dhunshëm. Mirk Iliçi po u jepte urdhër ushtarëve ta zhveshnin një njeri. Besi Bani dhe princesha Tahet e njohën shokun e tyre të klasës.

“Sigurisht e përgatitin ndonjë dramë nga mesjeta” – tha princesha.

“Veniani helmetën në kokë!” – urdhëroi Mirk Iliçi. “Mësojani tekstin, aktrimin; nesër do t'u prijë njerëzve drejt kufirit të Shqipërisë. Ata i besojnë kësaj hekurine të vjetër”.

Oficeri e pyeti Gjergjin me katër emra brenda hekurinës: “A e ke mësuar tekstin e paradrekës?”

“Po” – u përgjigj Gjergji me katër emra brenda hekurinës së vjetër me kutërbim të hekurit të ndryshkur.

Pasi një ushtar ia vuri këmbën në yzengjinë e kalit të hekurt, dyert e hekurinës u hapën dramatikisht.

oficeri, me megafon, e pyeti nga larg: “A je Gjergji apo je Skënderbeu?”

“Jam Gjergji” – mezi u dëgjua zëri nga zguri i hekurinës së ndryshkur.

“Ky ende do ta anësojë dallimin midis tekstit të natës dhe tekstit të ditës” – foli oficeri.

“Tash është natë. Thuaje tekstin e natës!” – i tha Mirk Iliçi hekurinës së Skënderbeut, krejt nga afër.

Roja e urdhëroi me një zë paksa dramatik: “Ndalo! Kush kalon?”

“Unë, Skënderbeu” – u përgjigj hekurina.

Oficeri, bashkë me Mirk Iliçin, dolën të kënaqur nga aktrimi i hekurinës.

“Përse e bëjnë këtë teatër?” – pyeti princesha.

Njeriu arketip subjektiven e mëton jashtë vetvetes. Arketipi prore ka mbetur jashtë psikikës së subjektit. Këtë hekurinë e kanë mbyllur brenda figurës simbolike të arketipit” – i tha një zë tjetër, krejt afër veshit, princeshës Tahet.

Ajo u mundua ta gjurmojë zërin. Hezitoi të vendosë në ishte zëri i profesorit apo i shkencëtarit vjenez.

“Në librat tuaja arketip, njerëzit tuaj arketip mendojnë me kokën e pushtetit shtetëror. Midis protagonistit dhe njeriut zhduket dallimi kur pushteti dreson, siç po dresohet sonte kjo hekurinë” – sërish zëri i papërcaktuar, këtë herë i foli Besi Banit.

Brenda kazermës u dëgjua një rrapëllimë copash hekuri bashkë me të qeshurat horas të ushtarëve. hekurina e Skënderbeut ishte rrëzuar nga kali i tij gërdallë. U dëgjua rekëtimi.

“Më duket më shumë se teatër; rektima e hekurinës më duket dhimje e vërtetë” – u ankua princesha.

“Le të largohen nga këtej!” –propozoi Besi Bani.

“U zdorgjën deri tek ura T”.

Në midis të urës T Besi Banin e zuri amoku i vapullimës. Provoi ta shohë princesshën Tahet. Amoku e shtynte drejt cepit tjetër të urës T.

Në fund të urës T, devetë, ushtarët, kuajt, konkubinat po e shijonin lëngun e fundit të gjumit para agsholit të atij mëngjesi. Besi Bani u afrua tek tenda e sekretarisë. Kryetagbitari po e priste me teftër në dorë.

“efendi Sulejman Besi Ban, ne jemi gati” – iu drejtua kryetagbitari. “I kam klasifikuar të gjitha ëndrrat e ushtarëve, deveve, konkubinave, të kuajve. Mund të japësh urdhër për t’u zgjuar.

“Cila ditë do të lindë pas dy orësh?” – pyeti Sulejman Besi Ban Efendia.

“Prilli i Ditës së Dytë” – u përgjigj kryetagbitari.

* *

*

Hekurina e rrëzuar nga kali, në oborrin e kazermë po rënkonte duke thënë përvajshëm tekstin e Mirk Iliçit.

“Në orën tetë do ta nxjerrin Gjergjin e tyre tek dera e kazermës; le ta shohë populli se heroi po u prinë të dynden përtej kufirit. Tek ura T, do t’ua merrni letërnjpfimet, pasaportat, fotografitë. Këta arketipë, siç thotë ai profesori vjenez subjektiven e shohin jashtë veteves, në objekt, në fotografi. Ne ua marrim identitetin, ajo ushtria tjetër përtej lumit ua merr mishin e mashkullit”, - po i fliste koloneli.

Në tre e tridhjetë e pesë minuta cingëroi telefoni në zyrën e sigurimit të kazermës. Zëri i copëzuar si xham i krisur ra mbi tavolinë.

Kur kujdestari, i trembur, doli në oborr kah koloneli, hekraina e Gerjgit me katër emra po e bënte provën e fundit për aktrimin e nesërm.

Koloneli ia la detyrën oficerit tjetër; pa fol me kujdestarin, u nis drejt telefonit.

“Aksioni le të zbatohet rrufeshëm!” – erdhi zëri nga ana tjetër. “Të gjithë ushtarët t’i nxirrni nga kazerma e t’i vendosni në kishën e Shën Antonit; kishën sonte do ta kursejë bombardimi i NATO-s”.

Ende pa folur koloneli, hapat nëntokësorë, të ngutshëm, nevrinë e dhanë ogurin. Telefoni mbi tavolinë u zvogëlua sa një insekt. Koloneli deshi ta shkelë insektin.

“Jeni gati? Sa kohë më parë ka ardhur urdhri?” – pyeti shefi i sigurimit.

Gjysma e bisedës teproi në tavolinë, derisa koloneli në oborr e shkamcoi ngutshëm hekurinën e Skënderbeut, prej së cilës ra mishi i breshkës me duhmë të rëndë. Brenda hekurinës u zbulua një fytyrë gjasovinë, e ndotur. Gjumi ia kishte zënë deri në kalbje anën e majtë të fytyrës.

“Sa kutërbojnë librat e tyre! Pesëqind e nëntëdhjetë e shtatë vjet e kanë ruajtur këtë mish breshke brenda kësaj hekurine si ogur patriotik”, – foli me veten e vet koloneli.

I erdhi dëshirë e papërmbajtur ta qëllojë me çizme ushtarake krahas fjalës “diversion”. Goditja jote do ta prishë aktrimin e mëngjesit.

“Frika e ndërron shprehjen, ajo e vendos vetëm detyrën, bile edhe në këtë kalbësirë idiotike”, – sërish i tha vetes koloneli.

“Gjumi i dytë është më i rrezikshëm se vdekja” – nga prapa i tha shefi i sigurimit.

Kolonelit iu bë se brenda shefit të sigurimit kishte tepër konspiracion. Këtë herë ai po e sillte ose po e merrte një të keqe.

“Shoku kolonel, a po dalin të gjithë ushtarët nga kazerma?” – e pyeti shefi i sigurimit.

“Po”, - tha prerazi koloneli me një hidhërim të pathënë.
Hekurinën tashmë e hipën sërish në kalë të lyer me bojë ushtarake.

“Kështu do të duket më tepër ushtarak”, i tha vetvetes koloneli, tek feksi i parë i mëngjesit.

Koloneli urdhëroi të ndizej zjarr nën barkun e kalit, për ta tharë bojën ushtarake, kur mishi kutërbues brenda hekurinës rënkoj.

“Dy herë brenda njëzet e katër orësh kjo hekurinë rënkon sikur ta kishte zjarrin e ferrit nën bark”.

“Dy herë, the?” - e pyeti koloneli.

Prilli i Ditës së Dytë solli shi. Përkrenarja e Gjergjit me katër emra po pikonte midis dy brirëve të dhisë-cjap.

Koloneli i brengosur sikur kishte folë: “Çdo gjë tek ta pikon: historia, shtëpitë, librat, gratë”. Ai pati kohë vetëm për të dhëmnë urdhër që ta mbyllin të çarën e përkrenares. Dikush i tha ntek veshi: “Shoku kolonel pse po nguteni kaq tepër? Që njëqind vjet po bie shi”.

Koloneli e pa shiun.

Mishi i breshkës brenda hekurinës po mbytej në ujë.

Kur koloneli dha urdhër ta hapin hekurinën për të rrjedhur uji, shefi i sigurimit e kundërshtoi; çdo moment mund të godasin raketat e NATO-s.

“Le të eën deri tek kisha”, - urdhëroi Mirk Iliçi.

“Sot në gjimnaz jam marrë vesh me të. Hekurinën le ta bartin ushtarët pjesë-pjesë”.

Ushtarët e ndihmuan të zbresë nga kali i hekurt. Këmbët i ishin mpirë sa mezi eci pas aq shekujsh kalërimi brenda hekurinës.

Mirk Iliçi e urdhëroi djaloshin e zbritur nga hekurina të mos dalë në qytet; bile ia përmendi edhe vrasjen.

Ushtarët po e bartnin hekurinën pjesë-pjesë drejt kishës së Shën Andonit, Njëri ushtar po i fliste shokut të vet për atë femrën e mbrëmshme me fustan të shkurtër me vithe të mufatura nga lëngu i ndritshëm i hënës.

“Po”, - u shkreh ushtari. “Ata të dy ecnin krahas mbrëmë vonë. Tek ai burri mungonte diç; dorën ia kishte hedhur rreth belit si një dru i gdhendur keq. Skenografia do të jetë e vjetër disa shekuj ose do të jetë punuar nga ndonjë mjeshtër i keq. Druri i gdhendur keq dhe mishi valuk i femrës e kundërshtonin njëri-tjetrin”.

“E shmangën rrugën?” - pyeti ushtari tjetër me sy të picërruar jashtë. “Sikur të...”

“Ajo femër në pikë të ditës të bënë të masturbosh. E tepron me përdorimin e kripës”, - foli ushtari i parë. “U pa në dritën e hënës, pastaj në dritën e reflektorit sa hakmarrshëm e nxit masturbimin kolektiv përkundër asaj copës së drurit të gdhendur keq rreth belit të saj. Po ta kishe parë, edhe ti do të kishe masturbuar, bile edhe në revistën e mëngjesit, para kolonelit”.

Hekurinën e hipën si një kazan të vjetër; bashkë me zllapat e ujit ra edhe mishi i breshkës i pluskuar me ndryshk hekuri. Me të rënë në tokë, nga barku i çelur i kalit burrit iu buhavit fytyra nga të ftohtit e mëngjesit të Prillit të Ditës së Dytë.

“Mbase ne e grisëm mitrën e historisë së tyre”, - u ankua koloneli. “e kemi rrëzuar mundësinë biologjike për t'i kthyer sërish në menstruacionet e tyre kronike”.

Djaloshi i rënë nga barku i hekurinës e ndjeu të ftohtit e Ditës së Dytë gjatë pesëqind e tridhjetë e një vjetësh të shiut mbi lëkurën e hekurt të kalit të tij. Nëpër barkun e kalit të tij të hekurt ushtritë lëviznin në drejtime të ndryshme.

Prillin e Ditës së Dytë Gjergji me katër emra e pa shiun. Rreziku u mpiskjes së ndryshkut të qullur e detyroi kolonelin të flasë me ushtarakllëk. “Mund të shkosh deri tek dera e Kishës së Shën Antonit. Gati harrova”, - iu drejtua ushtarit. “Grasatoje djaloshin para se t’i ngjizet ndryshku i qullur!” Gjatë grasatimit Gjergji me katër mera e ndjeu një të nxehtë mbi lëkurë.

Jashtë derës së kazermës eci njëqind metra. E pa kolonelin duke u dhënë urdhra ushtarëve, me një zë të qullur, tek dera e kishës së Shën Antonit. I pa edhe pjesët e kalit të vet të magazinuara.

“Mos u largo; mos e harro tekstin; po afron mëngjesi!” - i foli koloneli.

Gjergjit me katër mera po i pëlqente lëkura e grasatuara nga ushtari. Një kalë ushtarak, i lidhur tek dera, hingëlloi plot epush. Në fund të hingëllimës së kalit ushtarak, Gjergji me katër emra mendoi: “Ç’është, kalë a pelë hekurina e tij?!”

Koloneli e njoftoi se hingëllima e kalit ushtarak nxitet nga incesti ballkanik i pjesëve të grasatuara të hekurinës.

Gjergji me katër mera e kapërceu dyshimin mbi kalëpelën e tij të hekurt përtej kishës së Shën Antonit.

Prapë e pa shiun e Prillit të Ditës së Dytë kur arriti tek kisha e Zembrës së Krishtit me datën romake në derë. E mendoi kishën tepër të ftohtë për lëkurën e tij të hekurt. Shiu i oborrit të kishës e rrëqethi derisa muzika kundruall kishës e zvogëloi shiun tek zyra e OSCE-së.

Gjergji me katër emra hyri brenda.

Teuta assesi ta thithte cigaren; sytë po i nxirrnin lot nga tymi, nga frika apo nga ndonjë pikëllim i panjohur. Me tri lloje lotësh në fytyrë ajo i dha shenjë Gjergjit me katër mera.

Në tavolinën e Mbretëreshës kishte dy gota të mbushura pa shije kamerierësh.

“Shumë u vonove!” - foli Mbretëresha.

Në sy, në fytyrë, epshi i Teutës u mpiks në tri parë lot. Ajo u ngrit në këmbë bashkë me shenjën e epshit triparëlotësh. Ishte e bukur atë natë; koha ishte ngujuar në Menstruacionet e saj siç ngujohet në zemrën e mollës sherri i pjekurisë.

Pasi nguli shenjën e grishjes në pjesën mishtake të fytyrës së Gjergjit me katër emra ajo u nis kah toaleti. Bukurinë e shtatit e tërhoqi zvarrë prapa vetes me hire të vjeshtës së pjekur. Bukuria e saj e lëpinte vetevten deri tek dera e toaletit.

Gjergji me katër emra ndaloi para lavamanit kur ajo kaloi përtej derës me një vizatim kërcënues të këpucës femërore plot elegancë. Ai e lau fytyrën e gratuar. Në pasqyrë e pau një fytyrë gjatovinë, të qullur, nga po zdirgjej ndryshku me yndyrë të gratimit. Gjatë mendoi para pasqyrës: “Cilën pjesë të fytyrës t’ia ofroj Teutës?”

“Le të zgjedh vetë ajo”, - mendoi, pa ia shkëputur sytë këpucës femërore të vizatuar plot elegancë kërcënuese, kur nga dera e sallës së mysafirëve hyri kutërbimi i madh prej hudhreve përzier me alkool. Pas duhmës së rëndë të hudhrës Gjergji me katër mera e pa nga pasqyra një pjesë të Mirk Iliçit. U largua paksa nga lavamani për t’i bërë udhë etjes së Mirk Iliçit.

Duke e fshirë kokën e qullur i foli Gjergjit me katër emra: “Prej nga ti kështu? A ke lejedalje nga kazerma”.

“Po”, - u përgjigj Gjergji me katër emra.

“Ollga, mësuesja jote e gjuhës, sot m’u ankua në recitim tënd”, - e qortoi Mirk Iliçi.

“Ka depërtuar shiu brenda përkreanres”, - u shfajësua Gjergji.

“Këtu ke ardhur pas asaj zuzares? Të gjithë vini vetem për të”, e kërcënoi Mirk Iliçi.

Gjergji ndjeu pickim, pastaj kromë tek mishi i mashkullit. Mendoi të hynte në toaletin e meshkujve. Atje ishte zënë para njëqind vjetësh.

“Xherahët ua kanë hequr atë mish mashkullor”, - foli shpina e Mirk Iliçit duke dalë.

Gjergji me katër emra e dëgjoji vajin e princeshës Tahet. Ajo e kishte harruar Besi Banin në midis të ngulfatjes së gruas së re.

“Të gjithë jeni njësoj; vjetërsoheni hekurisht, pa arritur të bëheni meshkuj”, - u shkreh në vaj princesha.

“Prapë të erdhën menstruacionet?” - paskësh pas dashur t’i thotë Besi Bani.

“Po”, - u çjerr ajo për të satën herë këtij gruas së re nga lektisja për t’u bërë nëngrua.

Besi Bani, mërzitshëm, e fshini me dorë pluhurin e tavolinës.

“Sa herë, pas kaq vitesh, ktheheni në këtë dëshpërim, tek ajo tavolinë, tek këto dy gota të mallkuara”, – u shkreh ajo.

Dëgjo Besi Ban efendi!” – foli me çesendi princesha. “Sot paradreke, në klasë, Gjergji ka qenë tepër i frikësuar”.

“Ai e frikëson vetevten e tij”, - foli profesori.

“Prapë ky!” - fshani princesha.

“T’u ka mërzitur shpjegimi i tij mbi Gjergj Kastriotin”, - pyeti Besi Bani.

“Po”.

“Kur ditëve të zotit ua hiqnin mishin e mashkullit për t’i mbushur me fe, me moral, me pushtet e luftë, çka i mbetet gruas së re?” - foli profesori pas gotës së konjakut.

Profesori po sharronte në mjekrën e saporritur. Po i picërronte sytë, me vetevten e shkencëtarit, midis çjerrjes së zgjatur: “Kurvë e motit, Katarsis, Libido!”

Duhet të vizitohesh tek gjinekologu për t’u konstatuar menstruacionet e tua”, - i pëshpëriti Besi Bani.

“Ishte Mirk Iliçi tek lavamani”, - foli ndrojtshëm Gjergji me katër emra sa për ta fashitur zemërimin e tepruar të Mbretëreshës Teutë.

“Kur ishte aty?” - e pyeti Teuta neveritshëm.

“Kur ju ishit në toalet”.

Këtu në këtë vend, ende pa i sosur menstruacionet të mbytë kutërbimi i hudhrës”, - mendoi Teuta njëqind vjetët e fundit.

Profesori, i trashur gjuhësh, e thirri Gjergjin tek tavolina; e urdhëroi t’ia paguajë një shishe konjaku. Ende pa arritur Gjergji tek tavolina, profesori e porositi konjakun.

Në tabakun e kamerierit Gjergji e lëshoi një monedhë.

“Mbaje reston!” - i tha kamerierit.

Kamerieri e shikoi monedhën syzgardulluar.

“Zotëri, jeni arkeolog?” - e pyeti Gjergjin.

“Mendon ta studiojë arkeologjinë. Ashtu edhe unë i kam thënë” - ndërhyri profesori.

“Me këtë monedhë mendoni ta paguani konjakun?” - iu kthye profesori me një hidhërim të hollë në cepin e buzëve.

Gjergji nxori të tjera monedha në tabakun e kamerierit me një krenari paksa mbretërore.

“Po t’u dukën pak, merr sa të duash”.

“Zotëri, shefi im këto monedha do të m’ kthejë”.

“Thirrë shefin tënd!” - reagoi Gjergji mospërfillshëm.

Për një çast kamerieri u zhduk pas banakut. Konjakun e la në tavolinën e profesorit.

Me ngathtësinë e duarve prej shkencëtari vjenez, profesori e hapi shishen e konjakut.

“Vërtet ky konjak kaq i vjetër duhet paguar kavalierisht”, - u picërrua shkencëtari vjenez.

Shefi, një burrë i shkurtër, kokëtullac, shumë i gjallë, me një sjellje të dyshimtë, më në fund foli:

“Si qëndron puna, o shok?” - iu drejtua kamerierit të vet, sikur po e shihte për herë të parë.

“Ky shoku pagoi konjakun me këtë monedhë”- u shfajësua kamerieri duke ia treguar shefit monedhën.

Shefi e shikoi monedhën sikur e shihte për të parën herë; e shikoi paksa me vëmendje, si me kureshtje, fytyrën e Gjergjit të ndryshkur si monedha. Për një çast shefi mendoi: “Kjo fytyrë e ndryshkur të paguajë me këtë monedhë të ndryshkur?” - pyeti e prishur në çederin e fytyrës.

“Po pate marka gjermane paguaje shishen, ndryshe ktheje”, - i tha shefi më në fund Gjergjit.

Gjergji i nxori të gjitha monedhat në shuplakë të dorës. Me sjellje kalorsiake, i tha: “Merr sa të duash!”

Nga fytyra e shefit ra habia në ato monedha mbretërore; i lexoi ngathshëm emrat e shtypur në metal të monedhave: “Venetia”, “Napolitana”, “Mossul”, “Agafia”, “Scutar...”. Në monedhën e fundit mungonin disa shkronja nën protretin e skalitur të Mbretëreshës Teutë.

“Kjo fytyrë e bukur gruaje mendon ta paguajë konjakun?!” - foli paksa me qesendi shefi.

Përkthyesja e gjeneralit italian e ndezur në fytyrë, qëndroi kërcënueshëm para shefit.

“Zotëri, sa kushton konjaku?” - e pyeti me përbuzje të sheshuar përkthyesja e gjeneralit duke ia rrëmbyer nga dora monedhën “scuta...” pasi arriti ta standardizojë shprehjen në fytyrë.

Figura e gruas në monedhë e dha shenjën me qepallën e paqrpik.

“sa të ngjashme jeni”, - i foli shefi përkthyeses së gjeneralit italian.

“Po”, - u përgjigj ajo. “Me këtë monedhë ky, - bëri me dorë kah Gjergji me katër emra, - mendon ta paguajë një shishe konjak, vetëm një shishe”.

E nxehur, gjithnjë e më tepër në fytyrë, përkthyesja italiane iu kthye rrëmbyeshëm Gjergjit me katër emra: “Ik atje!” - ia bëri me dorë drejt tavolinës së Teutës ende pa e përmendur fjalën “kurvë”, meqë e ndaloi djersitja e monedhës. “Shko, në dash si Gjergj, në dash si Skënder, në dash si Kastriot, në dash si beg; asaj mbretëreshës sate i kanë ndaluar menstruacionet këtu e dy mijë vjet më parë. Çoje tek gjinekologu!”

“Edhe në klasë më vjen kështu me katër emra”, - iu drejtua profesori përkthyeses së gjeneralit italian.

Ajo e shikoi me përbuzje; ishte shkencëtari vjenez. E plagosi me shikim e me fjalë: “Në atë fenë tënde të quajtur ‘Psikanalizë’ njeriun e ke matur me kut të ri”, - me ‘Libido’”. Tek ky njeri, - bëri me dorë kah Gjergji me katër emra, - kuti yt dështon për tre emra, për gjithë atë mish të zhvatur”.

...Ditën e premte, ditën e Zotit, dy herë para dreke e sollën heqimin – xherah, pa pasur punë. Në midis të hidëhrrimit të heqimit-xherah, pse mbeti dy herë pa kryer punë, kryehaqimi i tha: “Dita, tek ky millet, vjen plot me gropa; ora dhe dita ia hedhin sherrin njëra-tjetrës; dita vjen kukudhe, me dy kërhiza, me dy mesdita të zvarura deri në fund të këmbëve. Ora nëntë allafranga dhe ora nëntë allaturka t’i japin rrugët e ndryshme. Në orën nëntë allaturka, djalin e Gjonit, i përndritshmi Padishah, do ta bëjë bir në shpirt. Pjesa e parë e emrit ‘Iskander’ ka arritur sot në mëngjes, pritet të arrijë pjesa e dytë, ‘beg’”.

Mendojmë se në pjesën e dytë të ditës së Zotit, kur ora allafranga ta ndjejë lodhjen, pjesa e fundit e emrit të tij do të

arrijë në pallat. Çdo e tepërt nga emri i tij i krishterë do të hiqet; do të hiqet baltovina e shtrirë në dy kontinente”.

Pjesa e dytë e ditës së Zotit, ajo më e rrëpinta, e sharruar në orën nëntë allaturka, e solli pjesën e fundit të emrit.

Kryeheqimin e kotur në divanin e pasdrekes e zgjuan trembshëm; i thanë se Padishahu e pret në audiencë, tash, menjëherë. kryeheqimi xherah eci, në fillim nëpër disa salla të ndriçuara, pastaj u bë gjysmerrësirë për t’u bërë errësirë. Kryetagbitari deshi ta dijë sa kishin udhëtuar nëpër errësirë kur nëpër të çarat e epërme filloi të rrjedhë dritë e dyshimtë. Gjithnjë e më tepër drita e dyshimtë po e mbështillte siluetën e udhëheqësit të rrugës deri sa sosën para dyerve të mëdha.

Kryeheqimi xherah u zvogëlua për ta dëgjuar vetveten para padishahut derisa i tha: “Nga emri i birit të Gjenit e hoqëm baltovinën e krishtërimin; nga mishi i tij mashkullor le të hiqet deri në gropë të zezë të qetësimit! Dua ta bëj djalë timin, bir në shpirt”.

Deshi ta kuptojë shenjën e molisur të dorës së Padishahut përtej gjumit. Padishahu po flinte.

I heshtur, kryeheqimi xherah u kthye nëpër korridorin e ndriçuar duke depërtuar ngapak në erën e morfinës.

Para erës së morfinës, në dhomë, e paskeshin pasë sjellë Gjergjin pa asnjë emër, të veshur me këmishë të gjatë deri në fund të këmbëve; ia hodhën gjumin e dytë brenda këmishës së mbështjellë rreth kokës.

Në fund të gjumit të dytë, ende pa u ngritur nga divani Gjergji i paemër, erdhën bijtë e princave për ta uruar synetin.

“Emrin tënd dhe trupin tënd t’i kanë pastruar nga mëkatet e kësaj bote”, - i thanë bijtë e princave duke dalë nga dhoma.

“...Ti zonjë do të thuash se ky arketip i zhveshur emrit e mishit mbetet jashtë ‘psikanalizës sime’?” - e pyeti shkencëtari vjenez.

“Këtu tepron dita, tepron gjuha, tepron mishi i njeriut. ‘Psikanalizës’ sate i ndalohet të merret me mishin e tepruar në dorën e heqim xherahut, ‘psikanalaziës’ sate i ndalohet të merret me tepricat gjuhësore të Lejbnicit”, - u çjerr përkthyesja e gjeneralit italian.

“U kam thënë prore nxënësve të mi se Mbretëresha Teutë ka qenë tepër e rrëmbyer”, - iu drejtua profesori përkthyeses së gjeneralit italian.

“Nga e di ti se kam qenë aq e rrëmbyer atë natë?” - e pyeti ajo profesorin vjenez.

“Kështu flasin librat e historianëve romakë”, - u shfajësua profesori.

“Idiot!” - u shfry përkthyesja e gjeneralit italian.

“Po si mund të psikanalizohet njeriu me tre lloje mishi në trup: me mishin e së premtës, të sështunës e të së dieles?” - trashagjuhas arsyetoi profesori.

“Në fenë tënde psikanalitike shqyrtohet vetëm mishi i Evropës, Logosi i Evropës, Gruaja e Evropës. Ti zotëri, pikërisht ti, ia shton nga dy herë mishin e mashkullit atij Doktorit tënd Faust. Gratë e Evropës me këtë dyfishim të mishit mashkullor të Doktor Faustit i shuajnë epshet prej maceje nëpër llozhet e teatrove evropaine. Ti, pikërisht ti, farën e fjaës e ke mbështjellë në tri lëkura propagandistike: Të Zotit, të Profetit, të Besimtarit”, - i erdhi zemërimi përkthyeses së gjeneralit italian. Ajo e pikasi shefin e hutuar aty afër, krejt të zvogëluar nga shtati. Ai tashmë e kishte sosur vetveten.

“Mirri këto të holla! Shporrmu sysh!” - shfryu ajo mbi kokën tullace të shefit duke ia lëshuar një grusht markash në shuplakë të dorës.

“Mbaje reston!” - e urdhëroi.

“Atë natë bënte shtrëngatë. Të gjithë ngurruan të më përcjellin tek toaleti. Ky idioti, - bëri me dorë profesori shkencëtar, - edhe tek toaleti, edhe tek shtrati katandiset t'i lexojë menstruacionet e grave mbretëresha.

Pa e pyetur në ishte Mbretëresha Teutë apo përkthyesja e gjeneralit italian profesori vjenez vazhdoi: “Në librat tanëmbretëreshat, ministrat, ambasadorët, shtetasit i mbështjellin në lëkura të kripura për të mos u prishur”, - sikur triumfoi shkencëtari profesor.

Atë natën e shtrëngatës ambasadori roman më përcolli tek toaleti. Krejt papritmas më erdhën të përmuajshmet. Ambasadori roman kishte pritur me durim kavalieri tek dera e toaletit. Roma e paskësh pas shpallur të zhdukur Ambasadorin e vet. Ai afrë Plutarku çufrak, - iu drejtua profesorit përkthyesja e gjeneralit italian, - gjakun e menstruacioneve e ngatërroi me gjakun e Ambasadorit roman. thonë se qenkësh bërë luftë. Kur dola nga toaleti e pashë se njolla e kuqe e gjakut tek këmba e Ambasadorit po ia shtonte arij zbehtësinë në fytyrë”.

“U krye çdo gjë”, - i tha Ambasadori roman. ‘ku të vemi tash?’

Krejt papritur Mbretëresha Teutë e pa bukurinë e Ambasadorit roman. “Le të zhytemi në gjumin e së shtunës”, - i propozoi ajo Ambasadorit roman.

“Të shtunën ka tepër gjumë, ka tepër harresë”, - kundërshtoi ai. “Të shtunën harresa zgjohet para diellit”.

Pasi Mbretëresha mëdyshoi, ai ia propozoi të dielën:

“E diela është tepër mishtake”.

Me zë të shkujdesshëm përkthyesja e gjeneralit italian iu drejtua Gjergjit me katër emra: “Përcjellmëni në toalet! Ajo tjetra le të presë!” – bëri me dorë kah princesha Tahet.

Përkthyesja e gjeneralit italian u mbyll përtej derës me atë këpucën elegante të vizatuar në të. Gjergji me katër emra i lau sytë para se të shikohet në pasqyrë. Bulëzat e ujit duke vrapuar fytyrës e spikatnin ndryshkun në fytyrën e tij.

Këtë herë Mirk Iliçi hyri më kujdesshëm; ishte esëll.

“Mbrend është ajo Mbretëresha kurvë?” - bëri me dorë kah këpuca elegante në fytyrë.

“Po”.

“Do të kishte qenë mirë ta marrësh me vete, nesër, tek dera e kazermës”, - i propozoi Mirk Iliçi.

“Mbretëreshën Teutë njerëzit e njohin vetem në libra për rrëmbyeshmërinë e saj. Nesër, po ta shohin tek dera e kazermës do ta marrin për një kurvë ushtarësh”, - kundërshtoi Gjergji me katër emra.

“Ajo e njohu veten në monedhën tënde”, - foli Mirk Iliçi.

“Çuditë se si përkthyesja e gjeneralit italian e njohu veten në atë monedhë!” - sikur u çmerit Gjergji.

“Për cilën po flet ti?” Për Mbretëreshën Teutë apo për përkthyesen e gjeneralit italian?” - pyeti Mirk Iliçi.

“Të dyja i ke aty; ato kanë hyrë në lëkurën e bukur të saj”, - sikur foli Gjergji.

“Kurva”, - u çinatos Mirk Iliçi.

Gjergji me katër mera sërish e shikoi fytyrën në pasqyrë mos kishin mbetur shenja gratimi. Dalloi diç si vaj e ndryshk së bashku; një vidhë në mjekër i ishte zhvendosur.

Kutërbimin e vajit ushtarak në fytyrën e Gjergjit me katër emra e dëboi aroma e parfumit; prapa tij përkthyesja e gjeneralit italian po e lyente fytyrën.

“Ishte shtrëngatë atë natë kur Ambasadori roman më përcolli deri tek toaleti”, - gati sa i pëshpëriti nga prapa përkthyesja e gjeneralit italian.

“Pak më parë këtu qe Mirk Iliçi”, - ia zhvendosi vëmendjen Gjergji.

“A pyeti për mua?” - u kreshpëros ajo.

“Ai ende në lëkurën tuaj i ngatërron Mbretëreshën Teutë me përkthyesen e gjeneralit italian”, - foli me pak qesëndi Gjergji.

Kur hsikimi i përkthyeses së gjeneralit italian u ndesh me atë të princeshës Tahet, vidha në mjekrën e Gjergjit me katër emra u zhvendos edhe më.

“Shko tek ajo”, - e urdhëroi përkthyesja Gjergjin.

Ajo vetë u nis drejt gjeneralit italian sikur po e shihte për herë të parë; ishte qetësuar krejtësisht në monedhën e vjetër.

Gjergji me katër emra në tavolinën e Mbretëreshës Teutë i pa dy gota të mbushura.

“Meshkujt tredhakë grinden rreth gruas së pamoshë. Dje në klasë profesori rropatej rreth atyre tri fjalëve. Teuta u ngacmua midis vegësh duke dalë prej klasës drejt toaletit. Në derë të klasës s ktheu fytyrën rrëmbimthi sikur deshi t’i thotë diç profesorit”, - sikur i tha dikush Gjergjit.

Ishte princesha Tahet apo përkthyesja e gjeneralit italian.

“Logosi Arketip ka mbetur i ngujuar në mitrën e gruas së pamoshë; atje d të arrijë maja e shpatës. Kot e ka profesori”, - sikur tha Mbretëresha.

“Jashtë!” - i bërtiti profesori; në gojë i mbeti fjala “kurvë”.

“Fetusi ëndërron para se të bëhet lufta. E gjithë përvoja e fetusit mbetet menstruacioni kronik”, - ndërhyri profesori vjenez. “Fetusi evropian u bë fetus social.

Gjergji me katër emra, i zhvidhosur në fytyrë, e qortoi Mbretëreshën me moralin e tij të llamarintë: “Ju po flisni kuturu; me të drejtë profesori të nxirrte jashtë klase.

Mbretëresha Teutë e vështroi me kujdes Gjergjin me katër emra; ai gjithnjë po hynte në moralin e llamarintë.

“Profesori impotent?” - u zdërvaj Mbretëresha. “Gjithnjë profesori ynë impotent e mbante dorën e majtë thellë në xhep, sikur kruante diç midis vegëve”.

Profesori e urdhëroi Gjergjin t’ia paguajë konjakun e tretë. Mbretëresha e bëri shenjën e miratimit.

“do të dehet përtej mase; ai do të marrë rrugë pas një ore”, - u ankua Gjergji.

“Do ta bartin makinat e OSCE-së deri tek kufiri”, - i tha Mbretëresha.

Ajo e nxori nga çanta një grusht monedha para se Gjergji të kishte folur. Pa i dhënë mundësinë e hezitimit e urdhëroi t’ia paguajë konjakun profesorit me ftohtësinë e monedhave të vjetra në grushtin e saj.

“Po”, - tha Gjergji pa e ditur në i tha profesorit apo kamerierit.

Gjergji me katër emra po e zbatonte urdhrin e llamarintë në orën e mësimit derisa profesori kaherë po pinte në shishen e tretë të rrëmbyer nga tabaku i kamerierit. Gjergji me katër emra dhe kamerieri po mateshin sërish rreth monedhës së dyshimtë.

“E dita”, - tha kamerieri.

“Këtë herë i kam të gjitha llojet e monedhave; mos shko te shefi!” - i tha Gjergji me zë të konvertueshëm!

Kamerieri e shikoi lakmueshëm fytyrën e gruas në monedhë, veçant kur ajo ia luajti syrin.

Pasi e hapi shishen e konjakut, shkencëtari vjenez me zë të shpëlarë fajit iu drejtua gjeneralit italian: “Sa kilometra ka nga këtu deri tek kufiri i Shqipërisë?”

Gjenerali italian u bë se po udhëtonte në fund të përkthyeses së vet; po e shikonte monedhën e vjetër-fytyrën e përkthyeses në të.

“Vërtet bënte shtrëngatë atë natë kur ti shkove në toalet? A i pate dhënë Ambasadorit roman shikim aq premtues për ta mbërthyer hutimin e tij në menstruacionet kronike? – e pyet gjenerali italian përkthyesen e vet.

“Edhe sonte po bie shi, po bën shtrëngatë”, - i tha më tepër me shikim përkthyesja fytyrëmonedhë.

“Po”.

Profesori e provoi edhe një herë ta mundë konjakun drejt gjeneralit italian: “Ambasadori roman befas e humbi rrugën e toaletit të Mbretëreshës Teutë. Thonë u vra i gjithë delegacioni roman”.

Ambasadori roman në monedhën e Mbretëreshës po mbytej në tym duhani. Ishte natë me shtrëngatë. Tymi i duhanit po vinte kushedi nga e cila luftë; e mendoi atë mikun e tij çufrak-Plutarkun.

“Logosi ynë evropian e humbi rrugën aty ku fetusit e sosit ujin e mitrës së vet. Ai Plutarku, miku yt, u bë tepër shtetëror t’i lakmojë menstruacionet e Mbretëreshës Teutë”, - u rrëmbye shkencëtari vjenez.

“Mbretëresha prore ia fshehu mikut tim, Plutarkut, të gjitha menstruacionet”, - e zuri shkencëtarin vjenez gjenerali italian.

“Ti flet nga monedha e vjetër. Njeriu kur hyn në metal i përsërit ato tri fjalët e shkruara mbi kokë. Ato tri fjalët e monedhave metalike të gdhendura mbi kokat e hyjnive, të profetëve, filozofëve...i shërbejnë trinisë së shërbesës politike

të: Shtetit-pushtetit-shtetasit”, - sikur paskësh folur shkencëtari vjenez.

“Kjo Trini e pasak sosur ujin e Mitrës së vet sipas fesë së ‘Psikanalizës’ sate”, - ironizoi gjenerali italian.

“Saktësisht”, - foli gota e konjakut. “Pyete mikun tënd, atë Plutarkun çufrak,në e dinte se Mbretëreshës Teutë i erdhën menstruacionet atë (natë?) shtrëngate. Miku yt, Plutarku, Menstruacionet e Mbretëreshës i lexoi: gjak luftë”.

“Po, duhej lufta. Ambasadori roman u zhduk bashkë me delegacionin”, - tha Plutarku pak i dehur.

“Roma e piu ujin e mitrës së vet derisa Mbretëresha ishte brenda në toalet”, - u çjerr profesori vjenez.

“Ti do të thuash se Evropa e ka pirë ujin e mitrës së vet sikur lopa kur e përbin qërojsen e vet posa ta lindë viçin”, - u stërkeq gjenerali italian.

“Saktësisht. Atë natën e shtrëngatës, kur e përcolle Mbretëreshën në toalet, miku yt, Plutarku, u mallëngjye nga humbia e jote”, - iu drejtua shkencëtari vjenez gjeneralit italian.

Ende pa e sosur hidhërimin Profesori vjenez, kamerieri e solli në tavolinën e tij një shishe uzo bashkë me një pusullë. Në të shkruante: “Të gjitha shpjegimet i keni në letër”.

Profesori u përpoq ta mundë konjakun; me syzet e trasha u thellua ta lexojë etiketën e prodhuesit të uzos. E pa skenën e trishtë të amforës në etiketën e uzos, ku Akili po e vriste Hektorin.

“Ti, me atë Libidon tënde të mallkuar po kurdis diç të dyshimtë për Akilin”, - shkruante në pusullën e sjell bashkë me shishen e uzos.

“Edhe sonte, kur po fillon Prilli i Ditës së Dytë, mbeti e dyshimtë se me cilën armë të vrau Klitemnestra. Ballin e ke të pastër nga ndonjë vurratë e vjetër. Mund të jetë bërë plaga me

heshtë, nën petkun tënd”, - profesori vjenez iu drejtua gjeneralit grek.

“Atë natë e kam provuar fuqinë mashkullore të burrit tim”, - e mbrojti përkthyesja e gjeneralit grek Agamemnonin.

“Shkrimtari yt të ka shpallur grua të përdalë; burrin tënd e ka shpallur impotent”, - u gajas profesori vjenez. “Në banjon tënde të ngrohtë shkrimtari yt gjakun e menstruacioneve tuaja e përzien me gjakun e Agamemnonit”.

“Edhe sa kohë të ka mbetur deri tek aktrimi yt i mëngjesit para kazermës?” - e pyeti Mbretëresha Gjergjin.

“Vetëm le të nisen këta të OSCE-së. Mjaft dërdëlliti profesori; siç shihet është bërë xurxull”, - u ankua Gjergji.

Përkthyesja e gjeneralit grek i kishte hipur mbi kokë profesorit; po matej ta bënte më të keqen.

“E sheh si është ndezur Klitemnestra? E ka vrarë burrin për t’i hyrë sa më thellë në gjenerali italian dashnorit”, - e provokoi Gjergjin Mbretëresha.

“Jo”, - e kundërshtoi profesori. “Menstruacionet e Klitemnestrës i ka mbyllur incesti; Agamemnoni ishte homoseksual”.

“Idiot. Një barbar të flasë kështu”, - u rrëmbye Agamemnoni ...Toka u trand nën këmbë nga raketa *Tomahok*; gruaja e re në shtrat, përtej çdo Bible e arriti Adamin ende pa u tharë glina. Eva e këshilloi ta thajë në diell mishin e ëmbël të mashkullit derisa ta ndjejë të gjallë.

“Glina e glinës përtej Biblës”.

“Mishi i mishit këtej Biblës”.

“U derdhën gotat mbi tavolinë”, - u shkri në farën e vet Mbretëresha Teutë.

“U derdhën gotat mbi tavolinë”, - foli në shtatzëninë e parë princesha Tahet.

Uji i shtuar në mitrën e Klitemnestra e mbyti incestin.

“Po si ndodhi? Unë të kem mbetur shtatzënë!” – u çmerit princesha Tahet.

Pasi toka hyri në gjendjen e re, dikush u kujtua të ndezë një, pastaj dy, pastaj shumë qirinj.

“Ç’ndodhi me tokën?” - pyeti Gjergji me katër emra duke e shikuar Mbretëreshën se si po i bënte detyrat në fletoren pakfletëshe të çupëzave.

Gjergji me një galdim të llamarintë, foli: “Ç’mund të kërkojë burri nga çupëza e kësisojt?!”

“Ti nisu tek aktrimi yt para kazermës, unë do të shkoj në tendën e Besi Banit para se ta ketë falë sabahun”, - i tha princesha Tahet.

“Raketa *Tomahok* erdhi nga deti apo nga toka juaj?” - e pyeti Agamemnoni Ambasadorin roman.

“Ç’është raketa *Tomahok*?” - e pyeti Ambasadori roman Agamemnonin.

“Tashmë le të nisen makinat e OSCE-së. Kufiri me Shqipërinë është vetëm nëntë kilometra nga këtu”, - ua ndërpreu bisedën profesori atyre të dyve.

“Pfu, pfu, ç’e ndot Evropën; çdo rrugë e asaj Libidos tënde të shpie vetëm tek religjioni i vaginës”, - iu drejtua Ambasadori roman profesorit pa e shikuar përkthyesen e vet.

Mbretëresha Teutë u fye nga fjalët e gjeneralit italian. E shikoi aprovimin e Plutarkut çufrak pa e ditur se ai do t’i thotë aty për aty Ambasadorit roman: “Ty të ka skuqur në gjak thika e Mbretëreshës Teutë”.

Përkthyesja e gjeneralit grek, shtathedhur, me përbuzje të dukshme, ia lëshoi mbi tavolinë padinë e nënshkruar nga Agamemnoni dhe nga Ambasadori roman.

Profesori që i zënë nga të dy duart; me një rën e mbante shishen e uzos, e në tjetrën gotën e konjakut.

Klitemnestra pasi ia lëshoi padinë në tavolinë, i tha: “E ke lexuar shumë atë Euripidin gënjeshtar; prej tij e ke mësuar religjionin e vaginës”.

Shkencëtari vjenez vetem e shikonte lëvizjen e heshtur të buzëve të Klitemnestrës, i mbështjellë krejtësisht në mëshikëzën e konjakut e të uzos.

“Sa memece qenka koha!” - i tha vetvetes profesori.

“Si duket e kërcënoi profesorin”, - foli Mbretëresha.

“E ka tepruar me konjak. ajo vetë i ofroi uzo”, - u shfajësua Gjergji.

“Do ta padisin profesorin në Gjyqin e Hagës për shpifje”, - i kishte thënë Mbretëresha.

“Kur gruaja i harxhon menstruacionet e veta hyn në moralin e religjionit të shtrigës”, - foli pritueshëm profesori duke dalë nga gota e konjakut.

“Vërtet do ta dënojnë me këto shprehje kaq kërcënuese”, - mendoi princesha Tahet.

Gjergjin me katër emra e priste dita e aktrimit. Në regjistrin e shkollës gjithnjë emri i dilte me shumë gabime. Profesori me një ligësi në fytyrë, përherë i dehur, e mëtonte të heqë diçka nga katër emrat: “Të katërt emrat do të të kalben pas këtij Prilli të Ditës së Dytë”.

Gjergji doli nga klasa vetëm pas kërcënimit të dytë të profesorit. U hidhërua kur i thanë se Teuta ishte shqepur gazit me profesorin e dehur.

“Ja bëre vetit. Ti i fshehe gjashtë llojet e vrasjes: tri nga Roma e tri nga Venediku. E pranove vetem atë të mushkonjës në Lezhë”, - i tha Gjergjit me katër emra profesori.

“Po pse ajo u gajas së qeshuri kur ti më nxore jashtë klase?” - e pyeti profesori.

“Cilën nga të gjashtë vdekjet e tua do të aktrosh tek dera e kazermës Prillin e Ditës së Dytë?” - e shulustrisi

(selestris?) profesori. “Ta ëndërrosh vdekjen heroike me aktrimin tënd brenda llamarinës së Gjergj Kastriotit Skënder Begut ngjan në ogur të zi. Mbrëmësonte të piku çatia e llamarinës pikërisht midis brirëve të përkrenares”, - e përzu nga klasa profesori duke ia përmendur një nga një katër emrat.

Prapë u gajas së qeshuri përkthyesja e gjeneralit italian.

Gjergji me katër emra e shikoi vëngër, gati për t’i thënë “kurvë”. E zuri atë fjalë si mizën nën gjuhë me t’i rënë ndër mend koha e gjatë e Menstruacioneve të Mbretëreshës.

Zhdukja e Ambasadorit roman e hutoi Plutarkun çufrak; pas dy javësh e ftuan në Ministri krejt të hutuar. Në Ministrinë e Punëve të Brendshme e këshilluan ta nënshkruajë variantin e parë të raportit ushtarak. Në raportin ushtarak u tha se Ambasadori roman u gjet i vdekur në shtratin e Mbretëreshës.

“Raporti i parë i Ministrisë romake u nxor nga përdorimi posa ra ndesh me Rregullën e Treshës së Logosit Evroromë; ra ndesh shteti roman me Pushtetin roman”, - sikur i foli dikujt profesori.

“Ambasadori roman mund ta ketë lakmuar kthimin e shpejt të Mbretëreshës nga toaleti”, - u rrembye përkthyesja e gjeneralit italian. “Mund ta pyetni Plutarkun”.

“Mbaj mend se në Ministri më thanë ta heq fjalën ‘shtrat’ enë vend të saj ta përdor fjalën ‘pus’”, - u çlirua Plutarku çufrak.

“Gramatika e Shtetit-Pushtet të Evroromës mbetet brenda rregullës: Menstruacion-Mitër”, - shpjegoi paksa më i zbutur shkencëtari vjenez.

Gjergji me katër emra u kthye në klasë gjatë hutimit të profesorit. E pyeti Teutën në mos e kishte shënuar profesori në regjistër.

“Të dy gotat e verës janë derdhur kur *Tomahoku* e dridhi tokën. Tashmë do të aktrosh tek dera e kazermës. Mbase

e kanë salduar përkrenaren, midis dy brirëve, tek pikonte”, - e plandosi Mbretëresha Gjergjin me katër emra.

Mbretëresha që në kohën e Mirk Iliçit ia kishte ngushtuar shikimin në fytyrën e ndryshkur të Gjergjit me katër emra. E pa se ajo vidha në mjekër ishte zhvidhosur edhe më shumë.

“Je bërë pa rruar”, - i tha ajo Gjergjit.

Profesori u përmend me shikim të ngulitur tek Gjergji pa e hequr asnjë fjalë. Të gjithë heshtën në klasë. Teutën po e nevríkoste sharritja e një dërrase të vjetër dikund jashtë. Asaj iu bë se në fytyrën e Gjergjit me katër emra ranë shumë sëmundje.

“Qytetarit, Marin Barletit, Venediku i tha: “Zgjedhe vetëm sëmundjen e Mushkonjës për vdekjen e Gjergjit tuaj me shumë emra!” Ishte natë kur e urdhëruan. Natës pareshtur i tepron diç. Tepricat e njeriut i hanë: ferri, burgu, sëmundja, vdekja, dënimi, ekzekutimi....frika”, - po fliste profesori në klasë.

“Ngritu! Është koha të aktrosh para derës së kazermës para se t’i dëgjosh të gjitha diagnozat e vdekjes sate”, - e urdhëroi Mbretëresha Gjergjin.

E zuri frika nga diagnozat floknajë të profesorit kur mendoi të niset sipas urdhrit të Mbretëreshës. Vetëm atëherë iu kujtua se orën e kishte harruar brenda kalit të llamarintë, në oborr të kazermës.

“Diagnozat falsifikohen. Pse kont Ugolini ta ketë zgjedhur vullnetarisht ferrin për vendbanim të përhershëm?” - e ndërpreu profesorin gjenerali italian.

“Krejt kot”, - u përgjigj profesori. “Tashmë klyshët e ulkonjës e kishin braktisur qumështin; tashmë hanin mish”.

“Mishi hahet në ferr; qumështi pihet në parajsë”, - u lazdrua përkthyesja italiane.

“Vetëm në ferr shkoqet mishi përvëlues i gruas së re në shtratin e natës dihatçare”, - u përpoq profesori ta përbuzë lazdrimin e përkthyeses së gjeneralit italian.

“Ti gjithnjë kthehesh vetem tek shtrati, tek epshi, tek Libido e mallkuar. Ambasadori roman e ndoqi rrugën kalorsiake të toaletit të Mbretëreshës Teutë; shtrati i saj mbeti i zbrazët aso nate e këso nate”, - kundërshtoi gjenerali italian.

Princesha Tahet i tha Besi Banit: “Pse Teuta skuqet kur profesori e shpjegon vetëm variantin zyrtar të vrasjes së Ambasadorit roman? Në secilën orë të letërsisë ajo kërkon të dalë jashtë klase”.

“Në secilën orë të letërsisë asaj i ngacmohen menstruacionet”, - u përgjigj Besi Bani.

“Vetëm fetusit të dënuar të këlluqet njëzet shekuj brenda menstruacioneve kronike i përcaktohen të gjitha llojet e vdekjes. Vdekjen ia vënë grackë tek porta e mitrës”, - po fliste profesori vjenez duke u munduar ta përzë një mendim.

“Makinat e OSCE-së u vonuan”, - u ankua Plutarku çufrak i lodhur nga provokimi i profesorit.

Mbretëresha po e nxirrte orën nga çanta për ta shikuar për Gjergjin me katër mera duke e aprovuar mendimin e Plutarkut. Profesori u nis drejt tavolinës në Mbretëreshës me një instrument në dorë.

E shikon plagën e thellë në karrigen gjinekologjike”. “Pikërisht”, - u përgjigj nga ana tjetër profesori vjenez. “Sa menjëherë, vetëm një orë pas goditjes së raketës *Timahok* fillon ndryshimi në menstruacionet kronike të Mbretëreshës”, - u galdua profesori.

Gjergji me katër emra e pyeti Mbretëreshën: “Si mundet profesori ta shohë ‘anën tjetër’ të historisë brenda menstruacioneve kronike?”

“Sipas profesorit, ‘ana tjetër’ bëhet e arrin pas muajit të nëntë. Pikërisht në muajin qershor”, - tha Mbretëresha duke e vërejtur xhelozinë në fytyrën e llamarintë të Gjergjit me katër emra.

“Po midis Prillit të Ditës së Dytë dhe qershorit ka vetëm muaji maj”, - u ankua Gjergji.

“Po ta kishe mësuar gjinekologjinë do të kishe parë se midis menstruacioneve të Mbretëreshës Teutë dhe politikës gjëllojnë: Shteti, pushteti, morali, religjioni, patriotizmi...”, - u gajas profesori vjenez me mjekrën e qullur gati duke i pikur.

“Ky profesori vjenez, me ekipin e tij para tetëgjetë e katërt vjetësh, i ka vënë pllakëzat matëse në kofshën e gruas së re për t’i matur menstruacionet e përziëra gabimisht me luftërat e tua të humbura ende pa filluar”, - foli Mbretëresha me zjarr në sy.

“Pije historinë tënde të paqenë!” - iu drejtua profesori vjenez Gjergjit me katër emra nga ‘ana tjetër’ e vrimës”. “Në anën e këtejme të vrimës të presin diagnozat e vdekjes sate të paqenë: punceura, Curis et Angustia Cordis, Taedio et senio confectus, ethe, shigjetë, helmim”.

Në derë u shfaq Mirk Iliçi. Shenjën e dorës e solli nga jashtë. Po e ftonte Gjergjin me katër emra se kishte ardhur koha të aktronte para derës së kazermës Prillin e Ditës së Dytë.

Nga jashtë oshëtimë zëri: “Makinat e OSCE-së po nisen.

* *
*

Profesori i pyeti të gjithë nxënësit nëse e dinin kush ka shkruar në tabelë; pastaj i kërcënoi. Nxënësit e mohuan mospërfillshëm duke u çmeritur me ngulmin e profesorit.

Në kulmin e hidhërimit epik për dignipzën e zëmundjes zyrtare të Gjergjit me katër emra profesori e dëgjoji të qeshurën kolektive të nxënësve. E mendoj më të keqen.

“Profesor, dikush prapë ka shkruar në tabelë”, - i tha plot gaz Bendisa.

Në tabelë ishte vizatuar logosi evropian, i prerë në tri profile. Profili i dytë e fyente profesorin duke e nyjzuar me pushtetin.

Gjergji gati sa shpëtoi pa u goditur nga profesori derisa po e fshinte tabelën. Kur Gjergji i ra në fund tabelës profesori u përpoq edhe një herë ta zyrtarizojë në klasë diagnozën: *Fibris reumatica* për vdekjen e Gjergj Kastriotit Skënder Begut.

Bendisa, këtë herë me më pak gaz, ia tërhoqi vëmendjen profesorit se sërish në tabelë u shfaq Logosi evropian në të dy profilet.

Pa e kuptuar as profesori, dikush e përmendi Internetin si faj të papërcaktuar politik.

“Çdo çast po shtohen derivatet e Logosit evropian. Sot në tabelën e klasës suaj u shfaq Logosi i imperializmit amerikan. Dikush nga ju po i then (shkel?) Kodet në Internet”, - kërcënoi drejtori duke iu afruar profesorit.

“Gjergji me katër emra, katër herë e ka infektuar Kodin në Internet”, - u shfaq në tabelë.

“...Kutërbimi i hekurinës së ndryshkur të Gjergjit me katër emra zbriti tek dera e kazermës”, - i paskësh thënë Bendisa profesorit.

“Mos e kthe kokën kah kazerma!” - e urdhëroi i ati.

“Paska ardhur Skënderbeu për të na prirë drejt kufirit me Shqipërinë”, - e përgëzoi Bendisa të atin me fjalët e fëmijës.

“Hekurinën e Skënderbeut e kanë lyer me bojë ushtarake”, - i tha i ati.

“Dëgjoni me mishin tuaj të pabërë!” - urdhëroi Koloneli tek veshi i Gjergjit me katër emra. “Do të zvarriteni prapa heroit tuaj kombëtar deri tek kufiri me Shqipërinë.

Zëri reumatik nga brenda hekurinës së Skënderbeut Bendisës i erdhi krejt i njohur nga klasa me zërin kërcënues të drejtorit.

“Gjergji me katër emra gjithnjë merrte notë të dobët në gramatikë; ai jashtë kohëve të foljes e urrente burgun e gramatikës! E do vetëm hekurin”, - fliste për shokun e klasës Bendisa.

Ajo i shikoi me ngulm sytë e Gjergjit me katër emra brenda hekurinës së Skënderbeut. E mori me mend se ai i kishte thënë ato fjalët e stërpërsëritura në klasë: “Princesha Tahet në qytetin tonë i solli ditët e breshkës: të dielën + mishtake, të shtunën Δ e zvetënuar dhe të premtën ...e gulatur (rrjepur?) mishit. Të xhumanë Besi Banit i shpalosën (përvjelën?) këmishën (gjer) mbi fytyrë për ta ndarë nga dhimbja tek mishi i mashkullit”.

“Sot Prillin e Ditës së Dytë, të premtën e parë, do të kuptoni se ditët dhe mishi i njeriut ju teprojnë.

“Ne paskemi dalë në Shqipëri!” - e përgëzoi çunin gruaja nga qyteti tjetër kur e pa Skënderbeun.

Dora e kolonelit u shkëput nga përkrenarja e Gjergjit me katër emra për ta grishur ushtarin nga kisha-kazermë me urdhëresën e shkruar: “Ikni përtej kufirit! Shtrydhni Prillin e Ditës së Dytë!” - kishte aktruar nga brenda llamarinës Gjergji me katër emra.

Pasi aktroi Gjergji me katër emra koloneli hezitoi derisa gjarpri e përbini bretkosën. Koloneli e bindi veten se gjarpri ende ngurron të hajë.

Gratë e turmës midis lojës së gjarprit me bretkosën derisa nga hekurina e Gjergjit me katër emra u zbraz mishi i breshkës në oborrin e kishës-kazermë.

“Po ta kishe ngrënë mishin e breshkës so t’i kishe shpëtuar diagnozës: *Fibris reumatic*”, - po e qortonte profesori Gjergjin me katër emra.

Gjergjit, para tabelës, po i rritej kutërbimi i mishit të breshkës për ta mundur diagnozën e parë: *Fibris reumatica*, po ë kot.

Koloneli po mendonte: “Këta vetëm aktrojnë në veshullinë e menstruacioneve kronike. Në barkun e kësaj pele, po edhe tek gjyshja e saj menstruacionet e hutuan ngjyrën e luftës. Për herë të parë pas goditjes së raketës *Tomahok* koloneli e quajti pelë kalin e Skënderbeut. E shtrydhi heshtjen e turmës para kishës-kazermë. Ushtria e kuptoi shenjën e gatshme të kolonelit për ta goditur pelën e Skënderbeut.

“Edhe Gjergjin tonë e goditi në shpinë ushtria!” - u çmerit një grua me fytyrë katrore. “E pashë gjinekologun e veshur me tesha ushtarake”.

Gruaja tjetër, afër, ia shikoi barkun e fryrë: “Mund të shkoshderi tek kufiri i Shqipërisë pa e lindur fëmijën”.

“Burrin ma kanë vrarë, moj përdalë!” - u zgurdullua gruaja fytyrëkatrore. “Ti do të ma lësh kopilin në bark”. Sot ka fare mjaft njerëz për të gjitha barqet tona”, - foli ajo gruaja tjetër.

“Do të ecim vetëm nëntë kilometra deri tek kufiri i Shqipërisë”, - aktroi sërish nga hekurina Gjergji me katër emra.

“Mami, ja po na flet Skënderbeu”, - u ngazëllye çupëza e llahtaritur.

“Dil e nxirre nga ajo drej llamarine Gjergjin me katër emra! Ka më tepër se dhjetë minuta ora e mësimit e, ai rropatet në atë hekurinë të braktitur”, - e urdëhroi profesori Bendisen.

“Atij gjithnjë i pëlqejnë llamarinat e ndryshkura”, - u përgjigj Bendisa.

Ajo e njohu shokun e klasës nga zgavrat e hekurinës së Skënderbeut, aty ku salduesi e kishte çel shikimin e ftohtë. Syri u hap me dhembje; në të kishte rënë vaj nga gratatimi ushtarak.

Koloneli, Mirk Iliçi, me shikim zhbirues po i zvogëlonte gratë si bretkosat në vapën e djegagurit. Gratë, të stepura, e kishin harruar kohën e menstruacioneve pas të vjellave të tyre kolektive.

“Katër vjet e ke burrin në Gjermani, pa të ardhur asnjëherë tek shtëpia”, - i thanë gruas zgurdullaqe, të humbur në copa të grisura gazetash.

“Qyqet ne! Na ndaluan menstruacionet”, - u alivanos një grua. Mishi eunuk, gratë barkdala, fëmijët e lemeritur po dëboheshin nga toka eunuke, nga qyteti eunuk gjymë ore pasi raketa *Tomahok* e kishte goditur barkun e tokës në oborrin e kazermës.

Njeriu i kapitur u foli dy të tjerëve të mbështjellë me pelerina të zeza: “Në Prillin e Ditës së Dytë do të maten pllakëzat e vëna para tetëdhjetë e katërt vjetësh në kofshët e grave të reja”.

“Ne, sot, jemi larg këtyre grave nëntë kilometra. Misioni i OSCE-së, sot në mëngjes, e ka kluar kufirin. Tashmë gjendemi në Shqipëri. Nga këtu aparati laparoskopik vështirë lexon mitrat e grave, apo pëllakëzat e vëna para tetëdhjetë e katërt vjetësh në kofshët e grave të reja”, - foli ndihmësi i parë i profesorit vjenez.

Profesori, i kapitur, me aparat laparoskopik po e bënte veprimin e dëshpëruar, nga nëntë kilometra largësi për t'i lexuar pllakëzat e vëna para tetëdhjetë e katërt vjetësh në kofshët e grave të reja.

“Ky profesori ynë na përzuri nga ligjëratat e Shkollës së të Merkurës në Vjenë. Tashmë na mëton t’i lexojmë nga nëntë kilometra largësi pllakëzat e vëna para tetëdhjetë e katërt vjetësh në kofhsat e grave të reja”, - u ankua ndihmësi i dytë i profesorit.

“Po flitet! Dëgjoni! Po dëgjohet!” - u çjerr profesori.

“Qenka tepër ftohtë të dalësh nga menstruacionet e ngrohta pas njëzet shekujsh. Mezi i gjeta eshtrat. I kam pas gjetur shkujdesshëm. Mendova se ato përherë do të mbesin të ndara nga mishi”, - i foli Bendisë mishi i ri i Gjonit nga barku i fryrë i Elizabetës.

Ajo shikoi në zgavrat e hekurinës së vjetër sytë e ftohtë të Gjergjit. Në sytë e tij ishte përngjitur faji nga qortimi i profesorit për vonesën në orën e mësimi.

“Pse i lakmon hekurinat e vjetra. Tashmë je burrë. A e sheh se me këto hekurina të vjetra dukesh si Magjistari nga Ozi”, - i tha profesori prtej të qeshurave të nxënësve.

Kur profesori e përmendi për të parën herë Magjistarin nga Ozi Bendisa e vërejtji gjollën e ndryshkut në fytyrën e Gjergjit.

Mishi i ri i Gjonit nga barku i fryrë i Elizabetës i foli sërish Bendisë: “Farën e shtuar në mitër e sollti njomëzimi i mishit; eshtrat u zbrujtën me mish e shpirt”.

Brendisa e diti se i foli barku i fryrë i Elizabetës.

“Po flet! Dëgjoni! Po flet mishi i ri nga barku i fryrë i Elizabetës. Eksperimenti doli me sukses”, - u galdua profesori vjenez.

“fara e shtuar në mitër nga raketa imperialiste *Tomahok* do t’ju mashtrojë. Në këtë Babel prore do të mbetet mishi veshullor, i pabërë. Lutuni, lutuni: ikja juaj të mos bie në dimër”, - foli koloneli tek përkrenarja e Skënderbeut.

Nga barku i pelës së Gjergjit me katër emra u zbraz mishi veshtullor i brshkës në plastmastin e shtruar nga katër ushtarë!

Me të dalë jashtë klasës Gjergji me katër emra, Bendisa e kishte dëgjuar hidëhrimin e profesorit: “Le të nisemi të gjithë!”

Drejtori i gjimnazit e kishte harruar shenjën e ndalimit në klasë. Koloneli u dha urdhër ushtarëve ta çmontojnë pelën e Gjergjit me katër emra. Tek filli i urës T. ushtaraku ia hudhi mbi shpinë pelës së Gjergjit plastmasin. “Të mos ndryshkesh”, - i tha.

“Tash ta sjellim pelën tënde. Salduesi dhe axhustatorët e kanë çmontuar pelën tënde; e kanë bërë të përshtatshme për fushime ushtarake”, - e ngushëloi koloneli Gjergjin me katër emra.

Ishte vegim...përtej kthjellimit të menstruacioneve Bendisa e pa shiun përzier me diellin e Prillit të Ditës së Dytë . Dita e mbushur mish të ri të Gjonit foli nga barku i fryrë i Elizabetës. Dielli i varur mbi dhëmbin e bjeshkës e zgjoi urinë e fëmijës së shashtisur. Ereniku po e zhvoshte lëkurën e thërë nëpër zaje të trasha. Prapa Bendisës po mbetej qyteti eunuk me heshtje të rysur në gojët e kambanave të kishës së Shën Antonit.

“Po u hutuam tek ura T. Ereniku do ta pijë vetveten. Pak para diagnozës *Fibris reumatica* të Gjergjit me katër emra Erenikut i mungonin dhëmbët”, - u kishte thënë profesori.

“Ditën e varrimit tim në këtë pelë të hekurt salduesit dhe axhustatorët harruan në barkun e saj shumë shi. Axhustatorët dhe salduesit e shkrinin hekurin mbi mua. Shiu plasi brenda hekurit të nxehtë pa mundur të dalë jashtë. Pas njëqind vjetësh reumatizma u dobësua apo unë u mësova me të. Shekujt e tjerë u bënë hutaq mbi shterpësinë e pelës sime. Pas

kaq vitesh kolonelit i duhen edhe mishi edhe eshtrat e mia”, - u ankua Gjergji me katër emra.

“Kujt i flet syri i ftohtë i Gjergjit?” – mendoi Bendisa duke u ngulitur në vargun e Biblës: “Lutuni! Ikja juaj të mos bie në kohë dimri”.

“A do të kthehemi kurrë më” – e pyeti të atin tek faqja e shtatëdhjetë e Biblës.

“Shiko vetëm përpara! Të shikuarit prapa të bënë gur kripe. Kështu shkruan në Biblën tënde”, - i pëshpëriti babai.

* *
*

Fundi i rrugës së varur në ajër, dyqind metra nga Kisha e Shën Antonit, e solli tek Brendisa cepin e urës T. Ajo deshi të shikojë andej nga kutërbonte tymi i oborrit të kazermës, andej kah oborri i buhavitur nga goditja e *Tomahokut*, kur në cepin e urës T. e vërejti pelën e Gjergjit të montuar me fytyrë kah perëndimi.

Koloneli e solli në midis të urës T. heshtjen e Prillit të Ditës së Dytë me makinën e kaltër të policisë.

“Skënderbeu do të na shpëtojë. Ai është shumë i fortë”, - u ngazëllye sërish çupëza.

Kolonelin e ngazëllye galdimi i çupëzës në ëndrrën e hekurit mashtrues derisa trembshëm po e mendonte shiun. Deshi ta sosë sa më shpejt mendimin e shiut për të thënë: “Para se të hyni në urën T. do ta shkundni vetveten nga supet tuaja; në cepin tjetër të urës T. do t’i hudhni në kutinë e kartonit të gjitha dokumentet”, - urdhëroi koloneli duke ia rregulluar pajisjet pelës së Skënderbeut.

Profesori po kërcënonte nga katedra pasi nxënësi paskësh thënë para syve të drejtorit: “Skënderbeu paskësh qenë i rrethprerë”.

“Përdore metodën autoritare të shpjegimit!” – e urdhëroi drejtori profesorin.

“Sa net i ke në trastën tënde?” – e ngriti në këmbë Gjergjin profesori pas asaj rrethprerjes së parë.

“Që të triat”, - u përgjigj Gjergji për habinë e Bendisë, kur e pa se makinën e policisë e zuri ngulfatja në midis të urës T.

“Po e kërkojnë dikë tek fundi i barkut të urës T. Ai gjithë natën e mblaqiti ujin me shtatë lloje kripërash”, - u frikësua krejt papritur i ati i Bnedisë.

Koloneli i hoqi dhëmbin e dytë të prillit për të kaluar Stalini me poetin çufrak nëpër midis të turmës drejt qytetit eunuk. Kur Stalini erdhi tek Pela e Skënderbuet e rroku amoku i çjerrjes: “Përbirohuni nëpër Prillin e Ditës së Dytë, andej nga erdha unë! Avionët e NATO-s po na e djegin lëkurën e shekujve tonë siç i djeg zjarri hardhucat në pyll. Ju, nëpërmes të të çelurës së Prillit të Ditës së Dytë do të bëheni qytetarë të botës. Sot po dilni nga mitra e incestit ballkanik, siç po ju thotë ajo NATO-ja juaj”.

Në fund të amokut të Stalinit heshtja dymijëvjeçare u zgjat e në cep të urës T. nën piklat e rralla të shiut duke sjellë përtomën e ndërkrjer nga majë e malit plot fërshëllimë mbi hekurinën e Skënderbeut.

“Dil jashtë!” – i kishte thënë profesori Gjergjit.

Në derë të klasës u shfaq Mirk Iliçi; e kishte zënë për dore Gjergjin me katër emra. E shtyri para profesorit duke e goditur fshehtas në brinjën e djathtë.

Nxënësit e klasës së Bendisë e dëgjuan çjerrjen e princshës Tahet. E kishte rrokur amoku u mallkimit. Gratë e

frikësuarua ua varën në qafë çunave nuskat e mësyshit. Princesha Tahet u ngrit nga banka e tretë e rreshtit të midisë mbi heshtjen e Besi Banit, siç i tha: “Ajo ushtri shkretinore, e nbështjellë në pluhur, e grishte shiun për t’u shndërruar në llucë. Nga majë e malit tri menstruacione i kam kaluar duke e grishur shiun krejt sipas këshillave të Mbretit tim të quajtur Babë.”

Në gjysmë të amokut të Tahetit në klasën e Bendisë u hap fjala se Hadumi i lagjes së vet qenka zhdukur pasi Mirk Iliçi e paskësh lënë lmuq gjumin mbi bankën e tij.

“A mund të humbasë njeriu në pleqërinë e lumit” – u çmerit Bendisa.

Në atë fund maoku makina e policisë po e gjurmonte dikë në shpinën e Urës T.

“Babi sharro thellë në kapelë! Zvogëlohu prapa syzeve!” – e urdhëroi Bendisa të atin.

Pasi kaloi edhe poeti çufrak pas Stalinit nëpër zgrapcyrën e Prillit të Ditës së Dytë, Skënderbeu e rriti aktrimin e trimërisë; një fustan i bardhë piku në barkun e butë të Erenikut.

“Lumi do ta nxjerrë jashtë një kurvë si ajo. Pesë shekuj ka qenë shtatzënë me atë hadumin e zhdukur, pa lindur kurrë as djalë, as vajzë” – u çjerr një grua, pastaj shumë gra.

“Ti je shtatzënë”, - i kishte thënë mjeku.

“Po unë...” – deshi të flasë Tahet.

“E di. Është hadum”, - ligshëm ia këputi mjeku me shikim të ulur poshtë.

“Po *Tomahoku* a sjelli farë mashkulli për të gjitha?” – u zhgreh Tahet.

“Ja, të gjitha kurvëritë e juaja doni t’i mbuloni me atë *Tomahok* të mallkuar.”

Ajo i dalloi: urrejtjen, frikën, ligësinë në fytyrën e mjekut. Ai e fliste një gjuhë të vjetër, plot lëng helmi për fetusin dhe për *Tomahokun*.

“Kopili yt e rëndon dyshimin mbi të gjitha gratë. Ky kopil i mitrës sate do t’i ketë baballarë të gjithë meshkujt e këtij qyteti”, - e mbrojti mjeku moralin e grave e të eunukëve.

“Këtej rallë kalon ndonjë kalimtar.”

“Në qytetin eunuk mitrat e grave të reja mbesin prore shterpa”, - i foli mjekut plot urrejtje.

Ajo qëndroi në paradhomën e mjekut derisa u trash muzgu. Thonë se hyri në trashësinë e parë të muzgut drejt harresës së atij mjekut aq fjalëlig.

“Princesha Tahet është dhá sikur të jetë rënduar me barrë”, - njëditë foli aq papritmas Teuta pas orës së parë të mësimi.

Besi Bani u skuq në fytyrën e tij qose deri tek shfaqja e gruas në zërin e tij. Teuta e shikoi me vëmendje fytyrën grarishte të Besi Banit duke i rënë këmba në fillim të mendimit të keq: “Këtu duhet ruajtur fytyrës së këtij deledashi aq sa shtatzënisë brenda menstruacioneve kronike.”

Për herë të parë, bashkë me gratë e tjera, dyshoi mos fustani i bardhë nga ura T. deri tek barku i butë i Erenikut të ketë qenë vetëm një halucinacion grarisht deri tek bërtinga e kolonelit: “Idiot, jepi kësaj makine! Një mijë vjet do të na ngrujosh në këtë urë të mallkuar.”

Shoferi u zvogëluar kur u rropat ta flasë të pamundurën. Koloneli e fashiti me tymin e kushedi të satës cigare tek koka e Gjergjit me katër emra të mbytur në kollitje të llamarintë.

“Kënderbeu e mbytkat tymi i duhanit!” – mendoj Bendisa duke u munduar t’ia qëllojë në pinte duhan në klasë Gjergji me katër emra.

“Dil jashtë, idiot! Në këtë klasë ndalohet duhani!” – i bërtiti profesori Gjergjit me katër emra. “Shko e sillma prindin!”

“Po babai im e ka të ndaluar të vijë në klasë, në këtë shkollë në këtë vend”, - u arsyetua Gjergji para profesorit.

“Pse? Babai yt është i syrgjynosur...?” – gati sa e pyeti profesori.

Në fund të pyetjes së profesorit Bendisa e kishte dëgjuar babain e vet: “Princesha Tahet me ujë të cemtë po i lanë menstruacionet. Ajo e mashtroi mitrën e vet dhe dëshirën e Teutës”.

“Ndalohet çdo mish mashkulli në orën e mësimi”, - sikur e qortoi profesori Tahetin.

Ajo as ndjeu dëshirë të flasë. Fytyra i rrëshqiti nën kuptimin e seciës fjalë. U frikësua për të parën herë seriozisht se profesori i hidhëruar do t'ia thërrasë prindin në shkollë. Do të zbulohet prejardhja e saj hazare.

Koloneli nga bishti i cigares sikur foli me të gjithë: “Ju e flijuat gruan pa e nërë kurrë nuse as nënë”.

Sërish Ateh u frikësua se nga të gjithë do të zbulohet origjina e saj hazare; pikërisht i bëhej se andej po shkonte koloneli derisa e nxori nga frika Gjergji me katër emra: “Në cepin tjetër të urës T. shkundni nga vetja juaj të gjitha letrat e shkruara nga e djathta në të majtë, po edhe nga e majta në të djathtë!”

Koloneli e ndaloi me shenjën e hidhërimit në fytyrë: “E ke thënë keq tekstin, tepër keq. Ç’të hyjnë ty në punë rrugëtimet e shkronjave nga e djathta në të majtë?”

Ushtarët e kuptuan në midis hidhërimit të kolonelit për ta zhbërë emblemën historike me goditje të forta çekani. Hekurinës së Skënderbeut i ranë sëmundjet në barkun e pelës së lyer me bojë ushtarake.

“Si mund të ngujohet sëmundja e grave në barkun e kësaj pele të hekur?” – erdhi nga nëntë kilometra zëri i profesorit nga aparati laparoskopik pasi arriti ta shohë vetëm përkrenaren e Gjergjit me katër emra.

“Në të gjitha pelat ballkanike, të drunjta apo të hekurta, e kanë skuqur tharmin e mitrës me incest. Në dru, në gur, në hekur, ku përfundon pela e ku fillon njeriu, ballkanasi kapardiste në kentaur”, - po fliste brenda aparatit laparoskopik profesori.

Koloneli nga bishti i cigares, me atë gradën ters të një lloj zoghardhuce iu qas urdhrin ushtarak: “Kontrolloja shtatzëninë kësaj pele pas goditjes së *Tomahokut* të mallkuar!”

Ushtaraku i gradës zoghardhuce e mori qëndrimin gatitu midis rregullës e zbatimit e më në fund u zbraz: “Shoku kolonel, pelës së hekurit i konstatohet shtatzënia”.

Koloneli e shtrydhi edhe më qëndrimin zoghardhuce për ta dhënë urdhrin tjetër: “Ekipi mjekësor le ta konstatojë punën tënde idiotike!”

Derisa dy ushtarë po e hapnin pjesën e prapme të pelës së Gjergjit me katër emra mbi Kishën e Shën Antonit u shfaq helikopteri i spitalit me kryqin e kuq, të dallueshëm qartë. prej spitalit civil e deri tek ura T. helikopteri e kishte bërë një rrugë vetëm prej një kilometri. Njerëzit u rrokën për njëri-tjetrin kur elisa e helikopterit i qapuriti (shpupurishi?) lisat e varreve.

“Po e hapin pelën e Skënderbeut. Siç duket do t’ia përdredhin mitrën pas ngulitjes së thellë të *Tomahokut* në mishin e tokës. Ushtria e kolonelit zoghardhuce po dyshon se pela e Gjergjit me katër emra mund të pjellë se ajo pela e Trojës”, - brenda aparatit laparoskopik u dëgjua zëri i profesorit pasi elisa e helikopterit e zbuloi pelën e Skënderbeut nga floknaja e lisave të varrezës.

Oficeri me gradë ushtarake zoghardhucë dorën e përvjelë, të mbështjellë me dorashkë të sterilizuar, e futi në anusin e pelës së Gjergjit me katër emra; po përpiquej ta zë me dorë mitrën e pelës.

“A të nisemi”, - u dëgjua zëri fëmijëror i Gjergjit, sikur deshi t’ia shpëtojë nderin pelës brenda qortimit në klasë kur ende profesori po fliste për variantin e katërt të vdekjes së Skënderbeut.

Në midis të diskursit të profesorit: “Markezi e Montras njoftojë prej ambasadorit të tij Giovanni Francesco de Maffei në Raguzë se Skënderbeu vdiq në betejë nga një shigjetë”, - në derë u shfaqën Mirk Iliçi dhe drejtori...

“Pse ka mbetur jashtë ky nxënës?” - pyeti nga midisi i qortimit drejtori i shkollës.

“Në çastin kur u godit me shigjetë Skënderbeu piku nga majë e kalit në lëndinë”, - vazhdoi profesori përtej pyetjes së drejtorit.

Drejtori e përsëriti pyetjen sapo Bendisës i ra ndër mend se profesori e kishte harruar jashtë klase Gjergjin qyshse ishte përmendur tymi i duhanit.

Tahet me pyetjen dënësore, të përvjedhur midis Mirk Iliçit dhe drejtorit e paska pas zgjatur si llastik diskursin e profesorit: “...Skënderbeu piku nga kali apo nga pela?”

Mirk Iliçi dhe drejtori i bënë vend midis tyre për të kaluar pyetja e Atehut kah ai nxënësi i hajthëm; Gjergji u ul pranë syve përbuzës të Teutës.

“Pse ajo Princesha Tahet pyeti për gjininë e asaj kafshe mjerane? – pyeti, e habitur, Bendisa.

“Në atë kafshën hardallinë të Karantinës Trojë, rreth së cilës u bë gjithë ai urinim, cilën gjini e vendos: të kalit apo të pelës?” – e kishte rritur ironinë profesori.

“E kanë hapur nga anusi; veterinari me gradën ushtarake të zoghardhucës po përpiqet t’ia përdredhë mitrën pelës së Skënderbeut pas goditjes së *Tomahokut*. Ka mundësi...” – ia dorëzoi me shkrim ndihmësi i parë.

“Atëherë qenka pelë”, - nga aparati laparoskopik u dëgjua qortimi i thellë i profesorit: “Po ia përdredhin aq shpejt mitrën për ta tharë fetusin”.

“Ne në shkollë e mësonim atë kafshë drusore të vjetër tre mijë vjet. Në mitrën e saj ka pasur kohë të bollshme për t’u rritur ai farë Uliksi...”, - u ankua Bendisa.

“Duhet ta kapërcejmë urën T. pasi e përmende atë ogurin Uliks. Edhe në cepin tjetër të rrës T. do ta zëmë Prillin e Ditës së Dytë”, - sharroi i ati në kapelën e vet.

Makina e policisë lëvizte një mijë vjet para-mbrapa, prej njërit prill tek tjetri Prill i Ditës së Dytë fare pranë veterinarit ushtarak me gradë zoghardhucë. E nxori foshnjën nga mitra vapullore e pelës së Skënderbeut.

“Uliksi, erdhi Uliksi!” – u dëgjua zëri i profesorit brenda aparatit laparoskopik.

Infermierja mbështolli në mnela Uliksin veshtullor plot dyshim për gjëllimin e tij.

“Vendoseni në inkubator! Do të mërdhijë pas sosjes së menstruacioneve në mitrën vapullore të Kalpelës së Skënderbeut”, - vazhdoi profesori nga aparati laparoskopik.

“Si paska arritur të jetojë ky Uliks tre mijë vjet në mitrën e përdredhur të pelës? Edhe në Libidon tënde shpërbëhet ky incest biologjik, i quajtur katarzis”, - ironizoi ndihmësi i parë i profesorit.

Pasi helikopteri u ngrit drejt spitalit civil lisat e varrezave u kreshpëruan sërish në shikimin laparoskopik të profesorit. Nga largësia nëntë kilometra ai konstatoi gjakun e përzier me bojë ushtarake të pelës së Skënderbeut. Koloneli po

e trembte kutërbimin me tym duhani krejt afër kokës së Skënderbeut pa ia vënë veshin kollitjes së tij brenda hekurinës ngulfatëse.

“Mami! Po lëviz Skënderbeu drejt urës T. Do të nisemi!” – u ngazëllye çupëza.

“Hesht!”

Pas galdimit të fëmijës koloneli u prir kah turma e zvarritur nga ura e deri tek kisha-kazermë. Shiu i posafilluar kolonelit ia lau hutimin e çastit nga fytyra; shiu e ha edhe Zërin.

“Për ta shpënë shiun deri tek ushtria e Besi Ban Efendisë Princeshës Tahet i janë dashur tri kapërcime stinësh”, - unguroi ligisht profesori duke shikuar në dritë të syrit Teutën.

Princesha Tahet mendoj në veteve: “Po ta zbulonte prejardhjen time hazare, profesori i lig do të ma thërrasë për çdo ditë prindin në shkollë. Babai im, mbreti im do të më shkojë në shpatë po të më gjejë këtu në klasë me Besi Ban Efendinë pas kastrimit të tij në Stamboll...”

* *
*

Në fillim të Prillit të Ditës së Dytë, të parën të premtë princesha Tahet iu ças ëndrrës së Besi Ban Efendisë, tek fundi i namazit, në tendën e ndriçuar nga tre shandanë rtë mëdhenj. Atë mëngjes të xhumasë së parë të Prillit të Ditës së Dytë po zvogëlohej Azia në ëndrrat e ngatërruara të ushtarëve, të deveve, të konkubinave, të kuajve, pasi raket *Tomahok* e kishte përshkuar gjumin e tyre veshtullor kah mitra e tokës.

Kryetagbitari, tek dera e tendës, derisa po e priste fundin e reçateve të Besi Ban Efendisë, e ndeshi hijallin e gruas së re, krejt të panjohur për ëndrrën eunuke. Si do t'i tagbirte

ëndrrat e ushtarëve, të deveve, të konkubinave, të kuajve, po edhe të Besi Ban Efendisë kundruall këtij oguri në hijall gruaje të re.

Përtej Erenikut po ziente asfalti i pistave të kazermës nga vapullima e *Tomahokut*.

“Nga andej paska arritur ky ogur në hijall gruaje”, - mendoi kryetagbitari pa ia prishur Besi Ban Efendisë. Gruaja hijall ia dha ogurin frikësues me shenjë dore siç iu drejtua Kryetagbitarit shikimi tek mishi më i ëmbël i gruas.

Kryetagbitari i ëndrrave e lexoi shenjën e dorës së ogurit në hijall gruaje sikur i paskësh thënë vetvetes: “Mos bje ndesh me unazën e gishtit të dorës, mos bje ndesh me tehun e shpatës!”

Kryetagbitari u përpoq në të gjitha vitet të dallojë se me cilin gisht i kishte folë oguri grua Prillin e Ditës së Dytë, në të xhumanë e parë derisa në gjysmë të reçatit të Besi Ban Efendisë i erdhi kumti:

“Besi Ban Efendia flen në mitrën e barkut të vet.”

“Estokfërllah!”

“Kështu tregon aparati laparaskopik, po edhe pllakëzat e vëna para tetëdhjetë e katërt vjetësh në kofshët e grave të reja”, - sqaroi veten profesori vjenez.

Profesori tashmë aparatin laparaskopik e kishte drejtuar në ëndrrat e ushtrisë aziate, thellë në gjumin e mbramë të ushtarëve, konkubinave, të deveve, të kuajve.

“Askujt mos ia beso ëndrrën tënde! Mashtro në fund të çdo reçati!” – i erdhi Kryetagbitarit. “Po u vonove, do të bëhet shumë vonë.”

“ishte djalli përpjetë Erenikut.”

Kryetagbitari llahtarej para kumtit të gruas-hijall, kah do ta shpiente: kah tredhja e madhe apo kah synetia e keqe.

“Të dyja të njëjta”, - i erdhi nga lumi.

“Estokfëllah!”

“Gratë e shmangin rrugën e shpirtit; ecin shtegut të rrezikshëm të shtratit. Ti vëre gishtin tënd të egër mbi këto shkronja të Allahut!” – i erdhi Kryetagbitarit në agsholin e parë të Prillit të Ditës së Dytë, të xhumanë e parë.

Profesori i rrëmbyer nga shpjegimi i kuptimit Subjekt evropian e zuri Besi Ban Efendinë tek po e shtinte dorën midis kofshëve valuke të Atehut; sikur kishte pëlçitur gjaku Besi Bani u rrëmbye kah dera e klasës. Midis rrëmbimit të Subjektit evropian profesori e urdhëroi Besi Banin të kthehej tek banka e tij.

“Në sytë e tu lexohet: lodhje, namaz, vdekje, shkretëtirë, hytbe, përtej gjumit ku shpirti dhe huri i mprehtë shthyhen midis tyre për ta fituar trupin e njeriut”, - i foli profesori shpinës së Besi Banit derisa po shkonte drejt bankës së tij.

Ateh u ndez tek ai farë shpjegimi i përzier me Subjektin evropian dhe shikimin e lexuar të Besi Banit.

“Fëmijët i shpëton besimi në fe; krenaria dhe zemërimi e thejnë zemrën e fëmijës”, - i mbajti fjalë pedagogjike profesorit. Mirk Iliçi i aprovoi me kokë të gjitha fjalët e drejtorit.

“Ju profesorët e kuptoni të fundit mashtrimin e librave tuaja, të shkrimtarëve tuaj, të grave tuaja. Librat, shkrimtarët e ndjekin shtegun e pushtetit, gratë e ndjekin shtegun e mashkullit. Librave tuaja u mungon fara e subjektit, grave tuaja u mungon fara e mashkullit”, - u kall Ateh.

Mirk Iliçi i bëri tre hapa aprovimi drejt profesorit të zhytur tashmë në sytë e Teutës. Ata të dy, drejtori dhe Mirk Iliçi, folën mbi moralin pedagogjik të profesorit.

“Librin tuaj, pikërisht atë librin tuaj të parë, në të dy anët, në fillim e në të sosur, e shartojnë me mashtrimin e

meshtarit. Nga gjysma e secilës javë tuajën fillon mashtrimi i së premtës e deri tek e djalës. Shkronjat tuaja fillojnë të ecin marramendi nga e djathta në të majtë, nga e majta në të djathtë. Tek ju ndodh gjaku në midis të alfabetit”, - e shoi Mirk Iliçi galdimin e profesorit mbi atë Subjekt evropian.

Kryetagbitari i ëndrrave, nga shikimi i gruas hijall e rriti frikën nga pushteti hadum i Besi Ban Efendisë në Prillin e Ditës së Dytë, të xhumanë e parë, para reçatit të tretë. Atë e kishin mëtuar t’i nxjerrë nga hutimi ëndrrat e ushtarëve, të konkubinave, të deveve, të kuajve; secilit t’ia gjejë ëndrrën e vet në atë pështjellim. Deshi t’i thotë Besi Ban Efendisë, në fillim të reçatit të tretë vetëm sa për provë: “Efendi, ti lakmon të lindesh edhe një herë mashkull i bërë synet keq, por jo i tredhur thellë. Shpëtoje veten me agjërime!”

Më mirë e la pa i thënë; do t’i zemëroheshin të dy, edhe gruaja, edhe Besi Bani.

Në Prillin e Ditës së Dytë, të xhumanë e parë, pa filluar reçati i tretë, Kryetagbitari u llahtaris nga sytë e princshës Tahet, të mbuluar nga agsholi i hershëm i mëngjesit. Ajo e kishte ndjerë kutërbimin e qelbit të ligatinës së mashkullit eunuk, as femër, as mashkull. Drita e shandanit tek fytyra e Kryetagbitarit e shpalosi palë-palë përpjekjen e dështuar; sikur të dy gjinitë e kishin braktisur pasi kishin dështuar në atë ligatinë.

Besi Banit iu shkalabav dora e djathtë midis vegëve të Tahetit nga fjalët zvogëluese të Mirk Iliçit, tek e zvogëlonin profesorin para tabelës: “Në Romë, sipas kalendarit të të katërt ungjijve, në vitin një mijë e shtatëqind e dy kur u zbulua *Meshari* i mashtimit tuaj. Djali juaj, ai farë Gjoni, e pau librin e gjymtë për fenë tuaj të gjymtë. Tek ju secila plagë rrah zemër në vete; ne do t’i ndihmojmë secilit nga ju të vdesë në atë anën tjetër të Erenikut, tek kazerma jonë.”

Pas zbulimit të librit *Meshari*, në gazetën *Le mond*, artikulli i dyshimtë mbi djalin e quajtur Gjon, udhëtoi me karrocë diplomatike nga Parisi në Stamboll.

Dy ministritë: e jashtme dhe e brendshme, e studiuan raportin e mabasadorit mbi *Mesharin* dhe mbi Gjonin. Në fund të raportit ambasadori e shkroi formulën e porosisë: “Kush bie ndesh me fuqinë e unazës së Padishahut dhe me tehun e shpatës së Padishahut e ka përbuzur jetën; ai do ta përqafojë vdekjen.”

Të njëzetën ditë pas raportit diplomatik të ambasadorit turk nga Roma qytetin eunuk buzë Erenikut tri herë si gjarpri katullaq e rrethoi ushtria. Mbrëmja me krrokamë sorrash iu kap në parzmë mëngjesit të Prillit të Ditës së Dytë. Njerëzit flisnin për ditën, për dritën sikur ato të kishin ndodhur një mijë vjet më parë.

Kryetagbitarit i kanë dhënë detyrë t’i shpjegojnë ëndrrat sa herë djalli e ngushton rrugën midis shkruarit e lexuesit. Ai në fillim të reçatit të tretë të Besi Banit në një dorë e mbante shandanin afër fytyrës së vet e me dorën tjetër i mbante shallvaret e rënduara nga kullimi i plagës eunuke.

“Kosh do ta konetë epshin e kësaj hergjeleje me ligatinën qelbanike të hadumit qimehollë”, - mendoi Kryetagbitari midis frikës së pushtetit të Besi Banit dhe frikës nga oguri i femrës duke i shtrënguar vegët të kujura nga shallvaret e lagura me qelb të plagës eunuke.

Princesha Tahet duke e parë cucatjen e Kryetagbitarit me një shenjë përbuzëse të dorës së saj, i ulëroi (iu hakërrua?) Kryetagbitarit: “Shko! Pëshurru si grua fatpreme, si grua barkthatë!”

Kryetagbitari i trembur, pak pa i shpëtuar nga dora, e lëshoi shandanin përdhé; iku pas tendës së Besi Banisë. Derdhi ujë me fishkëllimë hardhuce të çarë.

Tahet mezi e nxori dorën e shkalabavtë të Besi Banit nga kofshët valuke sikur e pati të zorshme të dijë ç'të bëjë me atë dorë të vyshkur hardhuce.

“Do të kutërbojë në klasë”, - mendoi Tahet duke ia dhënë profesorit një shenjë, si për t'i kërkuar leje.

Profesori e miratoi shenjën e saj deri tek dera e klasës kur i shkrepri pyetja: “Mbrëmë dole me këtë hardhucë?!”

Profesori u përpoq ta dallojë Besi Banin midis të të qeshurave. krejt papritmas profesorit e ndaloi shikimin tek Gjergji me katër emra sikur i paskësh thënë: “Të polli pela arketip, incest apo kërthi?”

“Në aparatin tënd laparoskopik vetëm arketipi paraqitet”, - ndërhyri ndihmësi i dytë i profesorit.

Profesori vjenez heshti kundruall fishkëllimës prej hardhuce të urinimit të Kryetagbitarit pas tendës së Besi Ban Efendisë sapo u përçoll lajmi i rojave deri në thellësi të tendës. Koloneli kërkoi në Prillin e Ditës së Dytë audiencë të Besi Ban Efendia. Pak para fundit të lajmit mbi audiencën e kolonelit, ai i çapiti lodhshëm fjalët sa e ngjalli tek roja dyshimin se ishte folur apo do të flitej për audiencën e atij koloneli.

Prapa tendës ende vazhdonte fishkëllima e hardhucës së Kryetagbitarit sikur po fishkëllonin të gjitha hardhucat e breglumit në vapën e djgagurit.

Sytë e princeshës Tahet e ndryshuan ngjyrën e ftohtë përballë hapit ushtarak të kolonelit. Në derën e tendës së Besi Ban Efendisë, mu në midis të urdhrat të gabuar, kur gjumi e trallis robin e Zotit u paraqit roja e ngathët me një urdhëresë në dorë.

Sipas rregullës ushtarake prej kalorësi, koloneli i bëri rrugë princeshës Tahet drejt derës së tendës në midis të lajmit të ngatërruar të rojës. Në fillim të ceremonisë ushtarake, tek dera e tendës e hudhën mbi princeshën tulin e tejdukshëm si

vetë nata. Ajri u rrallua brenda tendës së Besi Ban Efendisë. Kryetagbitari ndaloi afër divanit të Besi Ban Efendisë duke pritur shenjën e fillimit. U dha shenja e përshëndetjes më tepër sipas syve të Kryetagbitarit.

në fund të përshëndetjes ushtarake u ul nga krahu i djathtë i princeshës duke pritur kur Besi Ban Efendia sikur të mos e kishte vërejtur ardhjen e kolonelit, me zë të hollë plake i kishte pasë thënë Kryetagbitarit: “A i klasifikove ëndrrat e secilit?”

Ende pa folur Kryetagbitari, Besi Ban Efendia, me zërin edhe më të holluar prej plake, urdhëroi: “Ëndrrat e deveve, të konkubinave, të kuajve, të ushtarëve, vetëm do t’i renditësh, ëndrrën time do të ma bësh tagbir!” “Në ëndërr më shpërlan me ujë të foshnjës”, - vazhdoi pa dal nga ëndrra e mbrëmshme.

Kryetagbitari këtë herë e kuptoi se duhet të flasë para se të derdhë ujë si grua fatprerë: “Efendi, ke ëndërruar të lindesh sërish mashkull. Shpëtoje veten me agjërimit!”

Sikur e kuptoi gafletin e Kryetagbitarit koloneli ndërhyri midis Besi Banit e shpjeguesit të ëndrrave: “Ëndrrën tënde, gjumin veshtullor të ushtarëve, të konkubinave, të kuajve, të deveve i ka përshkuar tejpertej raket *Tomahok*.”

Besi Ban Efendia, i dobët si dritë kandili, u vjerr foshnjërisht në krahët e stërgjatur të Kryetagbitarit.

Princesha i dha shenjë profesorit në drejtim të Besi Banit. Profesori i dha rrugë shenjës së princeshës: “Mos e fut dorën aq thellë midis kofshëve të tij se do ta prekësh ligatinën qelbësore të eunukut!”

Koloneli po i frikësohej rritës së zemërimit të princeshës Tahet kur Besi Ban Efendia dhe Kryetagbitari ta kuptojnë se cilën deve koloneli po e quante me emrin kavrrisht *Tomahok*. Në hutesën e tyre koloneli bëri rrugë për vete kundruall padurimit të Princeshës: “Veterinarët e mi ushtarakë

e kanë hapur barkun e pelës së atij Gjergjit me katër emra nga i kanë nxjerrë kërthinjtë kopilë të asaj peles së madhe greke të Trojës.”

“Estokfërllah! Robi i Zotit të nxirret nga barku i pelës. Vetëm të krishterët kujtohen të nxjerrin foshnjën nga barku i virgjëreshës e nga barku i pelës. Vetëm kryqalinjtë Zotin e ngujojnë në anin e gruas”, - i lëshonte fjalët në prehër Besi Ban Efendia, krejt i molisur nga ajri i rënduar në tendë.

Kryetagbitari, sipas përvojës, e nxori me një urdhër molisjen e Besi Bani Efendisë jashtë tende, në ajër të freskët. Roja e derës në shenjën e Kryetagbitarit e kishte shtruar sexhaden para derës së tendës.

Fresku i Prillit të Ditës së Dytë Besi Ban Efendinë e shpuri tek ai emri i ngatërruar kavrisht nga ai koloneli.

“Kistar aga, - iu drejtua sipas titullit, - a e di ti cilën deve e quan ky koloneli me atë emër *Tomahok*?”

Kistar aga, i zënë ngushtë me këtë emër trallisës poaq sa me renditjen e ëndrrave të ushtarëve, konkubinave, deveve, kuajve e veanërsiht me ëndrrën e Besi Ban Efendisë, ngurroi për një çast për të folur: “Besi Ban Efendi, në vitin e breshkës reshën nga qielli rriske për robin e Zotit...”

Besi Ban Efendia këtë herë u ngut. Po rropatej ta kalojë shikimin në anën tjetër të Erenikut nëpër agsholin tisor të Prillit të Ditës së Dytë, sikur e kërcënoi mendimin e vonuar të Kryetagbitarit.

“Kistar aga, a di ti ta bësh tagbir ëndrrën e asaj devesë *Tomahok*?”

Kistar aga sërish u gjet ngushtë sa ta përplasë një shikim drejt kolonelit të sapodalë nga tenda; sikur po e kërkonte ndihmën e tij.

“*Tomahoku* e depërton çdo ëndërr deri tek mitra e kësaj toke shterpë”, - ndërhyri koloneli me shikim të ngulitur në dritat e syve të princeshës.

“Ushtria ime, devetë e mia, kuaj e mi, konkubinat e mia, Valideja e Padishahut pasi t’i kullojnë ëndrrat prej gjumit veshullor, vepër të cilin paska kaluar ajo deveja *Tomahok*, do ta kalojnë Erenikun për ta zbuluar Librin e tyre të quajtur *Meshar*”, - iu drejtua për herë të parë Prilli në Ditës së Dytë Besi Ban Efendia atij kolonelit sllav.

Papritmas tek dera e klasës u shfaq Mirk Iliçi apo, ende po qëndronte aty prej kur e solli brenda Gjergjin me katër emra; u ngatërrua filli. Në sytë e Teutës u vërejt krejt dukshëm mospërfillje deri në armiqësi. Si duket ajo fjala tjetër për raketën *Tomahok* e kishte zgjuar kromzën midis vegëve.

Dora e vyshkur e Besi Banit ngulmoi të zbrësë thellë në mishin e Atehut nëpër vështrimin e aparatit laparoskopik të profesorit. Ai po i shpjegonte nxënësit subjektin e Logosit evropian dhe incestin ballkanik sikur rrinë hija me trupin në sipërfaqen e lëmuar të ujit. Ai deshti të shprehë inatin në Mirk Iliçin, ngase e përdori atë fjalën “tjetër” krahas fjalës *Tomahok*.

Pa arritur t’i thotë asgjë Mirk Iliçit, profesori e trumhazi nxënësen Ateh: “Ngritu në këmbë ti!” – iu ngërmua (ngërdhuc?) nxënëses, gati për t’ia thënë atë fjalën *kurvë*”. “Pse e ngacmon me epshin tënd hazar plagën qelbanike të ballkanasit eunuk?”

Koloneli e ndjeu zemërimin e princeshës Tahet midis fjalës *Tomahok* dhe asaj fjalës tjetër këtej dëshirës së Besi Ban Efendisë për ta kaluar Erenikun.

“NATO godet nga qielli. Ushtria ortodokse doli nga kazerma për të shpëtuar në kishën e Shën Antonit”, - i erdhi.

“Estokfërllah! Një ushtri e tërë të kërkojë shpëtim në kishën e atij rjepacakut Shën Anton!” – krejt afër veshit i paskësh thënë Kryetagbitarit.

“NATO vetëm kishën e Shën Antonit e ruan nga bombardimet...” – kishte dashur të vazhdojë koloneli.

“Kistar aga! Cilën deve e quan NATO koloneli?” – Besi Ban Efendia e pyeti Kryetagbitarin.

“NATO është katolike si dhe vetë Shën Antoni”, - ndërhyri koloneli sikur po ankohej.

“Ti, kolonel, kryqin tënd ortodoks e ke futur midis dy kryqave katolikë vetëm për të shpëtuar? – i tha kolonelit Besi Ban Efendia pa e shkëputur bisedën me Kryetagbitarin. “Kistar aga! Sot, pa e sosur gjumin veshtullor ushtarët, konkubinat, kuajt devetë t’i therrësh të dy devetë kavrresha: devenë *Tomahok* dhe devenë NATO!”

Profesori e pa inatosjen në fytyrën e Besi Banit, tepër të vjetruar për moshën e tij si nxënës i gjimnazit me fjalë të përziera: “Dy kryqa katolikë e një kryq ortodoks e bëjnë vulën çifute.”

Hardhuca e vyshkur e Besi Banit, midis vegëve të Tahetit, po dihaste gojëhapur nga vapullia tek po i shmangej me ndrojtje vrojtimit të profesorit.

“Ajo mendon se çifuti shkul mish mashkulli nga vetja e vet”, - e ndoqi vetëm mendimin profesori.

Princesha Tahet deshi ta zdërvajë mendimin e ngecur: “Çifutët marrin mish mashkulli edhe tek rrisku i nuses së Sollomonit.”

Koloneli doli përpara zemërimit të princeshës Tahet sikur e kishte hetuar zemërimin e saj hazar midis fesë islame dhe fesë çifute, siç e zë një hardhucë të molisur. Ai e shprehu miratimin e ortodoksizmit krahas ankimit të Besi Ban Efendisë.

“Sa mish robi do të leni për ushtrinë time në këtë qytet?” – e pyeti Besi Ban Efendia kolonelin ortodoks.

“Pikërisht për atë marrëveshje e kam kaluar Erenikun sonte”, - u pajtua koloneli.

“Atë Gjoni, shtijakun e atij *Mesharit* e kemi dërguar ta sjellë Librin sakat, këtu, në këtë tendë.”

“Shumë paskenit pritur atë pusht. Ishte viti një mijë e shtatëqind e dyzet e dy në Prillin e Ditës së Dytë, ai ka qenë dashur të paraqitet para kësaj tende me Libër nën sqetull”, - llogariti koloneli kohën e Besi Ban Efendisë.

“Po, saktësisht”, - sipas llogarive të Kryetabitarit.

“Do ta pres vetëm edhe një orë. Po u vonua mjer për qytetin. Ushtria ime është tepër e rreptë”, - kërcënoi Besi Ban Efendia.

“Dyqind e pesëdhjetë e shtatë vjet qenke duke e pritur atë Gjonin e Librit!” – e ngacmoi koloneli. “Sot mos hyn në qytet. Do të takohen dy ushtri, mungojnë edhe pesë të tjera për t’u bërë rrëmujë.”

Princesha Tahet e ndjeu një pickim bosh në fund të barkut kur Besi Ban Efendia i tha kolonelit: “Vetëm një orë ka afat ai Gjoni i Librit për t’u paraqitur tek kjo tendë.”

“Vetëm edhe sot mos hyn në qytet! Ende veterinari im ushtarak po i nxjerr kërthinjtë nga barku i pelës së Gjergjit me katër emra”, e luti koloneli.

Profesori sërish erdhi buzë asaj fjalës tjetër tek ndaloj nga vrulli i nxënësve mbi divanin e Tahetit. Dikush e përmendi mjekun, bile edhe gjinekologun. Besi Bani i shkalafitur tek banka e vet u var në shikimin e profesorit. Nga aparati laparaskopik profesori për Besi Banin dhe për Gjonin e *Mesharit* e rrumbullakoi diagnozën: epilepsi adoleshentësh.

Makina e urgjencës hyri në oborrin e spitalit kur helikopteri ushtarak po e sillte kërthinin e tretë nga barku i

pelës së Skënderbeut. Rrëmuja e infermierëve shkonte drejt reparit obstetrik. Lektiga e Tahetit i bëri rrugë kërthinit të tretë të pelës së Skënderbeut.

Në katin e dytë të repartit obstetrik-gjinekologjik gjysmëmjekja shfryu: “Çfarë pele pjellake na qenka ajo gërdallë e vjetër!”

“Çfarë injorante je, - ia këputi kolegia, - pela e Trojës këtu e tre mijë vjet pjell kërthinj nëpër spitalet evropiane, bile nën përkujdesje të lartë shtetërore.”

“Inkubatori i tretë ka një prishje të vogël në tubin e oksigjenit. Rregollojeni para se ta vendosim këtë kërthi”, - urdhëroi gjysmëmjekja duke ia shpërthekuar fustanin Tahetit.

“Kjo grua është hazare, e një populli të zhdukur”, - i shpjegoi koloneli Besi Ban Efendisë në çastin kur hardhuca po mudohej ta arrijë gjoksin e fryrë të princeshës.

profesori heshti para rritës së hardhucës krahas menstruacioneve të zvogëluara të princeshës, anash ironisë së nxënësve, kur Besi Bani po bëhej hardhucë e zënë nga dora e gjysmëmjekes. Princesha Tahet para se të nisej e dëgjoi gjysmëmjekën: “Largojeni këtë hardhucë...”

Princesha Tahet tri ditë e net e grishi shiun nga maja e malit. Babai i saj, mbreti i saj hazar, nga shpati i tretë i Kaukazit, ia tregoi ushtrinë shkretinore, atje poshtë në fushë. Ushtria e madhe me ngjyrë të pluhurit shkretinor e bënte një gjollë bojëkafë në midis të fushës së paanë.

“e sheh atë gjollë bojëkafë atje poshtë në midis të fushës së paanë?” – e pyeti i ati, mbreti i saj, princeshën Tahet.

“Po, e shoh”, - u përgjigj princesha.

“Atë ushtri të tmerrshme, shkatërrimtare si murtajë, shiu i parë do ta shndërrojë në llucë. Ti vështroje me mishin e rinisë sate atë ushtri edhe kur ajo fle, edhe kur ajo zgjohet!” – e urdhëroi babai i saj, e urdhëroi mbreti i saj.

“Ç’do t’i bëjë shiu një ushtrie brenda tendave”, - e pyeti t’et princesha.

“Shiu i Kaukazit është i uritur për pluhur, e pluhuri shkretinor është i etshëm për shi. Kur të fillojë shiu i parë të gjithë ushtarët, devetë, konkubinat, kuajt, i rrok amoku u vrapimit nëpër shi”, - vazhdoi shpjegimin babai i saj, mbreti i saj.

“Pse duhet ta vëzhgoj me shikimin e mishit tim rinor atë ushtri ngjyrëpluhuri?” – pyeti babanë e saj, mbretin e saj.

“Thirre shiun tri ditë e tri net çdo të njëzet e tetën ditë të përmuajshmeve tuaja!” – urdhëroi babai i saj, mbreti i saj. “Pasi të vijë shiu mbi ushtrinë shkretinore ajo do të pëlcasë si pëlcasin gurët e gelqeres kur kur shuhen me ujë. Ushtria do të shndërrohet në llucë. Pas një jave në atë llucë do të mbijë një bisk. Natën vonë zbrit tek ai bisk buzë lumturisë sate.

“Sot, Prillin e Ditës së Dytë po bie shi mbi gjumin veshtullor të ushtrisë tënde shkretinore”, - e sëmboi ngazëllyeshëm koloneli Besi Banin e hardhuctë.

Koloneli e ëndërroi shpirtin e shiut mbi ushtrinë shkretinore të Besi Banit; t’ia përziejë ëndrrat e ushtarëve, të deveve, të konkubinave të ushtarëve. Kryetagbitari ta humbë dhuntinë e kullimit, të renditjes së ëndrrave. Ushtarët, devetë, konkubinat, kuajt t’i rrokë amoku i gjumit veshtullor derisa të shndërrohen në llucë. Çdo gjë e kësaj ushtrie të zhduket para revistës ushtarake të mëngjesit të Prillit të Ditës së Dytë.

“Padishahu, sipas dëshirës së Pejgamberit të pakrahasueshëm me asnjëri tjetër e ka hequr mishin mëkatnor nga robi i Zotit. Shiu tashmë rrëshqet nëpër mishin e ftohtë siç rrëshqet uji i lumit mbi gurët e shpërlarë”, - e zbuloi dëshirën e kolonelit Kryetagbitari.

Ndihmësi i dytë krejt papritur profesorin brenda aparatit laparaskopik: “Ç’do të ndodhë po të bjerë shi mbi Libidon tënde?”

“T’ia shkulësh mishin mashkullor Libidos e vret metodologjinë e punës. Shtatë perandori e kanë ngujuar Libidon e këtij populli brenda menstruacioneve kronike. Dy mijë e njëqind e nëntë vjet e kanë ndaluar të lindurit e foshnjës”, - u rrëmbye profesori.

“Këtë grua të mbushur plot menstruacione e me dhembje të lindjes e kanë sjellë gabimisht në repartin obstetrik gjinekologjik”, - e qortoi dikën gjysmëmjekja nën furinë e helikës së helikopterit. “Ç’pelë qenka ajo rrangallë e Skënderbeut?! Të satin kërthi e nxorën nga barku i saj?”

Qartë u përmend emri i Uliksit. Një tjetër e përmendi Agamemnonin, u bë tollovi para repartit obstetrik gjinekologjik. Helikopteri e kishte ngritur tek kati i tretë pluhurin e oborrit.

“Nga cila anë e Pelës së Trojës u pollën akejt atë natë: nga ana e parme apo nga ana e prapme?” – mezi pyeti gjysmëmjekja nën zhurmën e helikës së helikopterit.

“Po ai i Trojës qe kalë, bile kalë prej dërrase. Në çdo anë të tij mund t’i lenin mazgalla”, - krejt fëmijërisht foli ndihmësi i parë i profesorit.

“Ti flet çka të kenë mësuar në shkollë. Të gjitha pelat ushtarake nëpër Evropë pjellin njësoj me pelën e Trojës. Këtë pelën e Skënderbeut veterinarët ushtarakë e hapën kah anusi, sipas rregullave gjinekologjike”, - mendoi apo tha profesori. “Kjo pjellje e pelës së Skënderbeut qe vetëm imitim i dobët i skemës suhtarake evropiane”.

“Kjo grua vetëm e imiton shtatzëninë”, - qortoi gjysmëmjekja. “Në mitrën e saj shumë shekuj mungon fara e mashkullit”, - u çjerr gjysmëmjekja.

...Pasi erdhi shiu i natës së tretë u zdirgj floknajës së gjatë të princeshës Tahet deri tek ushtria e shkretëtirës. Avulli i tokës u ngriti i ngrohtë në qiell derisa pluhuri i nxehtë i ushtrisë shkretinore u shndërrua në llucë të valë.

Pas tri ditësh, të reshjes së pandërprerë, shiu iku tinëzisht nën vellon e mjegullës si ndonjë fajtor. Mjegulla filloi të çahet vende-vende, të hapen mazgalla, nga depërtuan rrezet e para të diellit mbi llucën e përhitur, të mbetur nga një ushtri e tërë.

Princesha Tahet, sipas fjalëve të babait të saj, të mbretit të saj, priti të mbijë bisku i gjelbër nga lluca e ushtrisë shkretinore. Gjashtë ditë dielli përvidhej nëpër mazgallat e reve deri tek lluca e ngrohtë plot valëzime të heshtura të shtatën ditë dielli përvëlonte nëpër të dridhurat valëzuese të ajrit.

kur dielli po qëndronte pezull mbi dhëmbët e bjeshkës u shfaq hutini i princeshës Tahet; tek bleni i flokut idhnak hutini po i zbriste në ballin e hirsuar me bojën e grurit. Ajo u zu me erën hidhnake për t'i dhënë rrugë shikimit të penguar flokësh kur thimthi i gjirit po i mufatej xiglueshëm. kur era e sosi vrapin e saj në majën e thimthit të mufatur kokërr, ajo e çoi dorën teposhtë gjinjve të saj zjarr i gjallë...

Profesorit iu zvar bistek jargësh nga goja deri në fund këmbësh fjala “kurvë hazare”, heshtazi në hutimin e nxënësve mbi alivanosjen e Atehut. Mendoi t’ua thotë nxënësve, mbase edhe ua kishte thënë: “Ja dy thimtha të mufatur gjinjsh prej ushujze”.

Gjysmëmjekja ia rroku rrëmbyeshëm dorën e Atehut të kapur mbi gjirin e djathtë sikur e ndjente sëmbimin xigluës. Furia e helikës së helikopterit, krejt e harlisur po vraponte nën fustanin e Atehut gjinjve teposhtë si e përhumur.

“Sa këso kërthinjsh do t’i sjellë gjithsej ky helikopter? Tashmë gati po mbaron orari i punës”, - e shpalli mërzinë e vet gjysmëmjekja.

“Është vetëm i tretë”, - iu bë se i tha infermieri më tepër me gishta se me zë.

Kur këmisha e hollë u qetësua mbi gjoksin e princeshës, zëri i gjysmëmjekes arriti tek infermieri kundruall saj, këtë herë plot pezmatim: “Sa kërthinj i solli elikopteri?”

“Deri tash vetëm tre”, - u dëgjua zëri i infermierit.

“Sa herë ka pjellë ajo pelë e mallkuar?” – pyeti gjysmëmjekja.

“Shtatë herë”, - i erdhi zëri.

Ajo i zgurdulloi sytë në heshtjen e infermierit.

Ndihmësi i dytë i profesorit, nga e mori nga figura hardhucë e Besi Banit i numëroi tre kërthinj të nxjerrë nga barku i Pelës së Skënderbeut.

Sa luftëtarë i polli pela prej dërrasah atë natë furtune në librin e atij Homerit?” – i erdhi zëri profesorit.

“Sa të duash!” Si duket e patën caktuar për kalë, por tek këta ballkanasit pjell edhe mushka. Homeri mund të mos e ketë parë kurrë gjininë e asaj gërdalle”, - mëdyshoi profesori. “ajo gërdallë, kalëpelë, kalëpelë polli në Athinë, pastaj çdo natë pille në skenat evropiane nën duartrokitjet frenetike të spektatorëve shtetas. Në librin e Homerit mungon numri i saktë i akejve brenda barkut të kalëpelës. Regjisorët evropianë, sipas dëshirës së pushtetarëve të tyre e rrisin dhe e zvogëlojnë numrin e akejve brenda kalëpelës”, - po fliste e po fliste profesori.

“A mund të depërtojë *Tomahoku* i John Harkerit në barkun e kalëpelës së Homerit?” – i erdhi zëri.

Posa u zërua emri *Tomahok*, koloneli e hudhi shikimin nga gjoksi i princeshës Tahet tek hardhuca. Kolonelit po i shtohej mosdurimi kur Besi Ban Efendia u ngjall paksa nga ngacmimi i

një krome në ligatinën e qelbosur të eunukut. Pas cigares së tretë koloneli e dha porosinë zyrtare: “Ti, efendi Besi Ban, frenoje zemërimin në ëndrrat veshtullore të ushtarëve të tu. Ushtria ime pas goditjes së *Tomahokut* të NATO-s po shkoq mish të keq nga ky qytet”.

Shpallja e emrit *Tomahok* tek Besi Ban Efendia e grishte ‘estokfërllahun’ zëhollë të hardhucës.

Hardhucën, Besi Ban Efendinë, e rroku riga e shiut të Prillit të Ditës së Dytë tek shkrihet ushtria shkretinore përtej përgjigjes tjetër të princeshës Tahet. Princेशa e çoi dorën tek thimthi i mufatur i gjirit në pjerrësinë e dytë të ditës së shtatë deri tek rigat e shiut të Kaukazit. Në fund të pjerrësisë së ditës së shtatë, pas shiut, gjumi i parë veshtullor e kishte trallisur mishin e robit të Zotit kur hijësimi tisor i flokëve të princeshës pluskoi mbi gjumin e ushtarit.

Ushtari deshi t’i hapë sytë kur e ëma e lëshoi vigmën në kupë të qiellit: “Kuku, ma morën djalin!”

Sytë i mbetën të mbyllur edhe kur duart e ftohta të jiniçerit e hudhën në koshin e mbushur plot fëmijë. U bë terr mbi të. Nëpërmes thuprave të koshit arriti ta shohë të ëmën përtej lumit duke e gërrithur kupën e qiellit. Nëna e piu Erenikun deri në shterim. Errësira u bë e trashë midis tij dhe të ëmës deri tek dritëhija tisore e princeshës Tahet.

Ajo e nxori ushtarin nga lluca deri rrëzë valëzimit të harlisur të tokës inatçore. Në qerpikun hijësor të princeshës robi i Zotit përumbi; e humbi peshën e llucës drejt fytyrës nagjepsëse atje në fund të floknajes pluskuese.

Rruqa e princeshës Tahet dhe rrugë e nënës së ushtarit u takuan si dy gjarpërinj tepër gjakësorë.

Ushtari piku nga koshi i errët i jeniçerit në mishin valuk të princeshës tek përumbën të gjitha stinët. Nëpër qiellin e kaltër të Kaukazit deri mbi fushën e paanë fluturonin me

thimtha të ngjitur të gjinjve, të buzëve mishtore. Ushtari ikte thellë në mugëllimin e mishit të ëmbël të princeshës.

Tek po zbritnin qiellit të shtatë drejt majës së blertë të Kaukazit me gërgëlatje galduese princesha Tahet e pyeti ushtarin: “O ushtar, nga cili vend i perandorisë vjen në ushtrinë e shkretëtirës? Cila është nëna jote?”

“Nëna ime e grithte qiellin, nëna ime e piu lumin”, - u përgjigj ushtari.

“Atëherë fli i mbështjellë në aromën e livadheve të paanë; mbase nëna jote do të ngopet me ujë”, - e mëtoi princesha ushtarin e vet.

Nëpër gjumin e parë, të pambrojtur të princeshës, hyri një ushtri e dalë fillimit e mbarimit deri tek gjumi veshtullor i ushtarit. Ia mbyllën sërish sytë; e hudhën në koshin e mbushur fëmijë.

U përpoq edhe një herë nga këtej Erenikut ta shohë nënën nëpër zgavrat e koshit tek po e pinte lumin. Ajo e kishte sosur lumin këtej etjes së saj.

Në fillim të gjumit të ngjizur të ushtarit u dëgjua kumti ogur: “Dezertor”. Pastaj u dha urdhri i prerë: “Le të dërgohet tek Kistar aga. Le t’i hiqet ajo copë mishi mashkullor. Tri perandorive: asaj romake, bizantine dhe asaj sllave u paska përvjedhur ky penis kaq i rrezikshëm”.

Sa ia hoqën brekushet e gjata e hetoi kur fresku i mbrëmjes i rrëshqiti teposhtë këmbëve lakuriqe. U bë gjysmerrësirë posa ia mbështollën kokën me këmishën e grisur. Përballë lutjeve kolektive të ushtarëve: “Allah, Allah!”, brenda këmishës së çelur për një çast ia hudhën brenda gjumin e dytë mbi gjumin e parë.

Midis të dy (vakteve të gjumit?) gjumëve u dëgjua thirrja “xherrah” sikur ta kishte thënë përgjumshëm fëmija i këputur; ushtari tashmë po udhëtonte midis dy gjumëve

(vakteve të gjumit?), i ndarë nga penisi i vet, harruar tri perandorish.

“E bënë synet?” – foli nga aparati laparaskopik ndihmësi i parë i profesorit.

“Edhe më shumë se synet”, - murmuriti profesori.

“Në të gjitha rastet hiqet mishi i mashkullit”, - e kundërshtoi ndihmësi i parë.

“Jo! Syneti dhe kastrimi ndryshojnë”, - mezi tha profesori. “Edhe pela e Skënderbeut po e aktron pjelljen aq sa syneti e aktron tredhjen e mashkullit.

“Atëherë çka bëri princesha Tahet me këtë ushtar deledash”, - gati sa pyeti ndihmësi i profesorit.

“Ajo shkoi pas tij deri në Stamboll. I thanë ta aktrojë gruan e lumtur në haremin e sulltanit, siç po e aktron kjo ushtri lindjen e kërthinjve nga pela e Skënderbeut”, - u shqetësua profesori.

“Atëherë paskan aktruar edhe akejtë në barkun e pelës së Trojës”, - e mendoi ndihmësi i profesorit.

“Aktrimi është shprehje zyrtare e pushtetit. Të gjitha ngjarjet, si dele të urta i shërbejnë pushtetit përmes aktrimit, siç i shërbeu ky Skënderbe ushtrisë serbe tek ura T”, - vazhdoi profesori. “Qysh nga Homeri i Trojës, në Athinë edhe në qendrat evropiane pelat pillnin nëpër skenat teatrore sipas vullnetit tiranik të pushtetit”.

Agamemnoni e shkeli nëpër fytyrë Uliksin në kulisat e errëta të teatrit pasi kishte përfunduar shfaqja. Uleksi e propozoi këtë kafshë sa budallaqe aq funksionale për makinerinë e shtetit. Tre mijë vjet i hudhin kashtë politike kalëpelës së Homerit nëpër teatrot evropiane me duartrokitje frenetike. Tre mijë vjet zbresin të njëjtit njerëz me litar nga barku i kalëpelës së Homerit; vrasin, presin, djegin, bëjnë kërdrinë deri tek duartrokitjet defektoze të spektatorëve. Pastaj shfaqja mbaron;

bie perdja; fiken dritat. Pastruesit e skenës i hudhin mbi njëri-tjetrin në kulisat e teatrit deri tek shfaqja tjetër. Kostumografët ua hudhin një sy para se t'i fusin sërish në barkun e kalëpelës së Homerit. Shfaqja sërish fillon, përsëritet.

“Sa vjet mund të jetojë njeriu në barkun e kalëpelës së Homerit?” – e pyeti profesorin ndihmësi i dytë.

“Deri sot, tek teatri i kësaj ushtrie”, si përbuzshëm foli profesori.

Koloneli po e thithte cigaren ngutshëm para tendës së Besi Ban Efendisë pas fluturimit të tretë të helikopterit nga spitali tek pela e Skënderbeut. Deshi ta pyesë ndihmësin, ashtu kot, sa herë kishte fluturuar helikopteri. Ai po e priste në fund të cigares së tretë përgjgjen e Besi Ban Efendisë sipas tij ajri i freskët i Prillit të Ditës së Dytë do ta shponte Besi Ban Efendinë nga katandisja fizike e hardhucës.

Koloneli e kapërceu shikimin nevrík nga sytë humbëtarë të princeshës Tahet tek Kryetagbitari në mos kishte mbetur diç nga qenërimi ushtarak. Kryetagbitari i ngriti brekushet e vjerra nga të qullurit e urinimit të shpeshtë prej gruaje. Kundruall hardhucës dhe krijesës deledash, pyetja e kolonelit u zvarrit deri tek shuarja.

Sikur ta kishte hetuar ndrojtjen e kolonelit Besi Ban Efendia i dha rrugë shenjës drejt Kryetagbitarit: “Merrja kërkesën e shkruar në letër”.

Koloneli dëshiroi të kaptojë shenjën e Besi Ban Efendisë, të vendosur në fund të raportit ushtarak. Ai deshi t'ia thotë edhe gojarisht: “Ju gjeneral do të qëndroni këtej Erenikut; rrugët e qytetit janë mbushur me mish njeriu deri tek ura T. Ushtria jote e kapërthyer ëndrrash katër shekuj bregut të këtij lumi le t'i kullojë ëndrrat e ushtarëve, të deveve, të konkubinave, të kuajve. Raket *Tomahok*, e futur thellë në mitrën e tokës i ka verbuar rrugët e perandorëve”.

“Estokfërllah!” – pëshpëriti Besi Ban Efendia në fund të herezisë së kolonelit duke e varur shikimin tek Kryetagbitari.

Profesori me kot e kishte thirrur Besi Banin të vijë tek tabela ndesh shenjës së Mirk Iliçit e hutesës teatraleë të drejtorit. Mirk Iliçi shkoi tek banka e Besi Banit për ta përvjedhur në tërësi shenjën patriotike në tabelë para se të ndërhyjë drejtori.

Profesori vjeez u shkëput rrëmbyeshëm nga shënimet patriotike në tabelën e profesorit ballkanas duke i thënë dytësorit të vet: “Ky profesor ballkanas në pellgun e menstruacioneve kronike bën shenja patriotike sipas Logosit hutaq të Platonit”.

Koloneli u ndie ngushtë midis dy të xhumave të Besi Banit sikur dytësori i tij Mirk Iliçi midis shenjës patriotike të profesorit dhe fjalisë hutaqë të Platonit. Edhe dytësorit eunuk të Besi Ban Efendisë profesori ia tërhoqi vëmendjen kundrejt ngacmimit të “kurvës hazare”: “Edhe hardhuca e marsit të ftohtë e lakmon diellin!”

Koloneli provoi edhe një herë të depërtojë midis Besi Ban Efendisë dhe Kryetagbitarit; këtë herë krejt për afër brekusheve të qullura të Kryetagbitarit. Kur e ndaloi kutërbimi i urinës koloneli i zhgënjyer mendoi: “Sa vështirë t’i dredhosh mendjes femërore të eunukut me gjymtyrë të stërkequra.”

Profesori hetoi ngurrimin ballkanik të Mirk Iliçit para shenjës patriotike në tabelë brenda konstruktit ogur të Logosit të Platonit hutaq...

...Edhe vetë profesori...

...Të gjithë profesorët ballkanikë brenda amokut patriotik të Aristotelit kur e mësoi nxënësin e vet, Aleksandrin e Madh: “Me grekët sillu si prind, me barbarët sillu si sundimtar. Ndaj grekëve sillu si ndaj miqve dhe njerëzve të afërt, barbarët përdori si i përdorim kafshët dhe bimët!” – i rrok amoku i patriotizmit aristotelian.

Kush është i menstruacioneveçur pas orës tetë të Prillit të Ditës së Dytë?

Kush është trim pas orës tetë të Prillit të Ditës së Dytë të vitit një mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë?

Kush është i pasur pas orës tetë të Prillit të Ditës së Dytë të vitit një mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë?

* *

*

“Rabii Johanan Ben Zakai”, - i erdhi.

“Kush është Rabii Johanan ben Zakai?”

“Kur luftëtarët kundër Romës vendosën në vitin 70 pas Krishtit të vdesin të gjithë se sa ta presin shkatërrimin e shtetit të Izraelit, Rabii Johanan ben Zakai bëri tradhti. Ai u largua fshehtas nga Jeruzalemi; u dorëzua tek gjenerali roman. I tha gjeneralit: “Unë heq dorë nga shteti i Izraelit, nga burokracia priftërore, nga tempulli, nga ushtria, nga kafshët e mia të shenjta, nga ritet. Unë kërkoj të ma lejoni themelimin e universitetit të judejve në Diaspor.”

“Kur je nisur nga Jeruzalemi për në tendën time?” – e pyeti gjenerali roman.

“Ishte natë e stuhishme mbrëmë. E vështirë për udhëtimin e një plaku, siç jam unë”, - u ankua Rabii ben Zakai.

“Po të më kishe pritur unë do të kisha ardhur në Jeruzalem”, - i tha gjenerali roman.

“Do të ishte bërë shumë vonë”, - e shprehu dyshimin Rabii i lodhur.

“Kush tradhtoi?” – pyeti gjenerali roman. “Ti apo Tribali i Madh i luftëtarëve fanatikë. Ushtria romane sonte hyri në Jeruzalem”.

“Tradhtia ime le të bëhet fillesa e traditës së pasur hebraike e qendresa e rabinëve fanatikë të Tribalit të Madh le

të bëhet humbja e pushtetit hebraik”, - lodhshëm ofshan Rabii ben Zakai.

Rabii ben Zakai, themelues i diasporës hebraike, i mohoi të gjitha llojet e vdekjes së traditës hebreje atë natë në tendën e gjeneralit roman. Rabii, në vend të vdekjes kolektive të të gjithë hebrenjve e zgjodhi rrugën e gjatë të Diasporës nëpër mishin e klyshit të konesë së Danielit, nëpër mishin e Djallit Mefisto të Doktor Faustit e deri tek Grigor Zanza i Francë Kafkës.

Në pjesën e parë të natës së Prillit të Ditës së Dytë, kur Jezusi i mbushi shtatëdhjetë vjet, në midis të zemërimit të Kryetagbitarit ia çatisi lajmi ogur i ëndrrës së klyshit: “Kryerabii kur jo, sonte, po vendosnit në Tribalin e Madh të vdisni të gjithë në luftë kundër Romës se sa ta prisnit shkatërrimin e shtetit të Izraelit, Rabii Johanan ben Zakai e bëri Tradhtinë e madhe: iku nga Jerusalemi, u dorëzua tek gjenerali roman. I kërkoi gjeneralit roman krijimin e universitetit hebre në Diasporë.”

A e pranoi gjenerali roman tradhtinë e Rabii ben Zakait?” – pyeti i pezmatuar kryerabii.

“Po. E pranoi.”

“Sonte ne i humbëm: shtetin, tempullin, hierarkinë priftërore, ushtrinë, kafshët tona të shenjta, ritet tona”, - mezi e tha kryerabii.

“Rabii ben Zakai, sonte në tendën e gjeneralit roman e rysi mishin e hebrenjve për ta ruajtur në mishin e klyshit të kones së Danielit, e rysi në mishin e djallit Mefisto të Doktor Faustit, e rysi në mishin e Insektit të Gregor Zanzas”, - u çjerr tuberkulozisht Franc Kafka.

“Ne rabinët e vdekjes, e kemi grishur vdekjen kolektive të hebrenjve këtej ëndrrës së klyshit të kones së Danielit”, - kumboi fundimtar zëri i Kryerabiinit.

“Në fund të mishit të klyshit të kones së Danielit, në fund të mishit të djallit Mefisto; në fund të mishit të Insektit të Gregor Zanzës u bë vdekje me bollëk e hebrenjve nëpër krematoriume”, - tha Ana Frank.

“Mos e ngutëm daljen tonë nga mishi i klyshit të kones së Danielit, nga mishi i djallit të Mefistos, nga mishi i Insektit të Gregor Zanzes!” – pyeti Rabii ben Zakai.

“Jo”, - erdhi zëri.

Tek përmendja e krematoriumit kryerabini e humbi rrugën.

Koloneli i foli Kryetagbitarit brenda brekusheve të urinuara, më fort për ta dëgjuar Besi Banin: “Mishi i këtij qyteti u fut në gabzherrin e pulës deri tek ura T; të vritet brenda menstruacioneve kronike dymijëvjeçare apo ta kalojë urën T kah universiteti në Diasporë i John Harkerit.

Kryetagbitari u fut në tendë ngutazi; sipas mendjes së kolonelit për ta shqyrtuar shenjën e mekur të Besi Bani Efendisë gati në kufirin e tagbirit. Para tendës mbetën vetëm ata të tre nën pluskimin e rigës së shiut të Prillit të Ditës së Dytë. Shiu pluskonte vetëm në ajër, sosej një metër mbi tokën e tharë. Në ëndrrën e Besi Banit të gjitha llojeve të shiut u ndalohej hyrja prej rigës e deri tek sqota e përzier me borë. princesha Tahet tashmë në karrigen gjinekologjike, e përlyer djersësh para tendës së Besi Banit me shenjën magjike e ftonte shiun hazar.

“Silljani një gotë ujë!” – porosit gjysmëmjekja. “Ç’zëzonë mashkulli paska qitë kaq pak farë në mitrën e kësaj gruaje?”

...Përtej gjumit të dytë, të ngjizur, të Besi Ban Efendisë, për të dytën herë, në mishin e robit të Zotit si thikë hyri kumti *xherah*.

Pas vdekjes nga gjumi i dytë, në fund të fjalës *xherah*, Kistar aga i parë erdhi për t'ia uruar plagën e dytë, emrin e dytë, detyrën e dytë; ia uroi gradën prej Kistar age. Ende pa u shëruar nga kutërbimi i morfinës, eunukë agat (agallarët eunukë?) ia çatisën njëri pas tjetrit me urimet në gojë të tyre të shuara zërit mashkullor: “I lumnuem kush jep sa më shumë mish të trupit për Allahun, Pejgamberin, Padishahun; i përndritshmi Padishahu i rrozullimit të ka pastruar nga epshi vrastar; tash hyn i pastër në haremin e Padishahut.”

Eunuk agat ia çatisnin në selamllëk; ashtu të qetë iknin pasi uronin me kafe e llokume. Me gjymtyrë të stërkequra mashkulli i mbanin përvjelë brekushet me plot naze grash të veja.

Shtatë ditë Hadum aga u kot midis femrës e amshkullit sikur dronte cilën rrugë ta merrte. në pjerrtësinë e ditës së shtatë Kistar aga i parë e ftoi në selamllëk Hadum agën e përgjumur:

“Të ka ndritur fati pa u sosur shtatë ditë”, - i tha. “Vdekja e Padishahut prej sonte të ka nderuar me gradën Kistar Agë në harem.”

Hadum aga ende i kotej drojës midis gjymtyrëve të stërkequra të mashkullit e nazeve të femrës për ta marrë rrugën e urimit të Kistar agës së parë.

“Tashmë netët do t’ua lidhësh ditëve në paqe të Allahut. Midis ditëve e netëve u hoq mëkati i mishit të egër.”

Vetëm kur i thanë të niset Hadum aga e kuptoi fundin e bisedës së Kistar agës së parë pa ia kthyer asnjë fjalë; ende po kotej në cepin e gjumit të dytë.

Në derë të selamllëkut të parë të haremit e priti vetë Validja e Padishahut. Sipas rregullës ajo ia zgjati shenjën e dorës Hadum agës vetëm për ta bekuar bashkëpunëtorin e saj të ardhshëm. Ashtu të trallisur nga gjumi i dytë e uli brenda

selamllëkut të parë në shilten e trashë, të rrethuar me jastë të butë. Tabakun e madh plot me shurube e llokume e sollën tri kopilka plot gaz të vrarë në gjokset e tyre të mufatura. Ato u afruan me hapa të numëruar.

Hadum aga kur e shikoi, ashtu përgjumshëm, kopilkën e parë, nga medalioni i qafores së saj të artë i erdhi shenja e zgjimit të çuditshëm. Shenjën e lexoi vetëm si ndjenjë sëmbimi derisa e nguliti shikimin në fytyrën e kopilkës së parë:

“E kujt do të jetë kjo vdekje?” – mendoi Hadum aga.

“E jotja”, - i tha medalioni i qafores, anash fytyrës së kopilkës.

Validja e Sulltanit ia uroi detyrën e re të gradës së Kistar agës në harem:

“Urtësia jote, tashmë jashtë mashkullfemrës, e arrin shpirtin e pastër; Padishahu, qoftë i lavdëruar, të shpëtojë nga mëkati i mishit të keq. Ajo kurva hazare ta pati trashur mëkatin në shtratin dymbëdhjetë pashë”, - e uroi Validja e Sulltanit.

Ajo i prini Besi Ban Sulejman Efendisë në inspektimin e parë të haremit, të gjitha rrugëve të përhumura tek siset edhe qenia mashkullfemër. Në kopshtin e fontanave, siç e quajti Validja e Sulltanit, nën tylet hijësorë Besi Ban Efendia i pa bukuroshet e haremit të Sulltanit. Për herë të parë, pas gjumit të dytë e ndjeu të ftohtit nën lëkurë; depërtues nga sytë e ftohtë të bukurosheve.

Tek sytë e ftohtë të bukuroshes së shtatë ia ngacmoi plagën zëri i princshës Tahet, e zbritur deri tek kopshti i fontanave të haremit. ndjeu dhembje midis kofshëve tek plaga e qelbur, nga i ishte hequr mishi i egër, mëkatar, i mashkullit.

Posa deshi ta çojë dorën tek vendi i sheshtë i kromzës së mashkullit Validja e Sulltanit ia parapriti: “Prej sot do të urinosh grarisht! Në harem vetëm padishahu i ndritshëm urinon burrërisht.”

Besi Ban Sulejman Efendia, i ngjuar në sytë e ftohtë të bukuroshes së shtatë, e nderu vigmën pëlçitëse nga thellë derisa po mbytej në lëngun e ftohtë të atyre syve.

“U sos edhe pika e fundit e lëngut mashkullor!” – gati pëshpëriti profesori. “Ajo gjysmëpotencë mashkullore, e harruar nga tri perandori sot u shua.”

Profesorit gati i erdhi në majë të gjuhës “kurvë hazare”, derisa Besi Bani u bë veshull i ftohtë midis vegëve të princshës Tahet.

Në sytë e Mirk Iliçit e pa kërcënimin profesori gjatë kapërcimit të shikimit nga Tahet tek Teuta. Në tabelë për të tretën herë Bendisa e fshiu trekëndëshin e rrezikshëm ku Teuta dhe ”kurva hazare” e zhvendosnin njëra-tjetrën nga këndi A në këndin B të Logosit ogur të Platonit.

“Kot krejt kot e keni”, - u tha profesori. “Këto pika të Logosit ogur të Platonit i lëvizin vetëm ushtritë. Të tjerët gabojnë.”

të tri herat Mirk Iliçi e fotokopjoi trekëndëshin ogur të Platonit në tabelën e profesorit të urvës hazare”; bile të tretën herë prapa supeve të drejtorit. Këtë herë Mirk Iliçi e fotokopjoi trekëndëshin e Logosit të Platonit duke menduar, plot frikë, mos po zbulonte diç të Rabii ben Zakait.

...Rënia e Besi Ban Sulejman Efendisë në lëngun e ftohtë të syve të bukuroshes së shtatë e ngjalli hardhucën e Besi Banit para tendës. Me dorën hardhucë e paskësh pas matur pak më shpejt përgjigjen e Kryetabitari.

Kryetabitari e nxori jashtë tendës mëkëmbësin e vet për ta zbuluar para Kolonelit të Ivan Groznit ëndrrën e Rabii Johanen ben Zakait.

Pasi Rabii Johanen ben Zakai iku nga Jerusalemi tek tradhtia para gjeneralit roman Tribali i Madh i rabinëve e kërkoi tek Mojsiu vdekjen e mohuesit. Mojsiu zbriti në Tribalin

e Madh të rabinëve. Tribalit i Madh i rabinëve e kërkoi sërisht vdekjen e Rabii ben Zakait në heshtjen e Mojsiut deri tek pleqëria e thellë e gjeneratës së parë.

në heshtjen e gjatë të Mojsiut kur Tribalit i Madh e kishte bjerrë përgjigjen u ngrit kryerabini:

“Le t’ia caktojmë javën e fundit të vdekjes së Rabii ben Zakait. Le t’ia caktojmë vendin e fundit të vdekjes Rabii ben Zakait. Dita e fundit e Rabii ben Zakait le të jetë Prilli i Ditës së Dytë të vitit të shtatëdhjetë të jezusit; vendi i tij i fundit le të jetë klyshi i bardhë me pikla të zeza i klyshit të kones së Danielit, të birit të Benjaminin.”

Kasneci ogur i Tribalit të Madh, tek shtrati i Rabii ben Zakait e sollti lajmin e rektueshëm ndesh vdekjes së shpejt.

“O Rabii ben Zakai! Të përshëndetë Tribalit i Madh! Ditën e fundit të jetës sate e ka caktuar në klyshin e bardhë me pikla të zeza të kones së Danielit të birit të Benjaminin.”

Në gjysmë të rrugës së kthimit të Kasnecit ogur tek shtrati i Rabii ben Zakait ia çatisi Jakobi i durueshëm i biri i Halevit për ta shëruar mikun e vet me lëngun e durimit.

“PAskësh mbaruar shërimi im, o miku im”, - rektiu Rabii ben Zakai.

Jakobi, i biri i Halevit, në fytyrën e vyshkur të Rabii ben Zakait e lexoi saktësisht njëmendësinë e fjalëve:

“O miku im, Jakob! Shko, sonte, në fshatin Abbi tek tenda e Danielit, të birit të Benjaminin! Fikësoje mirë konen e tij!”

Pas javës së dytë të vdekjes sime përcille shtatzëninë e kones së Danielit derisa ajo të pjellë. Ditën e parë të jetës së këlyshve të kones së Danielit atë këlyshin e bardhë me pikla të zeza godite tri herë, fort, me dru! Pas goditjes së tretë fute në thes e gjuaje në lumë!”

“Po pse ma bën me borxh krimin mbi atë këlysh fatkeq?” – u ankua Jakobi, i biri i Halevit.

“Tribali i Madh e ka gjykuar shpirtin tim. Pas vdekjes sime unë duhet ta vazhdojë jetën në mishin e vockël të këlyshit të bardhë me pikla të zeza të kones së Danielit, të birit të Halevit, në fshatin Abii.

“Atëherë ma bën me borxh me e goditë tri herë në kokë me dru të fortë mikun tim Rabii Johanan ben Zakain”, - shfryni Jakobi, i biri i Halevit.

“Po. Me këto tri goditje të forta në kokë, ti, o miku im, e shpëtove mikun tënd Rabii Johanan ben Zakain nga jeta në mishin e këlyshit të kones së Danielit; e shpëtove mikun tënd nga dënimi i Tribalit të Madh”, - e ngushëlloi mikun e vet Rabii Johanan ben Zakai.

Jakobi, miku i Rabii ben Zakait, heshti deri tek fundi i durimit të mikut të vet.

“Më premto me nyje tek jehovai i gjithpushtetshëm se goditjet do të jenë të forta sa edhe vdekja e menjëhershme e këlyshit të bardhë me pikla të zeza të kones së Danielit.”

Jakobi i biri i Halevit prapë heshti deri në fund të durimit të mikut të vet.

“Koha e shkurtër, vetëm një javë, më detyron sonte ta kapërcej heshtjen e mikut tim. Shpëtoje mikun tënd nga mishi i këlyshit të kones së Danielit, shpëtoje mikun tënd nga dënimi i Tribalit të Madh!”

Të tretën herë Jakobi i durueshëm foli e tha:

“Me bekimin e Jehovait të gjithpushtetshëm u bëftë dëshira e mikut tim Johanan ben Zakai!”

Të dytën javë pas vdekjes së Rabii Johanan ben Zakai, miku i tij, Jakobi i durueshëm e ngrehu tendën pranë tendës së Danielit të birit të Benjaminit. Çdo mëngjes i çonte ushqim

kones së Danielit. I dukej sikur koneja me sytë e saj njerëzor e kuptonte qëllimin vrasës të Jakobit.

Javën e fundit të shtatorit koneja e Danielit, e fryrë barkut, mesi merrte frymë. Me sytë e saj lutës mbeti tërë ditën ratë (shtrirë?) mbi shtrojë. Jakobit iu bë sikur e pa lutjen e mikut të tij Rabii ben Zakait. Pas dy ditësh e pa gëzimin e kones së Danielit mbi gjashtë këlyshët e saj të rrumbullakët. Këtë ditë koneja e Danielit e shikoi me ndrojtje Jakobin. Këlyshët e shtynin njëri-tjetrin drejt gjirit të nënës së tyre. Këlyshi i bardhë me pikla të zeza e theri në gjoks Jakobin.

ishte krejt këlysh Rabii Johanan ben Zakai kur Jakobi hyri në tendën e Danielit, të birit të Sebastianit me drojën e mikut në sytë e konesë së gëzuar.

Jakobi u gëzua se Danieli mungoi atë ditë në tendë. I thanë se kishte shkuar tek vathat e deleve tri ditë rrugë larg. Miku i Jakobit do të jetonte në mishin e këlyshit të kones derisa të kthehet Danieli në tendë. Pas një muaji Jakobi hyri në tendën e Danielit të birit të Sebastianit pasi e kishte ushtruar në mendje e në zemër goditjen e parë mbi kokën e këlyshit të bardhë me pikla të zeza.

Ngrohja e parë e verës në tendën e Danielit e nxitoi kërkesën e Jakobit:

“O miku im! Ta kërkoj për mbarë njerin nga këlyshët e kones sate”, - u çel Jakobi pa i treguar se cilin këlysh po ia kërkonte.

“Tre i kanë ngordhur”, - foli Danieli brenda ngrohtësisë së verës. Jakobi iu gëzua ngordhjes së tre këlyshëve; mos ndonjëri prej tyre do të ketë qenë Rabii ben Zakai; mos do të shpëtonte nga vrasja e mikut të vet.

Droja e gëzimit, më në fund, ia nxori kuvendin Jakobit:

“Po këlyshi i bardhë me pikla të zeza a ka ngordhur?”

“Jo. Bile ai këlyshi i bardhë me pikla të zeza e shpreh gëzimin e veçantë për jetën.”

Danieli nga fundi i blydës me verë i tha Jakobit:

“Po deshe, o miku im, ta dhuroj atë këlyshin e bardhë me pikla të zeza”, - e mbushëlloi frikën e Jakobit.

“Më ngadalë gërryen brenda se hidhërimi”, - u pajtuan të dy në fund të blydës (kupës?)me verë.

Koneja e Danielit e shtrirë në rrezen e mëngjesit, dremitsëm po i mëkonte të tre këlyshët e saj; u shqetësua nga vizita aq e hershme e Danielit me Jakobin. Në sytë e kones u ndërruan aq shpejt: hidhërimi, pikëllimi dhe kërcënimi. Këlyshët vetëm i tundën bishtat me gojë e mbushura plot me qumësht nëne.

“Zgjedhe cilin ta duash”, - i tha bujarisht Danieli.

Jakobi e shikonte i përhumbur këlyshin e bardhë me pikla të zeza se sa me babëzi po e kullufiste qumështin e nënës.

“Rabii Johanan ben Zakait t’i pëlqejë kaq shumë qumështi i kones?!” – mendoi në vete Jakobi i durueshëm.

“Pikërisht këlyshin e bardhë me pikla të zeza”, - foli për vete e për Danielin.

Urdhri i Danielit e rrëzoi kërcënimin nga sytë e kones. Danieli ia lëshoi në dorë Jakovit këlyshin e bardhë me pikla të zeza.

“Ky do të bëhet qen për mbarë”, - e solli në vete Jakobin e përhumbur.

Jakobi e peshoi këlyshin e bardhë me pikla të zeza duke ia kulluar sytë e lëngshëm deri tek vegimi:

“A mos je ti, miku im Rabii ben Zakai?”

Jakobit i zgjati shpresa aq sa zgjati heshtja e këlyshit të bardhë me pikla të zeza.

“Po. Unë jam ai miku yt Rabii Johanan ben Zakai.”

“Erdha të të marrë siç më ke porositur, o miku im Rabii. Do të të godasë në kokë vetëm një herë. I kam ushtruar të gjitha llojet e goditjeve këtu e një muaj.”

“Je vonuar miku im Jakob, shumë je vonuar.”

Në zërin e këlyshit të bardhë me pikla të zeza Jakobi, i biri i Halevit, e njohu zërin e mikut të tij, Rabii Johanan ben Zakai.

“Ditën e parë të këlyshnisë sate, Danieli, zotëria yt, kishte udhëtuar tek vatha e deleve. Ai u vonua një muaj”, - arsyetoi Jakobi.

“Ka qenë dashur ta zbatosh dëshirën time, betimin tënd në Jehovain, përkundër ligjit të Danielit në tendën e tij”, - i erdhi zëri i Rabii Johanan ben Zakait nga këlyshi i kones së Danielit.

“Si ka qenë dashur ta shkel ligjin e Danielit? T vjedh këlyshin e bardhë me pikla apo ta marrë me dhunë?” – u shfajësua Jakobi.

“Shikoje në sytë e mi rritën e qenit! Tashmë, pas vonesës sate po e shoh botën me qyrin e qenit. Të përgjërohem për Jehovain e gjithfuqishëm hiq dorë nga vrasja!”

“A mos ke filluar ta duash jetën e qenit?”- u habit Jakobi.

“Po. Tashmë jeta në mua hyn nëpër mishin e qenit, nëpër sytë e qenit, nëpër qumështin e qenit. Tashmë e dua jetën qençe. Shko miku im! Mos bën krim!” – i foli fjalët e fundit Rabii Johanan ben Zakai nga këlyshi i bardhë me pikëla të zeza i kones së Danielit. Fajtor për vonesën Jakobi i durueshëm e lëshoi nga dora këlyshin e bardhë me pikla të zeza tek gjiri i kones.

Këlyshi i gëzuar me tundje përshëndetëse të bishtit i dha shenjë mikut të vet, Jakobit. Rabii Johanan ben Zakai

tashmë po thithte gjenerali italian tek nëna e vet-konia e Danielit.

“Pse u vonove kaq shumë brenda pendimit tënd?” – e pyeti Danieli kur Jakobi e lëshoi këlyshin tek nëna e tij.

“U bë tepër vonë, miku im”, - foli Jakobi dy mijë vjet larg Danielit.

Në fund të rrëfimit të tagbitarit e kishte rrokur Kryetagbitarin ai tundimi i papërmbajtshëm për t’u përmjerrë si grua përtej tendës së Besi Ban Efendisë.

...Besi Ban Efendia i ngujuar në sytë e ftohtë të bukuroshes së shtatë të haremit klithi pëlçitshëm në lëngun e ftohtë të syve, njëjtazi me gjakun. Plaga po e vajtonte me lot gjaku, vegëve të Besi Ban Efendisë, mishin e zhvatur të mashkullit kur të tretën natë, në cep të gjumit, në haremllek u ngul thikë çjerrja ogure e Valides së Sulltanit. në katin e tretë të sarajit lloji po e zhbinte llojin e vet, gjinia po e zhbinte gjininë e vet, seksi po e zhbinte seksin e vet: xherahu-heqim po e kullufiste me raki ujqërisht mishin e ëmbël të mashkullit; Validja e Sulltanit nga dritarja e shtatë e katit të tretë po e tundonte grishjen e Princeshës Tahet:

“Oj hergjelja hazare! hyr në parajsën e birit tim, midis një mijë hyrive nga të tri kontinentet. Sulltani, biri im, do të të falë natën e njëmijë hyrive. Në fund të kësaj nate do të bëhesh Igball, pastaj Kadinë aga. Po bëhet e treta natë e paqjes së Besi Ban Sulejman Efendisë. Ai po zgjohet pa asnjë dhembje në trup e në shpirt.”

Besi Ban Efendisë, pasi u mbyt në lëngun e mërdhirë të syve të bukuroshes së shtatë, i dogji këmba e djathtë në çizmen e mbushur me gjak përvëlues nga plaga në fund të barkut.

“Pasi çizmja u mbush Libido mashkulli çka mbeti në këtë krijesë të pagjini?” – e ngacmoi ndihmësi i dytë profesorin.

“Asketët e tundojnë mishin e mashkullit, eunukët i ndajnë nga mishi i mashkullit, të vdekurit dalin jashtë mishit mashkullor.

Xherahu heqim po e han me raki Libidon, i harlisur nga mishi i mashkullit, në katin e tretë të sarajit”, - foli brenda aparatit laparaskopik profesori.

Zëri joshës i princeshës Tahet mbeti jashtë pallatit të Sulltanit, në natën sterrë tek sharruan të gjithë: Validja e Sulltanit, Sraji i ri, Besi Ban Efendia.

Tek princesha Tahet filluan menstruacionet e Breshkës.

“Në sytë e saj ka rënë ftohtësia e hardhucës së marsit”, - tha profesori në midis të zemërimit të gjysmëmjekes:

“Sa pak farë ka hudhur në mitrën e kurvës hazare.”

“Si quhet në shkencën tënde psikanalitike gjendja e gruas midis shtazënisë e shterpësisë?” – e vazhdoi gjysmëmjekja pa e pritur përgjigjen e profesorit.

Ajo këtë herë për vetveten: “Në cilin repart ta dërgojmë kurvën hazare? Ta dërgojmë në repartin e menstruacioneve kronike apo në repartin e shtatzënisë të klinikës psikanalitike të tij?” – bëri me dorë kah profesori. “Mungon reparti i menstruacioneve kronike. Evropës i mungon ky repart i sëmundjeve ballkanike.”

Sigmund Frojdi e hutoi zemërimi i gjysmëmjekes. Në vitin një mijë e nëntëqind e pesëmbëdhjetë, në pllakëzat e vëna tek kofshët e grave të reja ballkanike, vetë ai Zigmund Frojdi e pati shënuar të gravuar diagnozën: *Menstrualis chronica SF*.

Gruaja e re ballkanase me diagnozën e Sigmund Frojdit: *Menstrualis chronica SF* të ngjizur në mitër e lakmon seksin e breshkës, të mbyllur në karrocën e fortë.

Princesha Tahet, Prillin e Ditës së Dytë para tendës së Besi Ban Efendisë, me sytë e ftohtë e hetoi dëshirën e Kryetagbitarit për t’u përmjerrë si grua.

“U sos fara e mashkullit”, - mendoi duke e kapërcyer shikimin nga Kryetagbitari tek Besi Ban Efendia.

“Si do ta emërtoni ju, Profesor, menstruacionin kronik dymijëvjeçar të ngjizur në mitrën e gruas?” – e pyeti gjysmëmjekja sërish Sigmund Frojdin.

“Fetus kronik-arketip”, - shpjegoi profesori.

“Cili kod do ta shërojë mitrën e gruas ballkanase? Cili kod do ta shtojë rritën tek fetusi arketip ballkanas?” – me gjysmë frymë paskësh pyetur gjysmëmjekja.

“Kodi hebraik”, - u dëgjua vetëm zëri i Sigmund Frojdit nga aparati laparoskopik.

...Rabii Johanan ben Zakai hyri në mishin e këlyshit të kones së Danielit kur Jezusi i mbushi shtatëdhjetë vjet.

Rabii Johanan ben Zakai një mbrëmje riguese, para këmbëve të Doktor Faustit u shkëput nga mishi i këlyshit të kones së Danielit për të hyrë në mishin e Djallit Mefisto. Çdo mbrëmje, në teatrin e Berlinit para spektatorëve Rabii ben Zakai dilte nga mishi i këlyshit të kones së Danielit për të hyrë, poaq shpesh, në mishin e Djallit Mefisto derisa u plak thellë Jazef K.

U bë zjarr i madh në Bundestagun e natës së kristaltë kur Rabii Johanan ben Zakai e humbi rrugën midis këlyshit të kones së Danielit dhe Djallit Mefisto.

Rabii Johanan ben Zakai e pyeti policin e parë në rrugë:

“Në cilën anë është stacioni i trenit?”

Polici, i përshkllirë me blozën e zjarrit të Bundestagut, plot urrejtje, i tha Rabii ben Zakait:

“Hiq dorë! Hiq dorë!”

Ana Frank, sipas porosissë plot urrejtje të policit, heq dorë nga stacioni i trenit.

“PSe Evropa kaq herë e gaboi kodin hebraik të Rabii Johanan ben Zakait?” – i erdhi Logosi i kohës negative të

Platonit-Sokrat dhe strategjia ushtarake e Cezarit-August e mbyllën kodin hebraik të Rabbii Johanan ben Zakait”, -i erdhi.

“Kush e hapi kodin hebraik të Rabbii Johanan ben Zakait?” – e pyeti.

“Në fund të Shtegut të Oregonit zuri fill Logosi biodemokratik. Vetëm Logosi biodemokratik i Shtegut të Oregonit e hapi kodin hebraik të Rabbii Johanan ben Zakait”, - u përgjigj.

“Rabbii Gamliel ben Shimon që në rin, i fshehur në petkun roman, e udhëhoqi universitetin hebre në Diasporë”, - nga bishti i cigares së katërt i foli koloneli Besi Ban Efendisë së qullur.

“Rabbii Johanan ben Zakai hyri në mishin e këlyshit të kones së Danielit për ta ruajtur arketipin hebre”, - ia ktheu Kryetagbitari.

“Edhe ju, edhe ne. Të gjitha ushtritë evropiane e kanë ditur se kodi hebraik i Rabbii Johanan ben Zakait ka hile brenda”, - i tha koloneli Besi Ban Efendisë.

“Jozef K i Tribalit të Madh u sos para gjyqit-krematorium”, - foli koloneli vetëm me lektisjen për të sosur punë me Besi Ban Efendinë.

Profesori, kërcënueshëm, po e trashte kateten e trekëndëshit evropian në tabelë; gjithnjë i ngulitur shikimit në vithet provokuese të Teutës po i mëtonte nxënësit të lëviznin të gjithë, revolucionarisht, nga këndi C i trekëndëshit në këndin B.

Mirk Iliçi u bë sikur e përdhosi kureshtjen për trekëndëshin e profesorit derisa vetë profesori po përpiqej ta thejë gravitetin e Logosit të Platonit-Sokrat me revolucionin arketip.

Kolonelit, Mirk Iliçi, goditja e profesorit në muret e menstruacioneve kronike ia rriti shpresën e një rruge tjetër të

shqiptarëve nga rruga e Rabii Johanan ben Zakait në mishin e këlyshit të kones së Danielit; ndryshe nga rruga e Rabii Gamliel ben Shimonit.

Dy orë pas goditjes së raketës *Tomahok* në oborrin e kazermës koloneli, Mirk Iliçi, i frikësohej gabimit të Romës ndaj këlyshit të kones së Danielit, i frikësohej gabimit të Romës ndaj universitetit hebraik të Diasporës së Rabii Gamliel Shimonit; i frikësohej gabimit të Evropës ndaj fetusit arketip të shqiptarëve.

“Pse Evropa shtatë herë e gaboi kodin arketip të shqiptarëve?” – i erdhi.

“Logosi i kohës negative të Platonit-Sokrat dhe strategjia ushtarake e Cezarit-August e mbyllën kodin arketip të shqiptarëve”, - i erdhi.

“Kush e hapi kodin arketip të shqiptarëve?” – e pyeti.

“Në fund të Shtegut të Oregonit zuri fill Logosi biodemokratik. Vetëm Logosi biodemokratik i Shtegut të Oregonit e hapi kodin arketip të shqiptarëve”, - u përgjigj.

“Atëherë Rabii Johanan ben Zakai prej mishit të këlyshit të kones së Danielit e deri te krematoriumet evropiane e paska kërkuar shpëtimin tek Logosi biodemokratik i Shtegut të Oregonit krejt sikur arketipi shqiptar”, - e pyeti.

“Saktësisht”, u përgjigj.

Kolonelit i ngutej t'i japë rrugë mishit të arketipit shqiptar. Mendo, ta nxis revolucionin e profesorit për ta derdhur menstruacionin pa u ngjizur në mish njeriu tek ura T.

“Tek e fundit mishi arketip i shqiptarëve le të mrumej në Evropë, mendoi koloneli për vetveten. “Ajo, OSCE, me raketën *Tomahok* të Semit të Madh e ka hudhur gjithë atë farë të mashkullit në mitrën arketip të shqiptarëve; le t'i mrumet mishi i keq i këtij populli brenda Evropës! Evropa e ka pësuar

tashmë nga lugatosja e Rabiï Johanen ben Zakait e Rabiï Gamliel ben Shimonit.”

“Të shtatë perandoritë, sipas vullnetit të Allahut, i kanë hudhur nga një blydë (kupë?) thartirë mitrës së Mbretëreshës Teutë”, - i tha Besi Ban Efendia.

“Para dy orësh raketa *Tomahok* i depërtoi të shtatë perandoritë nëpër gjumin veshtullor të ushtarëve, të deveve, të konkubinave, të kuajve, deri tek oborri i kazermës sime. Ndaj po të doli shtatzënë kjo kurva hazare mos u çudit”, - e ngacmoi koloneli Besi Ban Efendinë.

Kryetagbitari e mori shenjën e Besi Ban Efendisë këtej gjumit të ushtarëve, të deveve, të konkubinave, të kuajve. I përgjurmur grarisht i paska pasë thënë Besi Ban Efendisë:

“Në gjumin e ushtarëve, të deveve, të konkubinave, të kuajve u sos ëndrra jote për të lindur mashkull.”

“Estokfërllah! Kistar aga, zgjoje xherahun heqim le ta qërojë mitrën e kurvës hazare!”

Koloneli, Mirk Iliçi, e mori për asgjë ëndrrën aziatike kundrejt gëzimit për revolucionaritetin e profesorit në trekëndëshin arketip. Koloneli po i druhej vetëm ngjizjes së shpejt të fetusit arketip tek ura T., siç i ndodhi Romës me Rabiï Johanen ben Zakain, siç i ndodhi me Diasporën e Rabiï Gamliel ben Sharonit.

“Sot, Prillin e Ditës së Dytë thelloje gjumin aziatik; mos e nis ushtrinë tënde drejt qytetit. Ushtritë tona do të ngatërrohen keqas tek ngushtimi i rrugës, para kishës së Shën Antonit”, - u ngut koloneli.

* * *

Pasi e hudhi bishtin e cigares në ujë, koloneli e dha shenjën e madhe të nisjes. Nga hekurina e Skënderbeut-kollitja e thatë e shpalli lëvizjen e parë.

“Mami, Skënderbeu gati e kapërceu urën T.”, u ngazëllye çupëza (çupëlina?).

Ngazëllimi i çupzës ra zog i vrarë para këmbëve.

Arkitekti ushtarak i ngërtheu dy cepat e urës T në trekëndëshin e nxjerrë nga tabela e profesorit. Po e matnin bashkë me urën T edhe hekurinën e Skënderbeut.

Trekëndëshi i profesorit, i lyer me ngjyrë ushtarake, e maste largësinë e tre numrave nga njëri cep i urës tek tjetri, sipas Logosit të Platonit-Sokrat.

Uhstarët, sipas matjes së arkitektit ushtarak i ngulën dy shtylla në cepin e andejmë të urës T, ndërsa të tretin e ngulën afër çupëlinës, në anën e këtejme të urës T.

Ushtarët e kolonelit i këmbyen flamujt e shtatë perandorive brenda Trekëndëshit të Logosit të Platonit-Sokrat.

“Shfaqja filloi, shfaqja mbaroi”, - mendoi ndihmësi i dytë i profesorit.

Pastaj ai e pyeti profesorin derisa po shëtitnin buzë Danubit:

“Ç’ngrehinë po bëjnë këta ushtarë midis urës T?”

“Teatrin arketip po e zëvendësojnë ne teatrin evropian”, - shpjegoi profesori.

“Dy mijë vjet të plotësohen vetëm brenda dy orësh?!“- u nemit ndihmësi i profesorit.

“Tre mijë vjet!”

Gjithshka ngutej. Stinët e kapërthenin njëra-tjetrën. Në fytyrën e mamit çupëlina e hetoi lojën e çakërdisur të stinëve.

Kolonelit po i shtohet ngutia nën lëkurën e mufatur:

“Sa më shpejt të vehen flamujt trengjyrësh në shtyllat ushtarake!”

I gjithë ekipi i teatrit ushtarak punoi gjithë mëngjesin e Prillit të Ditës së Dytë, plot stuhi, në Romë.

“A do të vritet Cezari sot?” – pyeti ndihmësi i profesorit.

“Po. Sot në urën T për të njëmijtën herë do të vritet Cezari”, - ia priti profesorin.

“Kaq shpesh të vritet një njeri?! Njëfarë Cezari!” – u shashtis ndihmësi i parë i profesorit.

“Vritet sa herë të duash. Vetëm le të jetë teatër evropian”, - shpjegoi profesorin.

“Po në teatrin arketip, a vritet kështu shpesh?”

“Asnjëherë.”

Në klasë profesori ende rropatej me rrugëtimin revolucionar nëpër hipotezën e Trekëndëshit të Platonit-Pitagor prej Treshit të shtetasve kah Dyshi i Pushtetit.

“Ky profesor synon revolucionin”, - foli profesori dytësor (dytëshor?) nga aparati laparoskopik. “Frika e pushtetit të Platonit-Sokrat, e Augustit Cezar, krejt kot fillon nga këndi i tretë, nga shtetasit e filozofit. Ushtria ia ruan pushtetin e uzurpuar, kujt tjetër, vetëm Platonit.”

Sapo e mori veten nga ngulfatja, profesori vazhdoi: “Dy mijë vjet hipotenuza e Trekëndëshit të Platonit-Sokrat nga: Filozofët-ushtarët-shtetasit, kullon gjak.”

“Dy mijë vjet?!”

“Po. Tre mijë vjet.”

Heshti.

Profesori mbushet frymë sa herë katandiset t’i qepet përpjetës së hipotenuzës së Trekëndëshit të Platonit-Pitagor kah Teuta nevrrike, tek princesha Tahet, tek Besi Bani.

Dikush, nga nxënësit e përmendi Sizifin në fund të fjalëve: gjakpirëse, kuvë hazare, eunuk.

Pas këtyre aventurave revolucionare të profesorit nëpër Trekëndëshin e Platonit-Sokrat nxënësit pëshpëritnin: “Profesori ka qenë në burg.”

Profesori kthehej në klasë i buhavitur, i qethur, i heshtur.

“Çupëlina ia lexoi së ëmës numrat NJË dhe DY në majë të shtyllave ushtarake”, - ia kujtoi të atit Bendisa.

“Mos i lexo kurrë ata tre numra! Sot do ta kapërcejmë urën T. Vetëm edhe nëntë kilometra arrihet tek kufiri i Shqipërisë”, - e qortoi i ati.

“Atëherë po e fshij Trekëndëshin e Platonit-Sokrat në tabelë”, - iu drejtua Bendisa profesorit.

“Mos e lexo kurrë Trekëndëshin e Platonit-Sokrat brenda një dite as brenda një jete. Platoni-Sokrat, e, pastaj të gjitha shtetet janë frikësuar se Treshi i Trekëndëshit të Pitagorës do t’i kapërdijë NJËSHIN dhe DYSHIN; se populli do t’i kapërdijë SHTETIN dhe PUSHTETIN”, - e qortoi profesori Bendisen.

Ushtarët në fund të cigares së kolonelit e sosën punën e flamujve në shtyllat ushtarake baras me kokën e Skënderbeut. Ura T. u bë me dy anë.

“Mos e ka ditur Hegeli nga e cila anë polli pela e Trojës?” – pyeti qortueshëm profesori vjenez.

Të dy ndihmësit e kuptuan pyetjen ende pa u ngritur nga toka helikopteri i spitalit; e kuptuan se nga cila anë e pelës së Skënderbeut, sot, veterinari ushtarak do t’i nxjerrë akejtë-kërthinj.

“Po ky profesori nëpërmes aventurës nëpër Trekëndëshin e Platonit-Sokrat mendon ta zbulojë nga e cila anë e pelës së Trojës u nxorën akejtë atë natë të stuhishme”, - e pyeti paksa i habitur ndihmësi i dytë.

“Më shpejt, më sakt deri tek pela e Trojës arrin çdo veterinar ushtarak se çdo profesor i katedrës evropiane. Ky profesori ballkanas secilën orë të mësimit i mashtron nxënësit

me revolucionaritetet xhuxhe të Evropës”, - tha profesori duke bërë me dorë andej kah ushtarët.

“Ja ata ushtarë i heqin rrethojat e urës T. për të zbritur helikopteri i veterinarëve ushtarakë.”

Veterinarët ushtarakë, me shprehje tallëse, po e pritnin aterimin e helikopterit në midis të urës T tek duhej të pjellte (pillte?) për të katërtën herë pela e Skënderbeut.

“Po ç’pis teatër bëjnë këta evropianët!? Skenografët e tyre injorantë e komplikojnë skenën e teatrit të Ponc Pilatit, sot, Ditën e Dytë të Prillit një mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë net nga Nata e Madhe e Betlehemit. Pas goditjes së raketës *Tomahok* mishi i njeriut do të ngjizet brenda nëntë orësh”, - u ngut të thotë koloneli, i shqetësuar për vonesën e helikopterit.

Në urën T. teatri evroortodoks e vuri në hamendje kryeveterinarin ushtarak; po t’i nxirrte akejtë nga Pela e Skënderbeut mund të mërðhinin deri të vijë helikopteri i spitalit.

“Sa vjet po përsëritet ky teatër?” – papritmas pyeti ndihmësi i dytë i profesorit.

“Dy mijë vjet.”

“Janë shumë!”

“Tre mijë vjet.”

Heshti.

Në urën T. filloi të rigojë. Ngutia e mitrës së pelës së Skënderbeut, para se të zbresë veterinarin ushtarak nga helikopteri, pengoi të shihet se nga cila anë u nxor kërthiri Ajaks. Akejtë e pelës së Trojës po i nxirrnin nga barku i pelës së Skënderbeut.

“Si u quajt ky kërthi?” – pyeti gjysmëmjekja duke e mbështjellë kërthirin e nxjerrë nga pela e Skënderbeut.

“Ajaks”, - u përgjigj veterinarin ushtarak.

“Është djalë apo vajzë?” – pyeti infermierja e re.

“Merre foshnjën, oj budallaqel!” – i tha gjysmëmjekja me përbuzje. “Qysh nga ajo nata e stuhishme në Trojë nëpër spitalet e Evropës pela e Homerit pjell vetëm meshkuj. Edhe klinika jote psikiatrike është teatër evropian”, - fliste gjysmëmjekja në të njëjtën kohë me infermierën dhe me profesorin.

Profesori vjenez u befasua nga saktësia e punës tremijëvjeçare spitalore e teatrore të gjysmëmjekes. Filloi të mëdyshojë në kishte më tepër mjekësi apo teatër në personën e saj.

Helikopteri ushtarak e solli në spital foshnjën tjetër, të nxjerrë nga barku i pelës së Skënderbeut.

Me ta marrë në dorë, pa e mbështjellë ende në mnela (me pelena?), gjysmëmjekja u çjerr, këtë herë jashtë mjeshtërisë teatrore:

“Futeni shpejt në inkubator!”

Edhe veterinari u step nga çjerrja femërore e gjysmëmjekes derisa ra ndesh me shikimin qortues të kolonel Mirk Iliçit.

Profesori vjenez u detyrua t’u japë përgjigje dy ndihmësve të vet përtej *Libidos*: “Gjysmëmjekja e pa për herë të parë pas tre mijë vjetësh foshnjën hibride. Në këtë fosnjë ka shumë menstruacione kronike të Platonit-Sokrat.”

Mirk Iliçi buzëqeshi edhe një herë në klasë me lektisjen revolucionare të profesorit kryeneç. Profesorin e kishte rrokur amoku u vrapimit nëpër Trekëndëshin e Platonit-Sokrat kur Mirk Iliçi mendoi në vete: “Evropa e njeh saktësisht këtë popull”, - pasi e ndaloi Bendisën ta fshijë tabelën.

Profesori, i futur aq ngutas në inkubator, sërish u rropat të bëjë revolucion brenda Trekëndëshit të Platonit-Sokrat. Ai

arriti të shkëputet nga turma rysur tek cepi i urës T., me vrap të çmendur, drejt hekurinës së Skënderbeut.

“Do ta prishë teatrin evropian ky profesori i çmendur”, - mendoi profesori vjenez pa e vërejtur gëzimin tinzar të Mirk Iliçit. Vrap ngulmues i profesorit po e çante ajrin përgjatë urës T. drejt uniformës ushtarake të kolonelit.

“Ky profesor po shkëputet gabimit të Hegelit. Lirinë e të gjithëve Hegeli e ka menduar vetëm në një rën anë të urës T. Ky profesor ballkanas instinktivisht po vrapon drejt heroizmit revolucionar të Athinës, Konstantinopojës, Moskës. Këtij profesori i shkon për shtati heroizmi e pakicës, jo e shumicës së Hegelit”, - ia sqaroi profesori vjenez ndihmësit të parë.

Amoku ballkanik e shtyri profesorin përgjatë urës T. derisa ndaloi zhurma e helikopterit ushtarak, ndaloi zhurma e avionëve të NATO-s, ndaloi gurgullima e ujit të Erenikut, ndaloi përplasja e ajrit në fytyrë. Amoku ballkanik e shtyri profesorin të vrapojë përgjatë urës T. deri sa hyri në tisin e agsholit. Ndaloi pranë zjarrit tek po shkrinin rrëshirë dërrasash. ishte punëtori dërrasash. Të gjithë punonin të mbështjellë në heshtje të çuditshme dërrasash, edhe atëherë kur e aktronin rrahjen e gozhdës me çekan; sikur aktohej puna me dërrasën. E heshtën ardhjen e befasishme të profesorit.

Amoku i racës së vogël ballkanaike e tundoi profesorin ta shkatërrojë çdo gjë rreth vetes: dërrasat skelet, vozgën e rrëshirës, zjarrin, bile edhe punëtorët e heshtur.

Duart, këmbët, gjithë trupin – siç deshi të mendojë profesori – ia prangoi heshtja rreth tij. E kuptoi se po pluskonte mbi popullin e vet. Në fund të heshtjes e nevríkosi ideja e Platonit-Sokrat: “Populli im – populli yt.”

Çasti ia solli veshët, sytë, gojën; krejt sipas rregullës e dëgjoi zërin e parë, e nisi lëvizjen e parë nga populli i Platonit-Sokrat drejt ushtrisë së Platonit-Sokrat.

Ai u çjerr në vetminë e tij: “Platoni-Sokrat e ka shitur popullin e vet.”

Në vetulla po i shtohet ehlli (?) i cemtë. E ngadalësoi ecjen revolucionare në Trekëndëshin e Platonit-Sokrat. Tek punëtorja e dërrasave po ndërtohet diçka midis pelës së drunjtë të Trojës dhe Trekëndëshit të drunjtë të Platonit-Sokrat. Amoku i profesorit u shkërmoq nëpër brinjët e drunjtë të Trekëndëshit të Platonit-Sokrat, krejt afër ngazëllimit të përmbajtur të Mirk Iliçit në fjalët: “E njeh Evropa profesorin ngordhalaq.”

Midis pelës së drunjtë të Trojës dhe Trekëndëshit të drunjtë të Platonit-Sokrat u shfaq një burrë me parzmorë të varur në gjoks. Profesori mezi e njohu Platonin-Sokrat para se t’i thotë: “Ti i ke mësuar ushtritë e Evropës ta hanë gjakmishin e shtetasve të vet. Në Trekëndëshin tënd të drunjtë, midis sheshit të Athinës, ushtria bashkë me filozofët e bënë puçin ushtarak. Filozofëve dhe ushtrisë ua ke dhuruar kohën e tashme, kohën e realizimit fizik; shtetasve të Athinës, e të të gjithë Evropës ua ke lënë vetëm kohën e mosrealizimit, kohën e shkuar, kohën e mashtrimit.”

“Unë e kam mbrojtur Athinën nga mashtrimi i Homerit”, arsyetoi Platoni-Sokrat.

“Homeri në Trojë me pelën e drunjtë e bën të njëjtin puç ushtarak sikur ti me Trekëndëshin e drunjtë në sheshin e Athinës”, - u rrëmbye profesori.

“Athinës ia dhashë tri kategori: filozofët për t’i dhënë mend Athinës; ushtarët për ta mbrojtur Athinën; shtetasit punëtorë për ta ushqyer Athinën”, - shpjegoi Platoni-Sokrat.

Trekëndëshi yt i drunjtë u shtri në sheshin *Omonia* të Athinës; u bë rregullë e gjakut mbi gjak. Në pikë të ditës filozofët e Athinës dhe ushtarët e Athinës e sundojnë gjakun e

punëtorëve shtetas të Athinës”, - shpërtheu profesori revolucionar.

“Atëherë unë u nisa”, - i tha Platoni-Sokrat.

Platoni deshi të ecën drejt skenës përkundër rregullës tremijëvjeçare të prokuratorit të Iliadës pa i treguar rojës se në cilën faqe të librit gjendet.

“Duket se kërkon punë në teatër”, - e pyeti roja.

“Po”, u përgjigj Platoni.

“Cilin protagonist të *Iliadës* e preferon ta aktrosh?” – e pyeti roja sipas rregullës së paraqitjes tek regjisori.

“Dua ta shtoj një protagonist krejt të ri.”

“Kjo ndalohet! Dënohet me ligj”, - kundërshtoi roja.

Në fund të zënkës së tyre Platoni e roja mbetën të armiqësuar, derisa u hap dera paksa. Dy burra e rrokën Platonin e fishkur.

“Ky dashka, sonte, të hyjë në barkun e pelës së Trojës”, - e paraqitën para regjisorit.

“Rast tepër urgjent. Shpijeni në spital!” – urdhëroi prerazi regjisori.

Fjalën spital Platoni e dëgjoji nga larg, krejt përgjumshëm.

“Është tepër ngërdhalaq për të hyrë në barkun e pelës së Trojës. Si do të zbresë në skenë ky ngordhalaq? A di të tregojë në cilën faqe të librit ka banuar këtu e tre mijë vjet?” – e pyeti mjeku ushtarak.

“E kemi sjellë në spital këtë profesor për ta mjekuar nga vegimet revolucionare. E rrok amoku në pikë të ditës nëpër librin e sakatosur”, - i tha Mirk Iliçi mjekut ushtarak.

“Këtij profesorit i teptis mishi i mashkullit në çdo kohë; edhe në midis të ditës e rrok amoku”, - gati pëshpëriti mjeku ushtarak.

“Hiqi çka ka tepër!” – e urdhëroi Mirk Iliçi mjekun ushtarak. Ende pa e sosur urdhrin Mirk Iliçi, ia çatisi era e morfinës me zhaurimë të ngutshme hapash.

“Mbështilljani rreth kokës këmishën e vet!” – e urdhëroi mjeku ekipin ushtarak.

Era e morfinës e ngjalli Besi Ban Sulejman Efendinë nga dremitja para tendës së tij. Me zë të përngutshëm iu drejtua kolonel Mirk Iliçit, sikur po i fliste për herë të parë:

“Këtë profesor e rrok shpesh amoku në pikë të ditës; sa herë e lexon librin e sakatosur të quajtur *Meshari*.”

“Gjithmonë i soset rruga jashtë librit të gjymtuar, tek fillon urrejtja”, - u ngazëllye kolonel Mirk Iliçi.

“Ku e ruan ky profesor atë libër handakap nga klima aq e ashpër e këtij vendi?” – pyeti mjeku ushtarak.

“Libri u zbulua në Romë nga bashkëqytetari i këtij profesori, sipas sugjerimeve të Vatikanit”, - u ankua Besi Ban Efendia.

“Po pse libri u bë handakap?” – iu rrit kureshtja mjekut ushtarak.

“Roma, për mbulesë politike, Librin e Gjonit, *Meshari*, e quajti libër handakap; të dëmtuar në fillim e në fund”, - fshani Besi Ban Efendia.

Mjeku ushtarak ndërhyri përngutshëm: “Hudhjani gjumin e dytë brenda këmishës së vet! Morfina mund ta lëshojë shpejt.”

Hiqimi xherah i Besi Ban Efendisë dhe mjeku ushtarak i kolonel Mirk Iliçit u shikuan sy më sy në shenjë miratimi.

“Le të hiqet mish mashkulli nga ky profesor aq sa të mos e rrokë kurrë më amoku nëpër asnjë libër!” – urdhëroi koloneli.

Krejt në fund të gjumit të dytë profesorin e vizituan dy grupe njerëzish shumë të qetë. Grupi i burrave me kollare u ul

në anën e majtë të krevatit të bardhë; burrat e veshur me shallvare u ulën në anën e djathtë të krevatit të bardhë.

Pasi e përgëzuan për operacionin e suksesshëm, udhëheqësi i burrave me kollare i tha profesorit fytyrëverdhe si çarçafi i krevatit:

“Tashmë shpëtove nga sëmundja e amokut të mallkuar të atij librit të gjumtë. Tashmë e ke fituar dashurinë e Stalinit të madh.”

kur e dëgjoji emrin e Stalinit të madh profesori deshi të ngritet paksa nga krevati sikur të mos e kishin shafitur fjalët e udhëheqësit të burrave me shallvare:

“Shkronjat e mallkuara të atij librit sakat të marrin më qafë në pikë të ditës. I shpëtove sëmundjes; e fitove bekimin e Padishahut të paaskundshoq.”

“Grupi yt u ngut me atë përgëzim aq të shpetë politik”, - e qortoi Besi Ban Efendia kolonel Mirk Iliçin.

“Ushtria ime është më afër spitalit”, - u tall koloneli sa për ta zhdaravitur hidhërimin e Besi Ban Efendisë.

Ambasada turke në Romë ia dërgoi raportin tepër sekret Minsitrisë së Brendshme në Stamboll” “Njëfarë Gjoni nga Jakova, në skajin më perëndimor të Perandorisë sonë, me sugjerimin e Vatikanit, e shpiku njëfarë libri të quajtur *Meshar*. Ky farë Gjoni, sipas të dhënave tona, do të dërgohet nga Vatikani në Jakovë pas dy javësh me mision të caktuar. Le të arrestohet të xhumanë e parë të Prillit të Ditës së Dytë!”

“A protestoi, sipas rregullës, qeveria turke tek qeveria e Romës?” – sërish pyeti mjeku ushtarak.

“Po. Qeveria turke protestoi ashpër. Pas dy ditësh gazeta italiane *Corriere dela sera* e demantoi ekzistimin e këtij libri. Vërtet Libri u fsheh për shumë shekuj në trezorin e qeverisë së Romës”, - vazhdoi Besi Ban Efendia me zë të qetë vërshtëlyes.

Pas dy javësh Gjon Nikollë Kazazi erdhi krejt i përhumur. Kur arriti në cepin e urës T. ia çatisi ekspedita ndëshkimore nga Stambolli bashkë me ekipin hetimor.

Besi Ban Sulejman Efendia të xhumanë e parë të Prillit të Ditës së Dytë, misionarin e Vatikanit e nxori para turmës...

E premtja e parë e Prillit të Ditës së Dytë a i kishte brenda saj tri nëntëshe?” – e pyeti koloneli.

“Po. I kishte.”

“E premtja e parë e Prillit të Ditës së Dytë me tri nëntëshe brenda saj është sot”, - sikur foli me vete koloneli.

“Unë e thashë.”

Heshtën të dytë, veçanërisht koloneli me një hije tisore hidhërimi në fytyrë. Hidhërimi në cepin e buzëve e dëshmonte dëshirën e papërmbajtur për të folur.

Prillin e Ditës së Dytë, të xhumanë e parë Besi Ban Sulejman Efendia i tha atij Gjon Nikollë Kazazit, misionarit të Vatikanit:

“Gjuha më e bukur shkruhet me amjë të shpatës. Gjuha më e ligë shkruhet me tehun e shpatës. Mos bjerë ndesh me tehun e shpatës e me unazën e Padishahut! Shko! Mos fli tri net e tri ditë! Trokit fort në barkun e çdo gruaje të re! Shtrydhe çdo mittër. Shtrydhe frikën e çdo zemre! Në fund të natës së tretë të kësaj kontratës sonë, sille librin ogur para kësaj tende!”

Gjoni i katandisur frikës e kaptoi Erenikun afër urës T. të ndriçuar nga reflektorët e ushtrisë së kolonelit Mirk Iliç.

E pa mishin e njeriut të rysur tek cepi i urës T. afër flamurit trengjyrësh të ushtrisë së kolonelit. Mishi veshtullor i njeriut zvarritej gjithandej rrugës përtej derës së kazermës, përtej kishës së Shën Antonit, bile edhe përtej zyrës së OSCE-së.

Gjoni e njohu Bendisën me mont (xhup?) të kuq, me Biblën e Simon Filipajt nën sjetull. Deshi t’i flasë vajzës sikur

mos ta kishte takuar shikimin e mjerë, tepër lutës të t'et të saj: "Mos na merr më qafë!"

Gjon Nikollë Kazazi e nxori kokën nga frika e vet nëpërmes mendimit: "Ky burrë i mjerë i fshehur pas syzeve të rreme, i futur aq thellë në kapelën fëmijërore, mendon të shpëtojë edhe në këtë Prillin e Ditës së Dytë përtej urës T.!"

Gjon Nikollë Kazazi e ndjeu ujin e ftohtë të Erenikut mbi gjunjë. "Erdhi çasti", - mendoi.

E filloi pagëzimin e mishit të njeriut tek ura T. Pagëzimi ra në ujin e Erenikut si lëkura e gjarprit në pranverën e parë. Mishi veshtullor i njeriut, i tulatur tek cepi i urës T. e deri tek zyra e OSCE-së, drithërueshëm e priste lejen e kolonelit për ta kapërcyer urën T. drejt kufirit të Shqipërisë.

Rregulla dymijëvjeçare u thye Prillin e Ditës së Dytë, të premtën e parë: mishi i njeriut në vend se ta lakmojë pagëzimin e Gjonit me ujë të Erenikut, po e lakmon lejen e kolonelit Mirk Iliç për ta kapërcyer urën T.

Gjoni nga mëshikëza dymijëvjeçare e ftoi mishin e njeriut kah uji i pagëzimit.

Mishi i njeriut u bë frikë-frika u bë mish njeriu. Besi Ban Efendia, i zgjuar nga dremitja e shkurtër, e urdhëroi Kryetagbitarin t'ia sjellin menjëherë para tendës atë Gjonin, misionarin e Vatikanit.

"Ende është dita e parë. Sipas kontratës i ka edhe dy ditëtë veta", - shpjegoi Kryetagbitari.

"Në gjumin tim të parë ai farë Gjoni, misionari i Vatikanit, u ka dhënë koqeve ujë të bekuar të Erenikut. Edhe dy orë do të më akuzojnë për epsheet e mia mbi këtë grua", - bëri me dorë kah princesha Tahet. "Ai, Gjoni, e aktron atë Gjon Pagëzorin e Biblës e unë do ta aktroj atë Herodin e Biblës. Sillmani menjëherë këtu!" – kërcënoi Besi Ban Efendia.

“Sipas kontratës ai ka afat edhe dy ditë”, - ia kujtoi edhe një herë Kryetabitari.

“Edhe sikur t’i ketë një mijë vjet, do t’i ketë pak. Sillmani këtu!” – urdhëroi Besi Ban Efendia.

Në çastin kur Gjoni po e hidhte pagëzimin mbi mishin e njeriut tek cepi i urës T., kuajt e ushtarëve të Besi Ban Efendisë i ngritën stërkalat e ujit deri tek ura e sheshtë. E morën Gjonin të ngrirë nga uji i bekuar.

Besi Ban Efendia u tregua mjaft diplomatik sipas zërit, kur i tha Gjonit: “Thellë në mishin e njeriut e paske pas rysur shkronjën e librit tënd. Heqimit tonë xhelat i duhet ta fusë majën e shpatës në mitrën e gruas së re për ta nxjerrë atë shkronjën e mallkuar të librit tënd. Nëse shpata e heqimit tonë xhelat shkon më thellë se shpirti i insanit, ti je fajtor.”

Besi Ban Efendia e paskësh pas dhënë shenjën pa i dhënë mundësi Gjonit ta sosë fjalën e parë. E futën në tendën e mbushur me erë morfine. Gjysmerrësira brenda tendës u bë errësirë e plotë kur me veladonin e tij prej prifti ia mbuluan fytyrën. Gjysmëgjumit të parë të Gjonit ia shtuan gjumin e dytë ende pa e përfunduar konsultën mjekësore.

Kryehqimi xhelat foli paksa me përbuzje:

“Testiset dhe penisi iu paskan mërdhirë; pak gjë paska mbetur për t’iu hequr.”

“Hiqi, ç’ka për t’u hequr!” – urdhëroi nga errësira kryehqimi.

“Sa ditë e mbajtën në përkujdesje ambulatore?” – e pyeti mjeku ushtarak Mirk Iliçin.

U bë heshtje.

Duhma e rëndë e morfinës e mbajti gjatë në gjumë Gjonin derisa u mësua të përmjerrte si grua.

Në fund të gjumit të dytë Besi Ban Efendia i nxori Gjonit llokume me kafe duke e uruar tashmë Kistar agë eunukun brenda zhgunit të Gjonit.

Besi Ban Efendia e përcolli Kistar agën e mbështjellë me zhgunin e priftit deri tek karroca me një “rrugë të mbarë”.

Në portin e Tivarit e përcollën përngutazi për në Romë, me një arkë diplomatike.

Gjoni kishte zënë kutërbim të rëndë. Plaga po i qelbej. Vdiq në një çelë të Grotaferarës.

Besi Ban Efendia u kthye kah tenda, kah gjumi veshullor i ushtarëve, deveve, kuajve, konkubinave, sot, pas goditjes së raketës *Tomahok*. Desha të mendojë në vetvete: sa do ta gërrryejë mitrën e gruas me shpatë për ta nxjerrë atë germën mëkatore të librit të Gjonit.

“A do të ketë vend për shpatën tënde pas goditjes së raketës *Tomahok*?” – pyeti koloneli sikur e hetoi mendimin e e Besi Ban Efendisë.

“Unë do të presë aty tek mitra e gruas së re.”

“Deri kur?”

“Unë thashë.”

U bë heshtje.

Profesori deshi t’i shmanget shikimit të Besi Banit duke vrapuar nëpër urën e sheshtë kur u gjend para ambulancës së mbushur me erë morfine.

Gjysmerrësira e ambulancës u bë errësirë e plotë kur me këmishën e ngritur ia mbuluan fytyrën. Gjysmëgjumit të parë të profesorit ia shtuan gjumin e dytë kur kryemjeku i ftoi të tjerët të shikojnë.

“Ka vetëm bulëza të testiseve e të penisit. Ia paskan hequr më parë!” – u tha kryemjeku.

Në të gjitha faqet e librit *Iliada* i ndalohet hyrja kësaj krijese arketip me këto bulëza kaq të rrënuara gjenitale. Në çdo

çast mund të pikë në skenë nga të çarat e Kalit të Trojës, veçanërisht kur të fillojë stina e thatë e verës”, - ankoj regjisori.

“Shtoji ç’mund t’i shtohet nga mishi i mashkullit pasi ka arritur deri këtu”, - e urdhëroi regjisori mjekun.

Duhma e morfinës gjatë e mbajti në gjumë profesorin derisa provoi disa herë të përmjerret si mashkull me bulëza gjenitale të shndërruara në formë zhapini të ftohtë e në fillim të marsit. Zhapini i ftohtë, aq i zorshëm për t’u mbajtur në dorë, ia rrodhi urinën nga të gjitha anët.

Pasi e shkundi zhapinin e ftohtë gjenital ranë përtokë nga *Iliada* e Homerit faqet më të nxehta të librit siç bien gjethet e zvetënuara të vjeshtës. Profesorin e shtynë deri tek e pesëdhjeta ditë e fundit të *Iliadës* së Homerit, tek i gjeti të ulur solemnisht rreth tavolinës akejtë dhe trojanët. Profesori e kishte menduar nga kushedi se kur armiqtësinë e ndërsjellë të akejve dhe të trojanëve siç ua shpjegonte nxënësve në klasë. Atij iu bë sikur Agamemnoni e pati një vurratë të përzgatur nëpër tërë fytirën.

Regjisori i ulur pranë profesorit-Platon e shkëputi mendimin e zëshëm:

“Këtu e tre mijë vjet ju luftoni kundër njëri-tjetrit. Akili, Patrokli, hektori të ulur sot këtu pranë nesh, sipas teatrit evropian vdesin në plagët e aktruara kirurgjikisht”, - fliste profesori nga fetusi arketip duke vrapuar drejt Athinës, Stambollit, Moskës nëpër urën e sheshtë deri tek pesëdhjetë ditët e fundit të *Iliadës* së Homerit. “Në barkun e pelës së Trojës dergjen aktorë të paguar nga shtetet evropiane. Aktorët akej hyjnë në Trojë nëpërmjet barkut të pelës.”

“Ashtu thotë Homeri.”

“Homerin e kam dëbuar nga *Shteti* im. Ushtria greke duhet të hyjë në Trojë triumfalisht për pikë të ditës duke i thyer dyert e qytetit”, - kishte thënë Platoni-Sokrat.

“Spektatorit i pëlqen intriga e kalit të Trojës më tepër se fitorja e njëtrajtshme e ushtrisë tënde. Sipas teje do të çmontohen të gjitha teatrot evropiane”, - regjisori tërthorazi u fliste nxënësve të vet.

“Unë në *Shtetin* tim e kam vënë ushtrinë në pozicionin e fitimtarit të përhershëm.”

“Të njëjtën gjë e bën edhe Homeri në librin e vet. Ai e fut spektatorin brenda teatrit me intrigën e kalit të Trojës. Ti që nga dera e jashtme e teatrit e shpall përfundimin e luftës të fituar nga ushtria e rregullt”, - e shkroi në raportin e teatrit të Berlinit regjisori.

“Po. Vetëm ushtria greke do të fitojë”, - e shkroi në librin e tij Platoni-Sokrat.

“Atëherë si do ta fusësh protagonistin e stërkequr ushtarak në barkun e kalit të Trojës?” – pyeti regjisori.

Heshti.

“Siç u fut Rabii Johanan ben Zakai në mishin e këlyshit të kones së Danielit”, - ndërhyri profesori vjenez nga fundi i aparatit laparaskopik.

“Rabii Johanan ben Zakai e kishte lektisur ushtrinë e rregullt, ushtrinë fitimtare. Ai i ishte frikësuar një grupi njerëzish fanatikë të Tribalit të Madh; ai grup fanatikësh të Tribalit të Madh e kërkonte vdekjen e sigurt të Izraelit. Rabii Johanan ben Zakai, nëpër rrugën e gjatë e kërkoi fitoren e sigurt të Izraelit”, - fliste4 raporti mjekësor i profesorit vjenez.

“Nga menstruacionet kronike dymijëvjeçare të shqiptarëve, sipas provave shkencore, mund të kalohet tek rruga e shpëtimit e Rabii Johanan ben Zakait. Pastaj rruga vazhdon, e përbashkët, deri tek fundi i Shtegut të Oregonit, tek fillon Logosi biodemokratik i Amerikës”, - shkruante kronika e spitalit të Diasporës.

“Si shpëtoi Rabii Johanan ben Zakai nga mishi i qenit?” – ishte shkruar në fund të dokumenteve të spitalit.

“Kush të tha se shpëtoi? E shpëtoi tek dera e krematoriumit logosi biodemokratik amerikan. Deri tek dera e krematoriumit Rabii Johanan ben Zakai i kishte kaluar: mishin e këlyshit të kones së Danielit, mishin e Djallit Mefisto të Faustit, mishin e Insektit të Gregor Zanzës”, - shkroi në dokumentet e spitalit civil.

“Cilën rrugë e zunë evropianët?” – deshi të pyesë profesori duke e sosur amokun në midis të urës së sheshtë tej punëtorja e teatrit sapo regjisori i sugjeroi brenda kalit të Trojës të mbajë shënime mbi rregullat e teatrit evropian.

“Cilat janë rregullat e teatrit evropian?” – deshi të mësojë profesori.

“Mbreti-aktori-spektatori.”

“Po mbetët jashtë të treve?”

“Hyn në mishin e kones së Danielit, hyn në mishin e Djallit Mefisto, fshehu në mishin e Insektit të Gregor Zanzës!”

“Po mbete sërish jashtë?”

“Kthehu në menstruacionet kronike të Mbretëreshës Teutë.”

“Po mbete sërish jashtë?”

“Ke mbetur në stërkeqjen tënde psikofizike të Logosit autoritar evropian.”

“Ku mbeti Tribali i Madh i hebrenjve atë natën e shtatdhjetë vjetëve të Jerusalemit?”

“Ta thashë.”

“E the?!”

“Po.”

“Pse ky profesori i shpëtoi stërkeqjes jashtë mishit të këlyshit të kones së Danielit, jashtë mishit të Djallit Mefisto, jashtë mishit të Insektit të Gregor Zanzës?”

“Gabon nxënësi im i mjerë, tepër gabon. Profesori dy mijë vjet u fsheh në menstruacionet e Mbretëreshës Teutë.”

“Më mirë qenka të lindesh dy mijë vjet më vonë sesa të lindesh herët!”

“Jo nxënësi im i mjerë. Më mirë është të lindesh me kohë e në kohë. Lindja e keqe e sërkeq krijesën: e bën kukudh fizik e psikik.”

“Evropianët e huqën rrugën e Rabii Johanen ben Zakait nëpër mishin e këlyshit të Danielit, nëpër mishin e Djallit Mefisto të Doktor Faustit, nëpër mishin e Insektit të Grigor Zanzës; po e huqin rrugën e menstruacioneve kronike të Mbretëreshës Teutë.”

“Po nxënësi im i mjerë. Evropianët e detyruan Rabii Johanen ben Zakain ta marrë rrugën e mishit të këlyshit të kones së Danielit, rrugën e mishit të Djallit Mefisto, rrugën e mishit të Insektit të Gregor Zanzës.”

Uliksi e nisi punën me kualitetin e dërrasës së Kalit të Trojës. E propozoi një ngrohëse elektrike për dimër e, mundësisht, një ventilator për verë.

“Po nxënësi im i mjerë, këta evropianët e kanë të vështirë të qëndrojnë në barkun e Kalit të Trojës një natë.”

Akili pak si në tallje, e sheshoi çështjen e kabllave elektrike kur trojanët ta tërheqin kalin drejt dyerve të qytetit.

Shtoi: “Tymi i stufës brenda barkut të Kalit do të na zbulojë tek trojanët. Pasatj mund t’i kapë zjarri dërrasat e pishës e të digjemi edhe vetë brenda duke na shikuar trojanët nga bedenet e kullave të rojës.”

Për të mos e ashpërsuar bisedën, Uliksi e kaloi tek censori i ri:

“Sot e mbuluam vendin e zbrazët të censorit tonëaq pijanik. Ai dehej nëpër bodrumet e Trojës edhe kur ne jemi në kulmin e betejës. Bile shpeshherë edhe flen brenda Trojës.”

Uliksi e shikoi vëmendshëm Platonin-Sokrat duke i thënë Akilit me zë tinëzar:

“ZCensori ynë i ri e ndalon takimin komprometues të Akilit me Patroklin brenda dhe jashtë Kalit të Trojës, sepse profesori vjenez dyshon në moralin e tyre.”

Akili heshti duke e kuptuar deri kur vriste qortimi dinak i Uliksit si tek fytyra e Platonit-Sokrat po aq në fytyrën e regjisorit.

“Censori ynë i ri”, - vazhdoi Uliksi pa i dhënë rast Akilit të reagojë, - e pranoi regjinë tonë evropiane tremijëvjeçare pa ia luajtur vendin asnjë gozhdë në dërrasat e Kalit të Trojës edhe kur grekët i këmbëjnë armët e tyre.”

Platoni-Sokrat kur u fol për censorin e ri, së pari me shenjë, pastaj me fjalë reagoi plot pezëm:

“Regjisor i juaj i ri është njeri i paguar nga Homeri dhe nga shtetet tuaja evropiane. Ai ka qenë dashur ta heqë diversionin e Kalit të Trojës duke i lënë siç u ka hije, dy ushtritë ballë për ballë njëra-tjetrës. Ju evropianët çdo gjë e bëni me ushtritë tuaja të komprometuara duke ua hedhur mbi, në pikë të ditës, velenxën e propagandës politike.”

“Kalit tim, - vazhdoi Uliksi me dredhi për ta anashkaluar hidhërimin e Platonit-Sokrat, - shirat, dielli dhe erërat e shkaktojnë rrallimin e dërrasave nga mund të shihet pa pengesa, kontrata e akejve me trojanët; po mund të shihet edhe sjellja e dyshimtë homoseksuale.”

Gjatë gjithë diskursit të tij dinak Uliksi e vështronte me kujdes fytyrën e Platonit-Sokrat. Mundohej ta zinte me fytyrën e tij ndonjë shprehje përfutuese miratimi. Platonin-Sokrat tashmë e kishte lëshuar amoku i ngarendjes në midis të urës T. Tundimi i Platonit-Sokrat për ta shtuar një protagonist të ri në barkun e Kalit të Trojës Uliksi dinak shpresonte ta zëvendësojë me amokun e Eneut.

Uliksi ngutej t'i hiqte pësesdhjetë ditët e fundit të *Iliadës* së Homerit për të arritur sa më parë tek pela e Skënderbeut në urën T.

“Edhe katër foshnja kanë mbetur në mitrën e Pelës së Skënderbeut. Deri në orën pesë të mbrëmjes së Prillit të Ditës së Dytë të gjitha foshnjat do të nxirren nga mitra e pelës së Skënderbeut. Po edhe katër herë do të fluturojë helikopteri ushtarak deri tek oborri i spitalit. Në mbrëmje, tek kufiri i Shqipërisë, nëntë kilometra nga ura T. pela e Skënderbeut do të çmontohet pjesë-pjesë. Me kamionë ushtarakë do të sillet sërish tek ura T.

Kështu do të veprohet deri tek kthimi i parë i pelës së çmontuar; pastaj në mbrëmjen e Prillit të Ditës së Dytë perdja e teatrit evropian do të bjerë përgjithmonë.

“Përgjithmonë?!”

“Po! Përgjithmonë!”

Platoni-Sokrat u ngatërrua në Trekëndëshin e tij me fjalët përbuzëse për shtetasin e vet: “homoseksual i drejt”. Nxënësit i ngazëlleu humori i profesorit-Platon me fjalët “homoseksual i drejt” duke i anashkaluar fytyrat e vërenjtura të Teutës, Besi Banit dhe të Gjergjit me katër emra.

Profesori-Platon e interpretoi *Iliadën* e Homerit jashtë faqes së dhjetë, këtej pesëdhjetë ditëve të fundit. Për herë të parë Akilin e vrau me sëpatë, Agamemnonin e ngulfati në pishinën e ftohtë të hotelit, Uliksin e futi në rrugën e gjatë të toaletit, Eneun e mbyti në gropën septike.

Drejtori i gjimnazit e hulumtoi thellë shenjën në fytyrën e Mirk Iliçit. Tek Mirk Iliçi u sheshua kënaqësia nga interpretimi i tillë i *Iliadës*, veçanërisht kur Teuta e përmendi fjalën “revolucion”.

Profesori-Platon u ngatërrua në Trekëndëshin e vet rrugëve drejt Athinës, Moskës, Konstantinopojës, kah

hipertrofimi i moralit, revolucionit, fesë, patriotizmit, përtej teatrove evropiane të quajtura krematoriume e gullagë...

Ngatërrimin e Platonit-Sokrat në Trekëndëshin e vet: Filozof-ushtar-shtetas, drejt Athinës, Konstantinopojës, Moskës, e dëgjoji Rabii Johanan ben Zakai gjatë gjithë rrugës së vet nëpër mishin e këlyshit të kones s Danielit, nëpër mishin e Djallit Mefisto, nëpër mishin e Insektit të Gregor Zanzës deri tek dyert e teatrit krematorium të Hitlerit evropian e të teatrit Gullag të Stalinit.

Posa u përmend emri i Stalinit, kolonel Mirk Iliçi e gjuajti bishtin e cigares bashkë me një duf tymi tek hunda e Skënderbeut. Kollitja kumbuese brenda hekurinës së Gjergjit me katër emra u përcoll me katër goditje provuese me çekan. Katër ushtarët e sollën kavanozin me vaj për grasatimin e pelës së Skënderbeut.

“Do t’ia bëjnë pjelljen më të lehtë kësaj pele-hekurinë.”

Ende pa e përfunduar fjalën e fundit, për çudinë e të gjithëve, veçanërsiht të Bendisë, profesori-Platon u shfaq krejt papritmas në anën tjetër të urës T. Bisedoi bukur gjatë me kolonel Mirk Iliçin para se t’ia marrë megafonin nga dora.

“Profesori do të na thotë të kthehemi në shtëpi”, - e përgëzoi Bendisa të atin e futur thellë në mishin e frikës.

I ati prapë heshti.

Meqë përgjigja mungoi, Bendisa e kaloi shikimin nga profesori me megafon në dorë tek i ati. Asaj iu duk i ati tepër i mjerë, i fshehur pas syzeve të rremë, i parruar, i futur thellë në kapelën fëmijërore. Ajo hezitoi thellë në atë çast ta mëshirojë të atin pas dy ikjeve ligaqe dhe strukjes nën batanie kur polici trokiti në derë.

I ati e nxori Bendisën nga hezitimi vetëm kur i tha: “Nga ajo pozita e sotme e profesorit-Platon vetëm interpretohet

vullneti i pushtetit shtetëror. Ai vetëm do të na ftojë njësoj sikur koloneli.”

“Po, ai, profesori ynë, sa herë e vizatonte Trekëndëshin në tabelë na thoshte se ushtria është interpretuese e vullnetit të filozofëve”, - i tha t’et Bendisa.

“Ai profesori yt vetëm do të na ftojë të nisemi”, - flistepër vete i ati i Bendisë.

Profesori-Platon i dronte mendimit të nxënësve. Gjatë orëve të mësimit qortonte pacaktueshëm deri tek fundi i klasës. Në mes qortimit dhe hutimit me Teutën nxënësit ia fshinin pjesët e Trekëndëshit në Tabelë.

Vetëm kur pushonte zhurma në sheshin *Omonia* të Athinës, profesori –Platon e hetonte se në tabelë i janë fshirë pjesë nga Trekëndëshi.

Atëherë jur nxënësit e pritën qortimin e profesorit-Platon, ai e mori megafonin nga dora e kolonelit. Iu drejtua mishit të njeriut në cepin tjetër të urës T: “Nisuni! I keni vetëm nëntë kilometra rrugë deri tek kufiri i Shqipërisë. Do t’i kapërceni këto nëntë kilometra rrugë po shpëtuat nga bombardimet e NATO-s.”

“Kot, krejt kot, ia keni prishur pjesët e Trekëndëshit në tabelë. Pa vullnetin tuaj, pa vullnetin e profesorit-Platon, Evropa e lexon këtë Trekëndësh sipas ligjit të saj”, - nga fundi i kapelës fëmijërore vazhdoi i ati i Bendisë.

“Po ne si do ta lexojmë Trekëndëshin e profesorit në tabelë”, - përtej syzeve të rreme e pyeti Bendisa.

“Kush jemi ne?”

“Ne, ky mish njeriu, i rysur në këtë cep të urës T”, - ndërhyri ajo, duke ia rregulluar syzet t’et.

“Ja shikoje Rabii Johanan ben Zakain si është fshehur aq bukur në atë këlysh mospërfillës të kones së Danielit. Ai këlysh përmjerret përgjatë urës T. Edhe ne jemi të fshehur në

menstruacionet e Mbretëreshës Teutë deri sa ta kapërcejmë urën T. Në anën tjetër të urës T. , tek fundi i Shtegut të Oregonit do të takohemi me Rabii Johanan ben Zakain”, - po fliste i ati i Bendisës nga fundi i kapelës fëmijërore.

Bendisa u përpoq ta shihte t’et në fund të kapelës fëmijërore duke menduar mos lodhja, pagjumësia, frika, ndërgjegjja e vrarë nga ikja nga zjarri e kanë hutuar derisa flet kaq përçart. Babai i saj ishte i zbehur, aq i zbahur! Dhembja për babanë ia vrau kujtimin fëmijëror. “Vetëm edhe sot të shpëtojmë, vetëm edhe sot!” Babës së vet ia shtrëngoi dorën e djersitur përtej ujit të Rozafës. “Vetëm edhe so të shpëtojmë, vetëm edhe sot!”

Bendisa në gjysmë të diskursit të t’et arriti të dëgjojë: “Mishi i njeriut, i rysur sot tek ura T. do të dalë nga menstruacionet e Mbretëreshës Teutë posa të kapërcejë tek Shtegu i Oregonit. Rrugën e Rabii Johanan ben Zakait: mishi i këlyshit, mishi i Djallit Mefisto, mishi i Insektit – ne do ta bëjmë: Menstruacionet e Mbretëreshës Teutë, mishi i qenit, mishi i mizës.”

Bendisa po e bënte rrugën e dëshpërimit pa e ditur cilën rrugë do ta bënte deri tek vargjet tetëmbëdhjetë, nëntëmbëdhjetë, njëzet të Zanafillës në Biblën e saj. Bendisa provoi ta eksperimentojë Kaptinën e Dytë të Biblës mbi këlyshin e lazduar të kones së Danielit; e thirri këlyshin e kones së Danielit: “...sepse secila kafshë e gjallë do ta mbante atë emër, me të cilin do ta quante njeriuu”.

Këlyshi i Kones së Danielit e shpërfilli thirrjen e Bendisës me përmjerrje tepër përçmuese. Vetëm atëherë Bendisës iu kujtua si mund ta grishë këlyshin e Kones së Danielit kur në mishin e tij është fshehur Rabii Johanan ben Zakai.

Babai i Bendisës e fshehu fdrikën në fund të kapelës fëmijërore krahas inatosjes së vajzës ndaj këlyshit të Kones së Danielit i tha: “Këlyshi i Kones së Danielit u bë para se ti të jesh formësuar nga mishi i infektuar i njeriut. Ka të drejtë këlyshi i Kones së Danielit kur e shpërfill grishjen tënde.”

Nëpër mes të djersës veshtullore të dorës, i ati i dha Bendisës shenjën e rrezikut andej kah ushtarët; ia detyroi shikimin tek shfaqja e beftë e hoxhës para ushtarëve, para kolonelit, para profesorit. Me vështrim të përhumbur hoxha filloi me zërin shkretinor gjysmëkëngë e gjysmëfjalë të flasë për varrimin e gjymtyrëve të vetmuara: “Nëse dikujt i kruhet këmba e varrosur, nëse tjetrit i kruhet dora e varrosur le t’i kruajë me lutje Pejgamberit! Nëse mëkatojmë me syrin e varrosur le t’i lexojmë fjalët e Pejgamberit me syrin e gjallë! Sot nga avionët e NATO-s do të varrosen shumë këmbë, duar, sy.”

Në fund të zërit shkretinor suhtarët e shtuan përngutjen e tyre nëpër rigën e hollë të shiut kur Bendisa e njohu Besi Banin brenda zhgunit (xhybes së?) të hoxhës.

“O babush!” – e tundi të atin përmes dorës së djersitur, - po ky hoxha qenka Besi Bani, shoku im i klasës!”

“Mos e zbuloj shokun tënd të klasës! Mos e zbuloj veten! Ai i dipërmendsh rrugët shkretinore të Kur’anit të vet”, - e ndaloi Bendisën i ati i saj.

Besi Bani, shoku i saj i klasës, në mbrëmjen e maturës u la në djersë deri tek përmendja e shpeshtë e shiut. Atë natë Tahetit i kishte humbur shikimi në largësi duke e përmendur së voni, bukur shpesh, shiun.

“Ta kruash vendin e heqjes së mishit mashkullor bëhesh me damkën e eunukut sikur Besi Bani jashtë mbrëmjes së maturës.

“Po ç’do të bëhet me profesorin?” – e pyeti Bendisa të atin.

Sërish Bendisa e kaloi shikimin tek profesori me megafon në dorë. Ai i kishte sosur të gjitha shenjat e dorës: duke hyrë në megafon u shndërrua në zë: “Le të nisemi drejt kufirit të Shqipërisë!”

“Cili foli? Koloneli, profesori apo Besi Bani?” – pyeti.

Ura T. u tkurr; dikush kishte shkelur në bishtin e saj.

Duke i rënë në tokë kryqi i pabërë Bendisa e përgëzoi t’et: “E gjithë ura T. filloi të ecën drejt kufirit të Shqipërisë”.

Zhaurima mbytëse hyri në gojën e hapur të urës T. me rrethojë të hekurt. Hekuri e shpalli urinë për mishin e njeriut.

Profesori po thërriste me megafon derisa Teuta e dëgjoi të tretën herë: “Dikush e ka dëmtuar Trekëndëshin e vizatuar në tabelë”.

Teuta e hutuar e priti urdhrin e profesorit nga cila anë e trekëndëshit të fillojë. E mati largësinë nga të dy cepet e urës T.

“E pat puna!” – mendoi Teuta kur profesori nëpërmes megafonit e lajmëroi kolonel Mirk Iliçin: “U vra delegacioni roman! U vra Ambasadori roman!”

Teuta, tepër e frikësuar deshi ta kundërshtojë profesorin së delegacioni roman u vra në Romë.

Profesori e bëri shenjën e papërcaktuar drejt Trekëndëshit të ndërtuar në tabelë duke folur nga midisi i amokut: “Po t’i kishte pasur menstruacionet Mbretëresha Teutë, atë natë të stuhishme me delegacionin roman, me Ambasadorin roman do të kishte ndodhur krejt ndryshe.”

Teuta e përtypi fajin e menstruacioneve që nga ajo natë e stuhishme.

“Menstruacionet e kanë ngjyrën e zjarrit”, - shfryni profesori.

...Teuta e kishte shikuar pungul në sy kolonelin Mirk Iliç, nëse kishte fjetur. Ajo e zgjodhi gjuhën e tretë përtej gjuhës së kolonelit të përgjumur.

Koloneli mbeti në amokun e gjumit të mëngjesit, i ekzatuar pas natës së tretë të saj. Gjatë u sorollat nëpër fushën e përgjumur mëngjesore. Përgjumja fushore pas natës së tretë të saj zërin borisë ushtarake, nga kazerma, e zbuti në këngë të bulkthit.

Ushtria e kolonelit pas natës së tretë të harlisur u bë ushtri e huaj për të. Urdhrat ushtarakë kolonelit i ngordhën në dorën e vyshkur nga përgjumja mëngjesore. Gjumi i kolonelit tri ditë e net po i mbante ushtarët të dremitur. Komandanti i kazermës u kot gjithë kohën jashtë natës e ditës; gjumi i kishte rënë në kazermë si tis oguri i keq (ogurkeq?).

Të tretin agshol tisor të mëngjesit koloneli po kthehej në kazermë, i dehur nga nata vapullore. Krisi një pushlë, vetëm një pushkë. Hija e njeriut e përzier me agsholin e mëngjesit u rrëzua në hithra vetëm tri metra nga telat gjembor të kazermës.

Komandanti i kazermës e mori informatën zyrtare nga kujdestari i rojave: “Një i panjohur u vra vetëm tri metra jashtë telave gjemborë të kazermës. përkundër urdhrit për t’u ndalur, ai eci. Duket se vdiq në vend. I vrari ende mbetet në vendvlarje deri të merret urdhri zyrtar për tërheqjen e tij.”

Komandanti zbriti nga krevati me një shenjë dore vështirë për ta kuptuar.

“Rojat nga vendi i ngjarjes largoji menjëherë! Rasti le të mbetet tepër sekret!” – urdhëroi komandanti i kazermës.

Agsholi tisor i mëngjesit po dobësohej kur komandanti i kazermës bashkë me kapitenin, e me një civil, i largoi kujdesshëm hirrat duke i shkelur me çizme. Midis hithrash e njohu kolonelin e vrarë; me një shprehje përmalluese të damkosur në fytyrën e zbehur. Komandanti i shkeli edhe ca

hithrat për t'i dhënë edhe ca dritë fytyrës përmalluese të kolonelit të vrarë.

“Është i vdekur.”

Bleu i flokut, i rënë në ballin e djersitur, shpjegonte se kapela ushtarake i kishte dalë (rënë?) nga koka para se të rrëzohej në hithra. Komandanti i kazermës e shploi plagën nën bleun e flokve. Plaga ishte aty, në midis të dy vetullave ende e rime nga vesa e mëngjesit.

“E qëlluar e saktë”, - shkroi në raportin ushtarak komandanti i kazermës sikur ta shprehte gëzimin.

“Të gjitha plagët mbesin të kuqe si menstruacionet”, - profesori e kërcënoi Teutën.

Teuta e priste, kur pas dreke erdhën tek dera e saj për ta matur vrasjen e kolonelit.

Profesori – Platon i kërkoi Teutës ta masë vrasjen e kolonelit me trekëndëshin e ndërtuar në tabelë.

Teuta u hutua për një çast kur profesori – Platon e detyroi ta masë vrasjen e kolonelit vetëm me Trekëndëshin ushtarak të Romës së Plutarkut. Masa tjetër e Trekëndëshit i mungoi Teutës dy mijë vjet.

“Tre mijë vjet.”

“Mirë. Tre mijë vjet.”

Sa mbeti atë natë Teuta në toalet, gjatë ngacmimit të menstruacioneve Ambasadori roman bëri raporte ushtarake për Romën.

“Pse stepesh? Pse i hap sytë guak? Ne e kemi masën e Trekëndëshit tonë ilir”, - e qortoi Teutën profesori. “Mate vrasjen e kolonelit me Trekëndëshin tonë ilir, jo me Trekëndëshin e Romës së Plutarkut!”

“E qëlluar e saktë”, - tha komandanti roman pasi e konstatoi vdekjen e Ambasadorit roman. “Të mos lëvizet nga

vendi deri të bie ëmuzgu! Raporti mjekësor të bëhet sa më bindës!”

“E qëlluar e saktë”, - tha komandanti i kazermës pasi e konstatoi vdekjen e kolonelit. “Të mos lëvizet nga vendi deri sa të bie muzgu! Raporti mjekësor të jetë sa më bindës!”

...Pas dreke koloneli u sorollat si gjarpër i shullanit për pak diell. Tek në agsholin e mbrëmjes u ringjall kur fresku ia ledhatoi ballin e djersitur, u vesh, u pispillos. U tfillua kah shtëpia e hijes tisore të Teutës. Me përçapje të ngadaltë e zgjati kënaqësinë e rrugës midis fushës, deri tek loja e fëmijëve para derës.

Posa e preku rrezën e derës rruga heshti. Me dorën e kapur në rezë e shikoi edhe një herë rrugën para vetes; fëmijët ishin aty; kalimtarët ishin aty; të gjithë ishin aty. U stepën duke e vështruar kolonelin në derën e Teutës.

Më në fund koloneli vendosi: e hapi derën. Hyri. kur koloneli i bëri tre hapa në oborrin e shtëpisë së Teutës, u çmagjeps rruga nga krismat e dy pushkëve. Dhimitri e Evreno këtu e tri ditë po fshiheshin në shtëpinë e Teutës.

Të habitur e pyetën Teutën: “Ç’kërkon koloneli i huaj, i vetmuar në oborrin tënd?”

Sikur të kishte dëgjuar Teuta mohoi. “Ky kolonel e ka gabuar derën. Për mua është i panjohur.”

Në të dy cepat e dritares dy pushkë i nxorën gojë të hidhërake plot helm; pastaj të dy pushkët i nxorën gjuhët e kuqe gjak. Pastaj gjuhët e kuqe gjak të pushkëve u zgjatën deri tek ballëgjoksi i kolonelit.

Koloneli shikoi i habitur, me pyetje të vdekur në sy, drejt dritares së Teutës kur kalldrëmi i oborrit u përplas për fytyrën e tij.

“U vra rruga!” – ra çjerrja në pluhur.

Rrëmbimthi nga dera e Teutës dy hije kapërcyen mbi vdekjen e kolonelit drejt rrugës. Ata ikën.

Togu i parë ia çatisi nga kazerma tek shtëpia e Teutës. Nga të tri anët reflektorët ushtarakë ia ndriçuan kolonelit plagën e kuqe në ballë. Kolonelit të shtrirë në kalldrëmin e oborrit puhiza e lehtë e natës i lëvizi kolonelit bleun e flokut të ngjitur për ballin nga gjaku i ngjizur.

“Goditje e saktë”, - sikur u gëzua komandanti në raportin e tij ushtarak.

Në fund të raportit ushtarak të komandantit fara e zjarrit u shtua deri sa u bë prush çdo gjë.

“Menstruacionet e kanë ngjyrën e prushit”, - profesori gati i tha ‘kurvë’ Teutës. “Me cilën masë do ta matësh vrasjen e kolonelit. Sërish, mbase, me masën e Romës së Plutarkut?”

Teuta, e fyer, e rrëzoi nga tabela Trekëndëshin e profesorit – Platon në hithrat pranë kazermës: në kalldrëmin e oborrit të vet; në sheshin e Romës...në të gjitha librat e pushtuar nga amoku i patriotizmit, fesë, moralit, ideologjisë...

Prushi gjak i komandantit të kazermës trokiti tek dera e Avdyllit të Zeqës.

“Ik, o Avdyli i Zeqës!” – i thanë. “Sonte prushi i komandantit të kazermës është i uritur për mish njeriu. Komandanti po hakmerret për vrasjen e kolonelit.”

“Pse të ik? Unë vetëm mirë u kam bërë njerëzve. Do të rri këtu, në shtëpinë time”, - zëri i Avdyllit të Zeqës i ra para këmbëve. Njerëzit u rraluan në gjirin e natës së shkrumuar. Avdyli i Zeqës mbeti tek dera, i përhumbur në natën e shkrumbit. I shkoi mendja tek uji, shumë ujë, pastaj i shkoi mendja tek floriri: “Vetëm uji, vetëm floriri mund ta shuajnë natën e bërë prush.”

Prushi i kuq gjak u zvarrë drejt fshatit të ujit me emër Ujz. Me sy të lëbyrur Avdyli i Zeqës i pa vrvashkat e zjarrit

në cep të fshatit Ujz. Gjuha e vravashkës e ndjente erën e mishit të njeriut; ajo iu qas Avdylyt të Zeqës.

“E kapërcyem ujin o Avdyl i Zeqës”, - çirrej vravashka e flakës.

“Floriri do të dalë më i fortë se uji sonte”, - mendoi Avdyli i Zeqës.

“Sille këtu gjithë floririn!” – urdhëroi vravashka e flakës së kuqe.

Avdyli i Zeqës duke e ofruar floririn ndeju në fytyrë firomën e çmendur të vravashkës së flakës. Ajo ngutas e rrëmbeu floririn nga dora e vdekur e Avdylyt të Zeqës anash gjuhës gjak të kuqe të pushkës.

“Kuku për ne! E vranë Avdylin!”

“E vranë”, - gati i tha ‘kurvë’ profesori Teutës. “Deri t’i masësh ti vrasjet me Trekëndëshin e Romës së Plutarkut tek telat gjëmborë të kazermës, tek kalldërmi i shtëpisë sate zjarri do të ta sjellë ferrin në shuplakë të dorës.”

Profesori, i rënë në amokun e vrapimit nëpër urën e sheshtë e bëri shenjën evrobiblike të Franc Kafkës: “Hiq dorë! Hiq dorë!”

“Ky është gjenocid mbi njeriun e pambrojtur”, - u zgurdullua Teuta.

Fjala ‘gjenocid’ e zgjoi Mirk Iliçin.

“Kush e tha?”

“Teuta para tabelës.”

“Mos i përsërit fjalët e Teutës!”

“Instinkti i Revolucionit të Bastiljes; në të gjitha grackat e librave evrobiblikë shtrigat, dhelprat, hardhucat kapërthehen me propagandën e Trekëndëshit autoritar. Ti do që me këtë Trekëndësh, të zbritur nga tabela, ta fshehësh gënjeshtren teatrale të Shekspirit në sheshin e Romës?” – nga midisi i amokut çirret profesori.

“E saktë.”

“Shekspiri përpiket nëpërmes dy llomotitjeve të Brutit e të Mark Antonit të fshehtë dy puçe ushtarake brenda një dite në Romë”, - mendoi se tha Platoni-Sokrat. “Ushtrinë time, nga Trekëndëshi i shtetit tim ky Shekspiri juaj e nxjerr ushtrinë në ilegalitet për t’i bërë vend blegrimës revolucionare të popullit”, - shfyu Platoni-Sokrat. “Edhe në sheshin para Ponce Pilatit mendon se ka brohoritur populli ‘Hosana Baraba?’ Jo!” “Hosana Baraba brohoritën argatët e Romës, spiunët e Romës. Vetë Roma, më tepër se kundërshtarët e Jezusit, ishte për shpëtimin e Barabës. Me Barabën do ta mbante konfliktin të ndezur; me Jezusin do të zbutej konflikti. Roma nëpërmes konfliktit, nëpërmes Barabës, do ta vrasë Izraelin; rabinët nëpërmes Barabës donë ta vrasin vetveten”, - thellë nga amoku i vet po fliste Platoni-Sokrat.

“Ku ishte Rabii Johanan ben Zakai atë ditë kur u amnistua Baraba?” – e pyeti nxënësin profesorin- Sokrat.

“Nga mishi i këlyshit të kones së Danielit e përcolli gjithë ngjarjen. Nga mishi i këlyshit të Kones së Danielit u dëgjua zëri i Rabii Johanan ben Zakait: “Është etpër herët për të dalë. Krimi qenka në fillim”, - vazhdoi profesori – Sokrat. “Kurrë mos u mashtro se revolucionet e popullit mund ta rrëzojnë pushtetin. Mos i beso Shekspirit! Mos u beso revolucioneve të librave!”

“E saktë.”

“Teutës Mbretëreshë i mungon Trekëndëshi propagandistik evropian për ta mbrojtur vetveten. Mbretëresha Teutë sot e gjithë ditën gjykohet sipas modelit të Romës së Plutarkut”, - dëgjohej nga thellë Trekëndëshit të vet zëri ushtarak i Platonit-Sokrat.

“Sa herë e dogje vendin me hutesën tënde?” – profesori desh e kapërdui Teutën. “Edhe sonte zjarri po i hakmerret hutesës sate.”

Vravashkat e flakës natësore u shpërndanë nëpër oborrin e Avdylit të Zeqës. mishi i gjallë i njeriut e ndjeu në mishin e mishit të vet se si po i gozhdonin dyert e kullës. Flaka e zjarrit e lëpiu shtëpinë siç e lëpin gjarpri bretkosën para se ta hajë. Nga brenda shtëpisë së rrethuar nga flaka klithma e mishit të gjallë i shpoi rrathët e tokës e të qiellit.

“Le të digjet krejt çka digjet. Shpirti i kolonelit sonte e lakmon zjarrin e hakmarrjes”, - çirrej komandanti i kazermës.

“E dua sonte ferrin në shuplakë të dorës!” – shkroi në raportin ushtarak.

* *
*

Në orën dy e tridhjetë minuta të Prillit të Ditës së Dytë zilja e telefonit e bëri një vrimë në gjumin veshtullor të shokut Dhimitër Trena. Trembshëm e futi dorën në vrimën e gjumit nga e nxori kufjen e telefonit. Tejtelasit e kishte filluar bisedën shumë më parë...derisa e kuptoi. E zbuti zërin: “Në telefon po ju flet shoku profesor, përgjegjës i sektorit të kulturës. Ka ardhur befaz nga Bshkimi Sovjetik shoku Ivan Jefremoviç Voroncov me porosinë e gatshme të shokut Josif Visioronoviç Stalinit.”

Dhimitër Trena kërceu nga krevati pa e ditur nga cila anë po i vinte zëri.

“Shoku Ivan Jefremoviç Voroncovi brenda pesëmbëdhjetë minutash do ta hapë mbledhjen. A kuptove?” – vazhdoi zëri i frikshëm i profesorit.

“Po. Kuptova”, - u përgjigj i stepur Dhimitër Trena.

Mbledhjen e hapi shoku Ivan Jefremoviç Voroncovi krejt shkurt: “Brenda botimit të sotëm të gazetës *Zëri i popullit*,

të Prillit të Ditës së Dytë, shoku Josip Visioranoviç Stalini do ta kapërcejë kufirin e Shqipërisë për në Kosovë”, - e shpalli qartë shoku Ivan Jefremoviç Voroncovi.

Për botimin e veçantë të *Zërit të popullit*, për artikullin e veçantë do të bisedonin brenda pak minutash shkrimtarët...

“Lidhja e shkrimtarëve të shtetit tuaj do të vendosë tash, këtu, se cili shkrimtar juaji do të udhëtojë sonte bashkë me shokun Josip Visioranoviç Stalinin përtej kufirit tuaj shtetëror”, - vazhdoi shoku Ivan Jefremoviç Voroncovi.

Ajri u zhbirua në shumë vende. Kërcënimi i shokut Ivan Jefremoviç Voroncovit po e hante heshtjen kur dikush e paskësh pasë përmendur Skënderbeun. Ai kundërshtoi: “Skënderbeun do ta caktojmë për udhëtimin e pasdrekës vetëm deri tek kufiri. Sonte, në botimin e *Zërit të popullit*, me shokun Josip Visioranoviç Stalinin, përtej kufirit tuaj shtetëror do të udhëtojë shkrimtari juaj i mirënjohur, shoku Millosh Gjergj Nikolla.”

Dhimitër Trena mendoj: “Shoku Migjen, i sëmurë nga tuberkulozi, si do të udhëtojë sonte me shokun Stalin?”

“Edhe shoku Josip Visioranoviç Stalin e ka dorën të sëmurë nga reumatizma; për hir të vëllazërisë së dy popujve tonë do të ushëtojë sonte përtej kufirit”, - vazhdoi Voroncovi sikur ta kishte kuptuar mendimin e të tjerëve.

“Në ekspedita të mëdha shkojnë më të mëdhenjtë”, - e ndihmoi profesori propozimin e shokut Ivan Jefremoviç Voroncovit.

“Shoku Josip Visioranoviç Stalin dhe shoku Millosh Gjergj Nikolla sonte, në botimin e veçantë të *Zëri i popullit* do ta kalojnë kufirin e Shqipërisë për në Kosovë nga do t’ia dnëprejnë rrugën Misrit amerikan, Misrit propagandistik. Në Kongresin e shtatë shoku Stalin pati thënë se edhe në Biblën fq

reaksionare mungon emri i misrit. Misrin e kanë shpikur imperialistët amerikanë.

Millesh Gjergj Nikolla i juaj, para shtatëmbëdhjetë vjetësh e pati zbuluar se Misri amerikan ua pati hequr koqet juve shqiptarëve në Shkodër; u pati bërë majmunë, paliço, para nëpunësit të prefekturës kur pritnit për t'i marrë nga njëzet kilogramë misër”, - gati kërcënoi Ivan Jefremoviç Voroncovi.

Ajri i zhbiruar erdhi duke u rralluar. Të gjithë shqiptarët e zgjodhën heshtjen.

“Misri i shokut Millesh Gjergj Nikolla le të bëhet antimisër!” – u vendos në Kongresin e shtatë të Bahkimit Sovjetik, krahas rrugëtimit të makinës së Institutit Bujqësor.

“Këtu është spitali ushtarak. Gabim e keni marrë për Institutin Bujqësor”, - i foli mjeku gjeneralit pa e shikuar vëmendshëm kokrrën e Misrit.

Gjenerali heshti rëndë deri tek Instituti Bujqësor. Aty e priti kryeagronomi me propozimin e prerë: “Le të tredhet koqeja e Misrit të Imperializmit amerikan!”

“Edhe në Biblën e tyre reaksionare mungon koqeja e Misrit amerikan”, - shtoi gjenerali.

Kokrra e Misrit amerikane e dëgjoi emrin e vet përtej perdes së gjumit të parë. Çarçafi i gjelbër ia mbështolli rreth kokës gjumin e dytë kokrrës së Misrit amerikan.

“I hoqëm mish paksa tepër kokrrës së Misrit amerikan. Plaga e thellë e kërkon tagrin e vet”, - tek në gjysmë të operacionit foli kryeagronomi për ta dëgjuar gjithë ekipi.

“Do ta mbushim plagën me mish të ri”, - ndërhyri ndihmësi i kryeagronomit.

Në fund të gjumit të dytë të kokrrës së Misrit amerikan erdhën Misri siberian dhe Misri kinez për të uruar operacionin e suksesshëm.

në derën e dhomës ku po këndellej pas operacionit kokrra e Misrit amerikan u shfaq Millosh Gjergj Nikolla për përgëzime.

Kokrra hibride e Misrit sovjetik i shpjegoi kokrrës së Misrit amerikan: “Çelovek stojashçij u dvorci – moj brat”.

Pasi kokrrës së Misrit amerikan iu hoq mishi i imperializmit amerikan bash me kokrrat e Misrit sovjetik, Misrit kinez dhe Misrit të shokut Millosh Gjergj Nikolla u bënë antimisër.

Komesarët politikë, ashtu sipas rendit, ia uruan detyrën e re kokrrës së Misrit të tredhur: “Kokrra e Misrit, Mishi i Bizonit, Gjaku i indigjenit e ushqyen imperializmin amerikan-imperializmin më gllabërues”.

Josip Visioranoviç Stalini duke hyrë në sallën e kongreseve përshëndeti miqësisht Millosh Gjergj Nikollën: “Ti shoku Migjen sot e ke shëruar kokrrën e Misrit nga shovinizmi i Imeprializmit amerikan”.

Kur dita e tretë e gjumit të dytë po e soste vetveten Millosh Gjergj Nikollën e caktuan shkrimtar në kooperativën e Institutit bujqësor. Gratë e racave të ndryshme e kishin braktisur dëshirën për të gjitha llojet e meshkujve. Në syrin e ftohtë të kryepunëtores hazare u mbyt zëri i dikujt: “Kokrrës së Misrit iu nxor fara e mashkullit!”

Shoku Migjen e pa vezullimin në sytë e drejtorit të kooperativës së Institutit bujqësor. E ngacmoi kroma tek mishi i mashkullit. Ende pa e çuar dorën midis vegëve foli Josip Visioranoviç Stalini me mburrje: “Çudi çka më shpëtoi: konstrukt i im i fortë fizik apo ballsami i mjekut të fshatit?”

Ivan Jefremoviç Voroncovi e peshoi një deng të gazetës *Zëri i popullit* brenda të cilit shoku Stalin do ta kapërcente kufirin e Shqipërisë për në Kosovë.

Ora e shokut Voroncov tregoi se kishte kaluar shumë kohë nga fillimi i mbledhjes. Duhej ngutur.

Zërat e zhbiruan ajrin e rralluar të natës së Prillit të Ditës së Dytë para se Josip Visioranoviç Stalini ta ndjente ankimin e gjyshes: “Është dita e tyre; ata do ta njohin njëri-tjetrin”.

“Për kë foli gjyshja? Për ne të dy?” – e pyeti Migjeni.

“Ishin ujqit”, - u përgjigj Migjeni.

“Pylli u sos”, - rënkoj Stalini. “Në Tbilsi gurgullima e ujëvarave të pranverës sjell lagështi nëpër çelat e Manastirit. Nga kjo lagështi të vritet gjaku i dorës së majtë.”

“Ikonat e Manastirit tim fryheshin si bretkosat, veçanërisht pas mesnatës kur i zinte lagështia”, - me zërin e tij të çjerrë foli Migjeni.

“Këtu tek Shqipëria bëhet cepi më perëndimor i Perandorisë sime. Perandorët, ndryshe meje, sonte udhëtojnë me lektiga, me deve, me karroca, me automobila, me trena, me avionë...Unë e bëj rrugën nëpër perandorinë time ilegalisht”, - rritej brenga e Gjeneralisimusit të fshehur në dengun e gazetës *Zëri i popullit*.

Në teh të gjumit veshtullor të ushtarëve, të deveve, të kuajve, të konkubinave, Kryetagbitari u çjerr mu tek veshi i Besi Ban Efendisë: “Rojat e gjumit të ushtarëve, të deveve, të konkubinave, të kuajve i kanë kapur këta kontrabandistë të gazetave.”

Besi Ban Efendia e sosi shenjën e dorës së trembur me një shikim ngulfatës mbi Stalinin dhe Migjenin, të mbështjellë në dengun e gazetës *Zëri i popullit*.

“Më është mpirë dora e masjtë; e ndjej për të huajën. Kjo dorë reumatike në shpëtoi nga ushtria e Carit”, - i pëshpëriti Migjenit brenda dengut të gazetës *Zëri i popullit* Stalini.

Besi Ban Efendia po e afronte llupën mbi Stalinin ngase ia tërhoqi vëmendjen rroba e tij ushtarake po të mos e kishte përmendur Kryetagbitarin.

Atëherë Besi Ban Efendia foli: “Në ëndrrat e ushtarëve të mi, të deveve të mia, të kuajve të mi, të konkubinave të mia, ndalohet hyrja ilegale e të huajve.”

Stalini vetëm u ankua: “E kam zënë dorën keq në këtë deng gazetash të mallkuara. Mirë më thoshte Jekaterina, nëna ime: “Soso, çojë dorën tek qëllimi para se ta çosh zërin!”

“Duro edhe pak, vetëm edhe pak, sa të lirohesh nga dengi i gazetave *Zëri i popullit*. Ato gazeta do t’i shpërndajmë ne nëpër rrugë, nëpër oborre e deri tek fusha”, - e ngushëlloi Stalinin vetë koloneli i heshtur.

Besi Ban Efendia u tërhoq trembshëm nga vështrimi me llupën e vet sepse e ngacmoi përmjerrja në shallvare.

“Po si të duroj kur ma kanë zënë kaq keq dorën e majtë në dengun e gazetave?” – ankoj Stalinin.

Besi Ban Efendia e sosi matanë tendës përmjerrjen grarishte me vështrim të zgjuar, me zë më të holluar i vuri në provë: “Ju paskeni dashur t’i shpërndani këto gazeta përtej Erenikut, përtej ëndrrave të ushtarëve të mi, pikërisht sot, Prillin e Ditës së Dytë.”

Koloneli e futi dorën në dengun e gazetave *Zëri i popullit* për ta konstatuar numrin e ekzemplarëve. Konstatoi sa njerëz do të burgosen. Do të burgosen njerëzit në shtëpi, në rrugë, në fushë. *Zëri i popullit* do të shpërndahet çdo natë sipas planit të arrestimeve.”

Kur shoku Stalin e konstatoi miqësinë e kolonelit, i tha: “Ky *Zëri i popullit* i përngajn gruas ruse: duhet të martohet me muzhikun, duhet të bëhet nënë e muzhikut, deri në vdekje t’i përkulet muzhikut.”

Stalini e ndjeu kutërbimin e urinës në fjalët e veta të qullta pas gjysmës së natës.

“Atëherë pse keni pranuar të hyni në këto gazeta? Ta kaloni kufirin kaq padenjesisht?” – ngacmoi koloneli pasi e konstatoi dobësinë e shokut Stalin. “Pas një gjysmë ore raketa *Tomahok* do ta djegë dengun e gazetës *Zëri i popullit*.”

“Po ti do të më nxjerrësh më përpara nga *Zëri i popullit*”, - gati e luti Stalini kolonelin.

“Estokfërllah!” – ra në fjalë Besi Ban Efendia posa e dëgjoji emrin e *Tomahokut*.

Ai do të kishte mbetur midis hutimit sikur Kryetagbitari të mos ia kishte kujtuar: “Gjenerali roman e lejoi Rabii Johanen ben Zakain për ta themeluar Sanhedrinin në qytetin Jahne tek i polli koneja e Danielit, në fund këlyshin e bardhë me pikla të zeza...”, - sikur u ngatërrua Kryetagbitari.

“Këlyshi i bardhë me pikla të zeza i konesë së Danielit u lirua të hyjë në mishin e Mefistos për ta mashtruar Doktor Faustin e madh gjerman. Rabii Johanen ben Zakai udhëtoi nga Tribali i Madh, nëpër tendën e gjeneralit roman, nëpër lazdrimin ushtarak të Faustit deri tek derë e krematoriumit nëpër tjetër rrugë nga Trekëndëshi im ushtarak”, - ndërhyri Platoni-Sokrat midis kolonelit Besi Banit dhe Stalinit.

Kur Rabii Johanen ben Zakai u fsheh në mishin e këlyshit të Kones së Danielit, Mbretëresha Teutë u fsheh në shtatë palë menstruacione. Të dytë, edhe Rabii edhe Mbretëresha, udhëtuan nga dy mijë vjet rrugë tjetër nga Trekëndëshi ushtarak. Rabii Johanen ben Zakai mbeti i hutuar kur Trekëndëshi evropian i maste standardet e kampeve naziste dhe Mbretëresha Teutë u hutua para gullagëve rus.

Stalini sharroi më thellë në dengun e gazetës *Zëri i popullit* duke iu ankuar kolonelit: “Ose duhet ta zgjedhësh

mishin e këlyshit të kones së Danielit ose lavdinë ushtarake e politike.”

Thënë të drejtën sonte, në dengun e gazetës *Zëri i popullit* po e shoh sa ngushtë e paskan pasur ata të dy: Rabii Johanan ben Zakai në mishin e këlyshit të kones së Danielit e Mbretëresha Teutë në shtatë palë menstruacione.”

Kryetagbitari duke e vërejtur ngushtesën e Stalinit në dengun e gazetave *Zëri i popullit*, sikur deshi t’ia shtojë dhembjen e dorës, foli: “Rabii ben Shimon Gamliel qysh në rini, i strukur në petkun romak, u bë udhëheqës i universitetit hebre në Jahne.”

Gjeneralisimusi Stalin shkoi shkarazi mbi bisedën e Kryetagbitarit; ai tashmë, i ngushtuar deri në ngulfatje në dengun e gazetave *Zëri i popullit*, kishte rënë në ëndrrën e shtatoreve të ngritura nëpër sheshet e Moskës, Varshavës, Pragës, Budapestit..., e deri në Tiranë.

“Të gjithë skulptorët kanë qenë të sugjeruar të m’i lënë të lira duart në të gjitha shtatoret, veçanërisht dorën e majtë reumatike. Kur duhej t’i drejtohesha popullit nga shtatoret e mia të llamarinta, skulptorët ma ngritnin lart vetëm dorën e djathtë”, - dikur vonë i paskësh treguar Kryetagbitarit prej ëndrrës së shesheve të qyteteve.

Në ëndrrën e thellë të llamarinës shtatoret e gjeneralisimusi Stalin, nëpër sheshet e qyteteve, së pari në Moskë filluan ta lëvizin edhe dorën e majtë reumatike sikur mëtonte të bëjë vend të shlireshëm në dengun e gazetave *Zëri i popullit*. Gjeneralisimusi Stalin Prillin e Ditës së Dytë u shkoq nga bazamenti me vrapin ngulmues nëpër urën e sheshtë.

Tek midisi i urës T. këlyshi i kones së Danielit po përmjerrej buzë parmakut me shikim mospërfillës. Gjeneralisimusi Stalin mëtoi ta kuptojë se në cilin drejtim po shkonte këlyshi i Kones së Danielit. Për çudinë e tij këlyshi,

me shikim krejt mospërfillës, hyri në punëtorinë e dërrasave; u ul afër regjisorit.

Në veshin e këlyshit të Kones së Danielit regjisor i pëshpëriti duke ia lëshuar përpara në tavolinë rrobat teatrore të Djallit të Mefistos: “Dërrasën e fundit të Kalit të Trojës po e lyejnë me vernik.”

Të gjithë në sallë po e aktronin të folurit brenda ajrit të shurdhuar.

Gjeneralisimusi Stalin mendoi se si përherë hrushovi po e aktronte të folurit. Kur në sallë, sipas lëvizjeve të duarve, filluan t’i duartrokisin Hrushovit, u kapërdis të dëgjojë diç me veshin e llamarintë të shtatores.

Vetëm kur Uliksi arriti t’ia zbulojë fjalët e Hrushovit: “Ndodhte shpesh kur i vinin kuadro të larta partie e shteti Stalini t’i dërgonte ose në burg, ose në pushkatim”, - deshi të çirrej Gjeneralisimusi. “Ti u bëre tradhtar i bolshevizmit!”

Sërish deshi ta kuptojë shenjën e ngadaltë të dorës së Hrushovit kah shtatorja e llamarintë kur ia hodhën mbi kokë çarçafin e kuq. Mendoi se po bëhej promovimi i shtatores së tij si zakonisht në sheshin e Moskës para se Uliksi t’ia shpjegojë: “Do të ta heqin mashkullin nga mishi yt i hekurt.”

Stalini edhe pas shpjegimit të Uliksit mendoi se vetëm do t’ia grasatojnë vidhat në fund të barkut.

Në fund të gjumit të parë e dëgjoji nga larg urdhrin e Hrushovit: “Le të hiqet krejt çka duhet të hiqet!”

Në fund të gjumit të dytë e zbuloi veten të shtrirë, të zhvidhosur në errësirë. E pyeti Uliksin e shtrirë afër vetes: “Ku gjendemi tash?”

“Në bodrumin e Teatrit evropian, shfaqja mori fund.”

“Dikush po tradhton”, - u mundua gjeneralisimusi Stalin t’i flasë Uliksit edhe për rrëshqitjen nëpër litarët teposhtë kalit të Trojës për në skenën evropiane.

“Sonte Mbreti do ta përcjellë shfaqjen”, - nëpër errësirë i tha Uliksi.

Stalini sikur e kuptoi dëshirën e Uliksit në fund të amokut pas këlyshit të konesë së Danielit. Nëpër errësirën e bodrumit të Teatrit evropian u fol për pajimet e kalit të Trojës në skenë. Stufa u vendos afër toaletit në barkun e kalit.

“Do të rrjedhë curril urina në skenë me kutërbim të rëndë”, - Uliksi ia tërhoqi vëmendjen regjisorit.

“Të tmerrojnë dy mijë vjet në barkun e kalit pa u përmjerrë asnjë herë?” – pyeti paksa me qortim regjisori.

“Tre mijë vjet.”

”mirë! Tre mijë vjet.”

Ti e konsideron dobësi timen përmjerrjen në barkun e kalit të Trokjës”, - i tha Uliksi Gjeneralisimusit të shtrirë në errësirë. “Drejtori i Manastirit në Tbilsi kur desh të të ndëshkojë ashpër të mbylli në çelë njëzet e katërt orë. Unë qëndroj në barkun e këtij kali këtu e tre mijë vjet.”

Në errësirën e bodrumit evropian Uliksi u kujtua për kohën. I mbledhi lecat e atij mëngjesi tek barku i kalit kur trokiti në dërrasën e shtatë të brinjës së majtë të kalit; në mazgallën e hapur aty për aty u shfaq syri i zgllubosur i Ajaksit. Ishte vetëm në kanatiere.

“Edhe një orë do të kacavirem me litar në skenën evropiane. Mendo për aktrimin tënd!” – i tha syri i zgllubosur përtej zavrakut.

“Të tmerrojnë dy mijë vjet ngujimi në barkun e kalit të Trojës?”

“Tre mijë vjet.”

“Mirë. Tre mijë vjet.”

Dritat i garuan njëra-tjetrës në sallën e kadiftë (kadifenjtë?) të teatrit evropian. Lozhat fytyrëmbuluara

(fytyrëveshura?) me nofullat e poshtme të dala jashtë perdeve po e përtypnin pleqërinë e vet dymijëvjeçare.

“Tre mijë vjet.”

“Mirë. Tre mijë vjet.”

Syri i zgllubavt i Ajaksit nga mazgalla e brinjës së majtë të kalit e urdëhroi ta zërë vendin e vet në skenën e shfaqjes së madhe evropiane deri sa sërish Stalini ngarendi urës së sheshtë i mbytur amokut të Trekëndëshit – Logos evropian. Stalini po ikte, po shpërngulej, nga gazetatat, nga librat, nga shtatoret e bronzta, nga gojë e njerëzve. Ai po ikte tinëz deri tek dengju i gazetës *Zëri i popullit*, në cepin më të humbur të Evropës.

Besi Ban Efendisë ia nxori Kryetagbitari nga dengju i letrës së përzier me agsholin e fillimditës së dytë të Prillit një ekzemplar të *Zërit të popullit*. Ishte gjeneralisimusi Stalin.

“Nga është ky gjeneral kaq i lartë?” – e pyeti Besi Ban Efendia Kryetagbitarin.

“Është perandori i Rusisë”, - u përgjigj Kryetagbitari.

“A ka qenë ndonjëherë në vizitë tek padishahu ynë?”

“Jo.”

“Pse?”

“Ky gjeneral është kundër zotit të vet.”

Besi Bani Efendia e përfundoi shenjën e lidhur nyjë nëpër gishtat e dorës së shtrirë kah Kryetagbitari përballë heqimit në derë të tendës. U pre letër gazet, u pre letër libri, u pre bronz shtatoreje, u pre gur bazamenti, u pre gjuhë goje.

“Kënd e ndjekin kështu nëpër gjithë këtë letër të prerë, nëpër gjithë këto shtatore bronzit të rrëzuara, nëpër gjithë këto gjuhë të prera?” – Besi Ban Efendia e pyeti paksa i frikësuar Kryetagbitarin.

“E ndjekin këtë gjeneralisimus të strukur në gazetën *Zëri i popullit*”, - ndërhyri koloneli.

Pas fjalëve të kolonelit Besi Ban Efendia iu kthye:

“Sa është i madh ky shteti i *Zërit të popullit*, siç po thuani ju?”

“Është i madh dy milionë banorë.”

“E paska burgosur veten patriku i Moskës”, - ankoj Besi Ban Efendia. “Le të hiqet çka mund të hiqet!”

“E kanë hequr me parë”, - shpjegoi Kryetabitari.

Evropa po heq letër gazete, po heq letër libri, po heq bronz të grasatuar, po heq gurë nga bazamentet, nga plaga e nbushur me djathë të pjekur tek vendi i mishit mashkullor të Stalinit kur kah dyert e hapura u shfaqen fanfarët. Temjani i dendur i prini Kryepatriarkut të Moskës në derën e hapur solemnisht për të hyrë konstrukti i drunjte me fjalët solemne: “Po e sjellin kryqin e madh.”

Dera e sallës së madhe të teatrit u bë e ngushtë për konstruktin e madh të kryqit mbi krahët e shumë sklleverve bashkë me buçitjen kolektive: “Rrëzoheni murin!”

Turma e egzaltuar iu lëshua teatrit evropian, Murit të atij farë Berlinit, nën buzëqeshjen e fshehur nën mjekrën e kryepatriarkut të Moskës.

“Krejt si në shfaqjen tonë të parë me drurin e kalit të Trojës, si me drurin e kryqit të Golgotës, si me drurin e Trekëndëshit të Logosit evropian”, - bërbeliti me veten Uliksi pak para britmës së një fëmije:

“Është ky dru masiv Trekëndëshi i Platonit.”

Në fund, krejt në fund të klithmave të largëta e çjerrëse: “Rrëzoheni murin e këtij farë Berlinit!”, u shfaq konstruktori, tashmë i qartë në sallën e teatrit evropian, i Trekëndëshit të Platonit-Sokrat bashkë me urdhrin: “Mateni Romën!”

Kur sklleverit e lëshuan Trekëndëshin e drunjte të Platonit në sheshin e Romës nën urdhrat e kryepatriarkut të Moskës, këndi i parë i ra brenda pallatit të Cezarit, këndi i dytë

i ra në senatin-Koloseum, këndi i tretë i ra jashtë Romës, në fushë.

“Si në të gjitha skenat evropiane”, - erdhi zëri paksa i nevrikosur.

Herët, para mëngjesit të Prillit të Ditës së Dytë, stuhia e gjeti ende të zgjuar Cezarin; krejt të vetmuar, të pafjetur tërë natën.

Bruti-Kas kishte vrapuar gjithë natën nëpër Trekëndëshin e Platonit-Sokrat deri tek Cezari-August. Bruti i dha bisedë Cezarit.

“Në skenën evropiane ngjarja zhvillohet krejt sipas rregullës: Cezari plagoset nga dy senatorë, me këtë kamë”, - Bruti e nxori kamën e lyer me gjakun e Cezarit apo me bojë. “Ti Cezar-August do ta nxitësh hidhërimin tim të Brutit-Kas.”

“E paske hequr atë fjalinë dramatike të Shekspirit: Edhe ti Brut, a?!”, - mëdyshoi Cezari-August.

“Të pëlqen aq fort ajo fjali dramatike?”

“Po.”

“Atëherë përsërite deri në orën nëntë të Prillit të Ditës së Dytë!” – e urdhëroi Bruti-Kas.

“Po ajo ditë vetëm sa filloi.”

“E di.”

Në fund të rrugës së kthimit nga përcjellja e Brutit-Kas me vezullim në thikë e në sy Kleopatra iu kthye Cezarit-August: “Ky njeri është vrasës. Ruaju prej Brutit-Kas!”

“E di”, - mospërfilli Cezari-August.

“Kur roja e hapi derën, era e rrëmbyeshme nën pelerinën e Brutit-Kas e zbuloi thikën ngjyrë gjake”, - e bindi edhe një herë Kleopatra.

“E paska vrarë Cezarin?” – vazhdoi Cezari-August.

“Po.”

“Atëherë vrasja qenka sosur për sot?” – qesëndisi Cezari-August.

“Vrasja përsëritet.”

“Vrasja e përsëritur mund të bëhet edhe me bojë të kuqe”, - vazhdoi Cezari-August.

“Si gjaku si boja e kuqe e yshtin vdekjen. Ti, sot, mos shko në Seantin-koloseum!” – e urdhëroi Kleopatra.

“Po u ranë në ujdi gjaku e boja e kuqe, ne të dy do të hamë darkë sonte në ndonjë restorant”, - ia përkëdheli paksa qafën Kleopatrës.

Kleopatra u tërhoq hidhërueshëm në dhomën e toaletit me përplasje të derës prapa vetes.

“Le të vdesë ky Cezari kokëfortë”, - i tha Kleopatra vetvetes.

“Edhe mund të vdesë sot”, - u kujtua Cezari për veten. “Bruti me tha: “Në orën nëntë të Prillit të Ditës së Dytë do të ndodhë vrasja me bojë të kuqe në senat. Në orën dhjetë popullin-begati do ta zhvendosin në sheshin e Madh të Romës. Unë do t’i flas turmës nga koha e tashme, nga e sotmja. Turmën duhet mbajtur gjithmonë në kohën e shkuar, në kohën metafizike, atje ku njeriu privohet nga çdo gjallëri, nga çdo sukses, nga çdo revolucion”.

“Ne jemi pushteti-shtetëror. Ne jemi koha e tashme, koha e suksesit të përherëshëm, koha e sundimit të përherëshëm. Këtë sundim të përherëshëm na e siguron Trekëndëshi i Platonit-Sokrat.”

“Po.”

“Populli mund t’i afrohet pushtetit-shtetëror deri tek koha e pakryer si turmë e përlur, e dëgjueshme, e bindur deri në mahnitje fëmijërore.”

“Po”, - tha Bruti-Kas. “Në popull do të përbihen spiunët e sigurimit tonë shtetëror. Ata do ta nxisin brohoritjen aktruese sipas avazit të ushtrisë sonë.”

“Këtu bëhet komplot ushtarak”, - mendoi Cezari. “Në cilën anë të ketë më shumë ushtarë do të shkojë fitorja.”

Bruti-Kas heshti mospërfillshëm.

“Ku do të qëndrojë ushtria deri tek Prilli i Ditës së Dytë?” – pyeti Cezari.

Në vezullimin e tehut të thikës në sy Bruti vazhdoi të flasë mospërfillshëm:

“Ushtrinë do ta zhvendosim nga Trekëndëshi i Platonit-Sokrat: nga pallati i Cezarit-August, nga senati koloseum do të aktrojmë tek sheshi i Romës në midis të turmës harbute.”

Para se të niset për tek Senati-Koloseum Cezari-August e thirri në pallatin perandorak Mark Antonin për ta pyetur:

“E ke përgatitur fjalimin e orës njëmbëdhjetë për masën halldupe tek sheshi i madh i Romës?”

Cezari e hetoi ngurrimin në fytyrën e buhavitur të Mark Antonit. Pastaj ngurrimi i Mark Antonit u kullua në mëtesën për sqarim:

“Në cilën anë do të qëndrojë ushtria Prillin e Ditës së Dytë, në orën njëmbëdhjetë?”

“Ushtria do të ndahet në dy pjesë...”, - sqaroi Cezari.

“Të barabarta?” – pyeti Mark Antoni.

“Atë çështjen e ushtrisë e ka marrë përsipër Bruti-Kas”, - sikur e mospërfilli Cezari-August.

“Brutin-Kas e tradhtojnë sytë lakmues të vrasësit”, - sëmboi Mark Antoni. “A do ta ndajë ushtrinë barabart midis vetes dhe teje”, - sërish sëmboi Mark Antoni.

“Ushtria e Prillit të Ditës së Dytë në të gjitha tekstet teatrore të Evropës do të heshtet”, - vazhdoi Cezari-August.

“Gjithë këtë zhvendosje të Trekëndëshit të Platonit-Sokrat e falsifikoni vetëm për çështje teatri politik?” – u bë i habitur Mark Antoni.

“Po nga të gjitha tekstet teatrore evropiane do ta heqim ushtrinë. Në vend të ushtrisë do të aktrojë populli.”

“Ti, Cezari-August dhe ai Bruti-Kas e falsifikoni Trekëndëshin e Platonit-Sokrat.”

“Mbase.”

“Ti, Cezari-August dhe ai Bruti-Kas i falsifikoni të gjitha librat e Perandorisë evropiane.”

“Mbase.”

“Unë, Mark Antoni, e përbuz fjalimin tim të orës njëmbëdhjetë pa hisen time të ushtrisë. Refuzoj të bëhem i mashtruari i parë i teksteve dymijëvjeçare të Cezarit-August e të Brutit-Kas “, - kundërshtoi Mark Antoni.

“Turma harbute do të ketë falsifikim shpresëdhënës”, - ngushëlloi Cezari të doemosdoshmen.

“Cezari-August dhe Bruti-Kas e falsifikojnë Trekëndëshin e madh të Platonit-Sokrat për çështje të propagandës politike. Platoni-Sokrat në Trekëndëshin e tij të madh: Filozofët-ushtria-populli, e vendos ushtrinë në pozicionin real të ekzekutorit të madh pa më të voglin falsifikim propagandistik”, - sërish Mark Antoni e kundërshtoi fjalimin e vet të orës njëmbëdhjetë.

“Fjalimi yt i Prillit të Ditës së Dytë, në orën njëmbëdhjetë në librat dymijëvjeçare do të dalë vetëm fjalim civil”, - e hutoi Cezari-August.

Mark Antoni, për habinë e Cezarit-August e kaptoi bisedën:

“E ke pyetur Brutin-Kas? A ka hequr dorë nga ushtria gjatë fjalimit tim të orës njëmbëdhjetë?”

“Do ta pyes kur të arrijë në Senatin-Koloseum.”

“Do ta pyesësh pas vdekjes sate? Ti do të vdesësh me të arritur në Senatin-Koloseum”, - vendosi Mark Antoni.

“Po”, - tha Cezari-August. “Librat tashmë janë shkruar pa ushtrinë tënde, vetëm me brohoritjet e popullit civil.”

“Në Teatrin e Berlinit kryepatriarku i Moskës po matej t’i japë fund urdhrin: ‘Mateni Romën’, kur në cep të fjalimit të Mark Antonit u shfaqën fytyra të skuqura civile: ‘Vrajeni Brutin! Ai e vrau Cezarin-August.’”

Në fund të çjerrjes së fytyrave civile cingërima e celularit të Mark Antonit e përbiroi një zë gruaje:

“Alo...!”

“Urdhëroni!” – u përgjigj Mark Antoni.

“A është drejtori i teatrit aty?”

“Po.”

“Bruti është shumë i sëmurë. Sot do të mungojë në punë”, - ia xigëloi veshin zëgruaja.

“Ku është Bruti tash?” – pyeti Mark Antoni.

“Bruti është i shtrirë në shtrat.”

“Le të vdesë menjëherë aty në shtrat!” – urdhëroi Mark Antoni.

“Mirë!”

Trekëndëshi i drunjtë tashmë kishte hyrë në sallën e Teatrit evropian nën urdhrat e kryepatriarkut të Moskës: “Mateni Romën!”

Trekëndëshi i Platonit-Sokrat sipas urdhrin të kryepatriarkut të Moskës hyri në sallën e teatrit të Berlinit. Këndi i filozofëve ra në lozhën e mbretit, këndi i ushtrisë ra në skenën e teatrit, këndi i popullit të Platonit ra midis turmës tek Muri i rrëzuar i Berlinit. Ra heshtja në sallën e teatrit.

“Për sa kohë kalohet nga lozha e Mbretit deri tek skena?” – e pyeti Stalini Mark Antonin.

“Menjëherë! Aty për aty”, - u përgjigj Mark Antoni.
“Bruti-Kas nga Senati-Koloseum tek pallati perandorak kalonte për një çast aq sa sot mund të kalohet nga lozha e Mbretit tek skena e teatrit evropian.”

“Atëherë pse unë sonte po e kaloj ilegalisht kufirin, i fshehur në dengun e gazetës *Zëri i popullit*, - ankoj Stalini.

“Ti e kalon kufirin ilegalisht ngase të ka lënë ushtria e Trekëndëshit të Platonit-Sokrat. Skena e Senatit-Koloseum u bë goja e madhe e Cezarit-August kur ai e kishte ushtrinë e Platonit-Sokrat”, - fliste i revoltuar Mark Antoni pas konfliktit me Cezarin-August.

“Po kjo skena e sotme evropiane?” – hidhërimi i Stalinit nga dhembja e dorës së majtë u bë më i ashpër.

“Skena e teatrit evropian, librat, religjionet, moralet,...u bënë goja e madhe e Mbretit, e Diktatorit...”, - derisa po ngritej perdja e madhe fliste Mark Antoni.

Besi Ban Efendia u tremb kur e preku me dorë lëkurën e butë të këlyshit të kones së Danielit. Kryetagbitari e afroi pishtarin tek sytë e këlyshit të Kones së Danielit.

“Ma thotë Kryetagbitari se në sytë e këtij këlyshi është fshehur i gjithë mashtrimi hebre”, - e ngacmoi Besi Ban Efendia kollitjen gërryese të Francë Kafkës.

“Më duhet të dalë nga mishi i njomë i këlyshit të Kones së Danielit”, - ankoj Rabii Johanan ben Zakai.

“Ku do të rrish gjatë shfaqjes së madhe? Mbase është herët të rrish jashtë.”

“Do të vendosem në mishin e djallit të Mefistos.”

“Mirë.”

Nga jashtë polici gjerman sa i nxjerrte kreje, çirrej: “Hiq dorë! Hiq dorë!”

“Më zbuloi para kohe ai mefistoja i marrë”, - mendoi Rabii Johanan ben Zakai.

Cingërima e celularit e futi regjisorin në xhepin e madh të xhaketes së trashë.

“Dëshiroj të flas me drejtorin”, - zëgruaja nga ana tjetër e telefonit gati sa urdëhroi.

Regjisori u përpoq t’ia qëllojë hidhërimit të zëgruas me përgjigjen e butë:

“Urdhëroni flisni! Këtu është regjisori.”

“Mefistoja sonte është shumë i sëmurë. Sontë do të mungojë në punë.”

“Ju jeni Magaritë”, - e qetësoi Regjisori.

“Po.”

“Ku është tash Mefistoja?”

“Në shtrat, i shtrirë.”

“Le të vdesë! Menjëherë! Aty në shtrat ai hebre i mallkuar!”

Margarita heshti në anën tjetër të telefonit. Regjisori e dëgjonte frymëmarrjen e saj të shqetësuar duke pritur në e kishte marrë urdhrin kur Margarita foli ankueshëm:

“Për të vdekur Mefistoja duhet t’ia dërgoni doktor Faustin e teatrit.”

“Pas vdekjes do t’ia dërgojmë doktor Faustin atij Rabii Johanan bin Zakait të mallkuar. Ai duhet të vdesë vullnetarisht për Mbretin tonë”, - urdhëroi regjisori me zë të holluar nga ironia sëmbuese.

“Mirë!” – përgjegji nga ana tjetër e celularit Margarita.

Regjisori doli nga xhepi i celularit tek perdja paksa e ngritur për ta këshilluar Mefiston:

“Mos u ngut të dalësh para kohe nga këlyshi i Kones së Danielit!” “Ky këlyshi i Kones së Danielit më zbuloi para kohe”, - pëshertiu Franc Kafka në shtratin e vdekjes. “Miku im pas vdekjes sime digji të gjithë librat e mi.”

“Ik nga mishi i Mefistos!” – e këshilloi miku i tij, Maks Brodi.

“Ku të rrij unë deri te vijë vdekja ime?” – pëshertiu sërish Franc Kafka.

“Hyr në mishin e ngrohtë të insektit!”

U bë heshtje.

“Regjisori ka shkuar në lozhën e kancelarit për të pyetur: ç’ të bëjmë me kaposhin Mefisto”.

Kancelari po çirrej rreth plagosjes së hershme të Cezarit-August. Ngjyra e kuqe e hedhur larg plagës e çliron vdekjen e Cezarit-August.

“Mefisto le të dalë menjëherë në skenë!” – urdhëroi kancelari.

“Mefistoja sonte mungon në punë. Është i sëmurë”, - sqaroi regjisori.

“Le të vdesë menjëherë Mefistoja!” – urdhëroi kancelari. “Nxirreni nga mishi i këlyshi i Kones së Danielit atë Juden Mefisto!”

Mefistoja doli para kohe, i përgjakur, nga mishi i kones së Danielit. Në çastin e daljes mungoi doktor Fausit. Ai ishte shumë i sëmurë, në shtratin e vdekjes.

“Le të vdesë, menjëherë në atë shtrat ai hebre i mallkuar!” – sërish urdhëroi kancelari.

“Duhet t’ia dërgojmë tre engjëj të teatrit në çastin e vdekjes. Kështu e lyp rregulla e lojës”, - kërkoi zbatimin e rregullës së teatrit regjisori.

“Le të vdesë ai farë Doktor Fausti pa asnjë engjëll!” – urdhëroi kancelari.

“Mirë!”

“Kanë filluar të mbushen mend këta gjermanët”, - mendoi Stalini. “Shumë e kanë llastuar njerëzit e librave këtë

doktor Faustin. Treqind vjet ky doktor Fausti vdes vetëm me engjëj. Le të vdesë, së pakut një herë pa engjëj!”

Shfaqjet plymësore të teatrit evropian u shpërndanë në të katërt anët e kontinentit:

Diku në midis të urës T. kalit të Skënderbeut po ia jepnin dorën e fundit të lyrjes me bojë ushtarake.

“Edhe nëpër libra e lyejnë kalin e Trojës”, - sipas rregullës së teatrit foli regjisori në fund të librit të xhiruar.

Në fund të librit të xhiruar me titull “Lufta e Dytë Botërore” Stalini e priti jekaterina. Ishte e ëma.

“Këtu po të prisja”, - i tha Jekaterina birit të vet. “Eja të shkojmë! Tashmë u sos libri i xhiruar.

Në fund të kromzës vegëve të qullura nga përmjerrja grarisht, Besi Ban Efendia u zgjua nga jehu i zërit të nënës.

“Ishte ajo!” – tha. “A është lumturi të të presë nëna në fund të rrugës?”

Josip Visioranoviç Stalini e bëri me kokë shenjën e miratimit përtej fjalës.

Besi Ban Efendia e zgjati durimin deri në cep të bisedës së Jekaterinës: “Eja, bir! Tashmë u sos libri i xhiruar.”

Stalini aprovoi nga përtej fjalës.

Në fund të librit të xhiruar Besi Ban Efendia vendosi të shkojë asaj rrugës së sosur.

Ende pa vendosur përfundimisht Besi Bani e dëgjoi kujën e nxënësve të klasës së katërt tre të gjimnazit “Hadu”. E pa kokën e vet të zvarur në midis të klasës.

Mezi arriti përtej fjalës të zë hidëhrrimin e profesorit duke u çjerrur mbi nxënësit:

“Le të vdesë ky eunuk i ndotur!”

“Kur doli në korridorin e shkollës, krejt afër tavanit e pyeti Gjergjin me katër emra:

“Përse nxënësit e klasës së katërt e bëjnë gjithë këtë kujë.

“Se ti u shërove.”

“Po ajo Princesha Tahet pse qan aq dhembshëm mbi njeriun e shëruar?” – u habit Besi Bani. “A mund të kthehemi edhe një herë në klasë?”

“Po.”

Mezi u zdorgjën tek dera e klasës së katërt tre ku Besi Bani e dalloi kufomën e vet të zgrehur mbi bankë. Po e prisnin mjekun për ta konstatuar vdekjen.

“Kush vdiq? Unë apo ai?” – bëri me dorë Besi Bani kah kufoma.

“Po deshe mund të kthehesh në atë kufomë”, - i tha Gjergji me katër emra.

“Kurrë më!” – kundërshtoi Besi Bani sshiquash sëshpërimin e princeshës Tahet mbi kufomën e Besi Banit.

...Kryemjekja i qortoi infermieret pse e kanë lejuar atë “kurvën hazare” t’u ikën nga spitali. Njëri nga infermierët, në fund të hidëhimit të kryemjekes arsyetoi:

“Po ajo ‘kurva hazare’ në fletëlëshim e kishte të shkruar: Shërim i menstruacioneve kronike.”

Fjalët e infermieres e kthyen të gjithë ekipin në midis të hidëhimit të kryemjekes.

Besi Bani me cegmën (cemtësinë?) e vdekjes nën lëkurë u nis kah sytë e dëshpëruar të princeshës Tahet. Përtej dëshpërimit të saj, dëgjoi:

“O Besi Ban Sulejman Efendia! Gratë gjëllojnë në mishin e ngrohtë të mashkullit. Ato po i nxore jashtë mishit të mashkullit thahen si lulja e nxjerrë nga toka e ngrohtë. Gjuhëve të mallkuara, grave mëkatore ligji ynë islam ua heq mishin e keq. shpirti bëhet vrastar vetëm po hyri në mish të keq.”

Besi Ban Sulejman Efendia e depërtoi plagën e qelbur drejt syve të dëshpëruar të princeshës Tahet...

...Ishte nëna. Ishte shtëpia e Besi Bani Sulejman Efendisë pas katërqind e gjashtëdhjetë e katërt vjetësh. Në midis të Prillit të Ditës së Dytë Besi Ban Sulejman Efendia e zuri vrapin katërqindgjashtëdhjetekatërvjeçar prej urës T. drejt shtëpisë nëpër pluhurin përcëllues të rrugës së djegur. Në gjysmë të rrugës e sëmboi mendimi: “Si do të duket fytyra e nënës?” E ndjeu se vrapin po ia gëlltitnin sytë e dëshpëruar të princeshës Tahet; atje në anën tjetër të Erenikut duart e nënës mbetën të shtrira kah uji, tek po i kalonin jeniçerët koshat e mbushur me fëmijë të ngarkuar në kuaj. Gishtat e mekur të nënës u zgjatën deri në gjysmë të Erenikut. Thonë se uji midis nënës dhe fëmijës e piu pikëllimin. Lumenjtë po e zbutkan dhembjen e dnarjes.

në kujtimin e jeniçerit Besi Ban Sulejman Efendia hyri pluhuri i shkretëtirës mbi vegimin e nënës për t’u bërë maskë e thëngjillit.

Ereniku u tha. Mbeti vetëm lëkura e ashpër e gurëve.

Të xhumanë e parë të muajit Rabi-ul-akar Besi Ban Sulejman Efendia, Prillin e Ditës së Dytë, me bekimin e padishahut të madhërishëm, e filloi ndërtimin e kësaj xhamie.

Në fund të ditës së dytë të xhumasë së parë të muajit Rabi-ul-akar Besi Ban Sulejman Efendia i madh po falej mbi sixhadë para tendës kur pas vetëtimës së dytë t’ia plasi rrebeshi i shiut. Midis dy selameve të fundit të namazit Besi Ban Sulejman Efendia u bë curril i gjallë uji.

Natën vonë çatia e ëndrrës së jeniçerit Besi Ban Sulejman Efendia pikoi. Pluhuri i shkretëtirës u shndërrua në baltë e balta u shndërrua në gur. Besi Ban Sulejman Efendinë e mbyllën në gurin e kësaj xhamie. Në fillim Besi Ban Efendia

e ndjeu të ftohtët e gurit të xhamisë deri tek ajo nata kur erdhi nëna. Ajo qan tek zemra e gurit të xhamisë.

Nëna kishte udhëtuar nga e Diela tek e Premtja për ta ushqyer gurin e xhamisë me qumështin e gjirit të saj.

Guri i xhamisë u zbut; u bë i përgjumshëm.

Të dytë: gurin e xhamsë dhe Besi Ban Efendinë i zuri gjumi. Në gjumin e tyre netët rralloheshin katërqind e gjashtëdhjetë e e katërtjet.

Besi Bani vraponte në amokun e tij prej urës T. kah shtëpia e fëmijërisë nëpër rrugën e djegur.

Para tij u bë shtëpia. Nga dera e hajthme e oborrit e deri tek dera e shtëpisë kaloi nëpër të gjitha zonat e rralluara të ajrit. Besi Bani e pa fundin: nëna u shfaq krejt mospërfillëse. Oborri i gjatë u bë gjarpër katullaq, u palua në fund të qytetit eunuk.

Dafrunga e muzikës jevge po shkëputej nga dita e Shën Gjergjit. Në fund të oborrit nëna po e tjerrete ajrin afër strehës së pikëllimit.

Besi Bani u përshkua nëpër ajrin e zhbiruar të oborrit duke u ruajtur të mos i shkelë copat e krisura të muzikës jevge. Eci ngadalë, tepër ngadalë deri tek shikimi i nënës. U mundua të dallojë diç në shikimin e saj të fshirë para se t'i thotë:

“Qe sa kohë po të pretë baba yt. Tërbimi i tij po rigon në këtë shtëpi qysh katërqind e gjashtëdhjetë e katër vjet.”

“kjo duhet të jetë nëna apo është vetëm vegimi i saj?” – mendoi Besi Bani.

Për të arritur deri tek i ati, Besi Bani u nis nëpër cepin e legjendës së varur në fund të oborrit. E shtroi lëkurën e legjendës përgjatë oborrit deri tek dera e shtëpisë.

“Pse u vonove kaq shumë?” – ulëronte shtëpia nga hidëhrimi i babës.

Fëmijën Besi Ban e trembi qortimi i t'et. U përpoq të gjejë shpëtim tek e ëma, tek po e tjerrete ajrin e rralluar të

oborrit. Ajo po e tundte dorën e mbushur me ajër me lëvizje gjithnjë e më të largëta.

Besi Banit i mbeti vetëm rruga e gjyshes.

U shtri në dhomë i mbuluar me djersë të përziera me frikë kur princesha Tahet e përgëzoi ngazëllueshëm midis turpit e frikës:

“Tashmë je mashkull.”

“Unë tashmë jam fëmijë”, - i tha princeshës.

U lëshua në atë gjendje gjumi deri tek trokitja e fortë në derën e dhomës së tij. E dalloi zërin më të vjetër:

“Biro, hape derën!” – sikur po i fliste gjyshja nga përtejderës.

“E ka zënë gjumi i thellë”, - u shkreh në vaj nëna.

“Çfarë gjumi i keq, kaq i gjatë! Qe katërqind vjet po i trokas në derë”, - tha i ati duke e vazhduar trokitjen nevrrike.

“Mos ka shkuar në shkollë?” – e pyeti nëna dikë nga jashtë.

“Mbase.”

Besi Bani papritur e hetoi se piku tek dera e klasës së katërt tree të gjimnazit “Hadu”. Eci drejt klasës, drejt syve të dëshpëruar të princeshës Tahet. Kur mendoi në vete: “Pse princesha të jetë e dëshpëruar?” Ajo e zbuloi vetëm para tij ngazëllimin. U mundua të flasë me të parase ajo t’i thotë: “E kanë shpallur vdekjen tënde.”

“Princesha Tahet mbeti shtatzënë”, - tha Teuta me duar të lidhura rreth barkut duke u dhënë shenja vajzave të tjera kah kufoma e Besi Banit.

“Ti je shtatzënë”, - konstatoi gjysmëmjekja. “A je kujtuar për babën e foshnjës?”

Princesha Tahet u përpoq ta dallojë urrejtjen nga hakmarrja në fytyrën e gjysmëmjekes.

“Kopili yt u bë dyshim i të gjitha grave të qytetit”, - foli urrejtja nga fytyra e gjysmëmjekes.

“Si mund të ndodhin kopilat në qytetin eunuk?” – pyeti princesha.

Ajo priti derisa të trashet hakmarrja në fytyrën e gjysmëmjekes për të dalë nga spitali. E ndjeu tashmë se fetusi në barkun e saj po e rëndonte plumb drejt tokës së raketës *Tomahok*.

“E ke vërejtur se profesori e fut shumë thellë në xhep dorën e djathtë?” – Teuta i tha me qësendi Gjergjit me katër emra.

“Ju vajzat vetëm atë gjë e mendoni.”

“Ju djemtë e klasës jeni bërë deledashë. I frikësoheni aq tepër princeshës Tahet. Ajo këtu e katërqind vjet përpiqet të bëhet gruanënë. Të shpëtojë nga menstruacionet kronike të Ballkanasve”, - i tha Teuta.

“Po ajo princesha erdhi nga Kaukazi. Pse ti e quan ballkanase?” – kundërshtoi Gjergji me katër emra.

“Ajo u dashurua para katërqind vjetësh në jeniçerin e padishahut.”

“Mendon se u dashurua në këtë Besi Banin tonë?” – bëri me dorë Gjergji kah kufoma.

“Pikërisht.”

“Atëherë Besi Bani ynë paska pasur pse të vdesë?” – pyeti Gjergji me katër emra.

“Në fotografinë e maturës aparati e ka fiksuar në fytyrën e princeshës Tahet gëzimin e nuses. Si e mendon ti një nuse me pikëllim në fytyrë?” – pyeti Teuta.

Gjergji me katër emra heshti.

“Nëna ime i frikësohet shumë xhelozisë sate të llamarintë”, - talli Teuta.

“Nëna jote po edhe ti ku do ta merrni xhelozinë kur ti do të vish nuse tek unë?” – Gjergji me katër emra e tundoj krenarinë e Teutës.

“Kush do të vdesë për një copë llamarinë!?” – përbuzi Teuta.

“Nëse ke fat t’i shpëtosh rrugës së plumbit”, - deshi ta përfundojë mendimin Gjergji me katër emra.

Besi Bani si një tollumbace fëmijësh e pati të vështirë të hyjë në klasë për ta parë edhe një herë kufomën e vet. U nis përgjatë korridorit të shkollës duke u shkëputur nga kufoma e vet.

...Kryetagbitari pasi i shtrëngoi përngutshëm brekusket e lagura pas përmjerrjes grarishte vrapoi drejt Besi Ban Efendisë. Deshi t’i ndihmojë në çastin e fundit. Iu rëndua trupi plumb mbi tokë nga lektisja për të sharruar në sytë e ftohtë të princeshës Tahet. Vetëm arriti t’ia thotë Kryetagbitarit: “Mos ia zgurdullo sytë fundit tim! Rruga qe e gjatë.”

I dha trupit drejt syve të ftohtë të princeshës Tahet.

Erdhi shiu Prillin e Ditës së Dytë. E qulli ushtrinë jeniçere të padishahut deri në llucë.

Në gjumin e parë kur tralliset mishi i robit të zotit hijësimi tisor i floknajës së zezë futë të princeshës Tahet ra mbi gjumin e jeniçerit Besi Ban Sulejman Efendi.

Nëpër rrugën e gjumit të robit të Zotit princesha Tahet hyri në mishin e jeniçerit Besi Ban Sulejman Efendi Jeniçeri Besi Ban Sulejman Efendia i magjepsur paska shkuar pas princeshës Tahet deri në shpatet e virgjër të Kaukazit.

“E pati puna e tij”, - shkroi në raportin ushtarak komandanti. Të nesërmen Besi Ban Sulejman Efendia u zgjua me vesën e mëngjesit, i mbuluar me tisin e floknajës së princeshës Tahet. Nga shpatijet e virgjëra të Kaukazit e bënë

bashkë perëndimet e purpurta të diellit e lindjet nazike të hënës.

“O jeniçer!” – e thërriste gjatë fluturimeve princesha Tahet.

“Ati im, mbreti im e vështroi nga lart ushtrinë tënde shkretinore. Vetëm në fund të vështimit më tha: “Pasi të vijë shiu i thirrur mbi ushtrinë e padishahut, ajo do të shdnërrohet në llucë të ngrohtë. Zbrit atje në fund të javës së parë tek bisku i shfaqur midis llucës. Merre biskun. Ai do të bëhet ushtari i jetës sate!”

“E ke pyetur babën tënd, mbretin tënd, ç’ka zbuluar në jeniçerin nga qyteti Jakovë i Rumelisë?”

“Po. Duart e nënës sate kanë mbetur të shtrira mbi ujin e Erenikut derisa tek ti u zu fara e mashkullit. Shiu i nënës sate ra mbi ushtrinë e padishahut”, - i kishte pëshpëritur tek bulza e veshit princesha Tahet.

Besi Ban Efendia duke i shikuar nëpërmes të thuprave të koshit të ngarkuar në kalin e jeniçerit se si nëna po i zgjaste duart e dëshpërimit mbi ujin e Erenikut ra në gjumin e parë.

Butësisht i dëgjoji fjalët e princeshës Tahet tek bulëza e veshit në gjethet e fierit të përgjumshëm: “Flij deri te kthehem unë nga baba im, nga mbreti im!”

Toka u trand kur një ushtri hyri në gjumin e dytë të jeniçerit Besi Ban Sulejman Efendia. Kjo ushtri shkretinore me vete i kishte sjellë edhe fjalët thikë *xerah, dezertor, kastrim...*

Në fund të gjumit të parë brenda këmishës së mbështjellë rreth kokës ia hudhën gjumin e dytë duke urdhëruar:

“Le të hiqet sa më thellë mishi i mëkatit mashkullor nga ky dezertor!”

Në fund të gjumit të dytë të Besi Ban Sulejman Efendisë i çatisi Kistar aga i parë për ta uruar. Pastaj ia çatisën

agallarët e tjerë plot gojën urime nazike. Të gjithë e sollën urimin e stampuar në jetën e tyre të shuar:

“Ke shpëtuar nga mishi mëkatar i mashkullit. Tashmë mund të hysh në Haremin e Padishahut.”

Eunuk agët me gjymtyrë mashkulli e me naze femërore i mbanin brekushet të përvjela pasi urinonin duke dalë.

Shtatë ditë Hadum aga u kot midis femrës e mashkullit sikur u druhej të dy rrugëve. Në fund të ditës së shtatë Kistar aga i parë i ftoi Hadum agën në selamllëkun e përgjumur për t’ia kumtuar detyrën e re:

“Besi Ban Sulejman Efendia të ka ndritur fati pa u bërë shtatë ditë. Validja e padishahut prej sot të ka nderuar me gradën Kistar agë në Harem.”

Huadum aga ende kotej midis gjymtyrëve të mashkullit e nazeve të femrës nën hijen e urimit të Kistar agës së parë:

“Tash ditët do t’i gëdhish në paqe të Allahut. Secili eunuk pasi ta ketë kryer detyrën me nder në Haremin e Sulltanit shpërblehet me një xhami në vendin e lindjes së tij.”

Vetëm kur i thanë të nisej Hadum aga e kuptoi fundin e bisedës pa e folur asnjë fjalë. Ende po kotej në cepin e gjumit të dytë.

Në derë të selamllëkut të Haremit e priti vetë Validja e sulltanit. Ajo sipas rregullës i zgjati dorën për ta shprehur intimitetin e bashkëpunëtorit në Haremin e Sulltanit. Ashtu të trallisur e uli brenda selamllëkut në shilten e trashë, të rrethuar me jastëk të butë. Tabakun me shurupe e llokume e sollën tri kopilka plot gaz të vrarë në gjokset e tyre të bukur. U afruan me hapa të numëruar ceremonialë.

Hadum aga kur e shikoi ashtu përgjumshëm kopilkën e parë nga medalioni i qafores së saj të artë i erdhi shenja e zgjimit. Shenjën e medalionit e lexoi vetëm si ndjenjë derisa e kapërceu shikimin në fytyrën e kopilkës së parë duke pyetur:

“E kujt do të jetë kjo vdekje?”

“Është vdekja jote”, - iu përgjigj medalioni nga qaforja.

Validja e Sulltanit ia uroi detyrën e re të gradës së Kistar agës:

“Urtia jote tashmë midis mashkullit e femrës arrin ta mundë teprinë. Ajo kurva hazare në shtratin dymbëdhjetë pëllëmbësh ta pati shtruar vetëm mëkatin. Padishahu të lirojë nga mëkati.”

Validja e Sulltanit i prini Hadum agës në inspektimin e parë të Haremit, nëpër të gjitha rrugët deri ku siset mashkulli.

Tek sytë e ftohtë të bukuroshes së shtatë ia ngacmoi plagën zëri i princeshës Tahet, zbritur nga shpatijet e Kaukazit deri tek dritarja e shtatë e Haremit.

“Besi Ban Sulejman Efendi!” – e thirri princeshja Tahet. “Nëna jote ka udhëtuar nëpër dashurinë time deri tek plaga jote.”

Besi Ban Efendia e njohu zërin e princeshës Tahet derisa filloi ta shohë nënën me duar të zgjatura mbi ujin e Erenikut.

Valides së Sulltanit i erdhi në majë të gjuhës: “Kurva hazare e thërret njeriun e pastruar nga mëkati.”

Në fund të zërit të princeshës Tahet Besi Ban Efendia ndjeu dhembje midis kofshëve, tek plaga e qelbur, nga ku ishte hequr mishi i egër i mashkullit. Sa deshi ta çojë dorën tek vendi i sheshtë i mishit të dikurshëm të mashkullit, Validja e Sulltanit e këshilloi apo e urdhëroi me një shikim të egër prej deledashi:

“Tashmë je liruar nga pesha e mëkatit; do të përmjerrësh si grua fatbardhë.”

Hadum aga e ngujuar në sytë e ftohtë të bukuroshes së shtatë e dëgjoi britmën e vet pëlcitëse deri në kupë të qiellit:

“U sos mashkulli, bre!”

Zëri joshës i princeshës Tahet mbeti anës së Kaukazit, duart e shtrira të nënës mbetën mbi ujin e Erenikut, në natën e ngjizur sterrë sharroi Validja e Sulltanit, Haremi sharroi Hadum aga.

...Kur dolën jashtë gjimnazit “Hadu” Besi Bani pyeti Gjergjin me katër emra:

“Ende e vajtojnë atë kufomë në kalsë?”

“Po.”

“Pse?”

“Sepse ti u bëre mashkull.”

U ndanë tek dera e gjimnazit “Hadu”.

Cilën rrugë do ta marrë Besi Bani?

Të gjithë pas raketës *Tomahok* do të shkojnë Shtegut të Oregonit. Atje po nis mishi i ri për të gjithë.

...Ditën e varrimit tim në mitrën e sime më kishte shumë lagështi. Ata u ngutën të m’i hudhin përsipër menstruacionet kronike pa më dhënë mundësinë të shkëputem nga reumatizma. Ata, pas varrimit tim u larguan në drejtime të ndryshme. I dëgjova hapat e tyre edhe kur thanë: “Menstruacione të kurvës ballkanike”.

Në mitrën e sime më e harruan shiun, i harruan menstruacionet e ngjizura me reumatizëm.

Pas dy mijë vjetësh në mitrën e sime më reumatizma u dobësua apo u mësova me të. Një mijë vjetët e tjerë u gatarraqa (zgafullova?) shlirshëm në mitrën e sime ëme. shekujt u bënë të urtë, të heshtur.

Gjumi, lagështia, reumatizma u pleksën tek pajtimi gjithstiyor. Stinët e shtynin njëra-tjetrën fëmijërisht.

Pas njëzet shekujsh u rehatova në stinën e pestë të mitrës së sime më.

Raketa *Tmahok* e futi farën e zgjimit në mitrën e tokës, në mitrën e gruas së re.

Mrekullia ndodhi, shtatëdhjetë e shtatë herë më e amdhe se në Bibël: pas njëzet shekujsh dola nga mitra e sime më në fund të Shtegut të Oregonit, aty ku nis Amerika.

Njerëzit po hynin në gabzherrin e pu7lës tek bishti i urës T. Prilli i Ditës së Dytë po plakej nga lektisja për ta kapërcyer urën T.

Në cepin tjetër të urës T. u shfaq koloneli me dy kërcënime në fytyrë. Ende pa e hedhur bishtin e cigares, urdëhroi: “Vendosni në trastat tuaja gjumin!”

Pas shenjës së kolonelit zhaurima e hapave të ushtarëve u nis drejt hekurinës së Skënderbeut. Kutërbimi i bojës ushtarake gati e bëri hekurinën e Gjergjit me katër emra të vjellë mishin e njeriut jashtë barkut të saj.

Nga skela e lartësuar krejt afër Skënderbeut mbi pelën e tij, koloneli me dy hidhërime në fytyrë përmes megafonit iu drejtua turmës në cepin tjetër të urës T:

“Sot të gjithë do të kapërceni përtej Prillit të Ditës së Dytë! Koha juaj është sosur nga goditja e raketës *Tomahok*.”

Ushtarët nën shenjën e kolonelit e kuptuan urdhrin për ta lëvizur hekurinën e Skënderbeu t me krikëllimë vajtuese. Krahas urdhrin koloneli buzëqeshi kur e pa qartë urrejtjen në fytyrat e grave të reja. Në gjysmë të gazit në fytyrë, koloneli tha:

“Po ju dëbon NATO, jo ushtria jonë popullore.”

Ende pa e sosur buzëqeshjen në fytyrë, koloneli mbeti prapa Prillit të Ditës së Dytë kur turma e njerëzve lëvizi drejt kufirit të Shqipërisë nëpër trekëndëshin nëntëkilometërsh të Platonit-Sokrat, të shtrirë nga ushtria jugosllave.

Rrugës së tij prej derës së gjimnazit “HAdu”, ai ndaloi në kodrën perëndimore të qytetit. I kapitur kishte dalë nga menstruacionet njëzetshekullore Prillin e Ditës së Dytë.

I paskësh thënë dikujt:

“Kush vdiq?”

“Vdiqe ti”, - i paskësh thënë dikush.

“Kush u lind?” – sërish paskësh pyetur.

“U linde ti”, - i paskësh thënë dikush.

Qenka shumë ftohtë të dalësh pas njëzet shekujsh nga varrimi në mitrën e nënës. Edhe kur në vitin njëmijë e nëntëqind e pesëmbëdhjetë profesori vjenez i vinte ato pëllakëzat në kofshët e grave të reja, u dëgjuan goditje tek fetusit arketip.

Ditën e varrimit në mitrën e nënës ata u ngutën ta hudhin menstruacionin veshtullor mbi fetusin arketip. Ata u larguan në drejtime nga të katërt anët u dëgjuan hapat e tyre nëpër gjithë lëkurën e Evropës së tharë edhe kur thanë plot pezëm: “Kjo kurva ballkanike vuan nga menstruacionet kronike. Le të bijnë mbi të lukunitë aziatike! Ato lukuni hanë çfarëdo mishi, pinë çfarëdo gjaku.”

Nga Shtegu i Oregonit, ku zë fill mishi i ri i botës, erdhi uturima e Avionit të NATO-s deri në mitrën e nënës. Avioni i NATO-s që ende kur e dërgoi kasnecin ogurbardhë *Tomahok* deri thellë në mitrën e tokës, në mitrën e gruas së re, në mitrën e nënës.

Toka ime, gruaja e re, nënë ime, në gazetatat evropiane u shpallën të përdala, kurva.

Vërtet qenka ftohtë të dalësh pas njëzet shekujsh nga mitra e nënës për ta arritur Shtegun e Oregonit, atje ku zë fill mishi i ri i botës.

Të lutemi! Ecja jonë drejt Shtegut të Oregonit të mos bie në stinën e dimrit.

Të lutemi! Ecja jonë drejt Shtegut të Oregonit të bie Prillit të Ditës së Dytë.

Në Prillin e Ditës së Dytë fetusit arketip i kosovarëve u nis drejt Shtegut të Oregonit. Babeli i mishit njerëzor tek këndi

i tretë i Trekëndëshit të Platonit-Sokrat, nga cepi i urës T. lëvizi përngutshëm, përzëshëm:

“Po qëlllove në jude ik në male, po qëlllove në terracë të shtëpisë mos zbrit për të marrë ndonjë gjë!”

Nisu menjëherë drejt Shtegut të Oregonit, tek zë fill mishi i ri i botës.

Nisja jote drejt Shtegut të Oregonit do të bie ndesh me shumëzimin e jezuve në inkubatorët e kooperativave të Evropës. Faji kolektiv i mishit të kosovarëve lëvizi nëpër Trekëndëshin e Platonit-Sokrat përgjatë urës T. Tashmë ushtarët e kolonelit po e shtynin deri tek kufiri i Shqipërisë mishin e kosovarëve nëpër Trekëndëshin e Platonit-Sokrat.

Shpirti i qytetit të Gjakovës mbeti andej Prillit të Ditës së Dytë kur Besi Bani pas katër shekujsh, në fund të amokut, u gjend në kodrën perëndimore të qytetit të Gjakovës.

Bendisa i pëshpëriti t’et se e njohu shokun e klasës. Besi Bani po vraponte përgjatë Trekëndëshit të Platonit-Sokrat përgjatë urës T. Koloneli në bisht të cigares pranë kokës së Skënderbeut po e vështronte me dylbi vrapin ngulmues të Besi Banit deri tek punëtorja e madhe në midis të urës T.

Ushtarët, civilët e djersitur po e çmontonin Trekëndëshin e Platonit-Sokrat, po e çmontonin kalin e Trojës.

“Arrite me kohë. Përpak ishim duke e çmontuar Trekëndëshin e drunjtë të Platonit-Sokrat”, - i tha regjisor.

“Arrite me kohë. Përpak ishim duke e çmontuar kalin e drunjtë të Trojës”, - i tha Uliksi.

Besi Bani u ngut ta zërë vendin në sallën e madhe të teatrit evropian, atje ku po bëhej çmontimi i këndit të Trekëndëshit nga lozha e Mbretit, këndi i popullit tek dera.

Çmontimin e këndit të ekzekutivit të Trekëndëshit të Platonit-Sokrat po e kudnërshtonte Mefistoja ende pa u shkëputur nga mishi i këlyshit të kones së Danielit. Për të satën

herë Rabii ben Zakai po zihej me regjisorin se kur duhej të sosej këlyshi i Kones së Danielit e kur do të fillonte Mefistoja në teatrin evropian.

Besi Bani mëdyshoi cili po fliste: Rabi Johanan ben Zakai apo Mefistoja kundruall mospërfilljes së regjisorit në skenën gati të çmontuar evropiane.

“Qëndro aty ku je!” – i tha regjisori. “Si mund të të lirojmë nga mishi i këlyshit të Kones së Danielit në këtë skenë kaq të dëmtuar?”

“Qëndro aty ku je, tek këlyshi i Kones së Danielit!” – e qortoi Franc Kafka Rabii Johanan ben Zakain. “Gati tre shekuj po të mashtrojnë në teatrin evropian. Edhe sot Prillin e Ditës së Dytë tek ura T po rreken të të mashtrojnë; sot kur Evropës John Harkerit po ia çmonton Trekëndëshin e Platonit-Sokrat, po ia çmonton kalin e drunjtë të Trojës.

Koloneli i ushtrisë jugosllave qetësisht nga bishti i cigares, tek koka e Skënderbeut po e përcillte çmontimin e skenës së teatrit të OSCE-së si çdo teatër të arixhinjve. Ai mendoi se ngarkimi i teatrit të OSCE-së si teatër arixhinjsh do të krijonte huti gravitacioni tek mishi i pabërë i ksovarëve në rrugë për Shqipëri.

Koloneli po e shpejtonte Prillin e Ditës së Dytë kur në zguhurin e hekurinës së Skënderbeut bërtiti sa i erdhi për kreje:

“Gjeneralisimus Stalin është më i forti, sot, në midis të urës T. Mbrëmë ka udhëtuar gjithë natën midis dengut të gazetës *Zëri i popullit*, ilegalisht, për të arritur në midis të urës T Prillin e Ditës së Dytë.”

Gjeneralisimusi për të fundit herë e kaptoi kufirin më perëndimor të perandorisë së vet nga Shqipëria në Kosovë në gjithë atë dhimbje në dorën e majtë reumatike. Këtë herë gjeneralisimusi Stalin heshti, i ngujuar në dengun e gazetës *Zëri i popullit*, i sëmubuar fort nga dhembja e dorës reumatike.

Koloneli e vështroi shtatoren ushtarake të gjeneralisimus Stalinit. Po i lëvarej dora reumatike mbi shtatoren e bronzte me një kërkëllimë metalike.

“Po lëviz”, - u ngazëllye në vete koloneli jugosllav. “Do të ketë revolucion.”

“Shoku Stalin e lëvizi dorën e majtë”, - u çjerr një fëmijë midis frikës e habitës.

Gratë i mblodhën fëmijët rreth tyre me disa fjalë të pakuptueshme.

Gjeneralisimusi hyri në sallën e teatrit ku po bëhej çmontimi i Trekëndëshit të Platonit-Sokrat duke shpresuar në një revolucion gjithëvropian. Edhe koloneli jugosllav, pranë kokës së Skënderbeut duke pirë duhan, mëtonte revolucionin e OSCE-së tek ura T. Prillit e Ditës së Dytë kur të paloheshin në kamiona ushtarakë pa kurrfarë rendi: Trekëndëshi i Platonit-Sokrat, Kali i Trojës, Shtatorja e Skënderbeut, gjeneralisimusi i llamarintë...

Prej fillimit të Prillit të Ditës së Dytë e deri tek pasdrekja e Prillit të Ditës së Dytë OSCE-ja jashtë Trekëndëshit të Platonit-Sokrat mbeti pa gravitacion politik: Mbreti në lozhën e vet iu frikësua revolucionit, Rabii Johanan ben Zakai deshi të shndërrohet nga mishi i këlyshit të Kones së Danielit në mishin e Mefistos edhe jashtë lojës së skenës së teatrit, populli po vërtitej në amokun e madh derisa u dëgjua për të gjithë:

“Gjeneralisimusi Stalin u arratis nga shtatorët e bronzta të Moskës, Varshavës, Pragës, Budapestit...”

Të gjithë e dëgjuan kur gjeneralisimusi Stalin tha:

“Qenka ftohtë pas kaq vjetësh të dalësh nga shtatorja e bronzte”.

Po i mërdhinte dora e majtë reumatike.

Nga lozha e OSCE-së, krejt afër Stalinit koloneli i ushtrisë jugosllave i foli Evropës: “Koha jote u sos. Këlyshi i Kones së Danielit do të hajë qull në tharkun e kooperativës bujqësore”.

Ngathtësia e kohës po largohej nga qyteti i Gjakovës hipur mbi makinat e OSCE-së.

“Qenka shumë ftohtë!” – foli për herë të parë Evropa.

Makinat e OSCE-së i zuri ngulfatja në midis të urës T.

“Jepi more idiot!” – e kërcënoi shoferin e makinës koloneli i ushtrisë jugosllave.

Shoferi deshi ta thotë të pamundurën.

Princesha Tahet pasi ia hodhi në fytyrë shoferit të OSCE-së hidëhramin e bretkosës, i tha: “Thirre shiun! Shtatë net e ditë e kam thirrur shiun mbi ushtrinë shkretinore. Ushtria e këtij koloneli shtatë ditë jashtë shiut shndërrohet në gur të rëndë.”

“Kurva hazare”, - shfryu koloneli.

Makinat e OSCE-së u nisën kah perëndimi i diellit të Prillit të Ditës së Dytë. Duhej kaluar ura T. pa e pirë vetveten Ereniku.

Hekurina e Gjergjit me katër emra lëvizti krikëllueshëm.

“U nis Skënderbeu”, - i tha t’et Bendisa.

Prapa Prillit të Ditës së Dytë mbeti qyteti fantazmë i Gjakovës.

* * *

*

John Harkeri mendoj ta kishin zënë rrugën e drejtë të Shtegut të Oregonit deri tek *Guri i Ujku*, siç e quante Ariu i Kuq, kur fliste për fundin e botës.

Ariu i Kuq e pushoi rektimën sikur ndodhi frika e Qepës së Madhe. John Harkeri e ndjeu frikën e saj në hapin e rralluar edhe kur ujqit ulëruan krejt afër.

Kur bora e butë filloi të forcohet nën huqet e pabesa të natës foli Qepa e Madhe:

“Le të pushojmë në *Luginën e Ujikut!* Vëllezërve të mi plagët e San Luisit po u zënë cegmë (cemtësi?) nate.”

“Sa veta ishin?” – Qepa e Madhe e pyeti John Harkerin.

“Dyzet e pesë veta.”

“Të vrarë?” – pyeti sërish ajo.

“Po të vrarë me duar të lidhura”, - gati rënkoji John Harkeri.

John Harkerit iu bë e pabesushme përsëritja e kolonelit të ushtrisë jugosllave kur ia ofroi raportin ushtarak: “Kemi informata të sakta se ky është vetëm grupi i parë i diversantëve. E kanë pasur për qëllim t’i krijojnë bazat e para të operimit në këtë luginë. U vranë në luftime të rregullta ushtri me ushtri.”

Cingrima e celularit e trembi heshtjen e John Harkerit këndej ulërimës së uqjve. Mezi e kapi cingërimën e celularit si hardhucë gjysmë të ngordhur nga të ftohtit.

Foli me shpirtin nga bota tjetër:

“Këtu kapiteni John Harkeri.”

“E keni parë ende zjarrin?” – pyeti zëri nga ana tjetër e botës.

“Zjarri ka kaluar përftueshëm mbi dyzet e pesë kufoma civilësh të paarmë”, - rënkoji John Harkeri.

“Jepe informatën në OSCE, në OKB, në gjithë botën! E gëzofsh çmimin Nobël!”

John Harkeri e zgjati kokën përpara për ta sosur habinë e vet. Kishte nevojë për mendimin e Qepës së Madhe. Ajo kishte hyrë në tendë për t’i vështruar palgët e vëllezërve të vet nga San Luisi.

John Harkeri mbeti jashtë tendës së Ariut të Kuq me shikim të vjerrë në bjeshkën e hijësuar. Provoi të mendojë sa

larg bjeshkës Tikako bie pushteti shtetëror kur Qepa e Madhe i pëshpëriti tek veshi:

“Pushteti shtetëror nga këtu i ka gjashtë muaj rrugë kali.”

Ulërimën e ujqve nga pylli i borigave provoi ta mundë me vargjet tetëmbëdhjetë, nëntëmbëdhjetë, njëzet të kaptinës së Dytë të Biblës kur Qepa e Madhe e ndërpreu:

“Katër vëllezërit e mi të çelur varrë tek mishi i mashkullit në San Lusi e kanë rrahur doktrinën e njeriut të lirë të Emersonit¹. Individu vetëm në këtë largësinë tonë të sontme nga pushteti shtetëror, në këtë natë të ftohtë të bjeshkës Tikako lirohet nga varshmëria e pushtetit”, - thoshin vëllezërit e mi.

“Pak më parë ishim në luginën e ujqërve”, - pyeti John Harkeri.

“Po. Ti e more çmimin Nobël”, - shpjegoi Qepa e Madhe.

“Ku e ke mësuar doktrinën e Emersonit?” – foli John Harkeri.

“Vëllezërit e mi pasi u kthyen nga San Luisi, herë pas here shkonin për t’i pastruar plagët. Në fillim gjatë vonesës së tyre i shikoja vizatimet e Biblës”, - fliste Qepa e Madhe në midis të ulërimës së ujqve. “Pastaj vëllezërit më ndihmuan ta kapë Doktrinën e Emersonit ku liria e njeriut kufizon me ulërimën e ujkut. Emersoni fton të gjithë shkrimtarët amerikanë të abstenojnë nga muzat e Mbretit të vdekur evropian. Nga nevoja e përhershme njeriu e krijon rendin e fortë të ligjeve. Besëlidhja me ujkun e sontëm, atje në pyllin e borigave e zhvillon shkathtësinë e mësimit të ndërsjellë ujk-njeri.

“Edhe nga këta ujqër të sontëm po mësua ka njeriu”, - u çudit John Harkeri.

¹ Emerson, *Esejet*.

“Po, edhe nga këta ujqër. Besëlidhja e shkathtësisë dhe e natyrës i vë në lëvizje të gjitha gjërat për të marrë (të mbajtur?) qëndrim armiqësor ndaj së keqes, thotë Emersoni”, - vazhdoi Qepa e Madhe.

“Atëherë unë, kot, krejt kot, e paskam sjellë Trekëndëshin e Platonit-Sokrat nga Evropa në Tokën e Re?!”

“Ujku i Trekëndëshit evropian i Platonit-Sokrat bëhet ujk burokratik, ujk përralle, ujk politik”, - shfryu Qepa e Madhe.

“PAske mësuar shumë nga librat e vëllezërve tuaj nga San Luisi!” – ndërhyri John Harkeri.

“Unë e adhuroj Xhems Fenimor Kuperin – zbavitësin e tre shoqes. Ai shkroi shumë libra vetëm për ta zbavitur të shoqen. Më pëlqen Nati Bumpo. Tek ky shkrimtar hyjnizohet familja, pronare tokash se si e krijon civilizimin midis egërsisë në aleancë me Bizonin, me Misrin, me Indigjenin. Që të tret mungojnë në Trekëndëshin e Platonit-Sokrat, mungojnë në Bibël.” Qepa e Madhe tashmë po fliste nën frymëzimin e borigave të mbuluara me borë, e frymëzuar nga ulërima e ujqërve.

“Nati Bumpo, në përmasa të vogla eksperimentale ud etyrua ta ndryshojë pozicionin e Trekëndëshit evropian të Platonit-Sokrat në Trekëndëshin biodemokratik të Misrit, Bizonit, të Indigjenit”, - duke folur John Harkeri u rrëqeth nga ulërima e ujqërve.

“Sonte nga bjeshka Tikako, nga këtu ku po qëndrojmë, tek kjo ulërimë e ujqërve, le të shtrihet rreth yt evropian i Platonit-Sokrat deri tek pushteti shtetëror. Këtë herë në pozicion të drejtë të Nati Bumpos, jo të atij Adamit gërdallë”, - ishte bërë si natë e acartë zëri i Qepës së Madhe.

John Harkeri ishte mbështetur për Qepën e Madhe kur i foli asaj:

“Ti po mendon tek Çarls Brokden Brauni, mbi krimet, neurezat, çmendjet, jashtë moralit të Trekëndëshit evropian të Platonit-Sokrat?”

“Jo! Çarls Brokden Brauni ka tentuar ta legjetimojë krimin mbi Trekëndëshin arketip të babait tim, Ariut të Kuq”, - u ngacmua Qepa e Madhe.

John Harkeri ra në syrin e lëngshëm të Qepës së Madhe nëpër amokun e vrapimit, nëpër ulërimën e ujërve, përtej rektimës së Ariut të Kuq, përtej Misrit, përtej Bizonit.

Në pasdrekën e Prillit të Ditës së Dytë John Harkeri u gjet kundruall kolonelit në urën T. Koloneli po e shtynte arketipin përtej urës T., kah kufiri i Shqipërisë duke e vërejtur habinë e John Harkerit kur e pa veten se nuk kishte asgjë në dorë sipas kontratave ndërshtetërore.

Bendisa ia zgjati John Harkerit Biblën e djersitur. Pasi e mori Biblën John Harkeri e hapi tek vargjet tetëmbëdhjetë, nëntëmbëdhjetë, njëzet të kaptinës së Dytë për t'i gjetur: Bizonin, Misrin, Indigjenin.

“Kot i kërkon”, - i tha koloneli jugosllav. “Pyete Qepën e Madhe, vajzën e Ariut të Kuq, çfarë i gjeti vëllezërit e saj në San Luis kur deshën t'i gjejnë në Bibël: Indigjenin hileqar, Misrin halldup, Bizonin shpërfillës.”

“Katër vëllezërit e mi i tredhën hugentot francezë në San Luis kur në Bibël deshën t'i gjejnë: Indigjenin, Misrin, Bizonin”, - rënkoi Qepa e Madhe.

John Harkeri pasi zbriti nga buzët veshtullore të Qepës së Madhe, pyeti: “Nati Bumpo në sa metra tokë e shtrini Trekëndëshin Biodemokratik?”

“Vetëm në formën e familjes së tyre”, - paskësh thënë Qepa e Madhe.

John Harkeri sërish duke zbritur nga buzët e trasha të Qepës së Madhe guxoi të pyesë për tredhjen e katërt vëllezërve

të saj, mu në midis të ulërimës së ujqërve kur hija e Malit Tikako po zgjatej mbi pyllin e borigave borake.

Qepa e Madhe para se ta pyeste John Harkeri e kishte filluar rrëfimin.

“Kur vëllai im i madh shkante të përmjerrte si grua ia zinja fletoren e shënimeve me pika lotësh, herë-herë të përziera me pika gjaku, veçanërisht kur i teptiste varra. Kur pikëllimi i përvajshëm i rritej gjatë përmjerrjes si grua, pak nga pak u mësova t’i lexoj brengat e tij. “Në kolonitë e francezëve sundonte urrejtja e mostrës evropiane. Francezët në kolonitë e tyre ushtarake më së pari i dërgonin misionarët hugenot. Ata e barazonin moralin biblik me patriotizmin shtetëror krejt si në Evropë.”

Lie Vitmani në San Luis mossuksesin me përpunimin e indigjenëve e zëvendësuan me rrugëtimin nëpër Shtegun e Oregonit. Në rrugën e gjatë dymijëmilëshe me qerret anije të tërhequra nga qetë udhëtonin karvanet drejt perëndimit, lindnin fëmijë, lindnin dashuri, vdisnin të moshuar. Të gjithë këta pionierë të demokracisë udhëtonin gjithnjë përpara pushtetit shtetëror.

“Popujt kanë udhëtuar në mënyra të ndryshme, në drejtime të ndryshme”, - mendoi John Harkeri kur turma njerëzore ndaloi tek kufiri i Shqipërisë. Edhe hekurina e Skënderbeut tashmë po qëndronte në mbrëmjen shianike me shikim të drejtuar kah Shqipëria sikur përgatitej të bënte diç. Ushtarët e kolonelit jugosllav e filluan çmontimin pjesë-pjesë të hekurinës së Skënderbeut për ta ngarkuar në kamionë ushtarakë.

Ushtarët e kolonelit jugosllav, sërish, tërë natën do ta montojnë hekurinën e Skënderbeut tek ura T. për aktrimin e nesërm. Sërish do t’i printe turmës prej urës T. deri tek kufiri i Shqipërisë.

Rrebeshi i shiut të ftohtë e solli gëzimin e Bendisë tek veshi i t'et:

“Ja Skënderbeu tjetër në anën e Shqipërisë!”

I ati shikoi nëpër syzet e rreme. Në anën e Shqipërisë po e montonin hekurinën e Skënderbeut të prurë nga Tirana. Edhe ky Skënderbeu i Tiranës kollitej nga tymi i llullës së gjeneralisimus Stalinit.

Në midis të Skënderbeut të kolonelit jugosllav dhe Skënderbeut të gjeneralisimus Stalinit, njeri duke u çmontuar e tjetri duke u montuar, në dhjetë metra tokë neutrale, binte shi i ftohtë.

Atë Skënderbeun e anës së kolonelit jugosllav profesori e quajti dezertor ndesh atij Skënderbeut tjetër të gjeneralisimus Stalinit. Në fytyrën e ndritshme të profesorit u shfaq trishtimi i zvarur deri tek fundi i këmbëve; i gufoi në fytyrë ngulmimi shianik.

“Le ta kemi nën mbikëqyrje atë Skënderbeun e kolonelit jugosllav; ai sot Prillin e Ditës së Dytë e aktron patriotizmin e lig”, - mendoi zëshëm profesori.

Stalini paksa i rrëqethur nga aftimi i shiut të ftohtë pa e hequr llullën nga goja e qortoi profesorin:

“Internacionalizmi proletar ka hequr dorë nga nacionalizmi; nacionalizmi çfarëdo qoftë është i lig.”

“Do ta kisha vra këtë shi të aftueshëm”, - foli profesori vetëm për ta hequr bisedën nga patriotizmi i lig.

Zhurma emakinave të OSCE-së ndaloi në sheshin e llucës së rrahur, para sallës së pritjes. Shefi i ekipit të OSCE-së e nxori kokën tullace nga njëra makinë por shiu i aftueshëm i Prillit të Ditës së Dytë ia këputi fjalën. Shefit më lehtë i erdhi të hynte në sallën e OSCE-së ku po rrinin zyrtarë të lartë në heshtjen valuke të konjakut.

“Në orën sa ka arritur turma e njerëzve tek kufiri i Shqipërisë?” – ngulmoi shefi.

“Unë vetëm nga celulari kam dëgjuar për ardhjen e këtyre njerëzve”, - deshi të përfundojë gjenerali në midis të cingrimës së celularit të John Harkerit.

Nga celulari i John Harkerit foli shpirti nga bota tjetër:

“A e keni parë ende zjarrin në *Luginën e ujqërve*?”

John Harkeri pak i besoi shenjës së zjarrit; ai po zhytej në shpirtin e vakët të ujërave të pranverës. E vështroi rrugëtimin e hënës mbi luginën e ujqërve pa e veneruar shstisjen e Qepës së Madhe kur ajo vrapoi për ta ngulur thikën në lëkurën e cemtë të borës.

Sipas ritit të fisit Su ngulja e thikës në lëkurën e cemtë të borës e pushon ulërimën e ujqërve.

“E sheh hënën?” – deshi ta hutojë Qepën e Madhe duke e pyetur.

“Ka hyrë pas malit Tikako. Është mjaft herët. E njoh rrugëtimin e saj”, - me një zë të ujësavtë (ujës?) foli Qepa e Madhe.

“Në cilën anë do të veni sonte?”

“Do të shkojmë drejt Shtegut të Oregonit. Këto shkurre halleliga rreth kësaj lëndine janë tepër fëmijërore për të na mbrojtur”, - vendosi ajo.

John Harkeri e kuptoi frikën e Qepës së Madhe veçanërisht gjatë rënkimeve të Ariut të Kuq brenda syrit të bizonit në tendë. Vëllai i saj i madh nga brenda syrit të bizonit po i fliste vetes apo t’et, Bizonit të Kuq, për John Harkerin që vështirë ta kuptojë. I kishte thënë Qepa e Madhe se vëllain e madhe të saj shpeshherë e zinte amoku i rëndë...deri tek ajo ditë, bashkë me dhembje rektuese.

Nëna e Qepës së Madhe, e shqetësuar, tha se të birit i ka teptisur gropa e zezë tek mishi i mashkullit. Gjithë ditën nëna

ia mbushi gropën e zezë me qepë të zier e patate të grirë. Qepa e Madhe, atë ditë, iku dy tenda më larg tek vendi i saj shkonte për të shkruar vetëm në fletoren e tij. Shpeshherë shkrimi i bëhej nevrrik, veçanërisht tek kishte shkruar mbi njollat në fletore: “Hegeli paskësh thënë, - Ndonëse vëlla i madh i Qepës së Madhe do ta ketë mësuar në San Luis kush paska qenë ky farë Hegeli, - se Lindja e njeh vetëm një njeri të lirë, grekoromakët i njohin disa njerëz të lirë, gjermanët i njohin të gjithë njerëzit të lirë.”

Atëherë francezët hugenotë, misionarë të seminarit, pasi ia gjetën këtë shënim vëllait të madh të Qepës së Madhe, të katërt vëllezërit e saj i futën në dhomën e errët të morfinës. Me këmishat e hedhura mbi fytyrë, ua hodhën gjumin e dytë brenda gjumit të parë. Në midis të gjumit të parë e gjumit të dytë u dëgjua urdhri i kryemjekut:

“Le të hiqet çka është për t’u hequr!”

Nga të katërt vëllezërit e Qepës së Madhe hoqën mish mashkulli nëpër gropat e zeza.

Të nesërmen, kur të katërt vëllezërit e Qepës së Madhe, gjysmë të zgjuar në shtretërit e tyre, erdhën bij apaçësh, sujuksësh, çerokësh...ua uruan plagët në heshtje gati fajtore.

“Ti më ke thënë se katër vëllezërit e tu në San Luis i kanë gjymtuar mishit të mashkullit se i kanë gjurmuar në Bibël: Bizonin mospërfillës, Misrin valuk, Indigjenin daulle”, - nxitoi tjetërkund John Harkeri.

“Në njëren fletore plot njolla gjaku shkruante kur i teptiste plaga”, - foli Qepa e Madhe sikur deshi ta ndërprejë bisedën.

Zjarri i John Harkerit e ngrohu ujin në fund të syve të Qepës së Madhe mbi buzët e saja të mufatura veshtullore. Në fund të ujit të vakët të natës së cemtë e harruan rënkimin e Ariut të Kuq.

“Sonte do ta arrijmë Shtegun e Oregonit”, - vendosi John Harkeri në gjysmë të amokut.

“Hesht!” – foli shpirti i ujit të vakët.

Njeriu i ujit po zhytej në fund të syrit të vakët të Qepës së Madhe. Tashmë e kishte mësuar ta flasë gjuhën e saj siç e fliste ajo ujësisht. Njeriu i ujit dyshoi në dashurinë e Qepës së Madhe kur liqeni vuri akull mbi vete. natën e daljes mbi akull u shtua uji i valë në sytë e Qepës së Madhe me dy hëna.

John Harkeri e pa seriozitetin përtej errësirës së syve të Qepës së Madhe sikur ajo ra në ujin e liqenit.

“Do ta kisha vra ujin sonte deri tej vezullimi i syve të tu”, - kishte thënë John Harkeri në fund të amokut.

Ai u përkul ta puthë në buzët veshtullore Qepën e Madhe kur e sëmboi celulari.

Në tokën neutrale, midis dy kufijve prej dhjetë metrash mbi mishin e njeriut të turmës po zbrazej shiu i ftohtë i Prillit të Ditës së Dytë. Kishte mbetur pak tokë për gjumë.

Gjeneralisimusin Stalin pranë hekurinës së Skënderbeut të sjellë nga Tirana, e rroku dhembja reumatike në dorën e majtë. Atëherë Migjeni në ngacmimet e kollës së përzier me gjak e vlerësoi të vështirë gjendjen shëndetësore të gjeneralisimusit Stalin.

“Këtu ka shumë lagështirë për shëndetin e tij reumatik”, - tha.

“Nxjerrni dengun e gazetës *Zëri i popullit* nga makina!” – vazhdoi Migjeni.

Bendisa mezi e njohu Migjenin e librave, të bërë skrop nga shiu i ftohtë i Prillit të Ditës së Dytë. Më teëpr i përngjante Çarli Çaplinit të nevrikosur me flokët e ndara përmidis rrashtës së kresë e me mustaqet e qullura. Ngjante në një figurë groteske vajagazi.

“Sonte amerikanët do të sjellin nozullime”, - e ngushëlloi i ati vajzën e hutuar pas Migjenit-Çarli Çaplin.

Bendisa pasi e gëlltiti habinë e vet për Migjenin-Çarli Çaplin e vështroi vegimin e ikonës së Josip Visioranoviç Xhungashvilit në murin e lagësht të manastirit të Tbilisit.

Ikona e Stalinit afër hekurinës së Skënderbeut, të sjellë nga Tirana, iu drejtua turmës së rysur në tokën neutrale midis dy kufijve: “Vetëm besimi juaj në socializmin sovjetik do t’u shpëtojë. Sot Prillin e Ditës së Dytë imperializmi amerikan po ju mashtron”.

“Me cilin Skënderbe është Stalini?” – e pyeti Bendisa t’et, pasi Stalinin e ndërpreu gjysmë dhimbja e fortë reumatike në dorën e majtë.

Jekaterina e luti të birin t’ia mbështjellë krahun e majtë duke e nanuritur sikur atëherë.

“Në shtatoret e tua të bronzta skulptorët hudhin më tepër metal në dorën tënde të majtë.”

“Po si ta lëviz dorën e majtë kur ma kanë zënë kaq ngushtë në dengun e këtyre gazetave të *Zërit të popullit!*?”

“Duro edhe pak! Gazetat do të shpërndahen nëpër oborre, nëpër shtëpi, nëpër rrugë. Pastaj do të bëhet revolucion kundër revizionizmit”, - e ngushëlloi Migjeni.

Gratë e ngujuara në rripin e tokës neutrale i mbuluan fëmijët me mishin e fjalëve magjik, kur Bendisa i tha t’et:

“Gjeneralisimusi Stalin u shkëput nga përqaftimi i Skënderbeut.”

Bazamenti i shtatores së Stalinit u vërejt i zbrazët në gjysmë të amokut të tij drejt sallës së teatrit të OSCE-së.

Amoku i vrapimit këtë herë gjeneralisimusin e la të molitur, të heshtur para Mollotovit.

Stalini deshi ta qortohtë Mollotovin pse aq paburrërisht i kishte braktisur të gjitha gazetatat.

Mollotovit krejt papritmas i iku frika përtej shikimit përbuzës kur arriti t'i thotë mikut të vet:

“Më lehtë iket nga një gazetë e zhbravitur, qullashe, siç ika unë sesa të ikësh nga bazamenti i lidhur me shufra çeliku siç ike ti, miku im.”

Stalini e kuptoi nga biseda e Mollotovit dallimin midis ikjes dhe dëbimit.

“ja tek kush na shpuri në Prillin e Ditës së Dytë miku yt, Hrushqovi”, - bëri me dorë kah salla e teatrit të OSCE-së.

Me të hyrë Stalini në sallën e OSCE-së me amokun e vet të sosur, princesha Tahet u nis kah toaleti. Duke ia shtrënguar krahun Besi Banit, ia tha atë fjalën tjetër.

Besi Bani e bëri atë shenjën e kuptimit “po e njoh”. Ai mendoi për figurën e dyfishtë ushtarake të gjeneralisimit Stalin e të kolonelit jugosllav.

“Sa vështirë e kanë të qëndrojnë brenda një palë rribave ushtarake!”

Princesha Tahet, e cila duke dalë nga toaleti e kishte zënë mendimin e Besi Banit, i tha:

”Poeti hazar, Sikteh, u bë hardhucë midis judaizmit dhe ortodoksizmit deri tek gjuha e kështenzës mitologjike me dy hëna. Babai im, mbreti im, belbëzonte sa herë merrte të tregonte në cilën hënë u mbyl poeti Sikteh.”

“Ti do të thuash se edhe gjeneralisimi e koloneli brenda të njëjtës palë rroba do të përfundojnë tek hardhuca”, - bëri sikur e kuptoi princeshën.

Ajo, me një miratim të gaztë në sy, i propozoi të dalin jashtë për ta parë nga lartësia e malit shiun mbi ushtrinë shtetërore të kolonelit jugosllav përtej kufirit.

Në fillim të rrugës së princeshës Tahet Besi Bani e sosi gotën e pijes së ëmbël. Dera e sallës së OSCE-së po largohej para tij kur Besi Bani ra në gjumin e thellë.

Aroma e shkrehur mbi të Besi Banin e ngriti lart si tullumbace fëmijësh kur përkthyesja e gjeneralit italian klithi tepër zëshëm:

“Sa të hiqtë e ka trupin ajo kurva hazare! Ajo e puth publikisht dashnorin e saj. Përpiqet ta mbajë dashnorin e saj midis dy kofshëve, siç e mbajti poetin Sikteh midis mashtrimeve derisa e bëri hardhucë.”

“Poetët vdesin në gjumë çdo ditë, edhe sot kur po bie shi i ftohtë i Prillit të Ditës së Dytë. Kush nga shqiptarët do të çirret për këtë Migjenin e tyre siç u çjerrën rusët e mençur në kohën e gjeneralit të tyre.”

“Na jepni Tolstoin e ri! E duam Tolstoin sovjetik, revolucionar!” – foli përgjumshëm profesori nga fundi i gotës së konjakut.

u bë heshtje nëpër gjithë oborrin e sallës së OSCE-së deri atje, midis tyre. Në Prillin e Ditës së Dytë, e kapitur rrugës së gjatë, turma e kosovarëve po ngujohej në atë rrip të hollë toke, midis kufijve; midis gjeneralisimusi Stalin dhe kolonelit jugosllav gjumi vinte i tërmekur. Turma e rysur e kosovarëve në llucën e rrahur po rrëshqiste në gjumin e përzier me llucën e ftohtë.

Në dengun e gazetës *Zëri i popullit*, Stalinit i ishte mpirë dora e majtë. Nëpër të gjitha gazetatat e botës këso rrebeshesh të shiut depërtojnë deri tek ilegale e fshehur në to. Pikërisht rendimi i ujit në dengun e gazetës *Zëri i popullit* gjeneralisimusi ia kishte shtrembëruar syrin e majtë.

Tash u bënë tre. Gjeneralisimusi e urdhëroi Molotovin të qëndrojë pranë hekurinës së Skënderbeut duke i dhënë shenjë të shikojë drejt kolonelit. Mollotovi vetëm kur e shpjegoi sheneralisimusi, e zbuloi atë Skënderbeun tjetër të kolonelit jugosllav, të çmontuar në kamionin ushtarak. I pa ushtarët e ulur duke pirë duhan mbi kokën e Skënderbeut.

Çizmet ushtarake po shkelnin mbi supet e tij duke ia cfiltrur bojën ushtarake të mëngjesit.

Gojët e hapura të dymëve të kamionëve po nxirrnin ushtarë, regjisorë, punëtorë për të ngarkuar mbi kamionë pjesë të skenës së madhe evropiane. Uliksi krejt i baltosur e shau Agamemnonin. Koneja e Danielit po mundohej të pillte nën një kamion ushtarak derisa Mefistoja po zihej keqas me regjisorin e dehur xurxull.

“Sonte do të rikthehemi për ta rikonstruktuar skenën e madhe evropiane në midis të urës T. për turmën tjetër të nesërme të ikanakëve. Po me kohë do ta aktrosh atë mashtrimin tënd”, - regjisorin e qortoi nëpër shi Uliksin e përbaltur. “E sheh konfliktin e aktrimit gjith evropian. Ata pinjollët e asaj Pelës së Trojës i emitojnë aktrimet heroike kur ajo gërdallë ngordhaleqe e Trojës po ngarkohet sonte në kamionë ushtarakë për t’u montuar sërish në midis të urës T.”

“Sonte, pas goditjes së raketës *Tomahok* Gjermania do të mbetet pa aktrimin e saj të doktor Faustit triumfal”, - zëroi Rabii Johanan ben Zakai nga këlyshi i Kones së Danielit. “Gjermania në teatrin e Berlinit për çdo natë ia çante barkun fatkeq të kones së Danielit pa e çar kokën për shtatzëninë e kones së Danielit me aq pak ujë në mitër. Gjinekologu gjuetar çdo natë në teatrin e Berlinit për tekat e doktor Faustit mburravec ia çan barkun kones së Danielit duke e këmbyer pjellën e saj me një gjyshe uloke e me një vajzë miturake.”

Gjuetari-hero, i përbaltur në rrëmujën e skenës evropiane e takoi regjisorin e bërë xurxull; e zuri për krahu duke i thënë ngutazi:

“Kësulëkuqja dhe gjyshja që në mëngjes më kanë mbetur në barkun e fryrë të ujkut. Duhet nxjerrë sa më parë. Ndryshe ato do të vdesin, do të ngulfaten.”

“E kanë ngrohtë aty në barkun e ujkut. Le të presin aty deri nesër kur të montohet skena!” – qesëndisi regjisorin. “Skena e madhe evropiane, e çmontuar sonte do të kthehet prapa deri tek ura T ku ishte sot në mëngjes. Nga atje do të aktrojë sërish nesër Skënderbeu, nga atje nesër do të nisen sërish kosovarë derisa të sosen.”

“Po gjyshja dhe kësulëkuqja do të ngulfaten në barkun e ujkut po mbetën atje deri nesër”, - ankoj gjuetari-hero.

“Këtu e dy mijë vjet shpëtoi pa u ngulfatur Rabi Johan ben Zakai në barkun e konës së Danielit, në mishin e Mefistos, në mishin e Insektit. Këtu e dy mijë vjet ky popull i Kosovës shpëtoi pa u ngulfatur në menstruacionet kronike të Mbretëreshës Teutë”, - reagoi regjisorin i nëpërngutur.

“Po hebrenjtë dhe këta kosovarët janë popuj të mallkuar. E kanë gabuar zejen gjinekologjike të gjuetarit kombëtar për t’i nxjerrë çdo mbrëmje në skenë nga barku i konës së Danielit, nga mishi i Mefistos, nga mishi i Insektit, nga menstruacionet kronike të Mbretëreshës Teutë”, - qortoi gjuetari-hero.

Qepa e Madhe u gajas së qeshuri.

“PSe qesh kaq papritmas?” – u tremb John Harkeri në midis të hezitimit.

“Ai njeri me kapelë e përmendi kësulëkuqen”, - mendoi për regjisorin.

“Në teatrot evropiane çdo lojë fillon me kësulëkuqen”, - arsyetoi John Harkeri.

“Tek ne, vajzat kur bëhen për martesë duhet ta ndjejnë thellë grishjen e ujkut. Këta evropianët sa herë vajza e tyre e mëton lirinë e dërgojnë gjuetarin halldup për ta nxjerrë nga barku i ujkut bashkë me gjyshen plot moral reumatik”, - vazhdoi të flasë Qepa e Madhe.

“Ti do të thuash se në grishjen e ujkut fillon liria”, - pyeti ai.

“Jo. Aty fillon mësimi, fillon bashkëjetesa me rregullën e natyrës. Ne sonte tek shtegu i Oregonit e fillojmë mugullimin e lirisë brenda rregullës së natyrës pa ndërhyrjen eurve evropiane, siç janë: shteti, pushteti, morali, feja, patriotizmi...”, - ajo gjithnjë po e zgjaste bisedën sikur të mos e kishte ndërprerë ai:

“Ti thua se sa herë çelet barku i ujkut e nxjerrin nga një kësulëkuqe të politikës reumatike të pushtetit shtetëror”, - e ngacmoi John Harkeri.

“Po. Teatri evropian është goja e madhe e Mbretit, e tiranit e pushtetit shtetëror...”

Vetëm në fund të fjalëve të Qepës së Madhe John Harkeri e pa me kureshtje zanafillën e iniciativës së lirë të Nati Bumpos se si në fermën e vogël i mugullon njeriu i lirë pranë Misrit halldup, pranë Bizonit mospërfillës, pranë Indigjenit daulle; e kishte lexuar Qepa e Madhe në fletoren e vëllait kur e zinin dhembjet e gropës së zezë tek mishi i mashkullit.

Nga ferma e vogël e Nati Bumpos John Harkeri e pyeti qendrën në Ohajo:

“Cili mund të përbirohet nëpër atë tej toke të askujt midis gjeneralisimit Stalin dhe kolonelit jugosllav Mirk Iliç?”

“Nëpër atë tej toke të askujt mund të përbirohen hebrenjtë dhe kosovarët gjatë rrugës së tyre nëpër mishin e këlyshit të kones së Danielit, nëpër mishin e Mefistos, nëpër mishin e Insektit, nëpër menstruacionet e Mbretëreshës Teuté”, - shpjegoi Qendra nga Ohajo.

John Harkeri e vështroi me kujdes se si në rripin e ngushtë të tokës midis gjeneralisimit Stalin dhe kolonelit

jugosllav Mirk Iliç po rysej mishi i njeriut kosovar, siç kishte sugjeruar Qendra nga Ohajo.

Leckat e gjumit dymijëvjeçar të menstruacioneve kronike të Mbretëreshës Teutë ranë në llucën e tundur e të ftohtë të Prillit të Ditës së Dytë. një grua u përgjak vegësh pas goditjes së raketës *Tomahok*; kishte dhembje në fund të barkut.

“Bushtra, gjatë gjithë rrugës e paska pasur jashtë”, - i skërmiti dhëmbët gruaja në moshë.

Një grua tjetër ia hudhi tek këmbët gruas së vjetër një tas ujë shiu bashkë me një tufë fjalësh të lidhura një:

“Kjo bushtra plakë u bie mësysh barqeve të nuseve e barkut të tokës pas goditjes së raketës *Tomahok*. Lugatesha!”

Bretkosat e grishin shiun e grave me duar të lidhura rreth fundit të barkut. Ato, të nemitura ndalojnë tek fjalët e lugateshës plakë:

“Ku do t’i fshihni kopilat tuaj pas Prillit të Ditës së Dytë? Pas goditjes së raketës *Tomahok* në mitrat tuaja do të lindin fëmijë pa babë...”

Përkthyesja italiane iu qas Plutarkut çufrak në fund të gotës së verës me gjysmëqortimin:

“Mbretëresha Teutë pas goditjes së raketës *Tomahok* doli shtatëzënë.” Ambasadorit roman, në fund të fjalëve të përkthyeses italiane, i gjithë gjaku i hipi në fytyrë.

“Unë e kam bërë raportin për delegacionin roman sipas relacioneve ushtarake të Ministrisë së brendshme”, - arsyetoi Plutarku. “Ç’faj kam unë se këto gra kanë mbetur shtatëzëna nga fara mashkullore e raketës *Tomahok*? roma i ka njohur këto gra, si dhe mbretëreshën e tyre, me menstruacione kronike.”

“Ta preftë ujku rrugën, oj bushtër! në barkun tënd prej beronje me menstruacione kronike dymijëvjeçare e paske pasë ruajtur farën e keqe”, - shpërtheu përkthyesja e gjeneralit grek.

“Raketa *Tomahok* ka futur farë mashkulli laboratorik në mitrën e këtyre grave”, - ndërhyri përkthyesja frenge. “Ajo, Amerika do ta kultivojë këtë racë arketipe të kosovarëve siç e ka kultivuar racën e hebrenjve. Të dy këto raca kanë ravguar nëpër mishin e këlyshit të Kones së Danielit, nëpër mishin e Mefistos, nëpër mishin e Insektit, nëpër menstruacionet dymijëvjeçare të Mbretëreshës Teutë deri buzë zhdukjes”, - merrte zjarr përkthyesja e gjeneralit freng.

“Kamerier sillma një shishe konjak”, - urdhëroi profesori nga fundi i shishes së parë.

Kamerieri kishte pritur tek tryeza e profesorit derisa në fund ia dha një monedhë metalike.

“Zotëri, e keni një monedhë tjetër”, - i tha kamerieri.

“Kjo është monedha më e mirë e emetuar ndonjëherë nga Austria. E sheh? Në të është figura e gjelit”, - unguroi profesori.

Kamerieri po e shikonte monedhën austriake kur profesori e kishte hapur shishen e konjakut.

“Nga metali i kësaj monedhe i kemi farkuar pllakëzat e vitit një mijë e nëntëqind e pesëmbëdhjetë. Ato pllakëza i kemi vënë në vegët e grave të reja për t’i matyr menstruacionet e tyre kronike. Ky metal fisnik i monedhave austriake i ka përballuar aq gjatë urinës”, - bërbeliste profesori.

“Shënimet tuaja tek pllakëza metalike janë fshirë nga urina, nga menstruacionet kronike. Sonte, atje në shi, në atë rrip toke po pjellin gratë e menstruacioneve kronike të pllakëzave tuaja”, - e sëmboi përkthyesja italiane duke e vështruar fytyrën e skuqur të Teutës.

“E pamundur! Krejt e pamundur!” – kërceu bashkë me shishen e konjakut profesori vjenez. “Në pllakëzat tona të vëna tek vegët e grave të reja në vitin një mijë e nëntëqind e pesëmbëdhjetë menstruacionet e Mbretëreshës tregonin pamundësi të pjelljes.”

“Ecni vetëm pesëdhjetë metra nga kjo zyrë e OSCE-së, po mund t’i ikni shiut, e, do të shihni në atë rrip toke, midis dy kufijve Kosovë-Shqipëri, se sot Prillin e Ditës së Dytë po pjellin gratë e tyre”, - ngulmoi përkthyesja franceze.

“Ju zonjë e nderuar po flisni sikur të pjellte kësulëkuqja në bark të ujkut”, - kundërshtoi plot afsh profesori.

“Sa herë e vrau të njëjtin ujk babai yt, Ariu i Kuq?” – John Harkeri e pyeti Qepën e Madhe.

“Po ta vriste ujkun babai im, Ariu i Kuq, vetëm edhe një herë vajzat tona do të mbeteshin pa u martuar. Ato vetëm ujku i grish për martesë”, - ofshani Qepa e Madhe.

“E ke lexuar fletoren e vëllait tënd të madh se sa herë e vrasin hugenotët francezë të njëjtin ujk?”

“Po. Kur vëllai im i madh kishte dhembje në gropën e mishit të mashkullit të mbushur me qepë të zier e patate të grirë unë e nëna i shikonim vizatimet në librin e tij. Në këto vizatime nëna gjithmonë e shihte ulkonjën e unë e shihja ujkun”, - foli Qepa e Madhe krejt e skuqur në fytyrë shkaku i ujkut të saj.

John Harkeri e kuptoi skuqjen e Qepës së Madhe ende pa e shtruar pyetjen:

“Pse zihesh me nënën shkaku i ujkut? Pse nëna jote ujkun e merr për ulkonjë e gjuetarin për kirurg?”

“Gratë tona në kohën e pjelljes së tyre shkojnë në pyll tok me burrin me qaforet plot dhëmë ujk. Pasi kthehen nga pylli me foshnjë në dorë, burri bëhet i sëmurë dyzet ditë”, - me pritesë shpjegoi Qepa e Madhe.

“Atëherë këta burra po e nxjerrkan foshnjën nga mitra e gruas së tyre sikur gjuetari kësulëkuqen”, - u tall John Harkeri.

“Jo”, - kundërshtoi Qepa e Madhe. “Po ndodhi të vdesë foshnja apo nëna, burri duhet të humbet në pyll, të vritet. Në tregimin evropian ndodh e kundërta: gjuetari e aktron heroin tek shtrati i fëmijës gjumëpakët e deri tek politika e Mbretit. Këtu duhet të vritet i njëjti ujk për ta rritur heroizmin e gjuetarit shtetëror”, - ndryshoi zë Qepa e Madhe kur dikush u tha ushtarëve:

“Keni ardhur me kohë. Do të hypni në kamionë ushtarakë mbi pjesët e çmontuara të teatrit evropian.”

“Sonte duhet të vritet ujku. Ndryshe gjyshja dhe kësulëkuqja do të ngulfaten në barkun e tij”, - sërish ankoj regjisori.

John Harkeri e nguli shikimin pyetës në bezbën e syrit të Qepës së Madhe kur regjisori t’ia krisi me tërë zërin:

“Ee idiot! dy mijë vjet ke vdekur në skenë e sonte bëhesh sikur i hutuar.”

Akili heshti. Ishte gjysmë id ehur. Në thembrën e shqyer të këpucës iu ngul një ashkël; shenjë ogur se duhet të vdesë jashtë skenës së teatrit evropian Prillin e Ditës së Dytë.

Një tufë fëmijësh të përbaltur po e ndiqnin këlyshin e Kones së Danielit. Ai iku nën kamionët ushtarakë. Krejt të qullur e të përbaltur, regjisori e hudhi në kamion.

“Si do të dalë në skenë kështu i përbaltur?” – nga Shtegu i Oregonit foli Rabii Johanan ben Zakai.

“Skena do të jetë fushore, mbi urën T. Do të mungojnë dritat e reflektorëve”, - ndërhyri regjisori.

“Pas goditjes së raketës *Tomahok* kot e shtrydhni atë këlysh për ta nxjerrë Mefiston nga mishi i tij”, - sërish ndërhyri Rabii.

“Në cilin mish gjendesh tash?” – e pyeti regjisori.

“Jam në fund të Shtegut të Oregonit; përtej mishit të këlyshit të Kones së Danielit, përtej mishit të Mefistos, përtej mishit të

Insektittë Grigor Zanzës”, - paskësh thënë Rabii Johanan ben Zakai.

“Ai Franc Kafka juaj përtej Mojsiut tuaj e zbuloi Amerikën. Evropën e shpalli tokë të faraonëve”, - skërmiti plot mëllef regjisori.

“Në gjithë këtë shi vështirë të ndizet zjarri i skenës sonë të Trojës”, - ndërhyri Uliksi në bisedën e tyre.

Fjalët e fundit Uliksi i tha vetëm sa për ta kthyer regjisorin në krye të detyrës.

“Kjo kofsha jonë lëviz me rektimë këtu e dy mijë vjet”, - Uliksi tregoi pelën e Trojës të çmontuar në kamionët ushtarakë.

“Tre mijë vjet.”

“Mirë.”

Regjisori mendoi se hekurina e Skënderbeut kur mbetet pa bojë ushtarake skërmit më tepër se kali dërrasor i Uliksit. Kali i Uliksit, akejtë e përgjumur do t’i mbroja nga lagështia, nga sufrina më tepër nga hekurina e Skënderbeut.

“Ky shi mizor do t’i përziejë skenat e teatrit evropian me teatrin arketip të kosovarëve”, - u ankua regjisori.

Teatri arketip i përzier me teatrin e Romës e solli Ambasadorin roman deri tek heshtja e Mbretëreshës Teutë. Ai heshtjen e Mbretëreshës Teutë e mori vetëm si ndrojtje të gruas së re. Pastaj Ambasadori roman kishte vërejtur gjatë qëndrimit pranë Erenikut se Mbretëresha Teutë prirej kah shelgu, kah uji, kah heshtja e peshqive.

Në breg të Erenikut plasi shtrëngata tunduese deri tek pallati i Mbretëreshës.

“Kjo Mbretëreshë e kronikave të trishta në cilën stinë jeton?” – e pyeti Ambasadorin roman konsulli i sapoardhur nga Roma.

“Thonë se kjo Mbretëreshë jeton në stinën e pestë”, - mendoi të ketë thënë Ambasadori roman.

“Dhjetë vjet të këqija në diplomaci e dëmtojnë perandorinë”, - qortoi papërcaktueshëm konsulli.

“Ç’fat i çuditshëm; njeriu i gjallë të robërohet në stinën e pestë”, - ndërhyri mjeku.

“Kjo do të ketë qenë stina e Mbretëreshës sa herë kemi dalë në shëtitje bregut të Erenikut”, - konstatoi Ambasadori roman.

Befas nga ana e majtë e fytyrës Ambasadori roman e ndjeu hukamën e dikujt të përzier me erë të fortë të naftalinës. U bë gjysmëfjetur brenda gjumit të parë. Gjysmerrësira e ëprzier me naftalinë u bë e plotë rreth kokës së mbështjellë me këmishë të Ambasadorit. Brenda gjumit të parë të Ambasadorit e hodhën gjumin e dytë të sjellë nga Roma.

“Hiqni krejt çka duhet të hiqet nga mishi mashkullor i Ambasadorit”, - urdhëroi konsulli.

Në raportin zyrtar të konsullit roman u fol se Ambasadorin e vrau Mbretëresha Teutë.

Përkthyesja e gjeneralit italian duke e shikuar Teutën me duar të lidhura rreth barkut gati se i tha *kurvë*.

“Në të gjitha kronikat shkruan se kjo Mbretëreshë zevzeke e vrau Ambasadorin tonë”, - bëri me dorë kah Teuta duke folur me Plutarkun.

“Tashmë në Romë të gjithë e dinë vrasjen e Ambasadorit”, - i aprovoi fjalët e përkthyeses italiane Plutarku i dehur.

në fund të gjumit të dytë Ambasadori roman deshi të sharrojë në sytë e flohtë të Mbretëreshës Teutë. Amoku i vrapimit e rroku kur Mbrtëresha e ftoi të ulet pranë saj, në fronin e lartë me kutërbim të rëndë gjaku. Mbretëresha i foli Ambasadorit me të gjitha stinës e përgjumura të menstruacioneve. Në fytyrën e Mbretëreshës stinët përngutshëm e kafshuan njëra-tjetrën. Në fytyrën e Mbretëreshës ranë shumë gjethe, pastaj cifla akulli me suferinë...

Ambasadori roman, të përgjumur, me shpurën e tij, e ndaluan para dyerve të Romës me fjalët profetike:

“Sa u besojnë njerëzit fjalëve tuaja?”

Ai u hutua në çastin e parë kur i thanë:

“Mate tregimin tënd me Trekëndëshin e Platonit!”

Urdhri i Ambasadorit roman i piku para këmbëve:

“Nxjerreni Trekëndëshin e Platonit nga karroca jonë e fundit!”

Nga karroca e fundit e Ambasadorit roman e nxorën Trekëndëshin xhuxh me kutërbim të menstruacioneve të Mbretëreshës. E shtrin para dyerve të Romës për ta matur raportin ushtarak të senatorit eoman.

“Është Trekëndësh tepër i vogël – arketip; ende në mitër”, - trishtueshëm foli arkitekti.

Moti i nxehtë para dyerve të Romës i grishi mizat në Trekëndëshin xhuxh të plyrur me menstruacionet e Mbretëreshës.

Trekëndëshi luftarak i Platonit qenka kalbur gjatë misionit të Ambasadorit në Iliri – ironizoi arkitekti.

“Kush do t’i besojë tregimit të Ambasadorit brenda këtij Trekëndëshi xhuxh, të plyrur në gjak, ku miza e sheh mizën nga secili kënd?” – shtoi drejtori i doganës.

Plutarku i skuqur nga vera e ngriti gotën e përthekuar nga sytë e përkthyeses italiane kur në të gjitha kronikat zyrtare u mbyll vdekja e Ambasadorit.

Në fillim të vdekjes zyrtare Ambasadori roman ndjell dhembje midis vegëve, tek mishi i mashkullit, andej syve të ftohtë të Mbretëreshës kur dikush foli:

“Punë e madhe si binte shi. Gjaku mbeti aty. Treqind vjet ky Ambasadori roman e harroi vdekjen e vet në menstruacionet e asaj bushtre Mbretëreshë.”

Krahas ngathtësisë së kohës nga derë e rritur e Romës Ambasadori roman po sharronte në sytë e ftohtë të

Mbretëreshës Teutë. Në kodrinën më lindore të qytetit ndaloi njeriu i kapitur, shikoi drejt Romës për t'u thënë dy të tjerëve:

“Ambasadori i Romës po zhytet në sytë e ftohtë të Mbretëreshës ilirike.”

Nga fundi i syve të ftohtë të Mbretëresha Teutë sikur qenka ankuar Ambasadori roman.

“Ditën e varrimit tim në menstruacionet e Mbretëreshës ra shi me xhyma. Ushtarët romanë u ngutën të më mbulojnë brenda varrit bashkë me reumatizmën dhe shiun. I ndjeva hapat e ngutshëm të Senatorit roman duke u larguar. Ushtarët romanë futen shumë shi, shumë reumatizëm në varrin tim. Brenda varrit tim të ngrohtë njëqind vjetët e para shiu u sos. Në njëqind vjetët e dyta reumatizma u mësua me mua. Në treqind vjetët e treta i zdërvaja eshtrat gjithandej varrit tim. Shekujt e tjerë u bënë të heshtur.”

Gjenerali italian u ngrit nga vendi sikur e huqi rrugën nga toaleti në drejtim të derës. Doli nga zyra e OSCE-së në aftimin e shiut të mbrëmjes së Prillit të Ditës së Dytë.

Trekëndëshi xhuxh, arketip, aq qesharak para dyerve të rritura të Romës, sonte, Prillin e Ditës së Dytë, do t'i bie tamam këtij rripi të tokës së hollë midis kufijve Shqipëri-Kosovë.

Bretkosat nga të tria këndet e Trekëndëshit xhuxh arketip në rripin e ngushtë të tokës, në midis të kufijve Kosovë-Shqipëri, po e rrisnin grishjen e shiut. Karvani bibliki, i gjatë nëntë kilometra, që nga ura T. po derdhej bashkë me hsiun në hapësirën e ngushtë midis kufijve Shqipëri-Kosovë.

Gjenerali italian i bëri disa hapa ushtarakë drejt kufirit Shqipëri-Kosovë, deri ku e lejonte konventa evropiane, në anën e djathtë të Skënderbeut të sjellë nga Tirana duke u bërë se e harroi gjeneralisimusin Stalin. E veneroi turmën njerëzore në rripin e ngushtë të tokës, nën shiun e bretkosave.

Nën shiun e lashtë të bretkosave gjenerali italian u bind se Ambasadorit roman i ishte kalbur Trekëndëshi autoritar i Platonit brenda menstruacioneve të Mbretëreshës Teutë.

Përkthyesja italiane, me ankth e zbuloi frikën e gjeneralit në sytë e ftohtë të Mbretëreshës Teutë kur ai deshi t'i përshkojë të gjitha rrugët xhuxhe të bretkosave deri tek fytyra e shembur e Skënderbeut. Vetëm atëherë iu bë e qartë se fytyra e shembur e Skënderbeu do të udhëtojë Prillin e Ditës së Dytë, sërish në kamionë ushtarakë të kolonelit për ta rikonstruktuar skenën e Teatrit evropian tek ura T, tek qyteti i Gjakovës.

“sa herë është arratisur Skënderbeu?” – mezi e dëgjoi zërin e vet gjenerali italian.

Turma veshtullore e kosovarëve nën shiun e grishur të bretkosave u tkurr kur çizmja e kolonelit shkeli në bishtin e saj. Një gruas i ra kryqi në llucë.

Gjeneralisimusi Stalin e nxori kokën nga karroca ushtarake kur koloneli i dha urdhër skenës së çmendur të Teatrit evropian të niset drejt urës T, drejt qytetit të Gjakovës.

“Është bërë vonë. Sonte tërë natën do të montohet skena e Teatrit evropian tek ura T. Edhe kjo hekurinë, - bëri me dorë kah Skënderbeu, - edhe nesër edhe ditëve të tjera, deri sa ta sosë mishin e këtyre kosovarëve do t'i prijë drejt shpërnguljes. E kanë mëtuar NATO-n, ja ku e kanë”

Dyert e hapura të kamionëve ushtarakë e nxjerrin ankthin e skenës së Teatrit evropian; sikur u stepën nga urdhri aq i befashëm i gjeneralisimusi Stalin drejtuar mikut të tij, Migjenit.

“Hudhni gazeta sovjetike mbi turmën e tulatur kosovare. Le të mësojnë njerëzit rrugën e tyre!”

“Cilat gazeta do t'i bëjnë ballë këtij shiu të bretkosave? Gjeneralisimusi Stalin do ta lirojë dorën e tij reumatike nga dengju i gazetës *Zëri i popullit*. Aty është zënë ngushtë pas ikjes

nga të gjitha gazetat e Paktit të Varshavës”, - shpurthi nga fundi i gotës së konjakut profesori.

Në midis të turmës kosovare, të bërë skrop nga shiu i bretkosave, shpërtheu vigma e një gruaje.

“Merre gjumin tënd, bir bushtre!”

Leckat e gjumit u shkundën, të ngrohta, nga sytë e buhavitur të grave, mbi llucën e tundur. pluskimi i gjumit përzihej me llucën nën atë mal të dendur këmbësh njeriu. Gruas i rrodhi kuq, prush, vazhda e gjakut gjatë gjithë këmbëve, nga mitra e çelur e deri tek lluca e tundur.

“Ku mbeti ajo mami e mallkuar?” – u dëgjua zëri i disa grave të nevrikosura.

Disa gazeta të Stalinit arritën përtej kufirit Shqipëri-Kosovë deri tek dyert e hapura të kamionëve ushtarakë të kolonelit jugosllav.

“Zor të të njohë nëna jote si je bërë me këto rroba të ndotura nga lluca!” – e qortoi regjisori Mefiston.

“Na nxori shpirtin ky shi i mallkuar”, - u ankua Mefistoja me këlyshin e Kones së Danielit në duar.

“Lëkura e butë e këlyshit të Kones së Danielit, rrobat e tua dendi, të plyrura nga lluca e tundur e tundojnë skenën e çmontuar evropiane. Sillu më natyrshëm!” – e qortoi regjisori me zë të lodhur.

Në këtë anë, ende jashtë këtyre kamionëve ushtarakë e shoh plagën tënde të mbushur pushtet aktrimi për lozhën e Mbretit, për lozhën e kryeministrit...Këtej nga vetja e shoh kufomën time të mbushur plot mish qeni”, - foli me zë tjetër Mefistoja.

Në Prillin e Ditës së Dytë po bëhej e gjashta natë e vdekjes së kontit Mefisto në bodrumin e kështjellës së doktor Faustit. Atë natë hapat e rëndë të doktor Faustit i njohu kufoma e kontit Mefisto. Kufoma e njeh kufomën. Plaga e njeh plagën.

Doktor Fausti, vetë i treti, zbriti në bodrumin e kështjellës nëpër derën e plagës së Kontit Mefisto me disa sharje nënës hebreje.

“Mos i jep nënë gjermane kryedjallit Mefisto, atij hebreut të përbatuar!” – i tha ai tjetri doktor Faustit.

Ushtria e xhelatit-mjek Prillin e Ditës së Dytë e solli zallahinë në bodrumin e kështjellës së doktor Faustit. Nga jashtë kështjellës shiu i bretkosave e qullte pikëllimin e nënës hebreje të kontit Mefisto, derisa doktor Fausti i nxirrte të përbrendshmet nga kufoma e kryehebreut Mefisto.

Me duar të kallura nga gjaku i kufomës së kryehebreut Mefisto doktor Fausti i blatoi plagët. Me gjysmë sharje ua tregoi atyre të tjerëve mjeshtërinë e xherahut-mjek:

“Sa mjeshtërisht i ka mbushur plagët me mish qeni ai xherahut-mjek në kufomën e kryehebreut. Në këto plagë ndalohet mishi i njeriut.”

Ai tjetri pranë doktor Faustit tha:

“Kufomë e përsosur. Djalli hebre le të mbetet pa gjini!”

“kend e vranë me Prillin e Ditës së Dytë? E vranë kryedjallin hebre Rabii Johanan ben Zakai apo e vranë atë këlyshin e kones së Danielit”, - pyeti i treti.

Delegacioni i mbretit Prillin e Ditës së Dytë u ngjit shkallëve të bodrumit të kështjellës së doktor Faustit deri tek dhoma gjysmë e errët.

Doktro Fausti e ndjeu kur delegacioni i Mbretit u ul në drurin e rëndë të divanit, tek sharroi në plagët e zeza u bë duke folur për lëkurën e tri perandorive.

“Ty, - iu drejtua Faustit kryeprokurori roman, - të kenë sharruar duart thellë në plagët e djallit hebre dhe të këlyshit të kones së Danielit. Mishi hebre prej këlyshit të Kones së Danielit e deri tek plagët e kaltra të kryehebreut Mefisto të pengojnë të arrish tek Trekëndëshi i Platonit-Sokrat.

Prokuratori roman sikur e sfidoi gjeneralin italian nën shiun e bretkosave. Ai e mati tokën e ngushtë midis kufirit Shqipëri-Kosovë për rrugën e Mefistos kah Trekëndëshi i Teatrit evropian. U bind se kishte pak vend për Drurin e Platonit-Sokrat në Kosovën e shiut të bretkosave.

Ambasadori roman, i rënë thellë në sytë e flohtë të Mbretëreshës, atë pasdreke valuke para dyerve të Romës, krejt papritur, e nxori Trekëndëshin arketip. Konsulli roman e veneroi Trekëndëshin xhuxh me madhësinë e hardhucës sikur paskësh thënë:

“Nga Kosova e NATO-s po vie kutërbimi i menstruacioneve kronike. Misri valuk i John Harkerit bashkë me Bizonin mospërfillës e Indigjenin daulle a mund të rrinë në Trekëndëshin biodemokratik amerikan?”

Në fund të këtyre fjalëve Ambasadori roman iu kthye Romës në fund të rrugëtimit të shtatë nga mitra e Mbretëreshës ballkanike. u detyrua të pranojë zëshëm në fund të amokut vrasjen e vet zyrtare në raportin e konsullit toman:

“Mbretëresha ballkanike e vrau delegacionin roman; e vrau Ambasadorin roman. Le të dënohet me menstruacione kronike derisa t’i plasë fundi i barkut nga gjaku i ngjizur!”

Mbretëresha ballkanike u habit nga mallkimi zyrtar i Ambasadorit roman.

Falltarët romanë i lidhën magjitë tri net hëne në themelet e kështjellës së Mbretëreshës ballkanike pas udhëtimit të ushtrisë romane për ta gjetur varrin e Ambasadorit roman. Ushtria romane mbi tokën e Mbretëreshës ballkanike e shtrii Trekëndëshin e rëndë të Platonit-Sokrat ; mbi çdo shkurre u bë harresa e gjelbërimit mbi çdo kreshtë u bë harresa e gurit, në çdo mitër ngujimi i gjakut.

Kur konsullit roman i thanë ta gjurmojë varrin e Ambasadorit në sytë e ftohtë të mbretëreshës ballkanike u bë Prilli i Ditës së Dytë.

Në midis të gjumit të Plutarkut çufrak senati roman e dërgoi një togë ushtarake deri tek paskuina me plagë të thella. kur trashet gjumi i Plutarkut kryeushtaraku i togës i trokiti derës me ngulm deri në midis të dhembjes së dhëmballës dhe dhembjes së mëlçisë. Plutarku tërë natën ishte përpëlitur midis dhembjes së dhëmballës dhe dhembjes së mëlçisë deri tek kotja e lodhshme e mëgjesit.

Para se të bie në gjumin e parë, të lodhshëm, të mëngjesit, i thotë të shoqes:

“Trembma vdekjen nga lule e ballit derisa të zbresë në fund të gjumit. Atje e kanë hedhur një paskuinë pa perandor. Do të zbres fundit të syrit të Mbretëreshës ballkanike për të gjurmuar varrin e Ambasadorit tonë.”

Kryeushtaraku i togës së senatit roman me ngulm trokitjen e derës e shndërroi në rrahje dere përtej vullnetit të gruas së Plutarkut. E shoqja e Plutarkut midis tundimit të trokitjes nevrrike të kryeushtarakut dhe urdhëresës së të shoqit e mori rrugën drejt derës.

Ushtarët e ruanin kohën gatitu kur kryeushtaraku i çeli kuvend të shoqes së Plutarkut:

“Në fund të gjumit të Mjeshtrit Plutark Shërbimi Informativ i Senatit e ka zbuluar paskuinën pa perandor. Do ta presim këtu Mjeshterin Plutark të vijë me ne deri në Senat...”

Ende pa e shkrehur ndalesën e kohës nga fytyra e ushtarëve e shoqja e Plutarkut ia këputi kuvendin kryeushtarakut:

“Tërë natën Plutarku është përpëlitur midis dhembjes së dhëmballës dhe dhembjes së mëlçisë deri tek ky mëngjes i juaj me paskuinë.”

“Nga e dini ju se mëngjesi ynë qenka me paskuinë”, - ia këputi kryeushtaraku.

“Në këtë orë të hershme Senati vetëm paskuinë gjurmon”, - ia këputi ajo duke ecur nga shtëpia.

Vigma e së shoqes së Plutarkut shkoi thik qiellit të afruar tek kulmi i shtëpisë. Aty po bëhej një vdekje midis dhembjes së dhëmballës dhe dhembjes së mëlçisë.

Kryeushtaraku e shkrehu kohën nga fytyrat e ushtarëve diku në gjysmë të oborrit, ende pa e shpallur vdekjen e shoqja e Mjeshtrit Plutark. E futi dorën thellë në gjumin e Mjeshtrit Plutark, midis dhembjes së dhëmbit e dhembjes së mëlçisë.

“Paskuinën e pate në dorë kur e fute krahun aq thellë në gjumin e mjeshtrit Plutark midis dhembjes së dhëmbit dhe dhembjes së mëlçisë – u hutua e shoqja e mjeshtrit Plutark midis gjumit e vdekjes.

“Ti mendon se paskuinat i vendos natën pushteti i Romës në gjumin e mjeshtrit Plutark për ta shpallur armik të perandorit, të senatit, të Atdheut”, - sikur u habit kryeushtaraku duke e nxjerrë krahun nga midisi i dhembjes së dhëmballës dhe dhembjes së mëlçisë.

Ende pa e sosur shenjën e dorës kryeushtaraku në lektisjen e kufomës së mjeshtrit Plutark, ushtarët e shtuan kërcënimin.

“Do ta marrim mjeshtrin Plutark deri në Senat vetëm për një bisedë të shkurtër informative”, - tha sa për t’u shfajësuar kryeushtaraku.

“Mos i shkulni mish mashkulli sa t’ia dëmtoni shtratin dhe varrin”, - ironizoi e shoqja e mjeshtrit Plutark.

Kryeushtaraku ngutazi e ktheu kokën kah ajo gati për t’i thënë *kurvë* për shtratin sikur ajo të mos e kishte shtuar edhe varrin.

Ushtarët e shtuan heshtjen prapa hidhërimit të kryeushtarakut.

Në zyrën e ngrohtë të OSCE-së ritmi i shiut të bretkosave brenda aromës dehëse të konjakut po zdirgjej kah fundi i

gjumit të Plutarkut – midis dhembjes së dhëmbit e dhembjes së mëlçisë.

Përkthyesja italiane hyri me nguti në zyrën e OSCE-së me hapa të shpejt kap Plutarku për t'ia dhënë porosinë e gjeneralit italian. Ajo e pa Teutën me duar të lidhura rreth barkut plot ngërçe me frikë se do t'ia ndëgjojë bisedën me Plutarkun. Kaloj përfaqësues Teutës nëpër rrugën e kohës tjetër kur Ambasadori roman ra në sytë e ftohtë të Mbretëreshës Teutë. Kjo rrugë e përkthyeses italiane i zgjati të dy dhembjet e Plutarkut.

Përkthyeses italiane i ra brtku për ta zënë pyetjen e gjeneralit italian: në cilën anë të horizontit është gjurmuar syri i ftohtë i Mbretëreshës Teutë, shiu i bretkosave, rrugët e gjeneralisimunit Stalin, kolonelit jugosllav, Ambasadorit roman?

Teuta i kuptoi të dy dhembjet e Plutarkut deri sa po i fliste Gjergjit me katër emra:

“Gjenerali italian po përpiket ta kuptojë rrugën e gjeneralisimunit Stalin e të kolonelit jugosllav nën shiun e bretkosave tek ky rrip kaq i hollë toke midis Kosovës e Shqipërisë.”

Aty po ndodhte heshtja e Skënderbeut të sjellë nga Tirana bashkë me gjeneralisimunit Stalin për t'ia vënë ndesh Skënderbeut të kolonelit jugosllav. Stalini i ngujuar në dengun e gazetës *Zëri i popullit* po lektiste ta çlirojë dorën e majtë reumatike.

Hekurinën e çmontuar të Skënderbeut koloneli jugosllav po e ngarkonte në kamionë ushtarakë për të nesërmen e Prillit të Ditës së Dytë. Të nesërmen hekurina e Skënderbeut e mbushur mish breshke do t'i prijë popullit të vet nëntë kilometra rrugë nga ura T. e deri te kufiri midis Kosovës e Shqipërisë. Hekurina tjetër e Skënderbeut, e mbushur mish bretkose, e

gjeneralisimusit Stalin e grishte popullin e Kosovës drejt eksodit biblik.

“Cili je ti? Me mish breshke apo me mish bretkose po e mashtroni popullin tuaj?” – i pyeti të dy Skënderbetë Teuta duke e përcjellë rrugës së gjatë të përkthyeses italiane drejt tavolinës së Plutarkut.

Mendohet se Gjergji me katër emra paska pas thënë:

“përkthyesja italiane, sipas porosisë së gjeneralit e pyeti Plutarkun se a u vra Ambasadori apo ra në sytë e ftohtë të Mbretëreshës Teutë?”

Teuta e kuptoi se Skënderbeu shprehu dyshim të qëllimshëm në moralin e saj krejt afër fjalës *kurvë*.

“Atij i kanë shkoqur mish mashkulli”, - Teuta bëri me dorë kah Plutarku. “Ty të kenë mbushur me mish breshke e mish bretkose.” “Mendon se kutërbimi i mishit të prishur të bretkosës dhe të mishit të breshkës brenda hekurinës sime të nxehtë e nxit të vjellurit e popullit?” – pa e menduar përgjigjen e Teutës paskësh pyetur Skënderbeu.

“Saktësisht! E sheh si po vjell shoqja jonë e klasës?” – i tha Teuta.

“E ke fjalën për Bendisën?” – e pyeti Gjergji me katër emra.

“Po.”

Përkthyesja italiane ende pa e sosur rrugën deri tek tavolina e Plutarkut, kryeushtaraku i togës së ushtrisë romane u rrek ta pikasë mendimin e konsullit roman. Ushtarët me kufomën e mjeshtrit Plutark në lektisje po shkonin drejt Senatit.

Në zyrën e konsullit roman era e morfinës i dëboi ushtarët para se konsulli ta kishte pyetur mjeshttrin Plutark:

“Në librin tënd paskuinë, të pabotuar, ti mendon se Ambasadori ynë piku në syrin e ftohtë të Mbretëreshës Teutë?” Mjeshtri Plutark sikur paskësh dashur t’i bie rrotull rrugës së fjalëve, foli:

“Edhe rënia e Ambasadorit tonë në syrin e ftohtë të Mbretëreshës Teutë i çelë rrugë ushtrisë romane ta nxjerrë nga atje.”

“Në të katërt anët e horizontit të tokës së Mbretëreshës Teutë, ushtria jonë e ka shtrirë Trekëndëshin e Platonit-Sokrat për ta zbuluar kufomën e Ambasadorit”, - konsulli foli me hidhërim.

“Ku ta vendosin Ambasadorin tonë? Ta vendosin në lapidar apo ta vrasin në sytë e turpshëm të Mbretëreshës Teutë?” – sikur i zgjodhi të dy rrugët mjeshtri Plutark.

“A ke zbuluar rrugë të tretë për librin tënd paskuinë?” – sikur përfundoi konsulli.

Mjeshtri Plutarku vetëm heshti.

Era e morfinës u rrit në zyrën e konsullit midis kirurgut e mjeshtrit Plutark. Këmisha e ngritur rreth kokës së mjeshtrit Plutark e trashi errësirën. Ende pa ia hudhur gjumin e dytë brenda këmishës së hudhur rreth kokës kufoma e mjeshtrit Plutark ra në urdhrin e prerë të konsullit.

“Le të hiqet mish mashkulli nga kjo kufomë deri tek harresa e syve të ftohtë të Mbretëreshës Teutë!”

Pas gjumit të dytë brenda këmishës së ngritur rreth kokës së kufomës, mjeshtri Plutark ra mbi shtratin paskuinë pa dhembjen e dhëmballës e dhembjen e mëlçisë.

Teuta e përcolli me vëmendje zvarritjen e përkthyeses italiane përgjatë gjithë zyrës së OSCE-së deri tek kufoma e Plutarkut të mbytur në duhmën e konjakut. E lakmonte me ngulm klithjen e përkthyeses italiane kur të vijë në vizitën e parë e shoqja e Plutarkut. E pa të shoqen e Plutarkut kur e futi dorën thellë nën mbulojën e kufomës së mjeshtrit Plutark tek dyshonte t’i kenë zhvatur shumë mish mashkulli.

“Këtu po munguaka penisi! Ja paskeni prishur kufomën!” – klithi në kupë të qiellit e shoqja e Plutarkut.

Konsulli roman e heshti vëmendjen në fytyrën e zverdhur të kufomës së mjeshtrit Plutark pas klithjes së dhembshme të asaj gruaje.

Në fund të rrugës, përgjatë zyrës së OSCE-së, tek tavolina e Plutarkut, e priti shikimi i Teutës përkthyesen italiane të molisur pas asaj klithme. Përkthyesja italiane e solli hezitimin tek tavolina e Plutarkut se a mund të pikë kufoma e mashkullit në sytë e ftohtë të Mbretëreshës Teutë?

Teuta e pa trishtimin e thellë të të shoqes së Plutarkut në sytë e përkthyeses italiane. Triumfalisht e përplasi shikimin mbi fytyrën e Gjergjit me katër emra. Ai u bë sikur i paskësh pas thënë Teutës:

“Ambasadorit roman, jo mjeshtrit Plutark, ka qenë dushur t’i zhvatet mishi mashkulli.”

Në gjuhën e tij rrinte varë fjala *kurvë* për Mbretëreshën Teutë. Teuta po rrekej të dilte nga shikimi i Gjergjit me katër emra andej kah po fliste profesori vjenez:

“Atë natë shianike Ambasadori roman arriti vonë para dyerve të Romës së vet.”

“Do të thuash se Ambasadori u kthye gjallë në Romë?” – i shkëlqyen sytë gjeneralit italian duke e shkundur mantelin ushtarak nga shiu i bretkosave.

“Gjallë e shëndoshë u kthye Ambasadori në Romë”, - ngacmoi profesori vjenez.

“Ju gjermanët mendoni ta ktheni Ambasadorin gjallë në Romë të turpëruar”, - ironizoi gjenerali italian.

Në fund të rrugës së përkthyeses italiane Teuta e pa shikimin prej maceje të egërsuar në sytë e të shoqes së Plutarkut, atë shikim urrejtës të gruas kundër gruas. Teuta e kuptoi se këtë shikim kaq urrejtës e arriti edhe Gjergji me katër emra; bile edhe mund ta ketë dëgjuar kur e shoqja e Plutarkut ia shkrehu në fytyrë konsullit roman:

“I zхватët mish mashkulli Plutarkut të varfër vetëm pse ai Ambasadori juaj u tarahit me atë Mbretëreshën Teutë.”

“Ambasadorin tonë e ka vrarë ajo Mbretëresha Teutë”, - zbriti nga heshtja konsulli roman.

“Mos iu gëzo akuzës kundër Mbretëreshës Teutë”, - i foli Gjergjit me katër emra profesori. “Ambasadori u kthye shëndoshë në Romë; ai shpëtoi nga sytë e ftohtë të Mbretëreshës dhe nga thika e ftohtë e saj.”

“Asnjëherë, hiç, asnjëherë.”

Atë natë shianike, roja e dyerve të Romës e praptoi rrugën e Ambasadori roman deri tek agsholi i mëngjesit. Urdhri ogur i rojës e ngurosi Ambasadorin roman në majë të kalit. Vetëm në fillim të urdhrit Ambasadori deshi të kapë diç në mendjen e ujësavtë nga i gjithë ai rrebesh shiu. Iu bë sikur nata e fillimit të misionit tek Mbretëresha Teutë do të kishte vazhduar përjetësisht po mos të kishte kërkëlluar dera e madhe e Romës. Dy pishtarë sikur u shkëputën, para të tjerëve, drejt Ambasadorit roman, me zërin grishës për të lëvizur drejt dyerve të Romës.

Ambasadori roman e hetoi ogurin para se të thotë:

“Ende qenka larg mëngjesi i Prillit të Ditës së Dytë.”

Pa i rënë në fund të Prillit të Ditës së Dytë potkonjtë e kalit të tij troklluan në kalldrëm, brenda dyerve të Romës. Ai u përpoq të kuptojë kush e ngashnjente aq ogurzisht kalin e tij kah ajo rrugicë e ngushtë, gjithnjë duke u shndërruar në tunel derisa mbeti jashtë shiu i bretkosave. Tashmë heshtja hyri nën potkonjtë e kalit të Ambasadorit roman. Ecejakja u shndërrua në rrshqitje drejt dyerve të mbyllura vetëm kur kali i tij ndaloi, aq papritmas, Ambasadori e kuptoi se gjithë kohën paskësh udhëtuar kaluar. Krejt kot iu shfaq ai mendimi se kali e sfidon magjepsjen. Tashmë rruga u sos.

“Je vonuar”, - i tha konsulli roman.

Ishte mision i vështirë”, - gati u arsyetua Ambasadori.

“Ushtri e perandorisë e zvarriti nisjen për në tokën e Mbretëreshës Teutë duke e pritur kthimin tënd nga ai mision i mallkuar”, - e qortoi konsulli.

Ambasadori roman gati e kuptoi fajin e vet brenda heshtjes së qëllimtë të konsullit. Heshtja e konsullit gati e kishte zbuluar dënimin zyrtar tashmë të përfunduar në të gjitha dokumentet zyrtare, bile edhe në librin e Plutarkut.

Njeriut të vdekur po iu tek të dalë nga vdekja zyrtare bëhet i rrezikshëm për miq e shokë mbi varrin e vet të dytë sërish të hapur nga pushteti shtetëror, Ambasadori roman vetëm sa deshi ta provojë vonesën e vet midis syve të ftohtë të Mbretëreshës Teutë kur mjeshtri Plutark sipas Trekëndëshit të Platonit-Sokrat u detyrua ta shpallë vdekjen zyrtare: Mbretëresha Teutë jo me sytë e saj të ftohtë, por me thikën e saj të ftohtë, e vrau Ambasadorin.

Në fund të raportit zyrtar të mjeshtrit Plutark Senati i Madh i Romës e lidhi mallkimin zyrtar në Mitrën e Mbretëreshës Teutë:

“Le të ndalohet pjellja e saj! Menstruacionet e Mbretëreshës Teutë të mbesin të ngujuara në mitrën e saj deri tek pëlçitja e barkut të saj!”

Në fund të librit zyrtar të mjeshtrit Plutark konsulli roman i tha: “Poezia dhe gratë mashtrojnë para çdo fjale.”

Gjergji me katër emra, pas fjalëve të konsullit roman, zbriti triumfalisht nga sytë e ftohtë të Mbretëreshës Teutë, për afër gruas së mjeshtrit Plutark, deri tek përkthyesja italiane në zyrën e OSCE-së. Plutarku po sharronte plogësht në erën dehëse të konjakut.

Teuta e kuptoi trishtimin e përkthyeses italiane deri tek mllefi i gruas së mjeshtrit Plutark. Ajo deshi ta kuptojë pse i hoqën aq shumë mish mashkulli Plutarkut të varfër: për mashtrimin

poetik të syve apo për thikën e vdekjes së vonuar të Ambasadorit.

Konsulli roman e pyeti Ambasadorin teksa po dilte nga zyra e OSCE-së:

“A provove ta shtrish Trekëndëshin e Platonit-Sokrat tek dyert e Romës?”

“Po. Ishte shi i rrëmbyeshëm bretkosash”, - u përgjigj Ambasadori.

“Cilat kënde të Trekëndëshit të Platonit-Sokrat ranë brenda Romës e cilat mbetën jashtë?” – sulustrisi konsulli roman.

“Këndet e shtetit e të pushtetit të Platonit-Sokrat ranë brenda mureve të Romës, deri tek koloseumi. Këndi i tretë, ai i popullit të Platonit-Sokrat mbeti jashtë mureve të Romës, në shiun e bretkosave”, - paskësh folur Ambasadori roman.

“Populli i Romës, nga jashtë mureve të qytetit e ka marrë vesh vonesën tënde në sytë e ftohtë të Mbretëreshës Teutë. Çdo pushtetari të Trekëndëshit të Platonit-Sokrat i ndalohet rrëshqitja kah populli i Platonit-Sokrat. Po rrëshqiti ky pushtetar kah populli, Platoni-Sokrat e dënon me vdekje”, - sqaroi konsulli roman.

“Ju romanët e braktisët mjeshtrinë e mbushjes së plagës me mish qeni”, - e talli gjeneralin italian profesori.

Konsulli roman sikur e heshti mendimin mbi mishin e qenit; ia la përpara në tavolinë Ambasadorit roman thikën dhe shpatën.

“Për vdekjen tënde zyrtare zgjedhe cilën të duash: thikën apo shpatën. Funeralin tënd madhështor qeveria e ka bërë atëherë kur e sollëm kufomën tënde nga toka e Mbretëreshës Teutë. Ajo të vrau me thikën e saj të ftohtë. Pra, për vdekjen tënde zgjedhe thikën? Pas vdekjes sate zyrtare fëmijët dhe gruaja jote e marrin pensionin shtetëror”, - e këshilloi Ambasadorin roman konsulli.

Me të dalë konsulli roman nga kthina e errët e Ambasadorit u dëgjua nga brenda regëtima e vetvrasjes.

“E bëri”, - i tha ai tjetri konsullit.

“Po. Ambasadori vetëm e përsëriti edhe një herë vrasjen e gatshme. Në Trekëndëshin e Platonit-Sokrat çdo pushtetar do ta ketë mësuar mjeshtrinë e vetvrasjes”, - foli konsulli roman duke e lënë bodrumin e ministrisë.

“Po me Mbretëreshën Teutë ç’u bë?”- pyeti ai tjetri ndrojtshëm.

heshtja e trashë e konsullit roman krisi nga tehu i ftohtë i metalit:

“Ambasadorin tonë e vrau Mbretëresha Teutë, bile disa herë.”

“Ç’vdekje e përzgatur qenka bërë!” – mezi arriti të thotë ai tjetri, krejt në fund.

Konsulli e ktheu kokën andej kah erdhën fjalët e skeletit të mbetur në shkallë pa ditur se i tha atij tjetrit:

ushedi nga kur është harruar ky skelet këtu.”

Në sallën ovale të Minsitrisë së Punëve të Brendshme konsulli roman arriti krejtësisht vetëm. I kishin thënë se Mbretëresha Teutë do ta përsëriste abortin brenda menstruacioneve kronike. Gjysmëhapja e derës së mbështjellë në agsholin e Prillit të Ditës së Dytë e solli fëshfëritjen nga tyli. Kudo në ajër, rreth vetes, konsulli e ndjeu misterin e lodhjes së gjakut. Midis lodhjes së gjakut e fëshfëritjes së fustanit po kutërbonte hardhuca. Era e rëndë e morfinës e përshkoi sallën ovale të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Pastaj konsulli i dalloj hijet lëvizëse nëpër agsholin e Prillit të Ditës së Dytë. Flisnin me njëra-tjetrën me pëshpëritje të çjerrë nga ftohja e grykës. Vetëm atëherë konsulli roman u kujtua se në bodrumet e Ministrisë ka shumë lagështi.

Dikush nga to hije arriti të thotë:

“Sa vjet mund të ketë qëndruar ky konsull këtu i kapluar nga pezhishka e merimangës?”

“Sikur e ka pritur dikënd”, - u ngut ai tjetri.

Konsulli roman deshi të thotë se po i priste ata po mos t’iu mbyt zëri në gjoksin e bërë zguhur. E dëgjoi veten se si fliste përtej Ambasadorit roman.

Era e rëndë e morfinës po trashej veshullisht përgjatë fustanit të Mbretëreshës Teutë ndërsa ajo po binte në gjumin e parë.

“Futni gjak hardhuce në mitër!” – urdhëroi kryemjeku.

brenda fustanit të mbështjellë rreth kokës së Mbretëreshës Teutë ia hudhën gjumin e dytë. Mbretëresha sharroi në gjakun e spërlagur të hardhucës.

“E vëretë! Plotësisht e vërtetë! Gjaku i spërlagur i hardhucës në mitrën e Mbretëreshës Teutë e rrudh fetusin për të mos lindur kurrë. Kësaj mbretëreshe i ndalohet pjellja sipas pllakëzave të vëna në kofshat e grave të reja të vitit një mijë e nëntëqind e pesëmbëdhjetë”, - paskësh folur profesori vjenez.

Konsulli roman nga përtej vejtëve të merimangës e notoi gajkun e hardhucës brenda menstruacioneve të Mbretëreshës Teutë deri te Trekëndëshi arketip i fetusit arketip;

U bë mbrëmje e kuqe gjaku kur konsulli i dehur gjakut të hardhucës qëndroi para derës së Mbretëreshës Teutë.

Deshi t’i dallojë fëmijët nga të rriturit; më kot çdo krijesë ishte bërë arketipe para dyerve të Mbretëreshës.

“Shtoni edhe më gjak hardhuce në mitrën e saj!” – urdhëroi kryemjeku.

Konsulli roman deshi ta hapë derën e Mbretëreshës Teutë kur në mbrëmjen e kuqe gjak i sëmboi në gjoks maja e mprehtë e metalit vezullues. Ai mendoi të rrëzohej para plagës së gjoksit.

“Plaga e hapur pa gjak përjashtohet nga proceset gjyqësore”, - i tha mjekut administratori i heshtur.

Administratori roman e kërkoi raportin zyrtar për llojin e plagës në gjoksin e konsullit roman. Raporti zyrtar do ta caktonte se cilën anë të rënies e kishte marrë plaga e konsullit në çastin e rrëzimit.

Arketipi në mitrën e Mbretëreshës Teutë mëton të arrijë tek dera e kazermës së kolonelit jugosllav, të arrijë tek derë e gjyqit evropian, te senati roman, tek soses rruga e Rabii Johanen ben Zakait.

“Shtoni sërish gjak hardhuce në mitrën e Mbretëreshës Teutë. Le ta kapërcejë rrugën e mishit të qenit të Rabii Johanen ben Zakait”, - urdhëroi kryemjeku.

Në gjoksin e konsullit plagavezulluese e hekurit e kishte humbur gjurmën e gjakut nga plagosja e tij në pluhur. Atëherë kryemjeku e kuptoi mëtesën e kryeadministratorit roman se duhej hudhur gjak hardhuce mitrës së Mbretëreshës Teutë dhe plagës së konsullit roman.

E kuqja e rritur me gjak hardhuce në menstruacionet e Mbretëreshës e mund të kuqen tek gjoksi i konsullit roman në raportin zyrtar të administratorit...

Atëherë kryemjeku e pakësoi gjakun e hardhucës në mitrën e Mbretëreshës Teutë derisa administratori e lexoi raportin zyrtar në librin e Plutarkut.

“Mbrëmja u bë e kuqe gjak pas dy netëve galduese të Ambasadorit në parzmën e Mbretëreshës Teutë. Që në mëngjesin e asaj dite Ambasadori roman e kishte harruar tendën e delegacionit, i përhumbur fushës së vetmuar.

Në fusnotën e raportit të Plutarkut shkruante se Ambasadori roman shumë ditë u sorollat] fushave të vetmuara i kapërthyer nga amoku i Mbretëreshës. Duke e lakmuar mbrëmjen e kuqe gjak Ambasadori roman e çoi dorën te reza e derës së Mbretëreshës përtej shurdhimit të gjakut. Ambasadori eci i përthunur nëpër oborrin e Mbretëreshës deri tek vezullimi i dy

majave të mprehta të metalit lakmitar në gjoksin e tij. Trupi i Ambasadori roman

deri tek vezullimi i dy majave të mprehta të metalit lakmitar në gjoksin e tij. trupi i Ambasadorit roman ende po rrëzohej kundruall komisionit të gjeneralit roman.

“Kush u vra? U vra konsulli apo ambasadori roman?” - pyeti profesori vjenez gjeneralin italian. “A i niset ushtritë romane drejt Mbretëreshës Teutë pas të gjitha vrasjeve të Ambasadorit tuaj?”

Në prehrin e skeletit të konsullit roman Administratori e gjeti të përfunduar raportin zyrtar për të shtatën vrasje të Ambasadorit roman:

“Atë mbrëmje të kuqe gjak Ambasadori roman e kishte kapur rezen e derës së Mbretëreshës Teutë. Në nismë të oborrit dy maje vezulluese u kapën gjarpërisht tek gjoksi i Ambasadorit. Komisioni ushtarak, po atë mbrëmje të kuqe gjak, i shënoi të dy plagët e Ambasadorit të fshehura në menstruacionet e Mbretëreshës.”

“Kush u vra në mitrën e Mbretëreshës?” – u egërsua profesori vjenez. “Nise drejt Mbretëreshës Teutë ushtrinë romane se po u vonove plagët e kuqe të Ambasadorit roman do të mbyten në menstruacionet e asaj Mbretëreshë.”

Raporti zyrtar i mjeshtrit Plutark vazhdon:

“Plagët e Ambasadorit roman atë mbrëmje qenë më të kuqe se menstruacionet e Mbretëreshës Teutë. Komisioni ushtarak po atë mbrëmje e mati oborrin e Mbretëreshës me Trekëndëshin e Platonit-Sokrat.”

Në raportin ushtarak dërguar konsiliumit mjekësor në Romë, urdhërohet:

“Në fund të gjumit të dytë të Mbretëreshës Teutë gropat e mishit të saj të mbushen me menstruacione kronike. Populli arketip i saj le të ngujohet në menstruacionet e Mbretëreshës së

vet siç u ngujua Rabii Johanan ben Zakai në mishin e këlyshit të konesë së Danielit!”

“Po Rabii Johanan ben Zakai nëpër mishin e këlyshit të konesë së Danielit, nëpër mishin e Mefistos, nëpër mishin e Insektit të Gregor Zanzës e shpuri popullin e vet deri tek Shtegu i Oregonit atje tek fillon Logosi biodemokratik amerikan”, - i paskësh thënë profesori vjenez gjeneralit italian.

Gjenerali italian edhe pse e ndau mendjen t’ia thotë atë fjalën *kurvë* Teutës së zverdhur dhembjesh, me duar të lidhura rreth fundit të barkut, hoqi dorë. Ajo po gjurmonte me sy një dorë femre për ta nxjerrë nga dhembjet e lindjes së fëmijës.

Shiu i bretkosave e kishte rritur llucën deri tek puplat e grave kosovare ndesh atij raportit të Komisionit të Romës, ndesh ngujimit të menstruacioneve në barkun e Mbretëreshës Teutë...Mbrëmja e kuqe gjak e Komisionit roman në oborrin e Mbretëreshës filloi të mugëtohet deri tek çjerrja e profesorit vjenez:

“Dilni të gjithë nga ajo zgafellë e quajtur zyra e OSCE-së! Le të dalë e gjithë Evropa tek shiu i bretkosave e të shohë se pas goditjes së raketës *Tomahok* Mbretëresha Teutë po e lind fëmijën e parë pas dy mijë vjetësh.”

Përgjatë zyrës së OSCE-së, evropianët kaluan përafër John Harkerit drejt shiut të bretkosave deri tek çjerrja e gruas kosovare:

“Mbretëreshën e kanë zënë dhembjet e fëmijës.”

Në fund të çjerrjes së gruas kosovare, Qepa e Madhe e zbriti nga buzët e trasha John Harkerin në cegmën (cemtësinë?) e Logosit evropian.

“Ti je harruar sonte në buzët e ngrohta të Kikakos sate edhe kur Mbretëreshën Teutë e kanë zënë dhembjet e lindjes së fëmijës”, - e qortoi Qepa e Madhe.

“Mbretëresha Teutë po e lind fëmijën e parë në fund të dy mijë vjetësh pas goditjes së raketës *Tomahok*. Kjo raketë i ka çarë shtatë seanca mallkimesh të shtatë perandorive mbi mitrën e Mbretëreshës Teutë”, - foli John Harkeri duke e nxjerrë nga xhepi celularin-hardhucë.

Në dritën e xixëllonjës ngordhaqe mezi e lexoi hidhërimin e Ashli Harkerit:

“Pse vetëm ti po hyn në zonën e kuqe të kurvave ballkanike?”

Qepa e Madhe e zuri në fund hidhërimin e Ashli Harkerit, pak para se të shuhej drita e zvetënuar e xixëllonjës në barkun e celularit-hardhucë.

“Johni i vogël ka rënë në fund të sëmundjes. Orë të tëra ka qëndruar në ballë të pronës sonë të re me Bibël në dorë kundruall Bizonit mospërfillës për ta lidhur me vargjet nëntëmbëdhjetë e njëzet të Zanafillës.”

“Sa hakmarrëse është kjo zonja Ashli!” – e mendoj apo e tha Qepa e Madhe pasi e vuri syrin e madh në syrin e John Harkerit. “Vëllezërit e mi, po edhe djemtë e fisit Su, në San Luis ranë deri në gjumin e dytë brenda këmishave të tyre të ngritura mbi kokë. Të tretën ditë, nëpër erën e athët të morfinës erdhën djemtë e Apaçëve, Çerokëve, Sujukësve, deri tek katër djemtë e Ariut të Kuq. Ua uruan plagët e reja para se të sharrojnë në plagët e tyre.

Edhe Li edhe Vitmani dështuan para ngulmimit të katërt vëllezërve të mi për t’i gjetur në Bibël: Bizonin, Misrin dhe Ariun e Kuq”, - foli Qepa e Madhe brenda gacës së syrit rrëzë malit tikako derisa John Harkerin po e zinte bishtin e hidhërimin të të shoqes në dritën e zvetënuar të celularit-hardhucë.

John Harkerin e shtrengoi mantelin, e futi kacurrin në kokë për t’u mbrojtur nga shiu i bretkosave tek kufiri Shqipëri-Kosovë kur dikush e preku me bërryl.

Ishte profesori.

Së pari John Harkeri ia dalloi vetëm lëvizjen e buzëve nën shiun e bretkosave para se t'ia dëgjojnë edhe fjalët e profesorit vjenez.

“Prej mbrëmjes së kuqe gjak të ambasadorit roman e deri tek ky shi i bretkosave, shtatë perandori popullin kosovar e kanë ngjuar, njëra pas tjetrës, në mitrën e Mbretëreshës Teutë. Ngujimi dymijëvjeçar i kosovarëve në mitrën e Mbretëreshës Teutë e ka ruajtur metabolizmin arketip deri tek prilli i Ditës së Dytë të *Tomahokut* tënd”, - nëpër shiun e bretkosave i paskësh thënë profesori vjenez John Harkerit.

“Ti do të thuash se rruga e kosovarëve nëpër shtatë ngujimet në mitrën e Mbretëreshës Teutë i përngjet ngujimit të Rabiit Johanen ben Zakait në mishin e këlyshit të Kones së Danielit, në mishin e Mefistos, në mishin e Insektit të Gregor Zanzës deri tek Shtegu i Oregonit?” – paskësh pyetur John Harkeri.

“Saktësisht”, - u përgjigj profesori. “Natën e stuhishme të Jerusalemit Tribali i Madh e zgjodhi rrugën e vdekjes kolektive, e zgjodhi rrugën e asaj përrallës arushake të Davidit kundër Goliatit. Tribali i Madh, i kapërthyer nga amoku i luftës, i besonte gurit të hobesë së Davidit në ballin e perandorisë goliatë të Romës.”

“Atëherë Rabiit Johanen ben Zakai e paska zgjedhur rrugën e jetës, atë rrugën e Mojsiut, jo rrugën e përrallës arushake të Davidit?”

“Saktësisht”, - mezi paskësh pritur të flasë profesori. “Rabiit Johanen ben Zakai atë natën e stuhishme të Jerusalemit e pa se Tribali i Madh e kishte rrokur amoku i vetëvrasjes kolektive kundër Goliatit roman. Rabiit e zgjodhi rrugën e profecisë së Hyut, drejt Tokës së Premtuar duke u mishëruar nga shtatë perandori nëpër mishin e këlyshit të Kones së Danielit, nëpër mishin e Mefistos, nëpër mishin e Insektit të Gregor Zanzës

deri tek Shtegu i Oregonit, atje ku zë fill Logosi biodemokratik amerikan.

Ku do ta kishte gjetur Amerika jote pas dymijë vjetësh Izraelin po të ishte realizuar amoku luftarak i Tribalit të Madh atë natë të stuhishme në Jerusalem?”

“Ti vërteton se kosovarët sot, në Prillin e Ditës së Dytë, pas dy mijë vjetësh, po e sosin ngujimin e shtatëhershëm, aty ku e sosi Rabii Johanan ben Zakai, tek Shtegu i Oregonit, tek zë fill Logosi biodemokratik amerikan?” – John Harkeri e paskësh pyetur profesorin.

“Po”, - u ngut të flasë profesori. “Në pllakëzat tona të vitit një mijë e nëntëqind e pesëmbëdhjetë të vëna në kofshat e grave të reja më kot e kemi ngacmuar mitrën e Mbretëreshës Teutë. Atëherë ne, Komisioni austriak, e pamë Rabii Johanan ben Zakain të fshehur në tri lloj mishrash krejt njësoj sikur ngujimin e shatëfishtë të kosovarëve.”

“Vetëm popujt e ngjuar po e kërkuakan shpëtimin tek Shtegu i Oregonit”, - konstatoi John Harkeri duke e ndjerë hukamën e padurimit të profesorit:

“Po. Logosi biodemokratik e gjen shpëtimin e popujve të robëruar. Popujt gjysmë të lirë evropian e konsiderojnë robëri Shtegun e Oregonit, tek zë fill Logosi biodemokratik amerikan.”

“Amerikanët, vetë, si arritën tek Shtegu i Oregonit të tyre?” – këtë herë në zërin e John Harkerit ngeci diç.

“Gabimi i Hegelit mbi lirinë e të gjithë gjermanëve u pa në të dy luftërat evropiane. Mua, vetë, më mungoi liria gjermane në kohën e nacizmit; u detyrova të emigrojë në Angli për ta shpëtuar kokën time të thinjur”, - foli plot mëllëf profesori vjenez.

“Po amerikanët si arritën tek Shtegu i Oregonit të tyre?” – sërish pyeti profesori.

Tashmë profesori, i ndezur, heshti për një çast për të shpërthyer:

“Anglezët e inisiativës së lirë u shkëputën nga Logosi i Trekëndëshit të Platonit-Sokrat , një mijë vjet e kapërcyen Atlantikun drejt Tokës së Re. Në fund të stuhisë njëmijëvjeçare anija *Fover* dha shpirt para bregut të thepisur të Plimuthit.

kur gjysma e ekuipazhit të anijes *Flover* dhe shpirt para dimrit të egër John Harkeri vajti tek tenda e kryetarit të Sujuksëve.

Ariu i Kuq, i mbështjellë në lëkurë të bizonit dëgjoji me vëmendje kur John Harkeri i kishte thënë:

“Unë heq dorë nga Trekëndëshi i Platonit-Sokrat, unë heq dorë nga tempujt fetarë, unë heq dorë nga pushteti shtetëror, unë heq dorë nga...vetëm mësom ta mbijetoj këtë dimër të egër.”

Ende pa i sosur fjalët, John Harkeri para Ariut të Kuq hipur mbi kalin e djersitur, kasneci po vraponte drejt Tribalit të Madh të Evropës për ta dhënë lajmin ogur(mirë?):

“John Harkeri e mohoi çdo gjë evropiane para kryetarit të sujukësve; e mohoi atdheun, e mohoi tempullin, e mohoi fenë, ...”

Tribali i Madh evropian e dënoi tradhtinë e John Harkerit:

“Le të ngujohet John Harkeri në mishin e kafshës jashtëbiblike, le të ngujohet në bimën jashtëbiblike, le të ngujohet në mishin e njeriut të egër jashtëbiblike!”

Në fund të mallkimit të Tribalit të Madh evropian John Harkeri i paskësh thënë kryetarit të sujukësve:

“Sa ma shet viçin e palindur të Lopës sate të shtatë?”

Ariu i Kuq me pritesë dimërore e pyeti John Harkerin:

“Cilin viç të Lopës sime të shtatë do ta blesh? Kjo lopë ende është bars.”

“Kur të pjellë lopa jote e shtatë do ta lindë një viç të kuq me tri pika të bardha në ballë. Atë viç kërkoj ta blej. Në atë viç të lopës sate të shtatë më ka ngjuar Tribali i Madh evropian.

Ditën e parë do ta therrësh; do të më shpëtosh”, - ia shpjegoi John Harkeri kryetarit të sujukësve.

Ariu i Kuq pa dhënë asfarë shenje se e kuptoi bisedën e John Harkerit, e pyeti:

“Sa do të paguash për viçin e lopës sime të shtatë?”

John Harkeri ia ofroi dy pasqyra me korniza të bukura për viçin ende të palindur të lopës së shtatë.

Ariu i Kuq pasi i shikoi me kureshtje dy pasqyrat e bukura i dha shenjë John Harkerit edhe për një tjetër: i kërkoi gjithsej tri pasqyra.

në fund të marrëveshjes për çmimin e viçit të lopës së shtatë John Harkeri e pyeti Ariun e Kuq:

“A mund ta therrësh viçin viçin ekuq me tri pika të bardha në ballë posa ta pjellë lopa jote e shtatë?”

Ariu i Kuq, krejt i qetë, ia dha shenjën e miratimit plot zell. Nata e cemtë po zbriste prej majës së Malit Tikako mbi borigat borake kur Qepa e Madhe u tremb nga zëri i vetvetes së John Harkerit:

“Rabii Johanen ben Zakai u nis kah Shtegu i Oregonit.”

“Shtegu i Oregonit të shpie tjetërkund nga Evropa”, - ndërhyri në vetvete profesori vjenez.

Lopa e shtatë e Ariut të Kuq e paskësh pjellë viçin e kuq me tri pika (të bardha?) në ballë Prillin e Ditës së Dytë, e lajmëruan Ariun e Kuq.

Ai u nis me thikë në dorë deri tek sytë e lëngshëm të lopës së vet të shtatë. Ajo po e lëpinte plot mallëngjim viçin e kuq me tri pika të bardha në ballë. Në sytë e lopës së shtatë u shfaq shqetësimi.

Para se kryetari sujuks ta zërë viçin e kuq me tri pika të bardha në ballë, nga Mali Tikako zbriti një tufan i rrëmbyeshëm. Ai e çoi shikimin kah maja e malit kur e pa hënën e re.

“Ndalohet derdhja e vetëm një pike gjaku deri tek hëna e pesëmbëdhjetë”, - e dëgjoi zërin e vetvetes Ariu i Kuq.

Sytë e lëngshëm të lopës së shtatë u qetësuan mbi viçin e kuq me tri pika të bardha në ballë.

Qepa e Madhe, e kthyer kah maja e Malit Tikako, pesëmbëdhjetë ditë u rrek t’i flasë t’et nëpërmes mishit të viçit të kuq me tri pika të bardha në ballë. Kur hëna e arriti mbrëmjen e pesëmbëdhjetë Qepa e Madhe u orvat ta rrisë hutesën e t’et. Nëpër rrezen e hënës së pesëmbëdhjetë Ariu i Kuq me thikë në dorë shkoi tek sytë e lëngshëm të lopës së shtatë. Ajo po e mëkonte viçin e saj kur vezullimi i thikës ia shpoi trupin.

Posa e zuri viçin e kuq me tri pika të bardha në ballë, Ariu i Kuq u tremb nga zëri i vetvetes së John Harkerit:

“Ke ardhur vonë, miku im, shumë vonë. Tashmë u mësova në mishin e viçit t’i fshehem Tribalit evropian tek u takova me Rabii Johanen ben Zakain. Më duhet ta bëj rrugën time nëpërmes mishit të Bizonit, nëpërmes mishit të Misrit, nëpërmes mishit të Indigjenit.”

Profesori vjenez e dëgjoi zërin e vetvetes së John Harkerit, kur e pyeti:

“Ç’u bë me Huan Garsia Gonzalesin e Amerikës latine? Nëpër cilën rrugë udhëtoi ai?”

Profesori vjenez e shpërtheu bisedën e mufatur:

“Huan Garsia Gonzalesi erdhi nga Evropa nëpër rrugën e misionarit të pushtetit shtetëror. Me vete i solli të gjitha standardet e Evropës sipas të tri kodeve të Trekëndëshit të Platonit-Sokrat. Indigjenin e San Salvadorit e ftoi tri herë sipas vargjeve: nëntëmbëdhjetë e njëzet të Zanafillës së Biblës. Pastaj, krejt kot, e detyroi Indigjenin e San Salvadorit të vrapojë rëndë nëpër Trekëndëshin e Platonit-Sokrat pa i dalluar kodet e pushtetit, të Shtetit, të Shtetarit.

Në tendën e Huan Garsia Gonzalesit e sollën Indigjenin e San Salvadorit tek u sos gjumë i parë. Rreth kokës së mbuluar të Indigjenit e hodhën morfinën e gjumit të dytë bashkë me urdhrin e Huan Garsia Gonzalesit:

“Le të hiqet sa më shumë mish mashkulli nga ky Indigjen!”
ditën e tretë, aty kah fundi i gjumit të dytë të Indigjenit, Huan Garsia Gonzalesi vajti për ta vizituar kur pa se pas tri ditësh të gjumit të dytë, Indigjeni i San Salvadorit ishte shndërruar në plak të regjur, krejt i heshtur si dru i tharë.

në fund të hidëhimit, Huan Garsia Gonzalesi zu kuvend me shpurën e vet ku ishte edhe konziliumi mjekësor:

“Kush i ka faj kësaj egërire pse gjendet kaq larg civilizimit evropian? Kjo egërisë e rëgjuar le të shpiket në gjumin e tretë!”
– urdhëroi Huan Garsia Gonzalesi për ta kuptuar të gjithë.

“U bë mbrëmje e parë në San Salvador”, - arriti të thotë profesori vjenez.

Nga thellësia e natës së cemtë të Malit Tikako nëpër mishin e viçit të kuq me tri pika të bardha në ballë zëri i vetvetes arriti deri tek John Harkeri:

“San Salvadori mbeti jashtë Shtegut të Oregonit, jashtë Logosit biodemokratik”, - paska pas folur Qepa e Madhe. “Të katërt vëllezërit e mi Ariu i Kuq i nisi për në San Luis për ta mësuar Biblën e Huan Garsia Gonzalesit. Të katër vëllezërit e mi gjakuan t’i gjejnë në Biblën e Huan Garsia Gonzalesit: Bizonin, Misrin, Indigjenin e San Salvadorit pa e kuptuar se rrugët e Biblës së Huan Garsia Gonzalesit e sjellin gjumin e dytë të morfinës, pastaj edhe atë gjumin e tretë përfundimtar.”

Nga gaca e syrit të Qepës së Madhe u nisën kah përvëlimi i syve të Teutës, pas urdhrin të profesorit, bashkë me John Harkerin, për t’i lexuar pllakëzat e vitit një mijë e nëntëqind e pesëmbëdhjetë në kofhsat e grave të reja tek matën

menstruacionet kronike të arketipit kosovar qysh nga mbrëmja e kuqe e Ambasadorit roman.

Dikur natën vonë, në raportin e vet të përngutur, gjenerali italian paska shkruar:

“Në zyrën gjermane të OSCE-së profesori vjenez e nxjerr Ambasadorin roman të klonuar në mitrën e Mbretëreshës Teutë. Ambasadori ynë paskësh qenë i përhumur atë mbrëmje kur e preku rezën e derës së Mbretëreshës Teutë. Komisioni ynë ushtarak ia paska sjellë kontrabandë në Romë vdekjen e Ambasadorit roman.

Duke dalë nga zyra e OSCE-së John Harkeri ra ndesh shikimit të gjeneralit fren deri tek shpërthimi:

“Këtij kapitenit amerikan duhet hudhur në fytyrë bashkë me këtë shi bretkosah lëkurën e sujukësve. Le ta ndjejë dhembjen e gjeneralit Koster.”

po atë natë, vonë, profesori vjenez e vazhdoi raportin për vitin një mijë e nëntëqind e pesëmbëdhjetë:

“Nën shiun e bretkosave, tek kufiri Kosovë-Shqipëri, pllakëzat tona, të vëna në kofshat e grave të reja po tregojnë sosjen e menstruacioneve dymijëvjeçare, qysh nga nata e stuhishme e Ambasadorit roman.”

Ende pa e sosur raportin e vet profesori për të tretën herë atë natë John Harkeri zbriti nga buzët e trasha të Qepës së Madhe i tunduar nga shqetësimi i saj;

“Teutën e kanë zënë dhembjet e fëmijës. Duhet vepruar shpejt me mitrën e saj siç u veprua me mitrën hebraike.”

“Në mitrën hebraike Evropa kishte futur mish qeni, mish djalli, mish insekti”, - ankoj John Harkeri.

“Mishi i këlyshit të Kones së Danielit, mishi i djallit Mefisto, mishi i Insektit të Gregor Zanzës, duhet të digjen në krematoriumet e kodeve të Platonit-Sokrat për ta nxjerrë nga

këto mishra Rabii Johanan ben Zakain!” – urdhëroi doktor Fausti.

“Prillin e Natës së Dytë i dëgjova hapat e delegacionit tuaj”, - i tha Mefistoja doktor Faustit.

...Hapat e rëndë të doktor Faustit ndaluan para kufomës së Mefistos. Kufoma e njohu kufomën. Plaga e njohu plagën. Dlegacioni hyri në kështjellë nëpër errësirën e plagës së Mefistos duke ia sharë nënën e tij hebraike.

Në muzgun e nxehtë ndodhi zallahia; në bodrumin e kështjellës xhelati kryesor nxori diç nga kufoma e Mefistos. Me duar të ngrohura gjakut, duke i sistemuar plagët e kufomës së Mefistos, me gjysmëshenjë kryexhelati u tregoi atyre dy të tjerëve për mjeshtërinë e Doktorit:

“Sa mjeshtërisht e ka mbyllur plagën në mishin e Djallit Mefisto ai Doktor Fausti.”

Ishte mbrëmje zapullore kur hapat e konsiliumit po zbritnin shkallëve të bodrumit prapa kutërbimit të morfinës.

I pari në derën gjysmë të hapur u shfaq Doktor Fausti me pyetjen hidharake (hidhnake?):

“Cilin do ta heqni sonte? Mishin e qenit, mishin e Djallit Mefisto apo mishin e Insektit të Gregor Zanzës?”

Ata dy të tjerët, të mbështjellë me gjysmerrësirë, u tkurrën edhe më pa e marrë guximin në folë. Vetëm i ndihmuan Doktor Faustit për ta hudhur gjumin e dytë brenda këmishës së ngritur rreth kokës së Mefistos.

Doktor Fausti pyeti sërish:

“Cilin mish hebre do ta shkoqim sonte? Mishin e këlyshit të Kones së Danielit, mishin e mefistos së Gëtes apo mishin e Insektit të Kafkës?”

Ata dy të tjerët heshtën pasi konstatuan se Doktor Fausti kishte ende për të thënë.

“Vetëm kështu mund ta dënojmë mitrën çifute çdo mbrëmje në skenat e teatrit evropian.”

Konsiliumi mjekësor i Doktor Faustit u ul në lozhën e Mbretit për ta parë vdekjen e Mefistos në teatrin e krematoriumit evropian.

Shkrimtari i Doktor Faustit me zë fërshëllyes e lavdëroi në veshin e Mbretit punën e konsiliumit mjekësor:

“Doktor Fausti e shkoqi nga Djalli Mefisto mishin e këlyshit të Kones së Danielit.”

Ende pa e përfunduar bisedën shkrimtari i Doktor Faustit, Mbreti e dha shenjën për fillimin e shfaqjes së madhe të Prillit të Ditës së Dytë. Turma e spektatorëve e ndezur nga amoku i vrapimit u tulat tek kodi i Tretë i Trekëndëshit të Platonit-Sokrat.

Në heshtjen e madhe të skenës evropiane u dëgjua vetëm monologu i Mefistos:

“Në grykën e zezë të plagës sime, të hapur mjshtërisht me briskun e Doktor Faustit, çdo të tretën natë thërret nëna ime hebreje. Çdo natë nëna ime hebreje më sheh duke vdekur në teatrin evropian për ta rritur lavdinë lazdrajkë të Doktor Faustit.”

Një fëmijë u çjerr sa i zuri zëri:

“Mefistoja po djersinë çurg!”

“Si mund të djersijë Djalli?!”

“Mefistoja sot e ka bërë vaksinën”, - bërtiti sërish fëmija.

“Dhembja e krahut e bëri dje Mefiston ta harrojë çantën në shkollë”, - tha mësuesi. “Fausti, ai Fausti zevzek, e kishte hapur çantën e Mefistos. Në të e kishte gjetur një prokurë me vulë të senatit roman.”

“Çka rrëmon në atë çantë të pistë hebreje?” – e pyetën fëmijët e padurueshëm.

Natën, vonë natën, Mefistos iu shtuan gjëmët e dhembjeve derisa i ati e dërgoi në spital gati të mgulfatur. Mjeku kujdestar, i përgjumur, u ngatërrua në gjininë e Mefistos. Një herë e mori për djalë, pastaj për vajzë, më në fund pyeti i inatosur: “Është djalë apo vajzë?”

Prej asaj natës së ngatërrimit të doktorit rreth gjinisë së tij, Mefistoja i shmangej orës së fizkulturës. Nxënësit filluan ta tallnin si deledash derisa i thanë:

“Mefistoja i vesh fustanet e vajzave gjatë orës së fizkulturës.”

Nëna e Margaritës së Gëtes, krejt e çakërdisur, ia çatisi në shkollë. Pas zërit të saj hakërrues, ajo hyri në dhomën e mësuesve. Në dorë e mbante fustanin e Margaritës gati të shpalosur duke u çjerrë:

“Fustani i vajzës sime kutërbon mish qeni hebre.”

Para se dikush ta përmendë drejtorin ajo u gjend në zyrën e tij:

“Juve zonjë, u ka sjellë ndonjë hall i madh?” – foli drejtori me mirësjellje.

“Po bëhen gjashtë ditë nga dita e diel, e gjaku i këlyshit të Kones së Danielit sa po vjen më i kuq në fustanin e vajzës sime”, - e shkrehu pezmin e pqrë nëna e Margaritës së Gëtes.

“Gjaku i këlyshit të Kones së Danielit në fustanin e Mrgaritës do t’ia humbë asaj menstruacionet.”

“Rabii Johanan ben Zakai natën e stuhishme të luftës iku nga Jerusalemi”, - drejtori i foli Johan Volfgang Gëtes së zhytur në histerinë e nënës së Margaritës. Rabii çifut atë natë shkoi tek tenda e gjeneralit roman. I tha gjeneralit;

“Unë, Rabii Johanan ben Zakai, heq dorë nga feja ime; unë heq dorë nga tempulli im; unë heq dorë nga atdheu im; unë kërkoj nga Roma të ma lejojë themelimin e universitetit hebre në Diasporë...”

Në midis të bisedës së drejtorit Johan Wolfgang Gëtes i vezulluan sytë e nënës së Margaritës sikur e lektisi vazhdimin e tregimit.

...Natën, vonë, nga shkalla e gjeneralit roman në Judejë dolën kuaj duke tërfatur nga afshi i rrugës së gjatë. Në fillim e rrokën trokun, pastaj e rritën galopin për ta zënë, në fund, vrapin drejt Romës. Deri vonë atë natë të stuhishme u dëgjuan trokëllimat (troku i?) e kuajve; lajmi ogur (zi, mirë?) po udhëtonte drejt Romës nga Jerusalemi.

Kur nata sterrë u bë e vetvetes, gjenerali roman në heshtjen e tendës së vet e shqyrtoi mendjen në ia kishte thënë të gjitha Mark Sumit, para se ai të niset nga Jerusalemi për në Romë. Mark Sumi i shuar gjuhës mezi u shkëput nga errësira e thukët tek gojëdera e hapur e tendës së gjeneralit roman. Vetëm kur e bëri hapin e parë për të hyrë në tendë krejt afër fytyrës e ndjeu bezdinë e rojave të gjeneralit roman. Prapa dritës së pishtarit në tendë hyri gjenerali bashkë me erën e rëndë të morfinës duke thënë ngutazi:

“Ky njeri e paska bërë rrugën e largët të kohës së durimit.”

Në midis të kutërbimit të naftalinës, ende pa e përfunduar shenjën ushtarake gjenerali roman, u shfaq konsiliumi i përgjumshëm ushtarak. Mbi kokën e Mrk Sumit, të mbështjellë me këmishë, konsiliumi i mjekëve ushtarakë e hudhi gjumin e dytë. Era e morfinës bashkë me gjumin e dytë rrëshqitën në fund të këmbëve të Mark Sumit.

Tek soset gjumi i dytë kryemjeku i konsiliumit ushtarak i tha gjeneralit roman:

“Edhe gjumi i dytë i rrëshqiti në fund të këmbëve.”

Gjenerali roman në fund të rrugës së zemërimit arriti t’i thotë kryemjekut ushtarak:

“Mark Sumi le të udhëtojë tek Tribali i Madh çifut në Jerusalem. Ta sjellë lajmin e saktë për kërkesën e Rabii Johanen ben Zakait!”

Në fund të rrugës së Kohës Mark Sumi arriti tek drita hidhharake (hidhnake?) e Tribalit të Madh në Jerusalem krahas rojës sçifute:

“Po vjen njeriu i Romës!”

Mark Sumi e kuptoi sa rrugë të gjatë kishte bërë kur e dëgjoji urdhrin kumbues të Rabii ben Shimonit nga Tribali i Madh i Jerusalem:

“Le të hyjë në Tribalin e Madh njeriu i Romës!”

Ende pa e përshkuar nëpër vetvete mendimin e krisur në kokë dikush paskësh thënë në hebraishte:

“Shumë kohë paska pritur njeriu i Romës para dyerve të Jerusalem deri përtej çdo pleqërie!”

Mark Sumi e përshkoi vetveten derisa e zbuloi në Tribalin e Madh të Jerusalem zërin e trishtë të Rabii ben Shimonit:

“Nëpër cilin kod të Trekëndëshit të Platonit-Sokrat zbriti Rabii ben Zakai deri tek tenda e gjeneralit roman?”

Vetëm pas kësaj pyetjeje Mark Sumi u përpëliti deri tek shterrimi i vetvetes së trishtë, tek fjalët sikur të qenë të huaja:

“Rabii Johanen ben Zakai në tendën e gjeneralit roman heq dorë nga atdheu, heq dorë nga tempulli. Kërkoi nga Roma t’ia lejojë themelimin e universitetit hebre në Diasporë”, - duke ia zgjatur Rabii ben Shimonit letrën e gjeneralit roman.

Në letrën e gjeneralit roman me shenja ogur (keq, mirë?) ishte shënuar: “Rabii Johanen ben Zakai erdhi tek tenda ime përmes *Code-3* të Trekëndëshit të Platonit-Sokrat.”

“*Code-3* i rrugës së Rabii Johanen ben Zakai le të kalojë nëpër mishin e këlyshit të Kones së Danielit të birit të Sebastianit, nëpër mishin e Djallit Mefisto, nëpër mishin e Insektit të Gregor Zanzës!” – e mundi trishtimi Rabii ben Shimonin. “Të

tri llojet e këtyre mishrave le t'i eksperimentojë Evropa në krematoriumet e saj laboratorike.

“Pse Margaritës sime t'i kutërbojë fustani mish këlyshi të Kones së Danielit?” – hyri në mallkimin e trishtë të Rabiit ben Shimonit e ëma e Margaritës së Doktor Faustit. “Margaritës sime do t'i shterojnë menstruacionet për ta pjellë kërthinin evropian mu në midis të Gjermanisë.”

Fytyra e shëndetshme e drejtorit kishte sharruar brenda kraharorit kur brenda u fut polici me një fëmijë përdore. polici e kishte ndarë mendjen t'i flasë drejtorit tepër ngutshëm:

“Mendova se ky fëmijë është ardhacak në shkollën tuaj meqë tri herë m'u vardisë t'i tregojë se në cilën anë është stacioni i trenit edhe pasi i thashë tri herë:

“Hiq dorë! Hiq dorë!” – u shfajësua polici.

“Është Mefistoja”, - shpjegoi drejtori.

“Fëmija kutërbon mish qeni!” – u çjerr e ëma e Margaritës.

“Ëshët arratisur nga teatri.”

“Mefistoja i stërngopur, një mijë vjet me vajtje-ardhje prej mishit të qenit në mishin e Djallit, ka vendosur të arratiset Shtegut të Oregonit, tek fillon Logosi biodemokratik i *Kodit-3*”, - paskësh thënë profesori vjenez.

Në midis të hidhërimit të profesori vjenez vrujoi hakërима shtjellore në rrugë duke u afruar drejt dyerve të shkollës. Gra, fëmijë, të gjithë po iknin para zallahisë të lemenritur nga trokëllima e përbindëshit.

“Është arratisur nga thertorja Lopa e Madhe”, - foli përngutshëm, krejt i përgjakur, njeri nga kasapët.

Krejt papritur u bë qetësi. Lopa e Madhe, tërfatëse, me plagën e hapur, shtangu në vend.

“Ku venë kështu të çakërditur plagësh?” – e pyeti Rabiit Johanen ben Zakai.

“U arratisa nga thertorja”, - u përgjigj nëpër vetveten e saj Mbretëresha Teutë.

“Mbase je ngutur.”

“Jo. Për të shtatën herë po më therin në të njëjtën thertore”, - u ankua Mbretëresha Teutë.

“Një mijë vjet, për engledisjet e Doktor Faustit, për çdo të dytën natë, nëpër teatrot e Evropës më kalojnë nga mishi i këlyshit të Kones së Danielit në mishin e Djallit Mefisto”, - u ankua Rabii.

Çurgu i gjakut po shtohet në plagën e Mbretëreshës Teutë kur Rabii Johanan ben Zakai e urdhëroi të shtrihet përtokë. Si e nemitur Mbretëresha Teutë u shtri në pellgun e vetvetes së gjakut drejt asaj dore duke e dëgjuar si nga larg:

“A të pushuan dhembjet e plagës?”

“Po”, - deshi të thotë Mbretëresha në hutimin e çastit.

“Eja të shëtisim drejt fushës”, - paskësh folur Rabii.

Fletët e tërfillit kalonin nën ta në një ëndërr të largët lot brohoritje fëmijësh, burrash e grashë.

Atje, në fund të ëndrrës Mbretëresha Teutë e pyeti:

“Pse shpërtheu gjithë kjo brohoritje?”

“Ata brohorisnin pse u shërove tei”, - shpjegoi Rabii ben Zakai.

“Po, ata, këtu e dy mijë vjet më therin në të njëjtën thertore. Pse sot t’i gëzohen shërimit tim?” – u shashtis Mbretëresha Teutë.

mbi tërfillin e dendur të fushës Rabii Johanan ben Zakai i propozoi Mbretëreshës Teutë:

“Po deshe mund të kthehemi ta shohim gëzimin e atyre njerëzve.”

“Po. Le të kthehemi!”

Nga lart e pamë grumbullin e njerëzve brohoritës. E panë konsiliumin e mjekëve duke e hapur prerjen cezareske në një kufomë.

“Kujt ia hapin atë prerje cezarieske me aq entuziazëm?” – pyetiu Mbretëresha.

“Po e hapin mitrën e kufomës tënde për ta mxjerrë kërthinin arketip.”

“Më paskan tradhtuar austriakët”, - u ankua Mbretëresha.

“Po deshe kthehu në kufomën tënde”, - i tha Rabii.

“Kurrsesi!” – protestoi Mbretëresha Teutë me lot në sy nga tymi i mishit të djegur.

“Po qan për plagën tënde apo për fëmijën tënd të parakohshëm arketip?” – e pyeti Rabii.

Mbretëresha Teutë deshi ta fshehë vajin në sytë e vet përtej lotëve valuk tek mishi i shpirti po ia lënin shëndenë njëri-tjetrit. Atje poshtë, shumë poshtë nën ta, fëmijë, gra, burra, të lakuriquar deri në asht po hynin truma-truma (trumba-trumba?) në krematoriumet evropiane. Tymi i mishit të djegur u ngrit fjollë drejt qiellit deri tek syri i përлотur i Mbretëreshës Teutë.

“të gjithë po i lirojnë nga mishi i tyre”, - i tha profesori vjenez hekurinës së Mbretëreshës Teutë të sjellë me kamion ushtarak nga Tirana.

“Ti bashkë me konsiliumin tënd mjekësor më keni tradhtuar në vitin një mijë e nëntëqind e pesëmbëdhjetë”, - e përбузи hekurina e Mbretëreshës Teutë profesori vjenez.

“Ne austriakët e bëmë prerjen cezarieske të mitrës për ta nxjerrë foshnjën tënde të ngujuar dy mijë vjet”, - arsyetoi profesori vjenez para hekurinës së Mbretëreshës Teutë, të sjellë nga Tirana tek rripi i ngushtë i kufirit Shqipëri-Kosovë.

“konsiliumi i mjekëve tuaj, austriakë, i vitit një mijë e nëntëqind e pesëmbëdhjetë e nxori foshnjën-kërthi nga mitra ime për t’ia hudhur në gojë hekurinës së ujqërve. Një kërthi arketip, i paaftë deri më sot, të mbijetojë nëpër shiun e bretkosave, foli hekurina e Mbretëreshës Teutë.

“Në vitin e largët një mijë e nëntëqind e pesëmbëdhjetë të gjitha mbretëreshat evropiane abortonin para konsiliumeve naziste, fashiste, komuniste...” - vazhdoi profesori.

“Çka do të ndodhte sonte, nën këtë shi bretkosash, Prillin e Ditës së Dytë, sikur foshnjën e Teutës kosovare ta braktiste Amerika, siç e braktiset ju austriakët kërthinin e Teutës së Shqipërisë?” – shfryu zemra e hekurinës së Mbretëreshës Teutë. “Ja, sonte më sollën nga Tirana, hipur në kamionin ushtarak, bashkë me gjeneralisimusin Josip Visioranoviç Xhungashvillin e me atë hekurinën e Skënderbeut për t’i mashtruar fëmijët e ardhshëm të Teutës kosovare.

“Konsiliumi i mjekëve austriakë, me prerje cezareske të mitrës sate e nxori foshnjën arketipe të pavarësisë shqiptare”, - profesori vjenez u bë sikur u hidhërua.

“Ç’pavarësi e Kosovës do të ishte kjo, nën këtë shi bretkosash, sikur sonte, Prillin e Ditës së Dytë, Amerika ta braktiste foshnjën e Teutës kosovare?” – shfryu zemra e hekurinës së Mbretëreshës Teutë.

Mërdhezja e fytyrës së gjeneralit italian ishte rritur kur ai në raportin ushtarak kishte shkruar:

“Sonte e sollën nga Tirana hekurinën e Mbretëreshës Teutë tek kufiri Shqipëri-Kosovë, kundruall Teutës kosovare. Atëherë cila paska qenë nata e Ambasadorit roman?”

Në fund e kishte shkruar provokueshëm atë fjalën emblematike *Quo vadis?*

Profesori vjenez u kthye ngutas kah përkthyesja italiane sikur po e shihte për të parën herë. Ende pa folur ajo, profesori i paskësh thënë asaj:

“Ambasadori roman sharroi në sytë e ftohtë të hekurinës së Mbretëreshës Teutë.”

“Mbretëresha Teutë po qëndronte para dyerve të Romës suaj të Dytë”, - i tha përkthyesja italiane duke ia përmendur profesorit vjenez vitin një mijë e nëntëqind e pesëmbëdhjetë.

...Natën e shtrëngatës së vitit një mijë e nëntëqind e pesëmbëdhjetë lajmëtarin e Mbretëreshës Teutë e ndaluan para dyerve të Vjenës deri tek feksi i parë i mëngjesit. Shiut i pjerrët i mëngjesit e sillte tek dritarja e dilizhansit të saj mbretëror urdhrin e Vjenës.

Buzë feksit të Prillit të Ditës së Dytë, tre vetë të mbështjellë me guna të zeza u afruan tek dritarja e dilizhansit të saj mbretëror. I pari nga të tretë e dha shenjën e përzier në shiun e pjerrët për ta kuptuar dikur në mesditën e Prillit të Ditës së Dytë.

“Shumë paska pritur Mbretëresha para dyerve të Vjenës”, - i tha i pari atij të dytit.

Shenja e atij të parit e grishi Mbretëreshën Teutë drejt dyerve të hapura të Vjenës. Eci e përgjumur nëpër galerinë e mugët kur u sos dita para një dere.

Mbretëreshës Teutë iu bë se e ulën në një divan të fortë ndaj derës gjysmë të hapur nga po i afrohej dritë gjysmë e zvetënuar.

Konsiliumit të mjekëve i prini era e ngutshme e morfinës.

Kryemjeku pyeti qetësisht:

“A do ta shpieni Mbretëreshën Teutë tek kryeministri?”

“Jo! Kryeministri do të vijë pasi të ketë kryerë punë konsiliumi mjekësor”, - u përgjigj ai tjetri.

“A do ta shpieni Mbretëreshën tek Sigmund Frojdi për ta konstatuar gjendjen e saj psikike?” – sërish pyeti kryemjeku.

“Jo! Ai e ka vizituar para gjashtë muajsh. Ka konstatuar se Mbretëresha Teutë mund ta lindë foshnjën me prerje cezarieske”, - shpejtoi të flasë ai tjetri.

“Do të thotë se foshnja arketipe e Mbretëreshës Teutë po mund të jetuaka në atë farë pavarësinë shkretinore të vendit të saj!” –

ndërhyri kryemjeku. “Unë them se foshnja arketipe e Mbretëreshës Teutë, jashtë klinikës austriake, do të regjohet deri tek stërkeqja.”

Brenda fustanit të mbështjellë rreth kokës së Mbretëreshës Teutë konsiliumi i mjekëve vjenezë e hodhi gjumin e dytë derisa u sos dita.

“Prerja cezarieske le të bëhet e ngushtë!” – urdhëroi kryemjeku.

“Për foshnjën e saj arketipe do të ketë çelje të mjaftueshme.”

Tek po e soste gjumin e dytë Mbretëresha Teutë ia çatisi kryeministri për t’ia uruar plagën e mabrë cezarieske, për t’ia uruar foshnjën arketipe, për t’ia uruar pavarësinë shkretinore. Mbretëreshën e gjeti ende të shtrirë në divanin e fortë, në cep të gjumit të dytë.

Ende pa i sosur të gjitha përgëzimet, kryeministri e dha shenjën për largimin e konsiliumit mjekësor tek e filloi bisedën.

“Senati roman ia lejoi Rabii Johanan ben Zakait themelimin e universitetit hebre në Diasporë. Senati i Romës së Dytë austriake ia lejoi Mbretëreshës Teutë pavarësinë e vendit të saj. Hebrenjtë mbetën në Diasporë...Mbretëresha do ta rritë foshnjën arketipe në vendin e saj.”

Pasi Mbretëresha Teutë, e mbushur lot, deshi ta shohë foshnjën e vet arketipe kryeministri austriak ia ndërpreu:

“Rabii Gamliel ben Shimoni, qysh në rini, i mëshehur në petkun roman u bë Tanaim. Cilin petk do ta vesh foshnja ime arketipe për t’u fshehur nga ujqërit e suferinës ballkano-aziatike?” – ankoj Mbretëresha Teutë në klinikën austriake.

“Tribali i Madh i Jerusalemit dezertorin Rabii Johanan ben Zakai e dënoi të ngujohet në mishin e këlyshit të Kones së Danielit, në mishin e Djallit Mefisto, në mishin e Insektit. Senati austriak nëpërmes prerjes cezarieske të mitrës sate të ngjuar dy mijë vjet shtazënie ta dhuroi foshnjën e parë

arketipe. Ai Rabii Johanan ben Zakai ende rrugëton nëpër tri lloje mishrash”, - triumfalisht foli kryeministri austriak.

Mbretëresha Teutë kishte heshtur gjithë kohën këtej fjalëve të kryeministrit austriak. Ai po e gjurmonte atë fjalën e vet në pergamenën e çantës së vet.

“Sa e paskemi pas harruar rrugën e gjatë të Mbretëreshës prej natës së Ambasadorit roman deri në Vjenë!” – i tha kryeministri ordinancës së vet.

Nëpër shiun e bretkosave Qepa e Madhe deshi të pyesë John Harkerin sa do të zgjasë rruga e Rabii Johanan ben Zakait nëpër mishin e këlyshit të Kones së Danielit, nëpër mishin e Djallit Mefisto, nëpër mishin e Insektit.

“Nëpër tri llojet e mishrave Rabii ben Zakai do të udhëtojë dy mijë vjet për të arriur deri te Shtegu i Oregonit, tek fillon Logosi biodemokratik”, - ndërhyri profesori vjenez.

Atëherë pse ju shmange takimit me Mbretëreshën Teutë tek viti një mijë e nëntëqind e pesëmbëdhjetë kur ajo erdhi në Vjenë, tek klinika jote psikanalitike?” – me hidëhrim prej gruaje e tundoj Qepa e Madhe Sigmund Frojdit.

“Në vitin një mijë e nëntëqind e pesëmbëdhjetë pllakëzat e vëna në kofshat e grave të reja treguan se për foshnjën arketipe të Mbretëreshës Teutë do të bëjë tepër ftohtë jashtë klinikës austriake”, - profesori vjenez tregoi aftësinë e vet mjekësore.

“Ju po flisni për Teutën kosovare”, - u hodh Qepa e Madhe.

“Më mashtrove”, - i foli Sigmund Frojdit nëpër shiun e bretkosave hekurina e Mbretëreshës Teutë të sjellë nga Tirana.

“Erdhet të gjithë austriakët të ma uroni plagën cezareske, të ma uroni foshnjën arketipe, të ma uroni pavarësinë shkretinore. Ja çka ka mbetur nga Mbretëresha Teutë! Ka mbetur vetëm kjo hekurinë.”

Tri vjet pas mashtimit të Mbretëreshës Teutë në Vjenë për plagën cezareske, për foshnjën arketipe, për pavarësinë

shkretinore, kapiteni i ushtrisë jugosllave u sorollat nëpër fushë, pas natës dehëse pa e gjetur rrugën e kazermës. Do të kishte bredhur edhe më i ëprhumbur sikur mos e zinin dy flakë pushke gjoksin e tij të mbushur me dekorata.

Plumbat e nxehtë në gjoksin e tij ende po hezitonin në cilën anë ta rrëzonin kapitenin kur në raportin e komisionit ushtarak ishte shënuar:

“Goditje e saktë. Meqë kapiteni u vra në oborrin e Mbretëreshës Teutë, asaj le t’i qepet mitra edhe për një mijë vjet!”

Përpara konsiliumit të mjekëve arriti kutërbimi i morfinës. Brenda fustanit të mbështjellë rreth kokës së Mbretëreshës u hodh gjumi i dytë. kur u sos dita kryemjeku urdhëroi:

“Le t’i qepet mitra edhe për një mijë vjet kësaj mbretëreshe! Atëherë do të bëhet vonë, shumë vonë.”

“Vonë, miku im. Shumë vonë ke ardhur”, - i tha vetvetes së tij Rabii Johanan ben Zakai nga mishi i këlyshit të Kones së Danielit.

“Po. Erdha, Rabii”, - ngurroi Jakovi i biri i Halevit.

“Sikur ta kishte vrarë mikun e vet Rabii Johanan ben Zakain në mishin e këlyshit të Kones së Danielit atëherë Jakovi, i biri i Halevit, do ta kishte vrarë kodin hebraik pa arritur kurrë tek Shtegu i Oregonit, tek fillon Logosi biodemokratik amerikan”, - foli Sigmund Frojdi duke e bërë rrugën e ikjes në pleqëri drejt Anglisë.

“Atëherë tek viti një mijë e nëntëqind e pesëmbëdhjetë pse më mashtrove duke në përgëzuar për foshnjën time arketipe, për pavarësinë time shkretinore kur ti, sot, në pleqërinë tënde po arratisesh nga klinika jote vjeneze”, - lotsyshëm e pyeti Sigmund Frojdin hekurina e Mbretëreshës Teutë, e sjell nga Tirana.

“Mua më janë sosur të gjitha kodet e udhëtimit evropian. Rabii Johanen ben Zakai po ushëton drejt Shtegut të Oregonit duke e ruajtur kodin hebraik nëpër tri lloje mishrash, gjithë rrugës i fshehur nga dhuna e kodeve të Platonit-Sokrat. John Harkeri e sosi rrugën nëpër mishin e Misrit, nëpër mishin e Bizanit, nëpër mishin e Indigenit tek Shtegu i Oregonit. Foshnja e Mbretëreshës Teutë po udhëtonte e fshehur nga kodet e Platonit-Sokrat nëpër mitrën e ngujuar drejt Shtegut të Oregonit, tek fillon Logosi biodemokratik”, - i ra në fund diskursit të vet profesori vjenez.

“Foshnja e cilës Teutë po udhëton drejt Shtegut të Oregonit?” – syvaj ndërhyri hekurina e Mbretëreshës Teutë në shiun e bretkosave.

Pasi heshti tek dëshpërimi i hekurinës së Mbretëreshës Teutë, të sjellë nga Tirana, Sigmund Frojdi e pa se në raportin e ushtrisë jugosllave shkruan:

“Në mbrëmjen e kuqe gjak, kapiteni i regjimentit tridhjetë e tetë rravgoi i përhumur fushës për ta gjetur derën e saj. Dikur vonë e zuri rezën e derës së Mbretëreshës Teutë kur dy flakë pushke e lëpin gjoksin e tij. Kapiteni i regjimentit tridhjetë e tetë në gjysmë të oborrit ende hezitoi kah cila anë të rrezohet.

Vrasësi i parë nga dritarja e saj e pyeti Mbretëreshën:

“Cilës nga të shtatë ushtritë perandorake i takoi ky oficer me hap kaq të përhumur nëpër oborrin tënd?”

Kapiteni i regjimentit tridhjetë e tetë, me plumbat valukë në gjoks ende po qëndronte në këmbë, edhe paasi koloneli e urdhëroi ordinancën e vet:

“Shkruaje në raport se kapiteni i regjimentit tridhjetë e tetë u vra në oborrin e Mbretëreshës Teutë!”

“Të dy goditjet qenkan tepër të sakta.”

Natën vonë, për të pestën herë në të njëjtin divan gjinekologjik, konsiliumi i mjekëve brenda fustanit të mbështjellë rreth kokës

së Mbretëreshës Teutë e hodhi gjumin e dytë tek arriti urdhrti ushtarak i kolonelit të regjimentit të tridhjetë e tetë të ushtrisë jugosllave:

“Kodi i menstruacioneve të kësaj kurve le të ngujohet në mitrën e saj derisa t’i pëlçasë barku!”

Derisa konsiliumi mjekësor i regjimentit tridhjetë e tetë të ushtrisë jugosllave po i ngujonte menstruacionet e Mbretëreshës Teutë në mitrën e saj, kolonel Mirk Iliçi i dha urdhër togës ushtarake:

“Sonte digjeni krejt çka mund të digjet. Sonte dua të ma sjellni ferrin në shuplakë të dorës!”

“Ti më mashtrove në gjumin e dytë tek viti një mijë e nëntëqind e pesëmbëdhjetë. Nga mitra ime e nxore foshnjën arketipe kur ti vetë po arratiseshe nga klinika jote psikiatrike. Patriotizmi evropian i kodit të Platonit-Sokrat çdo të dytën natë teatralisht e nxjerr Kësulëkuqen nga barku i ujkut”, - syvaj nën shiun e bretkosave mezi po i fliste Sigmund Frojdit hekurina e Mbretëreshës Teutë e posaardhur nga Tirana.

“Kur Evropës, pas shumë tentimesh dëshpëruese, i mbeti Kësulëkuqja në barkun e ujkut, Vilsoni, njeriu i rrugës së Bizonit, i rrugës së Misrit, i rrugës së Indigjenit nga Shtegu i Oregonit, nga fillon Logosi biodemokratik amerikan, ia çatisi tek klinika ime psikanalitike në Vjenë”, - sikur i foli dikujt përtej shiut të bretkosave Sigmund Frojdi.

“Ishte vonë, miku im. Ishte tepër vonë. Rabii Johanan ben Zakai ende po udhëton i fshehur nga kodi i Platonit-Sokrat. Ai po udhëton ende nëpër mishin e këlyshit të Kones së Danielit, nëpër mishin e Mefistos, nëpër mishin e Insektit”, - hekurina e Mbretëreshës Teutë i foli Sigmund Frojdit nga përtej shiut të bretkosave.

...Pas një muaji të plotë Jakovi, i biri i Halevit, ktheu në fshatin Abbi tek plevica e Danielit. Këtë herë Koneja e Danielit e priti

miqësisht Jakovin. Këlyshët e saj e shpërfillën Jakovin, përveç klyshit të bardhë me pikla të zeza. Ai e njohu mikun e vjetër.

“Erdhe më në fund, miku im Jakov?”

“Po. Erdha Rabii.”

“U vonove shumë, miku im”, - i tha zëri i vetvetes Rabii Johanen ben Zakait nga mishi i këlyshit të Kones së Danielit.

“Ditën e parë i pate sytë të mbyllur. Danieli mungoi atë ditë. Ja, sot erdha të të marrë, sipas marrëveshjes sonë, për të të hudhur në lumin Abbi”, - duke e zhbiruar shikimin e Kones së Danielit, foli Jakovi.

“Miku im Jakov, shko në shtëpi! Tashmë e kam zgjedhur rrugën e gjatë për t’u fshehur nga dhuna e kodit të Platonit-Sokrat . Tashmë Roma edhe pse ma premtoi universitetin hebraik në Diaspor po i gozhdon hebrejtë nëpër kryqa të drunjtë në fund të çjerrjeve puçiste: “Hosana Baraba!”

“E dëgjove Rabii Johanen ben Zakain?” – e pyeti Sigmund Frojdi hekurinën e Mbretëreshës Teutë.

...Në sytë e metaltë të hekurinës së Mbretëreshës Teutë, të sjellë nga Tirana, u bë shtrëngatë edhe për Plutarkun:

“Mbretëresha Teutë e paskësh mbytur Ambasadorin roman në ujin e ftohtë të syve. Në mëngjes komisioni ushtarak e mati Ambasadorin roman me kodin e Platonit-Sokrat nga dyert e Romës deri tek Senati.”

Pasi në fund të raportit ushtarak, për të gjitha rastet dymijëvjeçare, u shënuar ogur emblemantik: “Goditje e saktë”, me urdhrin e konsiliumit mjekësor Mbretëresha Teutë në fund të përgëzimeve për plagë të mbarë, për foshnjën arketipe, për pavarësinë shkretinore, brenda dilizhansit të saj me foshnjën arketipe në prehër, si grua e ve e braktisi klinikën vjeneze të Sigmund Frojdit drejt rrugëve ballkanike.

Në gjysmë të rrugës, tek filloi suferina, vetvetja e foshnjës arketipe zuri të flasë nga sytë e lotshëm të Mbretëreshës së vetmuar:

“Qenka ftohtë të dalësh nga ngujimi dymijëvjeçar në mitrën e nënës.”

...Fundit të natës së stuhishme të Ambasadorit roman pasi u sosën plagët teatrale të Cezarit-August e të Brutit-Kas, i dëgjova hapat e senatorëve romanë pasi më ngujuan në mitrën e nënës sime Mbretëreshë. Ngutshëm në mitrën e nënës sime, Mbretëreshës Teutë, e harruan shiun e Ambasadorit roman dhe reumatizmen e Plutarkut.

Shekujve të parë shiu i Ambasadorit roman dhe reumatizma e Plutarkut e shtynin njëri-tjetrin kah fundi i barkut të nënës sime. Pastaj Plutarku çufrak u mësua të shkruajë në të gjitha librat, në të gjitha gjuhët e perandorive. “Goditje e saktë!”

Qenka ftohtë të të nxjerrin me prerje cezarieske nga mitra e nënës, në klinikën vjeneze të Sigmund Frojdit, siç e nxjerrin çdo të dytën natë Kësulëkuqen nga barku i ujkut në atë përrallën arushake për fëmijët e parritur kurrë të Evropës.”

Hekurina e Mbretëreshës Teutë Prillin e Ditës së Dytë ndaloi tek rripi i ngushtë i kufirit Shqipëri-Kosovë, tek shiu i bretkosave e solli të ftohtit në mishin e njeriut. Mishi i turmës njerëzore u tkurr kur çizmja e kolonel Mirk Iliçit i shkeli në bishtin e saj. Aty, në kufirin Kosovë-Shqipëri po çmontohej skena e madhe e teatrit evropian për t’u montuar sërish tek ura T.

“Është bërë vonë. Sonte do të montohen tek ura T. të gjitha këto hekurina!” – bëri me dorë kolonel Mirk Iliçi kah Skënderbeu, kah Mbretëresha Teutë, kah gjeneralisimus Stalini, kah Migjeni...

hekurina e Migjenit sikur stepi në vend nga urdhri i beftë i gjeneralisimus Stalinit, kur iu drejtua:

“Të gjitha gazetat *Zëri i popullit* hudhini në këtë rrip toke; hudhini midis turmës! Le ta mësojnë njerëzit rrugën e socializmit të tyre!”

“Cilat gazeta do t’i qëndrojnë këtij shiu të bretkosave. Gjeneralisimus Stalini vetëm do ta lirojë dorën e tij të majtë remutike, të zënë ngushtë në dengun e gazetave *Zëri i popullit*, - e pyeti Bendisa të atin.

“këtu po ndodh teatri i madh evropian: po bëhen gjashtë net të gjumit të dytë të Kontit Mefisto në bodrumin e kështjellës së Doktor Faustit”, - i foli Bendisë i ati.

Ajo deshi ta kuptojë kush i foli vetvetes së saj në të gjitha orët e mësimin. Sa herë Teuta, me dhembje fundit të barkut, dilte jashtë klasës, profesorët e thonin atë reefrenin e përhershëm.

“kemi qenë gjithmonë të robëruar”, - pastaj koteshin në gjumin e fjalëve të veta.

Kur Bendisa për herë të parë e pa hekurinën e Mbretëreshës Teutë, të sjellë nga Tirana tek kufiri Kosovë-Shqipëri, deshi ta pyesë të jatin për foshnjën arketipe, të lindur me prerje cezarske në klinikën e Sigmund Frojdit në Vjenë.

Pas largimit të mjegullisë së Prillit të Ditës së Dytë, dielli i mbrëmjes i tregoi Bendisë se ende paskësh ditë. Ajo e gjurmoi të jatin nëpër llucën midis kufirit Kosovë-Shqipëri për t’ia dhënë sihariqin e shpëtimit.

Vonë u kujtua në atë gëzim të shtejlluar ëndërr, ta ndjejë dorën e djersitur të t’et të shndërruar në foshnjë arketipe. Pasi e zbuloi t’et në foshnjën arketipe, e përqafoi fort pas dy mijë vjetësh nëpër zërin e vetvetes së tij:

“Qenka ftohtë të dalësh nga mitra e ngujuar e nënës pas dy mijë vjetësh!”

Në fund të shiut të bretkosave qielli u zvar. Të gjithë e panë Prillit të Ditës së Dytë rrugën e ndritshme qiellore të raketës

Tomahok prej Shtegut të Oregonit, tek fillon Logosi biodemokratik e deri tek mitra e Mbretëreshës Teutë.

Nga zyra e OSCE-së doli brohoritja e pështjelluar e zërave të Teatrit evropian.

“Pse brohorasin të gjitha këto zëra të teatrove evropiane?” – pyeti zëri i vetvetes së t’et të Bendisë.

“se ti u shërove pas dy mijë vjetësh”, - i tha Bendisa.

“Se u shërova unë!” – mërmëriti i ati.

“Po.”

Hekurina e Mbretëreshës Teutë, e tharë nga dielli i mbrëmjes së Prillit të Ditës së Dytë, po rridhte lot nga gropat e syve të saj të hekurt.

“Pse qajnë sytë e hekurt të Mbretëreshës Teutë të sjellë nga Tirana?” – deshi të pyesë të atin Bendisa.

I ati mendoi se i paskësh thëhë të bijës së vet:

“Tek viti një mijë e nëntëqind e pesëmbëdhjetë Mbretëreshës Teutë, të sjellë nga Tirana, i bën prerje cezarieske tek klinika e Sigmund Frojdit. Në gjumin e dytë të Mbretëreshës, ia nxorën nga mitra e ngujuar foshnjën arketipe. Konsiliumi i mjekëve, kryeministri austriak....ia uruan plagën e mbarë, foshnjën arketipe ia uruan pavarësinë e Shqipërisë. Tek dyert e Vjenës e përcollën dilizhansin e saj mbretëror me foshnjën në prehër. Mbretëreshën llahus, më foshnjën arketipe në prehër, drejt suferinës ballkanike.

Në gjysmë të rrugës foshnja arketipe e ndjeu të ftohtit e suferinës. U çjerr nga vetvetja e mishit të Teutës.

“Qenka shumë ftohtë të dalësh pas dy mijë vjetësh ngujimi nga mitra e nënës!”

“A ke të ftohtë?” – e pyeti Mbretëresha Teutë foshnjën e saj arketipe.

“Po.”

“Po deshe kthehu në mitrën e nënës sate.”

“Jo! Kurrë më”

“Pse qanë me sytë e saj të hekurt hekurina e Mbretëreshës Teutë, e sjell nga Tiarana?” – e pyeti sërish të atin Bendisa.

“Sepse fishnja e saj arketipe mbeti xhuxhe e regjuar (rrëgjuar?) nga suferinat ballkanike”, - dhimbshëm i foli Bendisë foshnja arketipe e t’et.

“Po ç’do të ndodhë me foshnjën arketipe të Teutës kosovare të Prillit të Ditës së Dytë? Ajo sot e lindi foshnjën e saj arketipe pas dy mijë vjetësh shtatzënie të ngujuar në mitrën e saj.” Kureshtja e Bendisë bashkë me frikën e rritën pyetjen.

“Foshnja e Teutës kosovare ndodhi ta bëjë rrugën e ngjshme dymijëvjeçare të Rabii Johanan ben Zakait”, - foli zëri i vetvetes së t’et.

...Rrugës së diellit të Prillit të Ditës së Dytë, tek u sos shiu i bretkosave, Rabii Johanan ben Zakai zbriti nga kodi i Platonit-Sokrat të gjeneralit roman në Shtegun e Oregonit, tek fillon Logosi biodemokratik amerikan.

Rabii Johanan ben Zakai në fund të pritjes tek dera e gjyqit evropian e dëgjoi zërin e vetvetes së vet kur Nati Bumpo me dorën e butë e preku në stomak këlyshin e Kones së Danielit:

“Ku gjendesh tash?” – e pyeti Nati Bumpo Rabii Johanan ben Zakain.

“Tash gjendem brenda mishit të Djallit Mefisto të Doktor Faustit, në Teatrin e Berlinit”, - foli zëri i vetvetes së Rabii Johanan ben Zakait.

Nga kulisa e Teatrit të Berlinit, në aktin e dytë të *Faustit* të Jhohan Wolfgang Gëtes Nati Bumpo e zgjati dorën tek supet e ngrehurë të Mefistos:

“Ku gjendesh tash?” – për të dytën herë Nati Bumpo e tundoj Rabii Johanan ben Zakain.

“Tashmë gjendem brenda mishit të Insektit të Franc Kafkës”, - ishte zëri i vetvetes së Rabii Johanan ben Zakait. “Gjendem para dyerve të çelikut të Teatrit- krematorium të Berlinit.”

Nati Bumpo për të tretën herë e preku karrocën e Insektit të Franc Kafkës kur iu shfaq përpara Rabii Johanan ben Zakai duke menduar se të tri herat paskësh pasë biseduar me Jakovin, të birin e Halevit.

“Më tradhtove!” – deshi t’i thotë Jakovit përtej Nati Bumpos.

“Le të ecim Shtegut të Oregonit!” – i ofroi Nati Bumpo kur e pa se Rabii Johanan ben Zakai e ngatërroi me Jakovin, të birin e Halevit.

Posa u nisën Shtegut të Oregonit në Sanhedrinin e Jahnes u zhgreh kujë rrëqethëse.

“Pse po qajnë studentët e Sanhedrinit të Jahnes?” – u habit Rabii Johanan ben Zakai.

“Studentët e Sanhedrinit të Jahnes po qajnë pse ti u shërove nga mishi i këlyshit të Kones së Danielit, se u shërove nga mishi i Mefistos, se u shërove nga mishi i Insektit”, - Nati Bumpo u ngut t’ia shpjegojë pa u ngatërruar me Jakovin, të birin e Halevit.

”Po deshe kthehu në të tre mishrat.”

“Jo! Assesi!” – kundërshtoi Rabii Johanan ben Zakai.

E dëgjove Rabii Johanan ben Zakain se si kundërshtoi të kthehet në tre mishrat?” – erdhi zëri i foshnjës arketipe të Mbretëreshës Teutë.

“Po, e dëgjova.”

Në fund të shiut të bretkosave John Harkeri në ballë të konsiliumit të mjekëve amerikanë në zyrën e OSCE-së po e gjurmonte Mbretëreshën Teutë.

“Në cilin gjumë gjendet tashmë Mbretëresha?” – sikur e pyeti dikë.

Gjenerali italian e aktroi hutesën duke bërë me dorë andej nga hekurina e Mbretëreshës Teutë, të sjellë bashkë me gjeneralisimus Stalinin nga Tirana.

“Jo atë. Po e lyp gjumin e Teutës kosovare”, - e sqaroi John Harkerin.

“Ju po e kërkon Teutën e Justinianës së Dytë?” – kuptoi gjenerali italian.

“Po.”

Në Ministrinë e Brendshme të Perandorisë Evropiane konsiliumi i mjekëve amerikanë e zuri gjumin e dytë të Teutës kosovare. Pasi kryemjeku i konsiliumit amerikan e konstatoi shtatzëninë e ngujuar shtatë herë në mitrën e Teutës kosovare, përtej gjumit të dytë, e pyeti:

“”Në cilin gjumë gjindesh tash?”

“Tashmë kalova nga gjumi roman në gjumin bizantin”, - foli zëri i vetvetes së Teutës përtej gjumit të dytë.

Konsiliumi i mjekëve amerikanë para se ta pyesë vetveten e Teutës kosovare e mati kodin e gjumit bizantin në mitrën e saj. Ajo çdo periudhë do të pjellte po mos t’i hudhnin gjak hardhuce në mitër.

“Ku gjendesh tashmë?” – e pyeti sërishm konsiliumi i mjekëve amerikanë Teutën kosovare përtej gjumit të dytë.

“Sapo hyra në gjumin sllav.”

Tek fundi i gjumit të dytë bizantin kryemjeku i konsiliumit konstatoi se Mbretëresha, e fryrë mitrës, po hezitonte ku të pjellë: në gjumin bizantin, në gjumin sllav apo në gjumin otoman.

Të tretë, pa kursim i hudhnin gjak hardhuce në mitër.

Vetëm kodi i ruajtur në mitër, përtej shtatë gjakrave të hardhucës, sikur kodi hebre i Rabii Johanen ben Zakait i dhunuar nga kodi i Platonit-Sokrat, e shpuri Mbretëreshën tek

Shtegu i Oregonit, tek fillon Logosi biodemokratik”, - foli i ngazëllyer kryemjeku i konsiliumit amerikan.

Në fund të shiut të bretkosave, në diellin e zvetënuar të Prillit të Ditës së Dytë Bendisa e njohu Rabii Johanan ben Zakain. Turma e kosovarëve e kaloi rripin e ngushtë të kufirit Kosovë-Shqipëri pas Rabii Johanan ben Zakait, rrugës biblike, drejt Shtegut të Oregonit, tek fillon Logosi biodemokratik amerikan. Për një çast ndaloi i ati i Bendisës i mbështjellë nga tisi i mbrëmjes szvetënuar. Ai po mbahej nga dorë e djersitur e të bijës kur me përmallim e vështroi nga larg qytetin fantazmë.

Në hutimin e tij i tha Bendisës:

“Ishte ftohtë kur dola nga mirta e ngujuar dymijëvjeçare. Tashmë po ngrohem në inkubatorin e klinikës amerikane.”

Pas fjalëve të foshnjës arketipe të Teutës kosovare, hekurina e Mbretëreshës Teutë, e sjell nga Tirana, e rriti vrujimin e lotëve nga gropat e syve të hekurit.

...Në klinikën e Sigmund Frojdit, në vitin një mijë e nëntëqind e pesëmbëdhjetë, mungoi inkubatori për mbrojtjen e foshnjave arketipe. Mbretëresha Teutë, hipur në dilizhansin e saj mbretëror, me foshnjën e saj arketipe në prehër e braktisi Vjenën drejt suferinës ballkanike.

“A u rrit ndonjëherë foshnja arketipe e Mbretëreshës Teutë? Hekurina e saj, e mbushur mish bretkose, mish hardhuce...po vrujon lot nga gropat e syve të hekurit pranë gjithë atyre hekurinave të ndryshkura”, - erdhi zëri.

“Po me foshnjën e saj arketipe ç’u bë?” – pyeti Bendisa.

U bë heshtje midis krramës (kuakut të?) së bretkosave.

Tre tisorë: Bendisa me t’et duke e përcjellë Rabii Johanan ben Zakain, të mbështjellë nga mugëtira e mbrëmjes së dytë të Prillit, hypën në makinën e OSCE-së.

“Ditën e varrimit tim në mishin e këlyshit të Kones së Danielit kishte shumë lagështirë në Romë. Ra shi tërë natën e

Ambasadorit të kthyer nga Mbretëresha Teutë kur senatori dha urdhër ta lëshojnë brenda lajmëtarin e gjeneralit roman nga Judeja”, - tha Rabii Johanan ben Zakai posa hypën në makinën e OSCE-së.

U bë qetësi brenda makinës së OSCE-së.

“E di”, - ndërhyri Rabii Johanan ben Zakai sikur i foli dikujt.

“Po atë ditë të varrimit senatorët romanë u ngutën të hedhin mbi mua sa më shumë mish të këlyshit të Kones së Danielit. Ata u larguan ngutshëm. Mbetën vetëm hapat e ngadalshëm të Jakovit, të birit të Halevit.”

Bendisës iu bë sikur e dëgjoji Rabii Johanan ben Zakain kur e pyeti atë tjetrin, si duket të atin e saj të djersitur:

“Sa herë të kenë varrosur në mitrën e nënës tënde?”

“Shtatë herë më kanë varrosur në mitrën e nënës sime”, - e njohu Bendisa zërin e t’et brenda foshnjës arketipe.

“Shumë herë të kenë varrosur në mitrën e Mbretëreshës Teutë”, - e shprehu dhembjen Rabii.

“Sa keq është me të varrosur shpesh. Mua, nga këlyshi i Kones së Danielit, çdo të dytën natë më bënin gazi i botës nëpër teatrot-krematoriume të Evropës duke më varrosur herë në mishin e këlyshit të Kones së Danielit, herë në mishin e Mefistos.”

U bë qetësi brenda makinës së OSCE-së.

Bretkosat pasi e sosën shiun, e gjetën freskun nëpër barqet metalike të shtatoreve hekurina, përgjatë gjithë rrugës së makinave të OSCE-së.

Kutërbimi i mishit të bretkosave të ngordhura nëpër barqet e hekurinave shtatore ii bënte ushtarët e NATO-s të ruheshin gjatë ngarkimit të tyre nëpër kamionë ushtarakë.

“Në barkun e gjithë këtyre hekurinave të ndryshkura anash rrugës mishi historik i bretkosave, hardhucave,

insekteve...kutërbon epidemi ballkanike”, - shkroi në raportin e vet kryemjeku ushtarak.

“Mund të kenë ngordhur vetëm nga vapa”, - ndërhyri mjeku i dezinfektimit.

“Prerja cezarieske në mitrën e Mbretëreshës Teutë, në vitin një mijë e nëntëqind e pesëmbëdhjetë, tek klinika e Sigmund Frojdit, në Vjenë, konsiliumi i mjekëve e ka lënë të hapur. Në barkun e hekurinës së kësaj mbretëreshë kanë hyrë bretkosa, zhapinj, hardhuca, insekte...Foshnja e saj arketipe u atrofua”, - vazhdon raporti ushtarak.

“Dorën e majtë e paska pasur të paralizuar nga reumatizma!” – u tha ushtarëve kapiteni derisa po e ngarkonin në kamion hekurinën e gjeneralisimus Stalinit, pa e hetuar përkthyesen italiane pranë hekurinës së Mbretëreshës Teutë.

përkthyeses italiane i rrëshqiti zilia përposhtë fytyrës kur bisedoi me vetveten e saj:

“Si mund të ketë rënë Ambasadori roman në sytë e kësaj Mbretëreshë kutërbuese nga mishi i bretkosave të ngordhura!”

“I gjori Plutark.”

“I gjori Johan Volfgang Gëte”, - e barazoi zërin e vetes së vet Rabii Johanan ben Zakai. “Mishi i këlyshit të Kones së Danielit, mishi i Mefistos, mishi i Insektit, sa qenkan prishur për Teatrin e Berlinit!”

Kufomën e këlyshit të Kones së Danielit, kufomën e Mefistos, kufomën e Insektit, ushtarët e NATO-s po i ngarkonin në kamionë bashkë me hekurinat e Skënderbeut, të Mbretëreshës Teutë, të gjeneralisimus Stalinit...

Në fund të Shtegut të Oregonit, tek fillon Logosi biodemokratik amerikan, Rabii Johanan ben Zakai u tha kosovarëve të ekzodit biblik:

“Perdja ra. Teatri evropian i kodeve të Platonit-Sokrat u mbyll.”

një burrë tuberkular (tuberkuloz?) me një Bibël në dorë po lektiste ta kalojë lumin Hadson. Diçka, e keqe, teatrale, po e pengonte në librin e tij “Amerika”.

Rabii Johanan ben Zakai e urdhëroi Bendisën:

“Jepja për një çast Biblën tënde ta kalojë lumin Hadson Franc Kafka!”

Bendisa e dëgjoi zërin e t’et duke i thirrur:

“Disa! Disa!”

Ajo po qëndronte në aeroport, pak pa u nisur, me plot ushtarë të NATO-s.

Franc Kafka, duke marrë Bendisën për Ana Frankun, i tha:

“Teatri evropian i Platonit-Sokrat u sos. Perdja ra”.